

# **GJYKATA ADMINISTRATIVE DHE SISTEMI SHQIPTAR I DREJTËSISË**

Pranvera Xhafaj


Dorëzuar  
Universitetit European të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Drejtësi, me profil E Drejtë Publike, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku

Numri i fjalëve: 65’945

Tiranë, Shkurt 2016



## **DEKLARATË AUTORESIE**

*Nën përgjegjesinë time deklaroj se ky disertacion është shkruajtur prej meje dhe se nuk është prezantuar asnjëherë përpara një institucioni tjetër për vlerësim.*

*Punimi nuk përmban material të shkruar nga një person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.*

*Ky punim shkencor është paraqitur mbi bazën e kërkesave të Rregullores “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”.*

**© E drejta e autorit: Pranvera Xhafaj**

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjete apo forme pa lejen përkatëse me shkrim të autores.

## **Abstrakt (Shqip)**

Ky punim ka synuar të nxjerrë në pah nevojën e krijimit të një strukture të re gjyqësore, Gjykatës Administrative, e cila është e specializuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet me natyrë administrative që hasen shpesh midis administratës publike dhe subjekteve private.

Në punim është paraqitur një kornizë konceptuale e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të administratës publike dhe subjekteve private, në seksionet për zgjidhjen e çështjeve administrative pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe zgjidhjeve që ofron një organ i specializuar gjyqësor siç është Gjykata Administrative.

Po ashtu avantazhet dhe eficaenca që solli krijimi dhe vënia në punë e një Gjykate Administrative, janë paraqitur nëpërmjet përpunimit, analizimit të situatës aktuale dhe ligjit për Gjykatën Administrative. Gjithashtu, në punim është kombinuar analizimi i rezultatit të nxjerrë me legjislacionin aktual mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me natyrë administrative në Shqipëri.

Nëpërmjet këtij punimi është synuar pasqyrimi i gjendjes reale të futjes së kësaj hallke të veçantë në sistemin e drejtësisë. Ajo zgjidh mosmarrëveshjet me natyrë administrative mes administratës publike dhe subjekteve private, mosmarrëveshje të cilat janë konsideruar si shkak për krijimin e raporteve të vështira mes tyre.

Domosdoshmëria e krijimit të Gjykatës Administrative në legjislacionin shqiptar u kthye në një objektiv të pashmangshëm, me qëllimin e vetëm për të krijuar një klimë sa më të qetë për mbarëvajtjen e raporteve mes administratës publike dhe subjekteve private.

Po ashtu, ky punim ka synuar të shërbejë si një nxitje për të vlerësuar drejt nevojën dhe domosdoshmërinë për ekzistencën e Gjykatës Administrative, duke qenë se Shqipëria është vendi i fundit në rajon që ka implemetuar një gjykatë të tillë.

***Fjalët çelës:*** Gjykatë administrative, administratë publike, mosmarrëveshje administrative, subjekte private, legjislacion.

### **ABSTRACT (English)**

This dissertation aims to point out the need to establish a new the judicial structure, the Administrative Court, which will be specialized to settle disputes with administrative nature, that are often encountered between public organ/s and private entity/ies.

In the paper is presented a conceptual framework of previous proceedings for resolving disputes between organ/s and private entity/ies from administrative departments at district courts and solutions that will provide a specialized judicial body such as the Administrative Court.

The advantages and efficiency that has brought the establishment and functioning of the Administrative Court will be present through the process of current situation analyze, pursuant to the definitions made in Law No. 49/2012 "On the organization and functioning of administrative courts and adjudication of administrative disputes". Besides the abovementioned, this study contains analysis of the current legislation for settlement of administrative disputes in Albania.

One of the main goals of this study is to demonstrate the situation created by the functioning of a particular link in system of justice, which aims to resolve administrative disputes between public organ and private entities that are consider as cause for creating tough relations between those parties. The necessity of creation of the Administrative Court in Albanian legislation has become an imminent objective, with the sole purpose to create a calmer environment for the smooth running of relations between organ/s and private entity/ies.

*In addition, this paper aims to serve as an incentive to assess the need and necessity of the establishment of the Administrative Court, because Albania is the last country in the region that has implemented Administrative Court.*

*Key words:* Administrative Court, public organ, administrative disputes, private entities, legislation.

*Dritës së syve të mi . . .*

## **Mirënjohje...**

Punimi për mbrojtjen e disertacionit “*Gjykata Administrative në Republikën e Shqipërisë*”, nuk do të ishte bërë i mundur pa ndihmën e palodhur e të pa kursyer si dhe përkushtimit maksimal të Udhëheqëses time Shkencore, në të njëjtën kohë edhe drejtuese e Departamentit Publik të Fakultetit Juridik në Universitetin Europian të Tiranës, Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku, e cila në vazhdimësi më ka dhënë përkrahje në krijimin e ideve frytdhënëse dhe opinioneve të zgjeruara në lidhje me grumbullimin e materialit shkencor dhe mënyrës së shtjellimit të punimit.

Punimi nuk do të kishte dalë në dritë pa mbështetjen e vazhdueshme, udhëzimeve dhe këshillave profesionale të profesorëve gjatë gjithë fazave të punimit, që nga grumbullimi i materialit, konsultimeve të vazhdueshme dhe deri në fazën e strukturimit përfundimtar, prandaj këtë punim e konsideroj si produkt të përbashkët timin dhe udhëheqëses time shkencore Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku.

Njëheri, shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë profesorët e Fakultetit Juridik të Universitetit Europian për ndihmesën e madhe që na kanë ofruar në ngritjen tonë akademike.

Falënderime të tjera shkojnë për stafin e Gjykatës Administrative, prej të cilëve kam përfituar shumë njohuri në lidhje me zbatimin e ligjit të Gjykatës Administrative në Shqipëri, problematikat që hasen në zbatim dhe mënyrat e mundshme të zgjidhjes së tyre, në dobi të ligjshmërisë dhe mbrojtjes sa më mirë e të garantuar të të drejtave të qytetarëve.

Gjithashtu, kam rastin të falënderoj të gjithë ata nëpunës të Gjykatës Administrative me të cilët kam diskutuar në mënyrë të hapur e të sinqertë për mënyrën se si e shohin

sistemin e Gjyqësisë Administrative duke qenë pjesë e tij me anët pozitive e negative që e shoqëruan në vitin e pare e në vazhdim të zbatimit të këtij sistemi në Shqipëri.

Një falënderim të veçantë edhe për familjen dhe miqtë e mi, për qëndrimet koherente të shfaqura në përkrahje të realizimit të synimeve të mia profesionale. Faleminderit.

*Ejuaja, Pranvera.*



## **HIPOTEZA**

Ky studim fokusohet në ngritjen e hipotezës mbi problematikat e studimit.

Ngritja e hipotezës është bërë në funksion të dhënies së përgjigjeve të çështjeve të mëposhtme, të cilat përmbajnë koncepte të pyetjeve të hulumtuara nga ana teorike ashtu dhe nga ana praktike.

**HIPOTEZA: Krijimi i Gjykatave Administrative në Shqipëri krijon mundësi për një drejtësi administrative më efektive dhe eficiente në lidhje me zgjidhjen e konflikteve administrative dhe garanci më të mëdha për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të subjekteve në përballjen e tyre me administratën publike shqiptare.**

## **PYETJE KËRKIMORE**

1. Cilat janë risitë e drejtësisë administrative dhe krijimit të gjykatës administrative në Shqipëri?
2. Cili është impakti që solli në drejtësinë shqiptare krijimi i këtyre gjykatave?
3. A është legjislacioni kombëtar në këtë fushë në përputhje me *acquis communautaire*?
4. A krijon gjykata administrative mundësi për një proces gjyqësor më efektiv dhe çfarë problemesh evidentohen?
5. A është gjyqtari shqiptar i kualifikuar për struktura të tilla gjyqësore dhe çfarë kualifikimi/trajnimi nevojitet për gjyqtarët administrativë? Etj.

**PASQYRA E LENDES.....Faqe**

Hyrje.....1

A. Qëllimi i kërkimit shkencor.....1

B. Metodologjia.....1

C. Shkurtime.....4

D. Struktura e punimit.....5

E. Kufizimet e punimit.....10

F. Kontributi i studimit.....11

**KAPITULLI I**

**KUPTIMI DHE ZHVILLIMI HISTORIK I GJYKATES ADMINISTRATIVE**

1.1. Gjygjësia administrative në Shqipëri në vitet '45 – '90.....13

1.2. Gjygjësia administrative në Republikën e Shqipërisë pas viteve '90.....16

1.3. Zanafilla e Gjykatës Administrative dhe Struktura e saj.....19

1.4. Raporti mes procedimit administrativ dhe procesit gjyqësor.....23

**KAPITULLI II**

**DREJTËSIA ADMINISTRATIVE NË DISA VENDE TË EUROPËS**

2. Përvoja përkatëse në vendet e tjera Europiane.....42

2.1. Instalimi i Gjykatave Administrative në vendet e Bashkimit European.....51

2.2. Modelet e përziera.....53

2.3. Sistemet e drejtësisë administrative.....54

2.3.1. Sistemet e drejtësisë administrative në nivel global.....55

2.4. Standartet europiane në lidhje me gjykimin e akteve administrative.....58

|  |    |
|--|----|
| 2.5. Zgjidhja e konfliktit në Gjykatën Administrative..... | 63 |
|--|----|

### **KAPITULLI III**

#### **PARIMET E GJYKIMIT ADMINISTRATIV**

|  |    |
|--|----|
| 3. Parimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive të individëve.....        | 64 |
| 3.1. Pavarësia e Gjykatave Administrative.....                                     | 65 |
| 3.2. Llojet e pavarësisë.....  | 67 |
| 3.3. Parimi i mbrojtjes së interesave të ligjshme.....                             | 72 |
| 3.4. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor brenda afateve të arsyeshme..... | 73 |
| 3.5. Parimi i mospushimit të gjykimit nga mosparaqitja e palëve në proces.....     | 75 |
| 3.6. Parimet e gjykimit administrativ.....   | 77 |
| 3.6.1. Parimi i ligjshmërisë.....  | 78 |
| 3.6.2. Parimi i barazisë.....  | 79 |
| 3.6.3. Parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave..... | 80 |
| 3.6.4. Parimi i drejtësisë.....  | 81 |
| 3.6.5. Parimi i dëgjimit të palëve.....  | 82 |

### **KAPITULLI IV**

#### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE ADMINISTRATIVE**

|  |     |
|--|-----|
| 4.1. Ngritja e Gjykatës Administrative dhe pasojat e para në praktikë..... | 87  |
| 4.2. Efektet e gjykatave administrative mbi gjykatat e zakonshme.....      | 97  |
| 4.3. Organizimi i Gjykatës Administrative.....                             | 100 |
| 4.4. Statusi i gjyqtarëve.....   | 103 |
| 4.4.1. Emërimi i gjyqtarëve në Shqipëri.....                               | 106 |
| 4.4.2. Specializimi i gjyqtarëve.....                                      | 111 |

|  |     |
|--|-----|
| 4.4.3. Kriteret në përzgjedhjen e trupës së gjyqtarëve.....                            | 113 |
| 4.4.4. Masa e vlerësimit të gjyqtarëve.....  | 115 |
| 4.5. Kontrolli dhe procesi gjyqësor administrativ.....                                 | 117 |
| 4.6. Gjykimi administrativ në të tre shkallët.....                                     | 122 |
| 4.7. Gjykimi në Shkallë të Parë.....   | 123 |
| 4.8. Veprimet përgatitore gjatë fazës së gjykimit të çështjes.....                     | 124 |
| 4.9. Kryerja e ekspertimit.....  | 130 |
| 4.10. Sigurimi i padisë.....   | 132 |
| 4.11. Shqyrtimi gjyqësor.....  | 137 |
| 4.12. Veprimet paraprake.....  | 150 |
| 4.13. Gjykimi në mungesë.....  | 153 |
| 4.14. Marrja dhe paraqitja e provave.....  | 155 |
| 4.15. Barra e provës.....  | 159 |
| 4.16. Diskutimi përfundimtar.....  | 160 |
| 4.17. Marrja e vendimit përfundimtar.....  | 162 |
| 4.18. Publikimi i vendimeve gjyqësore.....   | 164 |
| 4.19. Ekzekutimi i vendimit.....   | 165 |
| 4.20. Veprime të tjera të gjykatës gjatë ekzekutimit të vendimit.....                  | 171 |
| 4.21. Gjykimi në Gjykatën e Apelit.....  | 173 |
| 4.22. Palët që mund të bëjnë ankim, forma dhe afati.....                               | 177 |
| 4.23. Shkaqet e apelit.....  | 180 |
| 4.24. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit.....       | 181 |
| 4.25. Veprimet procedurale gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të<br>Apelit..... | 183 |
| 4.26. Marrja e vendimit.....   | 185 |

|       |   |     |
|-------|---|-----|
| 4.27. | Gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.....             | 190 |
| 4.28. | Shkaqet e rekursit administrativ në Gjykatën e Lartë, forma, afati..... | 192 |
| 4.29. | Shqyrtimi në Gjykatën e Lartë.....                                      | 199 |
| 4.30. | Marrja e Vendimit Përfundimtar.....                                     | 203 |

## **KAPITULLI V**

### **PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE SUBJEKTET E SAJ**

|       |  |     |
|-------|--|-----|
| 5.    | Kuptimi i marrëdhënieve juridike procedurale administrative.....             | 207 |
| 5.1.  | Subjektet e marrëdhënieve juridike procedurale administrative.....           | 210 |
| 5.2.  | Gjykata Administrative.....  | 211 |
| 5.3.  | Subjektet ndihmëse që bëjnë pjesë në procedurën administrative.....          | 215 |
| 5.4.  | Përmbajtja e marrëdhënies juridike procedural administrative.....            | 216 |
| 5.5.  | Veprimet procedurale të subjekteve të procesit gjyqësor.....                 | 219 |
| 5.6.  | Kuptimi i palës.....   | 222 |
| 5.7.  | Kushtet për të qenë palë.....  | 224 |
| 5.8.  | Zotësia procedurale për të vepruar ose zotësia për të vepruar në proces..... | 226 |
| 5.9.  | Zotësia procedurale për të vepruar e personit juridik.....                   | 228 |
| 5.10. | Legjitimimi për të qenë palë.....  | 229 |
| 5.11. | Bashkëndërgjyqësia.....  | 231 |
| 5.12. | Të drejtat dhe detyrat procedurale të palëve.....                            | 233 |

## **KAPITULLI VI**

### **JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA**

#### ***Seksioni I***

|      |                            |     |
|------|----------------------------|-----|
| 6.1. | Juridiksioni gjyqësor..... | 235 |
|------|----------------------------|-----|

|  |            |
|--|------------|
| 6.2. Juridiksioni gjyqësor administrativ.....                              | 237        |
| 6.3. Kufijtë e juridiksionit administrativ.....                            | 239        |
| 6.4. Juridiksioni gjyqësor civil kundrejt juridiksionit administrativ..... | 240        |
| 6.5. Kundërshtimi i juridiksionit administrativ në procesin gjyqësor.....  | 242        |
| <b><i>Seksoni II</i></b>   |            |
| 6.6. Kuptimi i kompetencës.....  | 245        |
| 6.7. Kriteret e ndarjes së kompetencës.....                                | 248        |
| 6.8. Kompetenca duke iu referuar natyrës së çështjes.....                  | 250        |
| 6.9. Kompetenca tokësore ose territoriale.....                             | 252        |
| 6.10. Kundërshtimi i kompetencës.....                                      | 255        |
| 6.11. Kompetencat e gjyqtarit administrativ.....                           | 257        |
| <b>KONKLUZIONE.....</b>  | <b>259</b> |
| <b>REKOMANDIME.....</b>  | <b>279</b> |
| <b>BIBLIOGRAFIA.....</b>   | <b>281</b> |

## **HYRJE**

### **A. Qëllimi i kërkimit shkencor**

Ligji për Gjykatën Administrative dhe vet Gjykata Administrative në praktikë janë themeli i studimit.

Qëllimi i këtij ligji është reformimi i kuadrit ligjor administrativ në Shqipëri në funksion të reformës në drejtësi.

Qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Me anë të këtij ligji, synohet krijimi i kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cënuara nga veprimet dhe/apo aktet administrative të nxjerra nga organet publike.

### **B. Metodologjia**

Për të shkruar këtë punim janë ndjekur dhe ndërthurur disa metoda pune.

Kryesisht punimi është mbështetur në kërkime për materiale, artikuj, raporte, studime, strategji e projekte që lidhen me gjyqësinë administrative në Shqipëri, por jo vetëm, sipas metodës kërkimore *desktop based research*, pra kërkimi kompjuterik përmes internetit.

Për zhvillimin e këtij punimi shkencor kam pasur parasysh disa metoda kërkimi, si, ajo analitike, historike, përshkruese, krahasuese, shpjeguese, sintetike, statistikore dhe parashikuese dhe thujse të gjitha mund të gjenden të përziara në stilin e punimit.

*Metoda analitike* bazohet kryesisht në analizën e thellë të dispozitave ligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative. Janë shqyrtuar gjithashtu edhe vendimet unifikuese të Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë, Vendimet e Këshillit të Ministrave, etj...

*Metoda historike* është përdorur për të pasqyruar zhvillimin evolutiv të dispozitave për gjykatën administrative nga periudha tranzitore me Programet e Përgjithshme për gjykimin në seksione administrative të gjykatës civile, nga projekt-ligji dhe deri tek dispozitat aktuale të ligjit për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative në territorin e Republikës së Shqipërisë, në fuqi, si dhe proceset evoluese të përfaqësimit gjyqësor administrativ në sistemin e drejtësisë.

*Metoda përshkuese* e përdorur në këtë punim ka pasur si qëllim identifikimin e gjendjes aktuale të gjykatës administrative duke përshkruar në hollësi e në mënyrë eksplicite për shembull dispozitat për gjykimin administrativ, parimet mbi të cilat mbështetet gjykimi, fazat e gjykimit dhe vendimit, ekzekutimi i vendimeve, etj....

*Metoda krahasuese* është përdorur për të vënë përballë gjykatat administrative dhe zbatimin në praktikë në shtete të ndryshme me rregullimin e ndryshëm kombëtar.

*Metoda shpjeguese* është përdorur gjatë punimit për të sqaruar nevojën e instalimit të Gjykatave Administrative në territorin e Republikës së Shqipërisë, kalimi i kompetencës nga gjykata civile tek gjykatat administrative në lidhje me mosmarrëveshjet administrative, etj.

*Metoda sintetike* ka gjetur përdorim në disertacion për të sqaruar dukuritë e zbatimit të gjyqësisë administrative ose procedurat administrative të lehtësuara në kuadër të ligjit për Gjykatën Administrative.



*Metoda statistikore* është përdorur kryesisht për të dhënë fakte e shifra në lidhje me gjykimet e mosmarrvëshjeve administrative para instalimit të Gjykatave Administrative si dhe pas instalimit të tyre në sistemin gjyqësor etj.

*Metoda parashikuese* është në funksion të objektit të temës dhe është përdorur për të vlerësuar perspektivën e Gjykatave Administrative pas hyrjes në fuqi të ligjit për GJ.A.

Nga sa më sipër, do të theksoja se puna për përfundimin e punimit ka kaluar në tri faza kryesore, ku secilës prej tyre i korrespondon një metodologji e veçantë shkencore:

1) **Faza e parë** ka pasur kryesisht natyrë grumbullimi dhe seleksionimi të informacionit, kombinuar njëkohësisht me kërkim intensiv shkencor dhe sistemim të materialeve të vlerësuar si të rëndësishëm për punimin.

2) **Në fazën e dytë** vëmendja është përqendruar në hartimin e pjesës teorike të punimit, me fokus evidentimin e standarteve bashkëkohore, bazuar në punimet më të rëndësishme dhe dokumentet kryesore ndërkombëtare në fushën e gjyqësisë administrative. Kësaj faze i korrespondon një metodë studimi me karakter selektiv, empirik dhe përshkrues, kombinuar me disa nga shqetësimet dhe gjetjet më të rëndësishme në fushën e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar.

3) **Në fazën e tretë**, që është edhe faza më e rëndësishme e punimit, është trajtuar instalimi i Gjykatave Administrative, risitë që solli dhe kufizimet që hasi.

Sigurisht që metoda kryesore e përdorur në këtë fazë ka qenë ajo e sistemimit, krahasimit dhe analizës shkencore të jurisprudencës së Gjykatës Administrative, ligjit dhe VKM-ve në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative.

## **C. SHKURTIME**

**BE-** Bashkimi European

**KC-** Kodi Civil

**KEDNJ-** Konveta Europiane e të Drejtave të Njeriut

**KPrA-** Kodi i Procedurës Administrative

**KPrC-** Kodi i Procedurës Civile

**KLD-** Këshilli i Lartë i Drejtësisë

**OKB-** Organizata e Kombeve të Bashkuara

**GJED-** Gjykata Europiane e Drejtësisë

**LGJA-** Ligji për Gjykatën Administrative

## **D. STRUKTURA E PUNIMIT**

Punimi është strukturuar duke u ndarë në gjashtë kapituj.

*Në kapitullin e parë* është trajtuar një retrospektivë mbi Gjykatën Administrative duke analizuar të gjitha etapat e procesit administrativ ndër vite duke qenë kështu një vështrim historik i Gjyqësisë Administrative në Shqipëri. Është përpjekur që në këtë kapitull të bëhet një përshkrim i shkurtër i mënyrës së organizimit të sistemit gjyqësor administrativ në Shqipëri, që nga kohët e hershme, duke marrë si periudha referimi para dhe pas viteve '90, deri në momentin e miratimit të ligjit, duke specifikuar ato momente historike që kanë patur rëndësi në fushën e drejtësisë administrative.

Me pas është vijuar me shpjegimin e konceptit “*gjykatë administrative*”, nga e ka zanfillën, instalimi i saj në Republikën e Shqipërisë si dhe është analizuar struktura e saj në sistemin e drejtësisë shqiptare. Gjithashtu në këtë kapitull është parë si e nevojshme trajtimi i ndryshimeve të procesit administrativ dhe procesit gjyqësor, në mënyrë që të sqarohen disa koncepte bazë, të cilat ndihmojnë në qartësimin dhe moskonfondimin mes këtyre dy procedurave që në thelb duken e njëjta gjë por që në të vërtetë ndryshojnë esencialisht.

Në fund të kapitullit të parë janë shtjelluar në mënyrë të permbledhur propozimet e para si dhe vet projektligji mbi gjykatat administrative. Ai solli një reformë të re shumë të rëndësishme në pushtetin gjyqësor dhe sistemin e drejtësisë duke krijuar këte organ të posatsëm të specializuar për të mbrojtur sa më mirë interesat e subjekteve dhe duke rritur kështu efikasitetin e procesit të gjykimit administrativ.

*Në kapitullin e dytë* është trajtuar përvoja gjyqësore dhe eksperiencia e vendeve anëtare të Bashkimit European në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Administrative. Me qëllim që të përfitohet nga përvoja e tyre e pasur, do të merren si referencë vetëm vendet me më pak se 10 milionë banorë (për të qenë në koherencë me Shqipërinë e cila ka vetëm 3 milionë banorë dhe premisat organizative nuk janë të krahasueshme me vendet me një popullatë shumë të madhe).

Europianizimi i Gjykatave Administrative është një shenjë identifikimi me standartet që janë përqafuar nga një numër i madh i vendeve të Bashkimit Europian dhe që tashmë kanë zënë vend në legjislacionet e tyre. Në këtë kapitull është trajtuar, përpos vështrimit të përgjithshëm të gjykatave administrative në disa vende, analiza e Gjykatave Administrative sipas sitemit common law dhe civil law duke u fokusuar tek disa pika kryesore siç janë juridiksioni dhe kompetenca.

*Në kapitullin e tretë* janë trajtuar parimet mbi të cilat mbështetet procesi gjyqësor administrativ. Edhe pse në ligj janë parashikuar në mënyrë të kufizuar parimet mbi të cilat mbështetet një proces gjyqësor i rregullt administrativ, në këtë kapitull janë analizuar gjerësisht parimet kryesore si dhe janë zgjeruar në shtjellim duke kaluar kufijtë e vendosur nga ligji.

*Në kapitullin e katërt* është trajtuar organizimi, funksionimi dhe kuadri ligjor i Gjykatave Administrative në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kapitull është trajtuar ndarja territoriale e tyre, shpërndarja nëpër qarqe, vendodhja e tyre, numri i gjyqtarëve që gjykojnë dhe në mënyrë të veçantë është ndaluar të mënyra e zgjedhjes së gjyqtarëve administrativë, si, specializimi, emerimi, mandatet, konkurrimi, etj.

Më pas është vijuar me funksionimin e Gjykatës Administrative dhe pasojat e para në praktikë. Duke qenë se Gjykata Administrative është instaluar tani vonë nuk mund të flasim për një sistem gjyqësor të arrirë, por për një sistem që synon të perfeksionohet

dita ditës. Prandaj është menduar si e përshtatshme trajtimi i argumentave pro dhe kundër Gjykatave Administrative si dhe risitë që sjell ky ligj në krahasim me Kodin e Procedurës Administrative dhe Kodin e Procedurës Civile.

Në këtë kapitull është trajtuar gjykimi në të tre shkallët e Gjykatës Administrative, në Gjykatën e Shkallës Së Parë, Gjykatën e Apelit dhe së fundmi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Është bërë një analizë e përgjithshme e dispozitave ligjore për secilën fazë të gjykimit në të tre shkallët e Gjykatës Administrative, që nga paraqitja e padisë deri te dhënia e vendimit, nga ankimimi deri te rekursi si dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore si faza e fundit e procesit të rregullt ligjor.

Në të tre nivelet e gjykimit është trajtuar mënyra e dhënies së vendimit perfundimtar duke analizuar hollësisht secilën pikë të ligjit. Në mënyrë të përmblodhur mund të thuhet se secila hallkë e Gjyqësorit Administrativ mund të nxjerrë vet akt administrativ, mund të shfuqizojë tërësisht ose pjesërisht aktin administrativ, mund të ndryshojë pjesërisht ose tërësisht aktin administrativ ose mund të detyrojë organin publik për të ndryshuar aktin administrativ.

Në këtë kapitull është trajtuar ankimi administrativ si një mjet juridik shumë i rëndësishëm i kontrollit të ligjshmërisë së veprimtarisë

së organeve të administratës publike por edhe si një mjet për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të subjekteve të së drejtës si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Nëpërmjet këtij të fundit kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i aktit si dhe kundërshtohet refuzimi i paligjshëm i organit për të nxjerrë aktin. Nuk është lënë në harresë gjithë rruga gjyqësore që ndjekin palët për rivendosjen në vend të së drejtës së cënuar nga organi

administrativ. Së fundmi, me anë të këtij kapitulli, synohet t'i jepet një ndihmë, edhe pse modeste, në kuptimin dhe zbatimin sa më të drejtë dhe korrekt të dispozitave ekzistuese të ligjit, lidhur me mënyrën e zhvillimit të procesit gjyqësor administrativ, duke mos munguar gjithashtu mendimet dhe rekomandimet përkatëse.

*Në kapitullin e pestë* është trajtuar procedura administrative, marrëdhëniet juridike-procedurale administrative dhe subjektet e saj. Si fillim është dhënë përkufizimi i marrëdhënies procedurale administrative që krijohet ndërmjet palës së cënuar dhe organit publik, më pas është vijuar me subjektet e marrëdhënies juridike procedurale administrative, ku përvec palës aktive (paditëse) dhe pasive (të paditur) bëjnë pjesë edhe persona të tjerë të cilët kanë edhe ata rol kryesor në mbarëvajtjen e procesit gjyqësor administrativ. Një rëndësi të veçantë në këtë kapitull paraqet edhe përmbajtja e marrëdhënies juridike procedurale administrative si dhe kufijtë e kësaj përmbajtje në të gjitha hallkat e gjykimit.

Njëkohësisht janë trajtuar palët ndërgjyqëse në procesin gjyqësor administrative të para në disa koncepte të legjitimitetit të palëve, rëndësinë e tyre në procesin administrativ si dhe kushtet ligjore që këto subjekte duhet të gëzojnë. Gjithashtu është trajtuar roli i personave të tretë në procesin gjyqësor. Nga përkufizimi që i jepet palëve të procesit gjyqësor administrativ në ligj, kuptohet se:

- personi që i drejtohet gjykatës për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e një të drejte që pretendon se i është shkelur nga nxjerrja po mosnxjerrja e nje akti administrativ do të njihet si Paditës, dhe,
- organi publik që thirret në gjykatë për t'u përgjigjur se sipas personit që e thërret, ka mohuar ose ka shkelur një të drejtë të tij nëpërmjet akteve të nxjerra (paditësit), do të njihet si i paditur.

Kushtet e lidhura me legjitimitimin, zotësinë, të drejtat dhe detyrimet janë të sqaruara në mënyrë të hollësishme në vijim.

*Në kapitullin e gjashtë* është studiuar dhe hulumtuar rreth konceptit të kompetencës së gjykatave si dhe koncepteve të tjerë të së drejtës që lidhen me të. Ato janë parë si çështje të cilat gjithnjë e më shumë po bëhen pjesë diskutimi/debate mes juristëve dhe specialistëve të së drejtës kombëtare por edhe asaj ndërkombëtare. Njëkohësisht po trajtohen si prirje të reja në arenën ndërkombëtare për të kuptuar më mirë rëndësinë dhe problematikat që kanë paraqitur kompetenca dhe konceptet e tjera në sferën e shqyrtimit të çështjeve të ndryshme gjyqësore administrative në rrafshin kombëtar. Në këtë kapitull është paraqitur një panoramë e përgjithshme e konceptit të kompetencës, kuptimin dhe llojet e paraqitjes së këtij koncepti thelbësor në pranimin dhe shqyrtimin e një konflikti të kthyer në një çështje gjyqësore, ndikimin që ka përcaktimi i organit konkret që do e shqyrtojë atë. Një moment, shume evident dhe i prekshëm nga gjithësecili, i rëndësisë së konceptit të kompetencës, është zhvillimi i reformave të ndryshme në sistemin e drejtësisë si dhe organizimin e tij. Reforma të cilat kanë ardhur si pasojë e ndërhyrjeve thelbësore në legjislacionin tonë të brendshëm nën konsulencën dhe mbikqyerjen e autoriteteve përkatëse të Bashkimit Europian si dhe Organizmave Ndërkombëtare ku vendi ynë aderon ose aspirojnë të aderojnë. Në seksionin e dytë të këtij kapitulli është trajtuar juridiksioni i Gjykatave Administrative.

## **E. KUFIZIMET E PUNIMIT**

Cilido që do të përfshihej në një trajtim shkencor të gjyqësisë administrative, do të ishte i detyruar të trajtonte në mënyrë të përgjithshme, paraprakisht, kuptimin e gjykatave administrative në përgjithësi dhe të analizonte në mënyrë të detajuar kuadrin e vetëm ligjor mbi organizimin dhe funksionimin e këtyre gjykatave pasi literatura dhe praktika gjyqësore janë të kufizuara për shkak të instalimit të vonshëm të tyre në vendin tonë.

Procesi i shqyrtimit të gjykatave administrative ka si objekt një analizë të detajuar të legjislacionit shqiptar. Ky i fundit studiohet në përputhje me përafrimin e tij me të drejtën e Bashkimit European.

Me synimin për të mos qenë një punim tërësisht doktrinor, në mungesë të praktikës gjyqësore shqiptare, punimi i është referuar praktikës së paktë të Gjykatave Administrative dhe Gjykatës së Lartë, praktikë e cila ka shërbyer si mjet në funksion të sqarimit të koncepteve dhe aspekteve problematike të organizimit dhe funksionimit të gjykatave administrative.

Në përfundim, studimi ofron konkluzione dhe rekomandime të vlefshme e të dobishme jo vetëm për studiuesit e së drejtës, por dhe për strukturat shtetërore të përfshira në procesin e draftimit dhe hartimit të ligjeve e akteve nënligjore, të strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e individëve të prekur nga akti administrativ dhe mbikqyrjen e organit administrative por mbi të gjitha informim dhe ndërgjegjësim i palëve për të vënë në lëvizje çdo strukturë me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.



## **F. KONTRIBUTI I STUDIMIT**

Mendohet se ky studim sjell kontributet e veta nëpërmjet:

- Paraqitjes së literaturës, studimeve dhe kërkimeve të kryera në lidhje me Gjykatën Administrative, organ i cili ka filluar të aplikohet që në Nëntor të vitit 2013 në Shqipëri, sistemin e të cilit e kanë aplikuar ndër vite shtetet e Bashkimit European.
- Duke qenë se në vend ka shumë pak studime të kryera në lidhje me këtë fushë, shpresohet që ky studim të sjellë vërtet një kontribut të vlefshëm.
- Studimi paraqet një gjendje aktuale të gjyqësisë administrative, duke bërë të mundur vendosjen e bazave krahasuese për studime të mëtejshme në lidhje me këtë fushë.

Mendohet që rezultatet e këtij studimi mund të paraqesin interes për:

- Stafin akademik dhe studentët: si dokumentacion plotësues në kuadrin e përmirësimit të kurrikulave në lëndët e së drejtës administrative (vecanërisht në procesin gjyqësor administrativ dhe gjyqësinë administrative).

## **KAPITULLI I: KUPTIMI DHE ZHVILLIMI HISTORIK I**

### **GJYKATËS ADMINISTRATIVE**

Ky kapitull do të trajtojë nga pikëpamja teorike dhe historike procesin gjyqësor administrativ. Kjo analizë praktikisht është fokusuar në elementet historike të gjyqësisë administrative, aq edhe në analizën e realitetit që tentohet të ndryshohet, natyrisht me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave legjitime të subjekteve të së drejtës. Në fakt, historia e së Drejtes Administrative mund të shkruhet ndryshe edhe si një histori e autoritetit dhe mënyrës së ushtrimit të tij, të formave të ushtrimit të pushtetit dhe transformimet e tij.

Trajtimi i zhvillimit historik dhe teorik të gjyqësisë administrative në Shqipëri ka një efekt të dyfishtë. Nga njëra anë ai tenton të krijojë një panoramë të evolimit të këtij koncepti, që nga krijimi dhe deri sot, por nga ana tjetër ka për qëllim të parashtrojë vështrimin historic të procesit gjyqësor administrativ dhe kuadrit ligjor në mbështetje të tij. Studimi është fokusuar në tre periudha kohore, të cilat paraqesin rëndësi në mënyrë të veçantë në drejtim të zhvillimit të Gjykatës Administrative në Shqipëri.

## 1.1. Gjyqësia administrative në Shqipëri në vitet '45 - '90

Zbatimi i përkohshëm i legjislacionit osman dhe zëvendësimi i tij me një legjislacion kombëtar të përparuar ishin shtruar nga Qeveria Kombëtare e Vlorës në vitin 1912. Edhe në programin e Qeverisë demokratike të kryesuar nga F.S.Noli ishte parashikuar shprehimisht zgjidhja e shpejtë e kësaj detyre.

Por rrjedha e ngjarjeve të njohura që ndoqën njëra-tjetrën në jetën politike shqiptare pengoi në atë kohë realizimin e saj. Vetëm në periudhën nga viti 1925 deri në vitin 1932 u bë e mundur të vendosen themelet e legjislacionit të ri shqiptar, mbështetur në parimet e së drejtës europiane e sidomos legjislacionit italian dhe francez. Legjislacioni administrativ i kësaj periudhe nuk ka qenë i përmbledhur në një Kod të posaçëm, por përbëhej nga një numër i madh aktesh normative të këtij karakteri që ishin frymëzuar më së shumti nga legjislacioni italian.

Mund të themi së për "*procedimin administrativ*" ka filluar të flitet nga fundi i shekullit të kaluar, me qëllimin për të treguar tërësinë e akteve të nxjerra nga autoritetet administrative të lidhur midis tyre me një qëllim të vetëm. Në periudhën midis fundit të shekullit të XIX-të dhe fillimit të shekullit XX-të, u krijua një koncept më i ngushtë për procedimin administrativ. Kjo ka ardhur si rezultat i kuptimit që filloi t'i jepte jurisprudenca Gjykatave Administrative në vendet ku ka qënë e parashikuar ekzistenca e gjykatave të tilla.

Kontrolli gjyqësor që realizohej mbi organet e administratës shtetërore gjatë kësaj periudhe (pas çlirimit deri në vitet '90) u ul ndjeshëm. Kjo për arsyen e thjeshtë se ekzistonte një kontroll administrativ efektiv. Gjykata si një organ i posaçëm i

ngarkuar me dhënien e drejtësisë nuk investohej për të gjitha llojet e akteve, por vetëm një kategori e caktuar aktesh mund të ankimoheshin në gjykatë.

Konkretisht, ligji i posaçëm në bazë të të cilit dilte akti, e parashikonte shprehimisht një gjë të tillë. Pra, ankimi gjyqësor i aktit ishte një përjashtim. Kjo në fakt ka dhe një konotacion politik dhe natyrisht ishte i lidhur ngushtë dhe me sistemin e asaj kohe. Në Shqipëri ka filluar të flitet për procesin administrativ vetëm pas miratimit të Kodit të Procedurave Administrative. Në vitin 1999 nuk mund të konceptohej si një formë e vacantë pushteti fakti se subjektet e të drejtës, të cilët pretendonin shkelje, të kishin një mjet ankimi efektiv, që të garantonte mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.

Gjatë kësaj periudhe rastet e kontrollit gjyqësor të akteve administrative parashikoheshin shprehimisht nga akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore dhe nuk përcaktoheshin nga ndonjë kompetencë e përgjithshme e gjykatës në këtë fushë.

Gjykimet që kishin për objekt shqyrtimi “mosmarrëveshjet administrative” ishin:

- ✓ Korrigjimi i listave elektorale për gabimet në listat e zgjedhësve.
- ✓ Anullime të urdhrave të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit të Rrethit, në fushën e administrimit të fondit të banesave.
- ✓ Anullimi i vendimeve të komisionit për vlerësimin e pasurive të shpronësuar<sup>1</sup>.

Pra, siç konstatohet, analiza e elementeve proceduralë të veprimtarisë së organit nuk gjente vend në gjykimet administrative. Për sa i përket zhvillimit të legjislacionit

---

<sup>1</sup>Shih “E drejta Administrative e RPSSH”, Pjesa e përgjithshme, Dispensa III, Tiranë, 1984

lidhur me procesin administrativ në vendin tonë vërejmë se në periudhën 1945-1999, pra deri në momentin kur në vendin tonë është miratuar Kodi i Procedurave Administrative, nuk ka ekzistuar ligj i veçantë për procedimin administrativ.

Një gjë të tillë e vë në dukje autori i librit “*E Drejta Administrative*”, Jani Çomo, në botimin e vitit 1984, kur trajton “*Ndjekjen e procedurës ligjore për nxjerrjen e akteve administrative*”.<sup>2</sup>

Duke trajtuar momentet e nxjerrjes së aktit administrativ, janë analizuar çështje të tilla si motivimi i aktit, rregullsia e votimit në mbledhjet e organeve kolektive, momente këto që të lënë të kuptosh se pavarësisht se ka munguar ekzistenca e një ligji të posaçëm, i cili të rregullonte në mënyrë të shprehur momentet e procedimit administrativ, shpeshherë ligji në bazë të të cilit do të nxirrej akti kërkonte që nga organi të respektoheshin disa rregulla të domosdoshme. Këto rregulla kishin të bënin me tërheqjen e mendimit krijues të masave të gjera, shpalljen e projektit të aktit në disa raste për një periudhe kohe të caktuar, etj.<sup>3</sup>

Por, pavarësisht nga këto parashikime, shumë kërkesa të ligjit në atë periudhë kanë mbetur thjesht një utopi dhe literatura e autorëve të shquar të së drejtës dhe ajo çfarë përçonin këta të fundit tek studiuesit qëndronte shumë larg realitetit.

---

<sup>2</sup>Po aty.

<sup>3</sup> Po aty.

## 1.2. Gjyqësia administrative në Republikën e Shqipërisë pas viteve '90

Pas viteve '90, Shqipëria ndryshoi sistemin ekonomik, shoqëror dhe politik. Vendi kaloi në një sistem të ekonomisë së tregut, në të cilin shteti mori rolin e rregullatorit, d.m.th. vendos rregullat e lojës në këtë sistem dhe garanton zbatimin e Kushtetutës dhe të gjithë akteve normative në fuqi.

Me miratimin e Kodit të Procedurës Civile me ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996, kemi një realitet të ri në gjyqësorin shqiptar.

Në titullin e tretë të pjesës së dytë të tij (KPrCivile) u parashikuan “*Gjykimet e posaçme*”<sup>4</sup>.

Tashmë me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, atyre tregtare si dhe të atyre që lidhen me të miturit dhe familjen do të merreshin seksione të veçanta, të ngritura posaçërisht për gjykimin e këtyre mosmarrëveshjeve. Në kreun e dytë të këtij titulli u parashikua “*Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative*”, që përmbledhin rregulla të përgjithshme lidhur me gjykimin e këtyre mosmarrëveshjeve, etj.

Që nga ajo kohë, kur u krijuan seksionet administrative dhe deri më sot, gjyqësia administrative në Shqipëri është përballur me probleme të ndryshme. Në një mënyrë, këto probleme kanë qenë të lidhura me konsolidimin e këtij lloji gjykimi në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, në zhvillimin e së Drejtës Administrative në Shqipëri, një hap cilësor shënoi miratimi i Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative*”.

Kodi i Procedurave Administrative është një ligj kompleks, i cili rregullon shumë çështje duke filluar që nga sanksionimi i parimeve të cilat duhet të udhëheqin

---

<sup>4</sup> Ligji Nr. 8116, datë 29.03.1996

administratën publike, kompetencën dhe juridiksionin administrativ, mënyrën e garantimit të paanshmërisë në punën e administratës publike, procedimin administrativ në tërësinë e elementëve të tij, pjesëmarrjen e palëve të interesuara në procedim dhe rolin e tyre, parimin e administratës së hapur dhe të drejtën e informimit lidhur me një procedim administrativ e deri tek veprimtaria administrative, ku trajtohet gjerësisht akti administrativ, ekzekutimi i tij, etj. <sup>5</sup>

Nisur nga struktura e Kodit të Procedurave Administrative dhe përmbajtja normative, guxojmë të themi se Kodi ynë përmbush standartet e një ligji bashkëkohor. Gjithsesi, zbatueshmëria mbetet një sfidë, sepse në rast se nga ana e organeve të administratës do të zbatoheshin me rigorozitet dispozitat e këtij kodi, standartet e mirëqeverisjes në vendin tonë do të ishin të dukshme. Përvojat e para me gjykimin administrativ, flasin se ajo nga pikëpamja organizative u instalua në tri mënyra, sa i përket bartësve të saj:

- A. Gjyqësia administrative nëpërmjet organeve të administratës.
- B. Gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave të rregullta.
- C. Gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave të veçanta administrative.

Këto tri mënyra të instalimit të gjykimit administrativ instaluan tri sisteme të zgjidhjes së konfliktit administrativ<sup>6</sup>.

Gjyqësia administrative nëpërmjet vetë organeve të administratës, në parim, nuk u pa si një mundësi e mirë, sepse duke e ushtruar këtë lloj të kontrollit, ajo, në fakt, bëhej “*gjyqtar në çështjen e vet*” dhe, për pasojë, pavarësia dhe objektiviteti viheshin në

---

<sup>5</sup> Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative*”

<sup>6</sup> Me gjerësisht: Esat Stavileci, Hyrje në shkencat administrative, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997

pikëpyetje. Prandaj, mënyrat më të mira të instalimit organizativ të gjyqësisë administrative mbeten gjykatat e rregullta dhe gjykatat e veçanta administrative.

Mënyra e dytë e instalimit organizativ të gjyqësisë administrative, ajo nëpërmjet gjykatave të rregullta, në literaturë, përgjithësisht është e njohur si sistem anglosakson, për shkakun se lindja e saj lidhet me Britaninë e Madhe, por edhe me kolonitë e dikurshme të saj, veçanërisht me SHBA. Por, gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave të rregullta u përhap edhe në vendet e ndryshme skandinave në rend të parë në Danimarkë dhe Norvegji.

Komponentja nisëse e vendosjes së gjyqësisë administrative nëpërmjet gjykatave të rregullta ishte vetë e drejta britanike, e “frymëzuar nga ideja e së drejtës së përgjithshme” (Common Law) që përfaqëson një sistem të përbashkët (unik) të normave si dhe e parimeve juridike ndaj të cilave nuk vepron vetëm individi por edhe pushteti publik.

Vlen të përmendet se sistemi britanik dhe ai amerikan nuk dallojnë në parim, po sikurse që vlen të theksohet se, përveç gjykatave të rregullta, mbrojtja juridike realizohet edhe nëpërmjet “*administrative tribunals*” (gjykatave administrative) që, si rregull, themelohen *ad hoc*, për fusha të ndryshme të veprimtarisë së administratës.



### **1.3. Zanafilla e Gjykatës Administrative dhe struktura e saj**

Zhvillimi i shtetit të së drejtës shtroi si nevojë imediate vendosjen e modelit të mbikëqyrjes administrative i cili, si paragjykohej, do të duhej të siguronte “mbrojtje të gjerë juridike” në fushën e veprimtarisë administrative. Mendohej se ky mision do të mund të arrihej nëse bartës i mbikëqyrjes do të bëhej ndonjë trup i veçantë, pavarësia dhe autoriteti i të cilit do të siguronin që administrata në veprimtarinë e vet të sillej në kuadër të normave juridike të së drejtës pozitive. Kërkesa për instalimin e gjyqësisë administrative nëpërmjet gjykatave administrative u mbështet në një numër faktesh, ndër të cilët u theksua veçanërisht ai se gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave administrative paraqet një formë e mënyrë shumë adekuate të mbrojtjes juridike, qoftë për shkak të profesionalitetit, qoftë për shkak të pavarësisë së tyre organizative. Natyrshëm që mbi këtë dhe mbi një numër faktesh të tjera, Bashkimi Europian i dha një rëndësi të madhe gjyqësisë administrative.

Duket se dy momente janë me ndikim për rëndësinë që Bashkimi Europian i jep gjykatave administrative.

Së pari, shkakun se “pjesa më e madhe e së drejtës përgjithësisht gjindet në kompetencën e gjykatave administrative”.

Së dyti, për shkakun se vet “Bashkimi Europian i jep rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së interesit publik”.

Në Shqipëri janë bërë përpjekje për “t’u afruar” me Europën në fushën e legjislacionit, janë studiuar mundësitë e përshtatjes institucionale me përvojat e vendeve anëtare të Bashkimit Europian, është hapur procesi i reformave në fushën e gjyqësisë dhe “është ndjerë nevoja” që të shqyrtohet mundësia e instalimit të gjyqësisë administrative nëpërmjet themelimit dhe funksionimit të gjykatave administrative si gjykata të specializuara. Janë shfaqur perceptime të reja edhe në lidhje me “kufijtë e

ligjshmërisë” që do të thotë se dallimet në mes ligjshmërisë dhe të drejtës diskreciale “reflektojnë se nuk ekzistojnë më vendime tërësisht diskreciale”.

Ligji për ngritjen e Gjykatës Administrative e ka zanafillën që në vitin 2008. Ndërsa që prej vitit 2009, drafti qëndroi në Kuvend për shkak të ngërçit politik, ndërsa u votua me konsensus të plotë para zgjedhjeve të qershorit 2013 dhe tashmë pas propozimit të Ministrit të Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë u vendos çelja e Gjykatës Administrative më datë 4 nëntor të po atij viti (2013).

Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe miratuar strukturat dhe organikat e reja të gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve, përfshirë edhe strukturat e 7 gjykatave administrative. Kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ, që funksionon mirë, është një forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj dhe si pasojë, rritjen e besimit të qytetarëve për institucionet shtetërore. Pa pretenduar që të bëj zbërthimin në hollësi, po theksoj disa prej mundësive të gjyqësisë administrative.

- ✓ **Së pari**, “ndikimin në rritje” të kontrollit gjyqësor të organeve publike që shihet me shumë interes në gjyqësinë administrative.
- ✓ **Së dyti**, ndërtimin edhe të një modeli të veçantë të kontrollit gjyqësor me qëllim parësor zgjerimin dhe forcimin e tij.
- ✓ **Së treti**, shtrirjen e ndikimit të parimit të ndarjes së pushteteve në vëllimin e kontrollit gjyqësor që shihet me shumë interes në proceset e demokratizimit të shoqërisë.
- ✓ **Së katërti**, garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve me qëllim parësor sigurimin dhe forcimin e parimit të ligjshmërisë në gjyqësinë administrative.

Nga më shumë përparësi të gjyqësisë administrative, do të përmendim vetëm disa prej tyre, sërisht pa pretenduar zbërthimin e hollësishëm i cili do behet në krerët e mëposhtëm.

Në radhë të parë dhe para së gjithash, do të theksoja përparësinë e gjyqësisë administrative në “demokratizimin e sistemit gjyqësor”.

Një përparësi tjetër të gjyqësisë administrative përbën “ndarja funksionale e saj nga sistemi i gjykatave të kompetencës së përgjithshme”. Përparësi më vete e gjyqësisë administrative është edhe “rritja e besimit” të qytetarëve dhe të opinionit publik në punën e ligjshme të administratës.

Më në fund, përparësi e gjyqësisë administrative është edhe mbrojtja e shtetasve nga “arbitrariteti i administratës”.

Natyrisht, do të mund të bëhej fjalë edhe për favore të tjera të gjyqësië administrative.

Pa i rradhitur sipas rëndësisë që kanë ose që mund të kenë, këto favore të gjyqësisë administrative duhen parë si mundësi më shumë për:

- A. Specializimin
- B. Zgjidhjen më të plotë të konflikteve
- C. Rolin krijues të gjykatave administrative në zhvillimin e së drejtës administrative.

Gjykimi administrativ nëpërmjet gjykatave administrative ka dhe një përparësi shumë të veçantë. Ajo shprehet në kompetencat e gjykatave administrative.

Ç’është e vërteta, “gjykatat administrative kanë kompetenca të plota, jo vetëm në zbatimin e ligjit por edhe në vërtetimin e fakteve”. Pra, praktika e gjykatave administrative është e ndryshme. Në disa prej vendeve me gjyqësi të zhvilluar administrative, kontrolli i gjykatave përqëndrohet në çështjen se a është nxjerrë

vendimi i drejtë. Në disa vende të tjera, përqëndrimi i kontrollit të gjykatave administrative bëhet në të vërtetën materiale dhe në gjetjen e saj.

#### **1.4. Raporti mes procedimit administrativ dhe procesit gjyqësor**

Për “procedimin administrativ” ka filluar të flitet nga fundi i shekullit të kaluar, me qëllim për të treguar tërësinë e akteve të nxjerra nga autoritetet administrative të lidhur midis tyre. Në periudhën midis fundit të shekullit të XIX-të dhe fillimit të shek. XX-të, u krijua një koncept më i ngushtë për procedimin administrativ. Kjo ka ardhur si rezultat i kuptimit që filloi t’i jepte jurisprudenca Gjykatave Administrative në vendet ku ka qënë e parashikuar ekzistenca e gjykatave të tilla.

Ky zhvillim erdhi për shkak se vet praktika e këtyre gjykatave nxorri një varg pikëpyetjesh në lidhje me procedimin administrativ, si p.sh., a është e mundur të kundërshtohen në gjykatë mendimet apo opinionet e dhëna gjatë nxjerrjes së një akti, apo një përcaktim a propozim i bërë para se organi administrativ të dalë me një akt përfundimtar për çështjen? Përgjigja e dhënë nga gjykatësit gjatë shqyrtimit të çështjes ishte negative. Arsytimi i dhënë ishte që akte të tilla janë ndihmëse për nxjerrjen e një akti përfundimtar dhe nuk prodhojnë pasoja juridike të cilat mund të çojnë në humbjen, cënimin apo fitimin e një të drejte.

Efekte të tilla do të sjellin vetëm aktet administrative përfundimtare, aktet e tjera do të ndihmojnë në nxjerrjen e një akti përfundimtar sa më të drejtë<sup>7</sup>.

Si pasojë, më vonë, procedimi administrativ filloi të konceptohej si një seancë ku ballafaqohen mendime dhe opinione, seancë e cila përfundon me nxjerrjen e një akti i konsideruar si kryesor, i cili natyrisht paraprihet nga akte të tjerë në funksion të aktit kryesor.<sup>8</sup>

---

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Po aty

Është e kuptueshme se nxjerrja e një akti administrativ shoqërohet nga një tërësi aktesh, faktesh dhe veprimtarish, të lidhura me njëra tjetrën, që konkurrojnë me njëra-tjetrën në tërësinë e tyre për nxjerrjen e aktit final.

Duke patur parasysh se e Drejta Administrative është një degë e së Drejtës Publike, mund të themi se procedimi administrativ ekziston pasi një tërësi kërkesash dhe karakteristikash të së Drejtës Publike e imponojnë këtë gjë. Ndër këto mund të përmendim:

- a. mundësinë për të nxjerrë në pah zgjedhjen e bërë nga administrata përballë interesit publik, i cili duhet të jetë primar për këtë të fundit,
- b. rëndësia për të përvijuar rrethanat e nxjerrjes së aktit dhe, për faktin tjetër, se nga ana e gjykatës administrativ (në ato vende ku ekzistojnë Gjykatat Administrative) nuk shikohet vetëm zgjidhja finale por dhe rrethanat e nxjerrjes së aktit, që nënkuptohet ndryshe si ana faktike e nxjerrjes së aktit.
- c. ekzistencën e marrëdhënies juridike administrative, subjekt i së cilës është administrata gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj,
- d. domosdoshmërinë për të evidentuar se zgjedhja e bërë prej saj është ajo që ka më përparësi se të tjerat, sidomos në rastet kur administrata ushtron pushtet diskrecional.

Për këtë qëllim, nga procedimi arrin të evidentohen më së miri interesat që lidhen me çështjen, vlerësimi i rëndësisë së këtyre interesave si dhe fakti tjetër që gjatë procedimit individët kanë mundësi të parashtrojnë opsionet e tyre në lidhje me çështjen në diskutim. Formimi i nocionit të “procedimit administrativ” ka ndjekur një rrugë të gjatë që nga momenti i lindjes dhe deri sa ai është konsoliduar në konceptin bashkëkohor të tij, të tërësisë së veprimeve dhe akteve të nxjerra nga organi

administrativ me qëllim nxjerrjen e një akti administrativ përfundimtar sa më të drejtë dhe oportun.

Ajo çfarë konstatohet nga dispozitat e K.Pr.Adm. është pikërisht fakti i detajimit të procedurës në elemente të cilët i gjejmë gjatë procesit gjyqësor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Bëhet fjalë këtu për identifikimin e palëve të interesuara, rolin aktiv të tyre gjatë procedimit, të drejtën e paraqitjes së provave, të marrjes së ekspertëve si dhe të drejtën e dëgjimit si një ndër garancitë e procesit të rregullt ligjor. Dy ekstremitetet, pra procedimi administrativ dhe procesi gjyqësor kanë një marrëdhënie të ndërsjellë çka nënkupton që zhvillimi i njëres gjeneron produktin e tjetres dhe anasjellas.

Praktikisht sistemi ynë, si ai që kishim dhe ky aktual, i krijuar me miratimin e Ligjit “Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, është ndërtuar sipas konceptit klasik të tipit separatist. Kjo do të thotë se procedimi administrativ dhe procesi gjyqësor janë në kuptimin figurativ dy “botë” të ndryshme, të ndara në mënyrë të pastër nga njëra-tjetra.

Pra, secila prej tyre ka rregullat e saj në rregullimin e raporteve midis qytetarëve dhe administratës publike dhe natyrisht qëllime specifike të ndryshme.

Në një procedim administrativ marrin pjesë subjektet si dhe organi i administratës publike që do të nxjerrë aktin final. Ndërkohë që në një proces gjyqësor, përveç organit të administratës publike ekzistojnë dhe subjekte të tjera, të cilat kanë dhe mbrojnë interesa të ndryshme nga ai i organit të administratës. Juridiksioni gjyqësor mund të ushtrohet në formën e procedimit administrativ dhe anasjellas.

Pra, funksioni administrativ mund të ushtrohet duke ndërhyrë në përmbajtjen e aktit por dhe mbi subjektet të cilat mbrojnë interesat e tyre individuale<sup>9</sup>.

Sa më i gjerë dhe sa më cilësor të jetë kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë administrative, aq më pak i nevojshëm është disiplinimi i administratës me forma gjyqësore dhe, e kundërta, aty ku sigurohet një kontroll i kufizuar gjyqësor, procedimi administrativ duhet të formalizohet dhe të detajohet si një proces gjyqësor.

Vendi ynë aktualisht ka një procedim administrativ i cili përbëhet nga elemente të spikatur të procesit gjyqësor. Në këtë rast bëhet fjalë për dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, por organet gjatë nxjerrjes së aktit realisht bazohen në ligjet e posaçme. Shumica e këtyre ligjeve nuk e detajon procedurën administrative në elementet e parashikuara në Kod dhe rrallëherë zbatohen dispozitat e Kodit si element plotësues procedural i detyrueshëm për t'u zbatuar.

Procedimi Administrativ, i kuptuar si forma tipike e ushtrimit të veprimtarisë administrative, kjo sipas idesë antike të Feliciano Benvenuti, është në njëfarë mënyre i karakterizuar nga ana materiale nga elementë kushtetues si dhe nga të drejta të cilat garantohen në nivel kushtetues. Megjithatë, nuk mund të lëmë pa përmendur faktin që, nga njëra anë procedimi tenton të prekë në mënyrë të menjëhershme të drejtat e individëve dhe, nga ana tjetër, ka për qëllim të mbrojë interesin publik.

Pra, procedimi i tejkalon kufijtë tekniko-juridikë dhe merr një vlerë të lartë kushtetuese. Kjo për arsye se kemi një bashkëjetesë të qartë të dy koncepteve

---

<sup>9</sup> F. Benvenuti, *Funzione amministrativa, procedimento, processo*, në Revistën e të Drejtës Publike, 1952, faqe 135.



“autoritet” dhe “e drejtë”, i cili ekziston në çdo marrëdhënie të organit të administratës publike<sup>10</sup>.

Për të bërë një lidhje të drejtëpërdrejtë midis rëndësisë së procedimit administrativ gjatë kontrollit gjyqësor të aktit administrativ është e rëndësishme të theksojmë se cili është kuptimi që duhet të kemi në për atë që arrihet nëpërmjet sistemit gjyqësor.

Sipas konceptit të ngushtë që ne kemi për drejtësinë, një procedim administrativ mund të konsiderohet i drejtë dhe për pasojë akti administrativ do të konsiderohet i ligjshëm nëse organi ka respektuar të drejtën pozitive të lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me të drejtën e pretenduar të shkelur nga organi.

Ndërkohë, në një koncept më të gjerë të procedimit do të ishim para një procedimi të drejtë nëse drejtësia nuk ekziston por realizohet në një tension të vazhdueshëm drejt qëllimit final përmes procedimit administrativ.

Në rastin e parë, kemi të bëjmë vetëm me analizë të interesave të bëra prezente në fillim të procedimit dhe në rastin e dytë procedimi bën të mundur vlerësimin objektiv të vendimit nëpërmjet metodës së drejtësisë përmes përballjes dhe krahasimit të interesave të cilat dalin në pah në rastin konkret<sup>11</sup>.

Në një studim të kryqëzuar midis procesit gjyqësor dhe atij administrativ, skema e teorisë së përgjithshme na ka mësuar që procesi gjyqësor është një procedim, që do të thotë një tërësi normash, aktesh dhe situatash juridike të lidhura me njëra –tjetrën, në të cilin janë të aftë të marrin pjesë dhe ata të cilëve akti final që do të dalë mund t’u

---

<sup>10</sup> Mbi procedurën si formë për vetëkufizim të administratës publike dhe natyrisht lidhur me pasojën që vjen nga mungesa e procedurës në raport me mungesën në respektimin e të drejtave kanë shkruar ndër të tjerë përkatësisht F. Benvenuti dhe gjithashtu përmendim veprën e autorit G. Pastori, *Introduzione alla procedura amministrativa*, Vicenza, 1964,

<sup>11</sup> M. Nigro, *Procedimento amministrativo e tutela giuridizionale contro la Pubblica Amministrazione*, në *Shkrimet Juridike*, III, 1996, fq 1429.

prekë të drejtat dhe t'u sjellë efekte që në një ballafaqim të ndërsjellë mund të prodhojë argumenta.

Pra, elementi kryesor i nje procesi gjyqësor nuk është në pjesëmarrjen e tij, por në modalitetet e kësaj pjesëmarrjeje. Pra, që të kemi një proces gjyqësor nuk është e mjaftueshme të marrësh pjesë, të dëgjohesh dhe të kundërshtosh, por ka të bëjë me kontradiktoritetin. Domethënë, struktura e procesit duhet të karakterizohet nga një barazi simetrike e vendit të subjekteve. Kjo do të thotë se nëse *ratio distiguendi* i procesit gjyqësor është kontradiktoriteti, të thënit dhe të kundërshtuarit, rruga ka prirje të shkojë drejt "*emancipimit*" të funksionit gjyqësor dhe ngritjen e tij në skemën e teorisë së përgjithshme. Është e pamohueshme që parimi i kontradiktoritetit<sup>12</sup> në gjyqësor është bashkekzistues dhe në ato procedura administrative ku ballafaqohen një sërë interesash.

Flasim këtu për vendimmarrje të organeve të administratës publike, të ngarkuara me mbrojtjen e interesit publik duke përmendur këtu procedurat koncesionare, ato disiplinore etj.

Në fakt problemi qendron nëse këto elemente të procesit shtrihen në të gjithë të drejtën pozitive. Për të bërë të mundur këtë duhet së pari të identifikohen cilët janë elementet që e bëjnë një proces gjyqësor të mirëfilltë dhe më pas të shihet nëse këto elemente janë të përfshirë në të drejtën pozitive e cila parashikon procedimin administrativ.

Në fakt, parimet e përgjithshme të një procesi gjyqësor janë:

- a. pjesëmarrja e subjekteve, interesat e të cilëve mund të preken nga akti final,

---

<sup>12</sup>Sabino Cassese, "Corso di Diritto Amministrativo", "Istituzioni di Diritto Amministrativo", quarta edizione, Giuffrè Editore, Varese, Milano, 2012, fq. 19.

- b. njoftimi zyrtar i fillimit të procesit gjyqësor, me qëllim për të garantuar kontradiktoritetin,
- c. publiciteti,
- d. barazia e rregullimit apo e administrimit të provave, fakteve dhe argumentave të parashtruara,
- e. zgjedhja e mënyrës dhe përmbajtjes së mbrojtjes,
- f. arsyetimi i aktit final, pra vendimit gjyqësor.

Praktikisht, aty ku takohen apo ndeshen këto kërkesa kemi të bëjmë me elementet e një procesi gjyqësor, i cili shkon përtej procedimit administrativ të mirëfilltë.

Në fakt, ky është synimi ku kërkon të arrijë teoria e përgjithshme e procesit. Por, për të analizuar se sa procedimi administrativ duhet të jetë një procedim i drejtë në terma kushtetues duhet parë se sa këto elemente garantohen nga procedimi administrativ.

Në një vështrim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative nuk mund të themi që ai nuk ka të parashikuara elementet e sipërcituar dhe për këtë arsye me bindje mund të themi që kemi të bëjmë me një konceptim të procedimit administrativ si një proces gjyqësor.

Në këtë rast po t'i referohemi ligjit tonë do të gjejmë aty institutin e njoftimit, të identifikimit të palëve të interesuara, por vlen për t'u përmendur ngritja e të drejtës së dëgjimit, pra e mbrojtjes e cila mund të anashkalohet në rast se akti është në favor. Kjo do të thotë se në rast se akti do të jetë negativ, pra jo në favor, e drejta e dëgjimit në këtë moment mund të ngrihet në nivelin e një garancie si ajo e njoftimit apo komunikimit në të Drejtën procedurale civile, gjë të cilën ligji administrativ e përjashton.

Në analizë të ligjit për mosmarrëveshjet administrative konstatojmë evidentimin e disa parimeve të këtij gjykimi, të cilat janë parime të vetë organeve të administratës publike. Natyrisht kjo nuk paraqet asnjë problem në kushtet kur kjo gjykatë nëpërmjet procesit të saj do të analizojë pikërisht se sa është mbrojtur interesi publik dhe sa janë marrë në konsideratë të drejtat dhe liritë themelore, kushtetuese dhe ligjore të subjekteve.

Në fakt, në referencë të të drejtave kushtetuese ne do të përmendim procesin e rregullt ligjor, që sigurisht shtrihet dhe mbi procedurën administrative.

Por, në momentin që po ky ligj u jep një rëndësi të dorës së dytë elementeve proceduriale të një vendimmarrjeje administrative, duke bërë të mundur që të prevalojë ana materiale, mendoj se duhet të ishte theksuar në këtë ligj nevoja për një proces ku të ballafaqohen të gjitha palët, të drejtat pasurore e jopasurore të të cilëve preken nga veprimi ose mosveprimi administrativ.

Në nenin 37 të ligjit, pika b, konstatojmë se gjykata mund të vendosë vetë ndryshimin e aktit, por në të njëjtën kohë mund të vendosë detyrimin e organit për të ndryshuar një akt administrativ. Në këtë rast duhet të saktësohet nëse kjo çështje është tërësisht në diskrecionin e gjykatës apo të ligjit të posaçëm që rregullon marrëdhënien administrative.<sup>13</sup>

**Mendoj se risia e kësaj gjykate është të vlerësojë dhe çështje të cilat janë thelbësisht administrative, në ndryshim nga ajo çka kishim deri tani.**

Aktualisht sistemi ligjor në Shqipëri tenton të garantojë elementet e procesit të rregullt ligjor në procedurat administrative. E them tenton për arsye se elementet proceduriale

---

<sup>13</sup> Neni 37 i ligjit pika b e LGJA

të cilat e bashkëshoqërojnë një vendimmarrje individuale nuk kanë rëndësinë e duhur në analizën e vlefshmërisë së aktit. Kështu, pavarësisht se K.Pr.A në nenin 116/c parashikon se akti është absolutisht i pavlefshëm kur del në kundërshtim me procedurën e parashikuar në ligj, nga praktika gjyqësore e deritanishme e gjykatave, të cilat vihen në lëvizje me kërkesë padi me objekt konstatimin e një akti absolutisht të pavlefshëm, konstatojmë se elementet procedurale shikohen në raport me anën materiale të ligjit.<sup>14</sup>

Në realitet forma dhe procedura për nxjerrjen e aktit administrativ përbëjnë elementë të rëndësishëm të vlefshmërisë së aktit administrativ.

Mosrespektimi i këtyre elementeve do të përbënin një shkak për pavlefshmërinë e aktit administrativ në ato raste kur ato parashikoheshin shprehimisht nga ligji.

Ndërkohë që, në një këndvështrim tjetër, këto elemente janë të rëndësishme kur ato kanë ndikuar drejtpërdrejt në nxjerrjen e aktit. Paralelisht me këtë qëndrim ekziston dhe ai që Gjykata Kushtetuese<sup>15</sup> ka shprehur në jurisprudencën e saj.

Në analizën e kushtetueshmërisë së një vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ky i fundit, natyrisht nuk mund të trajtonte nëse ekzistonin.

---

<sup>14</sup>Ligji Nr. 44/2015 K.Pr.Adm.

<sup>15</sup> Kështu në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.17 datë 12.11.2004, Gjykata Kushtetuese ka vendosur, se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në referencë të rregullave procedurale që parashikohen për zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit, si dhe të konceptit kushtetues të individit për të gëzuar një proces të rregullt ligjor, ka shkelur të drejtën e kërkuësës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në të njëjtën kohë në këtë çështje Gjykata Kushtetuese është nisur nga kuptimi kushtetues që i është dhënë të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në veçanti ajo shqiptare, kanë pranuar se elementet thelbësore të kësaj të drejte zbatohen si për procedurat gjyqësore, ashtu edhe **për procedurat parlamentare dhe ato administrative**. E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasin kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit si dhe përbën njëkohësisht një detyrim për këdo që të mos çenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa u siguruar respektim i procedurave të rregullta ligjore.

Kështu, në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.17, datë 12.11.2004, Gjykata Kushtetuese ka vendosur, se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në referencë të rregullave procedurale që parashikohen për zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit si dhe të konceptit kushtetues të individit për të gëzuar një proces të rregullt ligjor, ka shkelur të drejtën e kërkuësës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në të njëjtën kohë, në këtë çështje, Gjykata Kushtetuese është nisur nga kuptimi kushtetues që i është dhënë të drejtës për një proces të rregullt ligjor.<sup>16</sup>

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në veçanti ajo shqiptare, kanë pranuar se elementet thelbësore të kësaj të drejte zbatohen si për procedurat gjyqësore, ashtu edhe për procedurat parlamentare dhe ato administrative. E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasin kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit si dhe përbën njëkohësisht një detyrim për këdo që të mos cënojë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa u siguruar respektimi i procedurave të rregullta ligjore. Pra, u konstatua që subjektit i ishte mohuar pa të drejtë e drejta e dëgjimit dhe për pasojë mjaftonte ky argument që vendimi të konsiderohej antikushtetues.

Analiza në fakt mund të çojë në konkluzionin që edhe kontrolli gjyqësor i akteve administrative të jetë në nivelet e një kontrolli kushtetues.

Dhënia e argumenteve të mësipërme nuk ka këtë qëllim, pasi kontrolli nuk do të ishte i mjaftueshëm, pra jo i plotë, ashtu si dhe është praktikisht sot.

---

<sup>16</sup> Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Sot, realisht është në çmimin e gjyqtarit nëse do ta konsiderojë aktin të ligjshëm në kushtet e mësipërme, nëse duhet të ndërhyjë ta ndryshojë atë duke respektuar elementet procedurale apo do të japë disa elemente të rëndësishëm që organi duhet t'i ketë në konsideratë në vendimmarrjen e tij në të ardhmen.

**Për këtë arsye në elementet e kërkuara të procedurës administrative do ta vija theksin në të drejtën dëgjimit.**

Çdo sistem ligjor duhet të vendosë për aplikimin e të drejtës për dëgjim, konkretisht të përmbajtjes së kësaj të drejte. Janë të nevojshme e të justifikueshme të drejtat gjatë një procesi për arsye se ato e bëjnë procesin të gjenerojë një akt më korrekt në rastin konkret<sup>17</sup>. Ana tjetër ka të bëjë me faktin se një individ duhet të trajtohet si një qenie njerëzore, e cila duhet domosdoshmerisht të dëgjohet para se të drejtat e tij mund të cënohen nga një vendimmarrje individuale.

Gjykatat e vendeve të Komunitetit kanë qenë aktiviste në mbrojtje të të drejtave të procesit lidhur me një vendimmarrje individuale. Ata e kanë vendosur të drejtën e dëgjimit si një rregull të përgjithshëm në të drejtën komunitare, pavarësisht nëse kjo ka qenë e parashikuar ose jo në traktat, rregullore, direktivë apo vendim.

Tendenca e përgjithshme gjatë trajtimit të çështjeve ka qenë që të vendoset e drejta e dëgjimit pavarësisht nga fakti nëse me aktin vendoset një sanksion apo jo, duke e akorduar këtë të drejtë edhe kur ai ka një impakt të kundërt me interesat e subjektit.

E drejta e dëgjimit është bërë tashmë pjesë e të drejtave themelore të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë<sup>18</sup>. Kjo e drejtë nuk mund të përjashtohet apo të

---

<sup>17</sup> Resnick, "Due process and procedural Justice", ne Pennock dhe J. Chapman, Due process (nomos, 1977), faqe 217.

<sup>18</sup> Ceshtja c-49/88, al-Jubail Fertilizer kunder Council (1991) ECR I-3187 etj.

kufizohet nga asnjë ligj dhe ky parim duhet të mbrohet si në rastet kur mungon parashikimi ligjor, ashtu edhe në rastet kur ky parim nuk është respektuar si duhet<sup>19</sup>.

Gjithashtu, e drejta e dëgjimit para se të jetë një masë individuale është pjesë e Kartës së të Drejtave themelore të Bashkimit European<sup>20</sup>.

Është e rëndësishme të theksojmë se çdo sistem ligjor duhet të vendosë lidhur me këtë çështje dhe ekziston mundësia që kjo çështje të rregullohet në mënyrë të detajuar nga Kodi i Procedurave.

Kjo praktikisht ndodh te ne. Kodi i ka të specifikuara modalitetet e të drejtës së dëgjimit të palës para se organi të nxjerrë vendimin. Ndërkohë ekziston dhe një mundësi tjetër, ajo e jurisprudencës që tek ne mungon, e cila do të bëjë të mundur që ky parim të përfshihet, rast pas rasti, më tej në procedurën e nxjerrjes së aktit.

Praktikisht, modelet që na serviren mund të jenë dhe një ndërthurje midis jurisprudencës, e cila rast pas rasti përvijon elementet e duhur të së drejtës për dëgjim por nga ana tjetër edhe ligjet e posaçme duhet që, në varësi të natyrës së aktit, të rregullojnë në mënyrë eksplicite të drejtën për dëgjim.

**Pa analizuar atë që sjell ligji që po diskutojmë sot, shpreh mendimin se në rast se do të minimizohej elementi procedural në këtë masë, atëherë kontrolli gjyqësor duhet të jetë në një nivel shumë të lartë.**

Kjo për arsye se deri më sot gjykatat e kanë patur praktikisht të pamundur dhe kjo ka sjellë zvarritje pa fund të proceseve, të cilat të vlerësojnë në mënyrë të plotë realitetin e nxjerrjes së aktit. Në kushtet kur ky sistem gjyqësor prezantohet i tillë, procedimi

---

<sup>19</sup> Ceshtja T-260/94, Air Inter SA kundër Komisionit (1991) ECR I-2257.

<sup>20</sup> Neni 41(2) i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European, OJ 2000 C364/1,



administrativ duhet të jetë sa më i plotë dhe më i qartë në mënyrë që të jetë lehtësisht e analizueshme vlefshmëria e aktit.

Por, aktualisht te ne, as procedura administrative dhe as ajo gjyqësore nuk arrijnë të garantojnë në mënyrë përfundimtare mbrojtjen e të drejtave të individit.

Kjo sepse praktikisht rezultatja e procedurës administrative dhe procesit gjyqësor është që në përmbushje të interesit publik, organet me veprimet e mosveprimet e tyre të sigurojnë mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjor të subjekteve të së drejtës.

**Si përfundim, nga sa analizova më lart, del si domosdoshmëri reformimi i akteve ligjore lidhur me kontrollin gjyqësor të veprimtarisë administrative.**

Realiteti që është bërë prezent na bën të pranojmë se misioni i gjykatave nuk mund të jetë vetëm dhënia e drejtësisë.

E kemi tashmë të provuar se kontrolli që gjykata sot i bën aktit administrativ të kontestuar është i paplotë pasi, jo rrallëherë, subjektet gjenden në një rreth vicioz që nuk shpëputet kurrë, pas procesesh që zgjaten pafundësisht në kohë.

Në vendin tonë ekziston nevoja për module juridiksionale efikase dhe funksionale, të cilat mund t'i japin një rezultat konkret kontrollit të realizuar nga ana e tyre në raport me mbrojtjen e të drejtave të subjekteve përballë administratës.

Konkretisht, Ligji i Gjykatave Administrative (LGJA) fokusohet mbi tri cilësitë bazë të sistemit të ri të gjykimit të konflikteve administrative që propozohen në të, si:

- **Barra e provës** për aktet e pakërkuara, e cila i është kaluar organit administrativ.

Në çdo rast të vendosjes së një gjobe, rivlerësimi tatimor, pezullimit të një veprimtarie, revokimit të një licence a leje, sekuestrimi, konfiskimi a raste të tjera aktesh e veprimesh administrative të natyrës ndëshkuese mbi qytetarët a bizneset do të jetë administrata që do të përpiqet të bindë gjykatën, me prova, fakte dhe arsyetim ligjor, për drejtësinë e aktit të saj. Një përmbysje e këtillë do të rrisë më herët mundësinë e rrëzimit të padrejtësisë së administratës.

Ligji sjell një risi në kuadër të gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, lidhur me detyrimin e organeve publike për të paraqitur provat që kanë mundësuar nxjerrjen e akteve apo kryerjen e veprimeve administrative, të cilat më pas kanë sjellë cënimin e të drejtave të ligjshme të personave.<sup>21</sup>

- **Procesi i gjykimit** është i shpejtë, si rregull jo më shumë se 30 ditë, përmes një procedure me hapa të saktë, të qartë, të thjeshtë e me afate fikse që nga dorëzimi i ankimit deri të marrja e vendimit.<sup>22</sup>

Procedura e shpejtë ndihmohet edhe nga qartësimi i termave, rregullat për njoftimet, zhvillimi i seancave edhe pa praninë e palëve e bazuar në dokumente, qartësimet mbi masat për sigurimin e padisë, rolin e ekspertëve, rregullime të tjera specifike e deri tek përdorimi i teknologjisë së informacionit e komunikimit. Sipas hartuesve të Ministrisë së Drejtësisë, qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave, nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të

---

<sup>21</sup>Neni 35 i ligjit

<sup>22</sup>Neni 7 i ligjit

arsyeshme. Me anë të këtij ligji është synuar krijimi i kushteve të përshtatshme për një shqyrtim efektiv, duke vënë në vend të drejtat e cenuara nga veprimet apo aktet administrative, të nxjerra nga organet publike.

Ligji sjell domosdoshmërinë e barazisë së interesit publik, nga njëra anë, me të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të personit, nga ana tjetër. Në kuadër të marrëdhënies administrative, nëpërmjet personave dhe organeve publike, synohet forcimi i rolit aktiv të organeve administrative për respektimin e të drejtave subjektive të personave.

- **Kompetencat vendimmarrëse** të gjykatës administrative i japin jetë një roli më aktiv e më të fuqishëm të saj në raport me organin administrativ.

Ligji cakton rregulla të detyrueshme për subjektet e gjykimit administrativ, organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore administrative si dhe organizimin e Gjykatave Administrative.

Gjykatat efikase administrative, gjithashtu, rrisin transparencën e vendimeve administrative dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

**Ky ligj ofron parimin se Gjykata Administrative gjykon mbi aktet shkresore dhe mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.<sup>23</sup>**

Ligji për mosmarrëveshjet administrative propozon eksplorimin përtej kufirit klasik të shqyrtimit të ligjshmërisë dhe i jep gjykatës kompetencat për të marrë vendime që, në një farë mase, “zëvendësojnë” organin administrativ duke rritur sa shpejtësinë, aq

---

<sup>23</sup>Neni 25/3 i ligjit

edhe sigurinë në vendosjen e drejtësisë dhe ekzekutimin e saj qoftë edhe me mjete detyruese e ndëshkuese kundër zyrtarëve pengues.

Shkurt, gjykatave administrative shqiptare u jepet fuqi sipas modeleve më të avancuara të simotrave europiane.

Ligji propozon të paktën gjashtë gjykata administrative të Shkallës së Parë dhe vetëm një gjykatë të Apelit. Ky është një hap centralizues krahasuar me gjendjen aktuale, ku çështjet administrative gjykohen në shtatëmbëdhjetë gjykata të Shkallës së Parë me seksione administrative dhe gjashtë gjykata Apeli.<sup>24</sup>

Qëllimi i centralizimit është arritja e masës kritike të rasteve gjyqësore, që lejojnë një trupë me një numër mbikritik gjyqtarësh, një ngarkesë të mjaftueshme pune për një gjyqtar, mundësinë e specializimit dhe minimizimin e ndikimit të lidhjeve të ndryshme të interesave në lokalitete të vogla. Për pasojë, distancat gjeografike do të rriten. Shqetësimi i rritjes së distancës për qytetarët dhe bizneset, pra edhe e kostos oportune të aksesit, është legjitim.

Rritja e numrit të gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit është një nga zgjidhjet e mundshme por që vjen me efektin e kundërt mbi mundësitë për specializimin e gjyqtarëve për shkak të numrit gjithnjë e më të vogël të rasteve për gjyqtar dhe/ose të numrit të gjyqtarëve për gjykatë.

**Ndaj, do të ishte e udhës që diskutimet të mundësojnë një zgjidhje që eviton lidhjen e kundërt ose, të paktën, e optimizon atë.**

Në fakt, një nga variantet e shqyrtuara ka qenë ngritja e vetëm një gjykate të Shkallës së Parë për të gjithë territorin e vendit dhe natyrisht edhe të vetëm një gjykate Apeli.

---

<sup>24</sup> Ligji “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”

Një gjykatë e vetme me seli qendrore në Tiranë edhe me disa mjedise në disa qytete të tjera – teorikisht po aq sa gjykata do të duam të kemi – si dhe gjyqtarë pjesërisht të fiksuar në territor e pjesërisht lëvizës sipas nevojës, e zgjidh njësoj çështjen e distancës, por me avantazhin që do të kemi vetëm një trupë gjyqësore kompakte, një kryetar si dhe një shërbim kancelarie. Njëkohësisht do të kishim evitimin e mosmarrëveshjeve për juridiksionin territorial duke siguruar një shkallë më të lartë të njëtrajtësisë së vendimeve për çështje të ngjashme.

Tek e fundit, çështjet organizative janë operative e menaxheriale e për pasojë, rregullimet e drejtpërdrejta në ligj duhet të jenë sa më elastike. Shpërndarja gjeografike e gjykatave duhet bazuar në analizën statistikore të numrit të rasteve në kohë dhe hapësirë e që kështu, në mënyrë dinamike, do të mund të optimizoheshin raportet e kundërta mes distancës dhe numrit të rasteve ankimore për çdo gjykatë.

*Gjykata administrative është një gjykatë e specializuar për gjykimin dhe zgjidhjen e çështjeve administrative, veçanërisht të çështjeve lidhur me ushtrimin e pushtetit publik. Roli i saj është të sigurojë që aktet e zyrtarëve publikë të jenë në përputhje me ligjin. Gjykata të tilla ka në disa vende europiane të cilat funksionojnë veçmas gjykatave të zakonshme.<sup>25</sup>*

Procedura administrative mund t'i referohet anës lëndore të çështjes ose cilësimit formal duke iu nënshtruar dispozitave të veçanta procedurale. Faktikisht, në të gjithë vendet që kanë juridiksion të veçantë administrativ, disa gjykime në lidhje me administratën publike kanë mbetur ose janë përfshirë në juridiksionin e zakonshëm<sup>26</sup>.

Ndër funksionet e rëndësishme të gjyqësisë administrative, dy janë themelore:

---

<sup>25</sup> Përkufizim i marrë në Wikipedia

<sup>26</sup> Shih: Jean-Marie Woehrling, Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në Europë: Drejt një modeli të përbashkët, i redaktuar nga SIGMA (një iniciativë e përbashkët e OSBEsëdhe BE-së).

- funksioni preventiv, dhe
- funksioni represiv.

Gjykatat administrative mbrojnë, në mënyrë preventive, të drejtat e individëve. Ky lloj i mbrojtjes “pengon tejkalimin e autorizimeve të pushteteve ekzekutive dhe administrative” në dëm të shtetasve.

Ky funksion i gjyqësisë administrative njëkohësisht shprehet me “ndikimin në procedurën administrative”.

Funksioni represiv i gjyqësisë administrative shprehet në aplikimin e sanksioneve kur të paraqitet “shkelja konkrete e rendit juridik”.

Një gjykatë administrative është një lloj gjykate e specializuar në të drejtën administrative, veçanërisht mosmarrëveshjet në lidhje me ushtrimin e pushtetit publik. Roli i tyre është për të konstatuar se aktet zyrtare janë apo jo në përputhje me ligjin. Gjykatat e tilla janë gjetur në disa vende evropiane me të drejtën civile dhe që konsiderohen të ndara nga gjykatat e përgjithshme.

Aktet administrative njihen nga vula, e cila i bën ato të detyrueshme pa pëlqimin e palëve të tjera të përfshira. Kontratat mes autoriteteve dhe personave privatë bien zakonisht në juridiksionin e sistemit gjyqësor të përgjithshëm.

Vendimet zyrtare të kontestuara në gjykatat administrative përfshijnë:

- tatimet
- shërbimi i përfitimeve monetare
- licencat mjedisore
- inspektimi i ndërtimit
- kujdestaria e fëmijës
- angazhimi i pavullneshëm

- vendimet e imigracionit
- largimet nga puna
- pagesat publike përmbledhëse (të ndryshme nga gjobat e shqiptuara nga gjykatat e përgjithshme)
- etj.

## KAPITULLI II: DREJTËSIA ADMINISTRATIVE NË DISA NGA VENDET E EUROPËS

### 2. Përvoja përkatëse në vendet e tjera Europiane

Organizimi i shqyrtimit gjyqësor të akteve administrative ndryshon në masë të konsiderueshme ndërmjet vendeve europiane në lidhje me çështjen e pasjes së gjykatave administrative autonome ose ngarkimit të juridiksionit administrativ gjykatave të zakonshme dhe numrit të shkallëve gjyqësore.<sup>27</sup>

Me qëllim që të mund të dalim në konkluzione sa më pranë realitetit por edhe të zgjedhim formën më të mirë të gjyqësisë administrative referuar eksperiencave më të suksesshme europiane, do të analizojmë dy mënyra krahasimi.

Së pari, do të fokusohemi në krahasimin e disa vendeve europiane të Common Law me disa vende europiane të Civil Law.

Së dyti, do të marrim si referencë vetëm vendet me më pak se 10 milionë banorë, pasi Shqipëria ka vetëm 3 milionë banorë dhe premisat organizative nuk janë të krahasueshme me vendet me një popullatë shumë më të madhe.<sup>28</sup>

Për të realizuar analizën e parë, vlen të përmenden karakteristikat kryesore të dy sistemeve. Në fakt, shumë vende sot ndjekin një nga dy traditat më të mëdha Ligjore në të gjithë globin: Common Law ose Civil Law.<sup>29</sup>

Tradita e Common Law u zbatua për herë të parë në Mesjetë nga Anglia dhe u aplikua pothuajse në të gjitha kolonitë angleze në të gjithë botën.

---

<sup>27</sup> Nëse nuk citohet ndryshe, informacioni është marrë nga CEPEJ, Sistemet Gjyqësore Europiane 2002 dhe faqja ne Internet e Shoqatës së Këshillave të Shtetit dhe Juridiksioneve Administrative Supreme të Bashkimit European ([http://193.191.217.21/en/home\\_en.html](http://193.191.217.21/en/home_en.html)). Verifikimi dhe plotësimi është kërkuar nga ministritë përkatëse të Drejtësisë, por jo të gjitha prej tyre janë përgjigjur.

<sup>28</sup> Informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme.

<sup>29</sup> <https://www.law.berkeley.edu/library/robbins/CommonLawCivilLawTraditions.html>, dt. 31 janar 2015.



Nga ana tjetër, tradita e Civil Law gjithashtu u zhvillua në të njëjtën periudhë historike brenda kontinentit evropian si dhe u aplikua pothuajse në të gjitha kolonitë e fuqive të mëdha mbretërore si psh të Mbretit të Spanjës apo të Portugalisë.

Vlen të përmendet se në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe të nëntëmbëdhjetë, tradita e Civil Law u adoptua nga ish-vende të cilat posedonin tradita dalluese Ligjore siç ishte Rusia apo Japonia. Por, ne do të fokusohemi vetëm në Europë.

Karakteristika dalluese e të dy sistemeve qëndron në faktin se tradita e Civil Law është e Kodifikuar, pra, ka ligje dhe kode të cilave gjykata iu referohet për dhënien e drejtësisë ndërsa tradita Common Law është e Pa-Kodifikuar çfarë do të dhotë që për dhënien e drejtësisë gjykata nuk bazohet në ligje apo statute të ndryshme por i referohet zgjidhjes që i është dhënë rasteve të tjera të mëparshme të cilat i ngjajnë rastit i cili po gjykohet.

Konkretisht, sai takon gjyqësisë Administrative, mund të themi se Common Law në Europë përfaqësohet denjësisht me Britaninë e Madhe ku edhe e pati gjenezën e vet.

Gjyqësia Administrative ndjek pothuaj të njëjtat hapa si gjyqësia e përgjithshme në BM, pra është e ndarë në gjykata të veçanta nga shkalla e parë në të fundit. Njëkohësisht, përveç të tjerash gjyqësia administrative ka edhe gjykata të tjera të veçanta siç mund të përmendim edhe Gjykatën për Azil dhe Imigrim<sup>30</sup>, etj.

Gjyqësia administrative në Sistemin Civil Laë ka lindur në Francë por u përsos në Gjermani. Ky sistem sikurse u tha edhe më lart bazohet në ligje dhe kode dhe sa i takon përbërjes, në Francë ajo ka dy shkallë të veçanta; në shkallën e parë dhe në Apel ndërkohë që shkalla e tretë e gjykimit ndodhet në Gjykatën e Lartë në formën e një Kolegji Administrativ.

---

<sup>30</sup>S. Rose-Ackerman and P. L. Lindseth, "Comparative Administrative Law", 2010, Printed and bound by MPG Books Group, UK, fq. 438

Nga ana tjetër, përsosja gjermane ka bërë që gjyqësia administrative të jetë komplet e ndarë në të tre shkallët e gjykimit duke patur një Gjykatë të Lartë të posaçme Administrative.

Por, cilat janë anët e errëta dhe ato të ndriçuara të Common Law dhe të Civil Law?

Në Common Law kemi si themelor “konceptin e shqyrtimit gjyqësor të merituar”<sup>31</sup> i cili përbëhet nga tre elementë thelbësorë. Konkretisht, elementi substancial ka të bëjë me sigurimin që është marrë vendimi i duhur, elementi i dytë ka të bëjë me procedurën dhe i fundit ka në thelb të tij ndreqjen dhe përsosjen.

Marrja e vendimit të duhur është tepër e rëndësishme sepse ajo është e lidhur drejtpërdrejt me gjyqtarin i cili e mori këtë vendim. Kjo për arsyen sepse ai vendim do të shërbejë si rast për zgjidhjen e rasteve të tjera të njëjta në të ardhmen. Në rast se ai vendim nuk është marrë në mënyrën e duhur atëherë edhe rastet që do të vijnë në të ardhmen do të gjykohen jo në mënyrën e duhur. Kjo është një nga anët e errëta të Common Law sepse dhënia e vendimit është subjektiv duke u varur nga mendimi personal i gjyqtarit, nga rritja dhe formimi i tij ndërsa në Civil Law është përfituar dhënia e vendimit në mënyrën më të pavarur të mundshme duke shmangur në maksimum subjektivizmin e gjyqtarit dhe duke i dhënë përparësi ligjeve dhe kodeve për rastin konkret. Në të njëjtën kohë, tradita e Common Law ka gdhendur një rregull të artë i cili konsiston në faktin se nuk ka një ndarje midis standarteve administrative mbi të cilat një Gjykatë duhet të insistojë dhe parimeve të ligjit nga ana tjetër të cilat duhet të jenë të aplikueshme nga një trup gjykimi.

Një anë tjetër e errët e Common Law është quajtur si “gabimi në ligj”<sup>32</sup> sepse ka të bëjë me mungesën e përqendrimit të vëmendjes ndaj ligjit duke u fokusuar më shumë

---

<sup>31</sup>Po aty, fq. 429

<sup>32</sup>Po aty, fq. 431

te precedenti, për rastet e mëparshme gjatë dhënies së vendimit. Pra, precedenti e kalon ligjin në plan të dytë dhe nuk e shikon atë si burim të zgjidhjes së çështjes konkrete.

Dhe ana tjetër e fundit e errët e sistemit Common Law është i njohur si “gabimi në fakte”<sup>33</sup> dhe konsiston në dhënien e më pak apo më shumë rëndësie të secilës prej provave dhe fakteve në çështjen konkrete.

Sistemi Civil Law është sistem strikt, i fokusuar për t’iu bindur vetëm ligjit duke e lënë mënjanë praktikën, analogjinë dhe precedentin. Vendimet janë gjithmonë të bazuara në ligj dhe se ligji është burimi i çdo vendimi të dhënë nga gjyqtari në Civil Law.

Sistemi administrativ në Civil Law është i ndarë midis shembullit francez (me dy shkallë gjyqësore të ndara dhe që takohen në Gjykatën e Lartë e cila është e përbashkët) dhe atij gjerman (me të trija shkallët të ndara nga gjykatat e zakonshme).

Por, ka edhe disa vende të cilat sistemin administrativ s’e kanë të ndarë nga gjyqësori i zakonshëm, siç edhe ka qenë Shqipëria para miratimit të Ligjit për Gjykatën Administrative.

Le të fillojmë me këto vendet e fundit të cilat ia kanë ngarkuar juridiksionin administrativ plotësisht sistemit gjyqësor të zakonshëm me tri shkallë, ku mund të përmenden Danimarka (5.4 milion banorë), Norvegjia (4.5 milionë) dhe Sllovakia (5.4 milionë).

Në Danimarkë<sup>34</sup>, sistemi gjyqësor, momentalisht, përbëhet nga 82 gjykata rrethi, dy Gjykata të Larta dhe Gjykata Supreme. Nuk ka gjyqtarë që të gjykojnë vetëm çështje administrative. Çështjet gjykohen nga një gjyqtar i vetëm në shkallën e parë, nga një

---

<sup>33</sup>Po aty, fq. 431

<sup>34</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Daneze e Drejtësisë.

trup gjykues me tre gjyqtarë në gjykatat e larta dhe nga një trup gjykues me të paktën pesë gjyqtarë në Gjykatën Supreme. Nuk ka statistika për çështjet administrative. Ka filluar tashmë një riorganizim i të gjithë sistemit gjyqësor që do ta reduktojë numrin e gjykatave të rrethit në 22, të cilat do të ushtrojnë juridiksion në shkallë të parë për të gjitha çështjet administrative (ndërsa aktualisht aktet administrative të nxjerra nga organet publike qendrore shqyrtohen nga gjykatat e larta si gjykata të shkallës së parë).

Qëllimi i këtij riorganizimi është sigurimi i një përdorimi më të dobishëm të burimeve në gjykata, duke i dhënë kështu mundësi Gjykatës Supreme për t'u përqendruar mbi çështjet me interes të lartë. Megjithatë, pasja e një sistemi gjyqësor të unifikuar duket se është një gjetje me vend.

Sisteme autonome të gjykatave administrative ekzistojnë, p.sh., në Austri, Finlandë, Suedi dhe Lituani.

Në Austri (8 milionë)<sup>35</sup>, juridiksioni administrativ autonom aktualisht ushtrohet nga “Verwaltungsgerichtshof” (Gjykata e Lartë Administrative) si shkalla e parë dhe e fundit gjyqësore. Megjithatë, ekzistojnë dy shkallë të mjeteve ligjore të mbrojtjes brenda administratës që duhen ushtruar para se të vihet në lëvizje gjykata.

Gjykata ka një ngarkesë prej 7'000 çështje të ardhura çdo vit, që gjykohen nga 61 gjyqtarë, të cilët përgjithësisht janë pjesë e trupave gjykues prej pesë gjyqtarësh.

Ndërsa juridiksioni administrativ autonom në Austri nuk kundërshtohet, pasja e vetëm një shkalle gjyqësore të nivelit të lartë konsiderohet si e pakënaqshme. Një reformë që është planifikuar parashikon një mjet të vetëm të mbrojtjes ligjore brenda administratës dhe krijimin e (të paktën) 10 gjykatave administrative në shkallë të parë,

---

<sup>35</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Austriake e Drejtësisë.

ndërsa Gjykata e Lartë Administrative do të bëhet shkallë rekursi që shqyrton vetëm çështjet ligjore të rëndësisë së veçantë<sup>36</sup>.

**Në Finlandë** (5.2 milionë)<sup>37</sup>, sistemi autonom i juridiksionit administrativ përbëhet nga dy shkallë. Tetë gjykata rajonale administrative me 156 gjyqtarë të cilët gjykojnë një ngarkesë vjetore prej 20'000 çështje të ardhura, zakonisht me trup gjykues prej tre gjyqtarësh. Në Gjykatën Administrative Supreme gjykohen rreth 3'800 çështje nga 21 gjyqtarë, zakonisht me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.

Projekt-ndryshimet që janë në shqyrtim e sipër në Parlament parashikojnë që në gjykatat administrative rajonale mund të gjykohen më shumë çështje nga një gjyqtar i vetëm. Në përgjithësi mendohet që sistemi në praktikë të ketë qenë funksional.

**Suedia** (8.9 milionë)<sup>38</sup> ka një sistem gjyqësor administrativ autonom që përbëhet nga tri shkallë. Shkalla e parë përbëhet nga 23 gjykata administrative qarku me 123 gjyqtarë profesionistë, të cilët gjykuan 103/366 çështje në vitin 2005 me trup gjykues me një gjyqtar dhe tre ndihmës-gjyqtarë. Katër gjykata administrative apeli me 93 gjyqtarë, që gjykojnë në trupa gjykues përkatësisht me tre dhe dy gjyqtarë, kanë përfunduar së gjykuari 25/555 çështje në vitin 2005. Gjykata Supreme Administrative me 18 gjyqtarë, shkalla e tretë dhe e fundit, ka shqyrtuar 6/813 çështje në vitin 2005. Me sa duket, sistemi mendohet të mos jetë i pranueshëm, pasi një program reforme i Qeverisë parashikon shkrirjen e administratës së gjykatave administrative të qarkut me atë të gjykatës së rrethit në të njëjtën bashki me qëllim që të arrihet shkëmbimi i ekspertizës ndërmjet gjyqtarëve dhe personelit tjetër, por, gjithashtu, të përdoren më me frytshmëri burimet.

---

<sup>36</sup> Shih: Raporti Final i Konventës Kushtetuese Austriake - Pjesa 3 ("Endbericht des Oesterreichischen Verfassungskongresses -Teil 3") dhe Raporti i Aktivitetet të Gjykatës së Lartë Administrative 2004 ("Tätigkeitsbericht des Oesterreichischen Verwaltungsgerichtshofs2004")

<sup>37</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Finlandeze e Drejtësisë

<sup>38</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Suedeze e Drejtësisë

Një ekspert suedez, i ngarkuar nga Këshilli i Europës<sup>39</sup>, përpiloi argumentet në favor dhe kundër krijimit të gjykatave të specializuara bazuar mbi përvojën në Suedi dhe arriti në përfundimin që një gjyqësor i unifikuar duhej të preferohej dhe “*gjykatat e veçanta duhet të shmangen, përveç kur ka një numër të mjaftueshëm të çështjeve brenda një fushe specifike të identifikuar të ligjit. Ngarkesa e pritshme e punës duhet të kërkojë më shumë se dhjetë gjyqtarë që gjykata e veçantë të mund të qëndrojë*”.

**Lituania** (3.5 milionë) ka një sistem gjyqësor administrativ autonom me dy shkallë, pesë gjykata administrative rajonale me 45 gjyqtarë që zakonisht gjykojnë në trup gjykues me tre gjyqtarë dhe Gjykata Administrative Supreme me 15 gjyqtarë, që gjykojnë në trup gjykues me tre ose pesë gjyqtarë.

Në vitin 2005, u gjykuan 13/450 çështje në gjykatat rajonale administrative dhe 3/923 çështje në Gjykatën Administrative Supreme.

Një vlerësim i kryer në vitin 2003 e ka gjetur sistemin përgjithësisht të pranueshëm.<sup>40</sup>

Vende të tjera, sidomos disa vende shumë të vogla të Europës Lindore, kanë krijuar sisteme të përziera.

**Në Letoni** (2.3 milionë)<sup>41</sup>, gjykatat administrative autonome gjykojnë në shkallën e parë dhe të dytë, ndërsa Gjykata Supreme e sistemit gjyqësor të zakonshëm funksionon si shkalla e fundit në çështjet administrative. Ngarkesa e çështjeve në vitin 2005 ishte rreth 3200 çështje të ardhura në shkallën e parë dhe rreth 1200 çështje të ardhura në gjykatën e shkallës së dytë.

**Në Estoni** (1.4 milionë)<sup>42</sup> çështjet administrative gjykohen nga dy gjykata administrative të shkallës së parë, me 27 gjyqtarë që përgjithësisht gjykojnë si

---

39 Shih raportin e Z Anders Lindgren/Suedi në: CEPEJ, Juridiksioni Territorial, 05 Dhjetor '03, f. 20, 26, 30, 32.

<sup>40</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Lituanëze e Drejtësisë.

<sup>41</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Letoneze e Drejtësisë.

<sup>42</sup> Informacioni shtesë i marrë nga Ministria Estoneze e Drejtësisë.

gjqtarë të vetëm. Në shkallën e dytë, dhomat administrative (11 gjyqtarë) të të dy gjykatave të zakonshme të apelit gjykojnë çështje administrative me trup gjykues me tre gjyqtarë. Në shkallën e tretë, një dhomë administrative me 5 gjyqtarë në Gjykatën Supreme e cila i shqyrton çështjet përkatëse me trup gjykues me, përkatësisht, tre ose pesë gjyqtarë.

Në vitin 2005, ishin 2'775 çështje të ardhura në shkallën e parë dhe 1'061 çështje në shkallën e dytë. Krijimi i gjykatave të veçanta është konsideruar sukses, pasi numri i çështjeve të kthyer në shkallën e parë nga shkalla e dytë është pakësuar dhe numri i çështjeve të ardhura në shkallën e parë nuk është pakësuar.

*Në Slloveni* (2 milionë), sistemi gjyqësor administrativ përbëhet nga dy shkallë.

Gjykata Administrative që ka statusin e një gjykatë më të lartë shqyrton çështjet administrative në shkallë të parë. Ankimet shqyrtohen nga Gjykata Supreme, e cila ka një Departament për Shqyrtimin Administrativ.

**Si përfundim**, vlerësimi i informacionit të marrë sa më lart nuk të çon në ndonjë përfundim të qartë nëse është më e preferueshme pasja e gjykatave administrative autonome ose ngarkimi i juridiksionit administrativ gjykatave të zakonshme.

**Ky nuk është një rezultat i papritur, pasi sukse si i çdo modeli varet nga shumë faktorë që ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, p.sh., objekti i juridiksionit administrativ, dendësia e popullsisë, dendësia e gjykatave, numri i gjyqtarëve në raport me numrin e banorëve, numri i shkallëve dhe përbërja e trupit gjykues, sofistikimi dhe kompleksiteti i ligjit dhe praktikës gjyqësore, buxheti gjyqësor dhe faktorë të tjerë.**

Megjithatë, modelet e ndryshme të zgjedhura nga vende të ndryshme tregojnë që një sistem autonom i gjykatave administrative kërkon një numër të madh çështjesh me qëllim që të kihet një ngarkesë e mjaftueshme çështjesh edhe në shkallën e fundit.

Meqenëse numri i çështjeve është në një shkallë të konsiderueshme në përpjesëtim me numrin e popullsisë, vendet e vogla do të ishte mirë t'ia ngarkonin juridiksionin e shkallës së fundit gjykatës më të lartë të sistemit të tyre të zakonshëm.

Përvoja austriake tregon se pasja e vetëm një shkalle gjyqësore nuk është efikase, pasi kjo e ngarkon gjykatën e nivelit të lartë edhe me çështje të vogla.

Nga ana tjetër, duke pasur dy shkallë të juridiksionit administrativ, duket se është funksionale në praktikë në shumë vende edhe nëse sistemi gjyqësor i zakonshëm është me tri shkallë. Nuk ka përvojë të përbashkët të vendeve të tjera europiane në favor ose kundër gjykatave administrative autonome.

Krijimi i gjykatave administrative autonome nuk përfshin domosdoshmërisht shkallën(t) më të larta. Nuk duhet të ketë më pak se dy shkallë gjyqësore të juridiksionit administrativ. Duhet menduar nëse është e këshillueshme pasja e më shumë se dy shkallëve të juridiksionit administrativ.

### **Pro-(të) dhe kundra-(t) e pasjes së një gjykate të veçantë administrative në Shqipëri.**

Krijimi i gjykatave të specializuara autonome që kërkon transferimin e gjykimeve përkatëse nga objekti i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, përbën një ndryshim të konsiderueshëm në sistemin gjyqësor, ç'ka kërkon shumë përpjekje dhe shpenzime. Për pasojë, nevoja për këto gjykata është shqyrtuar me kujdes gjatë hartimit të legjisllacionit për krijimin e tyre<sup>43</sup>.

---

<sup>43</sup> Një shtjellim shumë i plotë i kësaj çështjeje mund të gjendet tek: American Bar Association ABACEELI, Punim mbi Konceptin e Gjykatave të Specializuara, 25 qershor 1996, megjithatë, shumë nga temat e diskutuara atje u referohen disa parakushteve që ekzistojnë në sistemin ligjor të SHBA-së.



## **2.1. Instalimi i gjykatave administrative në vendet e Bashkimit European**

Gjyqësia administrative është e përhapur gjithandej nëpër vendet e Bashkimit European.

Sipas gjendjes, në vitin 2007, në 16 vende të Bashkimit European, nga gjithsej 27 anëtarë të tij, si në Gjermani, Austri, Belgjikë, Finlandë, Francë, Greqi, Itali, Letoni, Luksemburg, Hollandë, Poloni, Portugali, Ceki, Suedi, Rumani e Bullgari, veprojnë gjykatat administrative, si gjykata të specializuara.

Në 11 shtetet e tjera anëtare të Bashkimit European, si në Qipro, Estoni, Danimarkë, Irlandë, Lituani, Hungari, Maltë, Spanjë, Slloveni, Sllovaki dhe Britani e Madhe, veprojnë degët e specializuara ose dhomat për të drejtën administrative, në kuadër të gjykatave të rregullta të larta (supreme).

*“Europeanizimi” i gjykatave administrative është një “shenjë identifikimi me standartet që janë përqaftuar nga një numër i madh i vendeve të Bashkimit European” dhe që tashmë kanë zënë vend në legjislacionet e tyre. Mirëpo, “europeanizimi” i gjyqësisë administrative nuk do të thotë njëkohësisht se gjykatat administrative në ato vende janë të veshura me “të njëjtat parime”, po sikurse që nuk do të thotë “identifikimin e gjyqësisë administrative me cilindo nga rregullimet e përmendura organizative të saj”.*

Në këtë kuadër, edhe Shqipëria do të ketë mundësi që gjykata administrative t’ia përshtasë kushteve dhe rrethanave specifike të saj, pa patur nevojë që *“verbërisht t’i përmbahet një modeli”*.

Shtetet që kanë përqafuar standartet e gjyqësisë administrative janë në “*valën*” e reformave të saj. Ato po bëjnë dhe kanë planifikuar të bëjnë hapa të vendosur në drejtim të reformimit të gjyqësisë administrative në vendet e veta.

## 2.2. Modelet e përziera

Vetëm konkretisht, duke pasur parasysh situatën specifike të vendit përkatës, mund të përcaktohet nëse një model i përzier, i praktikuar në disa vende, mund të maksimalizojë mundësitë dhe të minimizojë rreziqet.

Si parim i përgjithshëm, duhet të shmangët qënia e gjyqtarëve të shkallës së parë më të kualifikuar në fushën specifike të ligjit për shkak të specializimit të tyre se sa gjyqtarët që shqyrtojnë ankimet kundër vendimeve të tyre.

Nëse ligji përkatës është tepër kompleks dhe teknikisht i vështirë, çka kërkon ekspertizë të konsiderueshme gjyqësore për ta interpretuar dhe zbatuar atë, niveli më i lartë i specializimit duhet të arrihet në shkallën më të lartë të gjykimit.

Megjithatë, nëse ekspertiza e specializuar kërkohet kryesisht për konstatimin e fakteve, gjykimi në shkallën e apelit, të bazuar mbi argumentet e zbatimit jo të drejtë të ligjit, nuk kërkon domosdoshmërisht gjyqtarë të specializuar.

### 2.3. Sistemet e drejtësisë administrative

Nevoja e kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës, udhehequr ky i fundit nga parimi që të drejtat subjektive të qytetarëve duhet të jenë të mbrojtura, jo vetëm kundrejt personave të tjerë, por dhe kundrejt administratës publike.

Duke qenë se shteti i së drejtës, njihet si postulati themelor për organizimin e shtetit, parimi i ndarjes së pushteteve, që në kuptimin absolut, ashtu sic ishte konceptuar në fillimet e të drejtës publike moderne, do sillte për rrjedhojë që pushteti gjyqësor nuk mund dhe duhet të shtrijë pushtetin e vet mbi veprimtarinë administrative, gjë që do ndërhynte në fushën e rezervuar të pushtetit ekzekutiv.

Në realitet parimi i ndarjes së pushteteve, nuk përbën pengesë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit kundrejt veprimtarisë administrative, kur të dy pushtetet limitohen në kufijtë e sanksionuar në kushtetutë.

Por lind problemi si mundet që të pajtohet me parimin e ndarjes së pushtetit, e drejta që i rezervohet gjykatësit për të anuluar aktin administrativ. Kjo në fakt mund të justifikohet me disa hipoteza si psh, vendosjen në vend të të drejtave subjektive të shkelur nga akti administrativ për të cilën është e nevojshme të eliminohen masat e marrë nga një organ administrativ. Por ama kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë administrative konsiderohet si ndërhyrje e gjykatave në sferën e rezervuar të administratës publike.

### 2.3.1. Sistemet e drejtësisë administrative në nivel global

Sistemi i juridiksionit të vetëm të zakonshëm është karakteristikë e vendeve anglosaksone (*common law*), por është implementuar dhe në vende të tjera si Norvegji, Izrael dhe disa vende të ish-Bashkimit Sovjetik.

Sipas këtij sistemi, veprimtaria e administratës publike i nënshtrohet shqyrtimi të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Por shqyrtimi i kësaj veprimtarie i nënshtrohet tre kufizimeve:

1. Shqyrton çështje që janë të lidhura me ligjshmërinë dhe tejkalimin e kompetencës (*ultra vires*), por nuk shtrihet në gjykimin e çështjeve dhe faktit,
2. Nuk ka tagrin të anullojë, të pezullojë ose të modifikojë një akt administrativ, veprimtarinë administrative, por kufizohet vetëm në dhënien e vendimeve për rivendosjen në vend të pasojave të shkaktuara nga veprimtaria administrative, psh. zhdëmtimin e dëmit.
3. Nuk janë pjesë e juridiksionit gjyqësor çështjet që hyjnë në juridiksionin e zgjidhjes së organit administrativ dhe këtë atribut e kanë zakonisht komisione speciale me karakter administrativ.

❖ **Sistemi i judiksionin të dyfishtë** (të zakonshëm dhe administrativ) është sistemi i adoptuar në pjesën më të madhe të Europës (Itali, Francë, Belgjikë, Austri, Gjermani, Zvicër, Danimark, Greqi, etj) si dhe në Amerikën Latine (Uruguai, Kolombi, Panama).

Sipas këtij sistemi, duke qënë se veprimtaria administrative është në të njëjtën kohë dhe ushtim i të drejtës publike, mbeten në juridiksionin e gjykatave të zakonshme gjykimi i mosmarrëveshjeve me karakter administrativ.

Ndërsa juridiksioni për anulimin e akteve administrative të paligjshme i rezervohet organeve që ushtrojnë juridiksionin administrativ, që formalisht janë pjesë e administratës publike por njëkohësisht e pavarur nga kjo e fundit, sepse ato gëzojnë statusin e gjyqtarit.

Organet e juridiksionit administrativ, zakonisht janë qendrore, me kompetencë të shtrirë në të gjithë territorin shtetëror, psh. *Consilio di Stato* në Itali, *Conseil d'Etat* në Francë e Belgjikë, *Bundesverwaltungsgericht* në Gjermani.

Por mund të ekzistojnë dhe organe periferike të juridiksionit administrativ, psh. *Tribunals Administratifs Regionaux* në Francë.

❖ **Sistemi i juridiksionit të specializuar:** një sistem i ndërmjetëm mes dy sistemeve të lartpërmendura që është implementuar në Spanjë.

Sipas këtij sistemi, ekzistojnë pranë çdo shkalle të gjykatave të zakonshme, seksione të specializuara për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative

(*Sala de lo contencioso administrativo de las audiencias territoriales,*

*Sala de lo contencioso administrativo de la audiencia nacional,*

*Sala de lo contencioso administrativo de lo tribunal supremo,*

*Sala de la revision*).

Seksione të tilla janë të formura nga 1/3 e gjyqtarëve të zakonshëm, 1/3 gjyqtarë administrativ dhe 1/3 nga specialist të administratës publike.

Keto seksione janë të inkuadruar në sistemin gjyqësor.

❖ **Sistemi i mbrojtjes indirekte nëpërmjet padisë së përgjegjësisë,** është një sistem i adoptuar në disa vende të Amerikës Qendrore, si Meksikë, Peru, Brazil, Kostarikë, etj. Sipas këtij sistemi, mbrojtja e të drejtave subjektive të

personave privatë të cënuar nga veprimtaria administrative bëhet nëpërmjet një padie të ngritur ndaj funksionarit publik pranë gjykatave të zakonshme.

Kjo padi është kuptuar si dhënie e vlerës së përgjegjesisë nga qytetarët drejt funksionarit publik gjatë ushtrimit të funksionit publik. Gjyqtari në momentin që pranon paligjshmërinë e veprimtarisë administrative, ka fuqinë jo vetëm të dënojë funksionarin publik që të zhëmtojë dëmin, por dhe të bëjë të pavlefshëm aktin administrativ.

## 2.4. Standardet europiane në lidhje me gjykimin e akteve administrative

Shqyrtimi i efektshëm gjyqësor i akteve administrative është një element thelbësor i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në të njëjtën kohë është një instrument i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë administrative dhe për të siguruar qeverisje të mirë.<sup>44</sup>

Për më tepër, është kërkesë e një ekonomie në zhvillim pasi siguria e tregtisë dhe investimeve ndërkombëtare kërkojnë organe publike vendimmarrëse që t'u nënshtrohen mjeteve të efektshme të mbrojtjes.

Kjo ide themelore është pranuar nga të gjithë vendet europiane në këto dekadat e fundit pavarësisht qëndrimeve të ndryshme në lidhje me krijimin dhe organizimin e juridiksionit administrativ. Edhe pse ky zhvillim bazohet në tradita të ndryshme dhe fusha e gjykimeve administrative ndryshon shumë në sistemet ligjore të shteteve të ndryshme, në të vërtetë po ngrihet një kuadër përherë e më i qëndrueshëm i parimeve të përbashkëta.

Këtu nuk përcaktohet se si duhet të organizohet shqyrtimi gjyqësor, por parashikon rregullat e përgjithshme që duhet të respektohen nga Shtetet Anëtare në organizimin e shqyrtimit gjyqësor të akteve administrative, dmth, ai reflekton gjendjen e tanishme të “*Standardeve Europiane*” të cilat duhet të respektohen.<sup>45</sup>

Në kuadrin e këtij diskutimi, vlejné parimet e mëposhtme:

---

<sup>44</sup> Jean-Marie Woehrling - Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në Europë: Drejt një Modeli të Përbashkët, i redaktuar nga SIGMA (një iniciativë e përbashkët e OSBE-së dhe BE-së). Në këtë material gjenden shumë standarte por unë kam paraqitur ato më thelbësoret.

<sup>45</sup>Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në Europë: Drejt një Modeli të Përbashkët, SIGMA



- *Shqyrtimi gjyqësor duhet të kryhet nga një gjykatë e ngritur me ligj, pavarësia dhe paañësia e së cilës garantohen në kushtet e Rekomandimit Mbi Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve.*

Ky parim konfirmon që zgjidhja e një mosmarrëveshjeje administrative është çështje e një gjykate të ngritur me ligj, në pajtim me kërkesat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse kjo e fundit fillimisht mendohej të zbatohet në fushën administrative, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e ka konsideruar atë të zbatueshme për çështjet administrative qysh nga viti 1971<sup>46</sup>.

Ndarja e juridiksioneve administrative është e një rëndësie të veçantë. Meqenëse u kërkohet të zgjidhin mosmarrëveshje ku përfshihen organe publike, gjyqtarët e çështjeve administrative janë të ekspozuar përballë një rreziku të lartë të të qenit të ndikuar apo që konsiderohen sikur janë të ndikuar nga pushteti ekzekutiv.

Kështu, juridiksionet e veçanta priten që të japin të njëjtat garanci të paañësisë dhe pavarësisë si dhe gjykatat e zakonshme. Gjyqtarët e çështjeve administrative nuk duhet të jenë nëpunës civilë që pak a shumë shqyrtojnë ankesa administrative formale, por gjyqtarë të vërtetë dhe plotësisht të pavarur.

- *Gjykata mund të jetë një gjykatë administrative ose pjesë e sistemit të zakonshëm gjyqësor*

Ky parim plotëson të mëparshmin, duke përcaktuar karakteristikat e organit përgjegjës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative.

---

<sup>46</sup> Gilles Dutertre, Pjesë nga çështjet kryesore, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut 2003, f. 174-180

Ky u referohet të dy modeleve që ushtrohen tradicionalisht në vendet europiane, dmth, një juridiksion administrativ që është autonom dhe një që është i integruar në sistemin gjyqësor të zakonshëm.

Këto modele shpesh janë vendosur kundrejt njeri-tjetrit duke e specifikuar të parin si një juridiksion administrativ “të specializuar”.

Megjithatë, kjo kundërvënie nuk korrespondon domosdoshmërisht me ndonjë ndryshim thelbësor, pasi edhe sistemi gjyqësor i zakonshëm mund të sigurojë një shkallë të lartë specializimi duke krijuar dhoma ose seksione të çështjeve administrative, ashtu siç kanë bërë shumica e vendeve që kanë ruajtur unitetin e juridiksionit. Sidoqoftë, përsa i takon përputhshmërisë me standardet europiane, të dy modelet janë të barabartë.

- *Vendimi i gjykatës që shqyrton një akt administrativ, të paktën në çështjet e rëndësishme, duhet t’i nënshtrohet ankimit në një gjykatë më të lartë, përveç kur çështja i dërgohet drejtpërdrejt gjykatës më të lartë administrative në pajtim me legjislacionin vendas.*

Megjithëse në bazë të Konventës për të Drejtat e Njeriut mjetet e ankimit nuk janë detyruese, kërkohet një e drejtë ankimi në shumicën e rasteve, me mendimin që mbrojtja e përshtatshme gjyqësore përfshin të drejtën për një gjykim të dytë.

Megjithatë, është në kompetencën e Shtetit të vendosë kufirin brenda të cilit mund të bëhen ankime tek gjykatat më të larta dhe të specifikojnë juridiksionin e organit të ankimit. Meqenëse përfshirja e një instance më të lartë në gjykimin administrativ mendohet thelbësore për të garantuar njëtrajtshmërinë e praktikës gjyqësore administrative, parimi nuk zbatohet nëse një çështje i dërgohet drejtpërdrejt gjykatës më të lartë në pajtim me ligjin e brendshëm.

- *Personave fizikë dhe juridikë mund t'u kërkohe të ushtrojnë mjetet mbrojtëse të parashikuara nga ligji i brendshëm para se të kenë të drejtën e shqyrtimit gjyqësor. Procedura e ushtrimit të këtyre mjeteve mbrojtëse nuk duhet të jetë e tejzgjatur.*

Ushtrimi i mjeteve të tjera mbrojtëse para kërkimit të shqyrtimit gjyqësor bën të mundur parandalimin e ngarkesës së tepërt të punës për gjykatat duke ndikuar në efikasitetin gjyqësor.

Kjo është në interes të gjyqësorit dhe administratës dhe mund të kontribuojë në pakësimin e shpenzimeve procedurale për individin. Megjithatë, ky detyrim nuk duhet të ndalojë personat fizikë dhe juridikë të kërkojnë shqyrtimin gjyqësor të aktit administrativ duke e zgjatur gjykimin në tërësi në mënyrë të parregullt.

Këshilli i Europës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) kanë luajtur një rol të veçantë në përcaktimin e standardeve në kontrollin gjyqësor të veprimtarisë së administratës publike. Këshilli i Europës ka miratuar disa rekomandime dhe ka shpërndarë informacion, dokumente dhe studime mbi praktikat më të mira.

Bashkimi European, e kryesisht vendimet gjyqësore me fuqi ligjore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, ushtron një ndikim të rëndësishëm në përafrimin e traditave kombëtare mbi kontrollin gjyqësor.

Këto vendime gjyqësore me fuqi ligjore, po influencojnë shtetet anëtare të BE-së sikundër edhe vendet candidate.

Disa teknika që kanë ndezur debate si nocioni ligjor i përgjegjësisë dhe kontrolli i fuqive diskreciale, i kanë të gjitha rrënjët në legjislacionin e shteteve anëtare. Në këto rrethana, një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare të BE-së si dhe disa vende

kandidate, janë duke rivlerësuar zgjedhjet organizative që kanë bërë si dhe rregullat procedurale të shqyrtimit gjyqësor mbi aktivitetet administrative.

## 2.5. Zgjidhja e konfliktit në gjykatën administrative

Franca konsiderohet “*djep*” i gjyqësisë administrative.

Ç’është e vërteta, praktika juridike franceze ka krijuar format e para të gjyqësisë administrative dhe të konfliktit administrativ (*le contentieux administratif*).

Në fillim të shekullit të XIX-të, zgjidhja e konflikteve administrative midis administratës publike dhe qytetarëve i ishte besuar këshillave të veçanta dhe Këshillit Shtetëror. Në këtë mënyrë, Franca shërbeu si “*model*” dhe si “*shembull*” për gjyqësinë administrative që, më vonë, u ndoq edhe nga vendet e tjera të Europës.

Qysh në shqyrtimet hyrëse vlen të theksohet se Këshilli Shtetëror në Francë, nga një “*organ administrativ*” me kohë “*u shndërrua*” në një “*gjykatë të veçantë administrative*”, me kompetencë që të zgjidhë konfliktet administrative.

Një fakt i tillë “*ndikoi në masë të madhe*” në “*qëndrimin e teorisë franceze*”, sipas së cilës gjykatat e veçanta administrative u konsideruan “*pjesë e pushtetit administrativ*”, e jo “*pjesë e pushtetit gjyqësor*”.

Në fakt, doktrina franceze përherë ka “*refuzuar*” që Këshillin Shtetëror dhe gjykatat e tjera administrative t’i trajtojë si pjesë e “*sistemit unik gjyqësoro-juridik*”, veçse i ka paraqitur si “*organizata të veçanta*”, të lindura në krahun e administratës<sup>47</sup>.

Gjyqësia administrative sot është e përhapur gjithandej nëpër Europë.

Në Shqipëri u bënë përpjekje të gjata për instalimin e saj. Në vështrimin e parë, i referohet historikut të instalimit të gjykatave administrative, hezitimeve dhe rezervave të para ndaj saj, përqafimit të modeleve të ndryshme, me një qasje të përgjithshme për mundësitë dhe përparësitë, ndërsa vështrimi i dytë përgjigjet në pyetjen që shtron konferenca për Gjykatat Administrative në Shqipëri: Alternativë apo Domosdoshmëri?

---

<sup>47</sup> Ivo Borkovic, po aty, faqe 449.

## KAPITULLI III: PARIMET E GJYKIMIT

### ADMINISTRATIV

#### 3. Parimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive të individëve

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është parashikuar si formë qeverisjeje Republika Parlamentare. Çka do të thotë se shteti ynë ka përkrahur një regjim të lirë demokratik duke përjashtuar çdo sundim arbitrar dhe autoritar.

Një nga elementët thelbësor të demokracisë funksionale ndër të tjera është njohja dhe zbatimi i kërkesave të parimit të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës është një parim universal, në thelb të të cilit vendoset garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Duke u nisur nga ajo që thamë më sipër, shteti duhet të marrë masat e duhura për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe për këtë arsye janë krijuar edhe gjykatat.

Të drejtat e individëve janë të drejta me karakter subjektiv dhe në momentin që shkelen, ata kanë të drejtë t'i drejtohen organeve kompetente për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur. Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, këto organe duhet të mbrojnë në mënyrë efektive të drejtat e individëve duke mos cënuar të drejtat e tyre<sup>48</sup>.

Ajo që vëmë re është fakti që organet kompetente (*Gjykatat Administrative*), gjatë ushtrimit të kompetencave për mbrojtjen në mënyrë sa më efektive të të drejtave të individëve duhet të zbatojnë drejt ligjin dhe të mos cënojnë të drejtat e individëve.

---

<sup>48</sup> neni 1\c i ligjit

### **3.1. Pavarësia e gjykatave administrative**

#### **Me pavarësi të gjyqësorit kuptojmë emancipimin e agjentëve të drejtësisë.**

Nisur nga përkufizimi i dhënë më sipër dalin dy nocione të cilat kërkojnë domosdoshmërinë e dhënies së një përkufizimi e për rrjedhojë dhënies së një kuptimi.

#### **a- Emancipim**

Me *emancipim* kuptojmë integritet të lartë moral dhe profesional, nënshtrimin ndaj ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit përmes së drejtës.

#### **b- Agjentë**

Me *agjentë* kuptojmë personat e emëruar konform procedurave ligjore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

Kur flasim për pavarësinë e gjyqësorit duhet të dimë se po flasim për themelet e një shteti demokratik dhe të së drejtës. Ideatori i konceptit të pavarësisë së gjyqësorit është Monteskje i cili mendonte se pavarësia arrihej përmes parimit të ndarjes së pushteteve, parim ky universal dhe kushtetues parashikuar në nenin 7 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë<sup>49</sup>.

Por, nga ana tjetër, kriza ekonomike që pësoi bota dhe efektet që ajo pati u reflektuan edhe në qeverisje, rrjedhimisht në administratë. Në mekanizmat e ndërmarrë për daljen nga kriza mund të gjejmë ndoshta një raport të ndryshuar mes dy pushteteve,

---

<sup>49</sup> neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

atij ekzekutiv dhe atij legjislativ. Të gjitha këto ndërmarrje na drejtojnë në një pyetje të rëndësishme: Mos po braktiset teoria e Monteskjës për ndarjen e pushteteve?<sup>50</sup>

Parimi i ndarjes së pushteteve doli për një qëllim, arritjen e një demokracie funksionale dhe liberale, për të mos lejuar mundësinë e përqëndrimit të pushtetit në një dorë njohur ndryshe si parimi i unitetit të pushtetit.

**Sipas Monteskjës, nuk ekziston liri në qoftë se pushteti për të gjykuar nuk është i ndarë nga pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës.**

Ky është një parim themelor sepse lejon ndarjen e sovranitetit politik i cili krijon të drejtën, nga sovraniteti juridik që zbaton të drejtën duke nënshtruar ndaj ligjit çdo subjekt.

Në nenin 5 të LGJA<sup>51</sup> flitet për kriteret e emërimit dhe të karrierës së gjyqtarëve, statusi i tyre, përgjegjësia për shkeljet disiplinore, masat disiplinore, procedimi disiplinor, administrimi i shërbimeve në gjykatë si dhe riorganizimi gjyqësor.

Këto kriteret rregullohen edhe sipas dispozitave të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, me përjashtim të rastit kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Kjo dispozitë në pamje të parë duket se krijon kushte të favorshme për pavarësinë e gjykatave sepse rregullat që vlejné për gjykatat e zakonshme do vlejné edhe për gjykatat administrative me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Çka do të thotë se ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë do të shtrijë efektet e tij juridike edhe mbi gjykatat administrative.

---

<sup>50</sup>Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku, Leksion për studentët e Doktoraturës “Hapësira Administrative Europiane (HAE). Globalizimi dhe e drejta Administrative”, Tiranë, 2013, fq. 6.

<sup>51</sup> neni 5 i Ligjit Nr. 49/2012



## 3.2. Llojet e pavarësisë

### A. Pavarësia juridiksionale

Ne mund të flasim për një rend juridiksional administrativ vetëm në qoftë se rregullat e funksionimit si dhe statusi i gjyqtarëve të juridiksionit është i ndryshëm nga ato të gjyqtarëve të zakonshëm. Në shtete të ndryshme si Italia, Gjermania, Franca, etj kanë një rend juridiksional në kuptimin e mirëfilltë sepse rregullat e funksionimit të tyre bëhen mbi bazën e një legjislacioni të ndryshëm nga ai i gjykatave civile apo penale.

Pyetja që ngre është: *ligji per gjykatat administrative a garanton nje rend juridiksional administrativ duke u nisur nga çka thamë më lart?*

Kur folëm për kuptimin e pavarësisë së gjykatave më sipër u citua neni 5 i LGJA dhe nga një interpretim logjik që i bëjmë dispozitës në fjalë, shikojmë që gjykatat administrative funksionojnë në bazë të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri.

Kjo në fakt na vendos në situatën që nuk ndodhemi përballë një rendi juridiksional administrativ.<sup>52</sup>

---

<sup>52</sup> neni 5\1 i LGJA

## **B. Pavarësia ndaj çdo ndikimi të jashtëm**

Pavarësia e gjykatave administrative arrihet përmes elementëve të tillë kushtetues si:

✓ *Eliminimi i marrëdhënieve hierarkike:*

Sepse marrëdhëniet ngushtësisht të ngatërruara midis eprorit dhe vartësit do të sillnin një çrregullim të raportit të balancuar që është arritur midis tyre, i sanksionuar shumë qartë në Kushtetutë. Ne këtë të fundit është përcaktuar në mënyrë taksative se gjyqtarët i binden vetëm Kushtetutes dhe Ligjit.

Nisur nga ajo që thamë më lart dhe nga një interpretim literal por edhe logjik dalim në përfundimin se gjyqtarët nuk kanë marrëdhënie vartësie midis njëri tjetrit. Në kuptimin që në vendimarrjen e tyre apo të ushtrimit të kompetencave nuk marrin urdhra të natyrave të ndryshme, tipike kjo për marrëdhëniet e vartësisë të krijuara nga marrëdhënie pune.

Duhet përmendur fakti që të njëjtën formë kanë ndjekur edhe shtetet si Gjermania, Italia, etj... që gjyqtarët nuk mund të detyrohen të marrin një vendim në bazë urdhri por janë të detyruar të zbatojnë Ligjin si dhe Vendimet Unifikuese të gjykatave më të larta në shkallë.

✓ *Publikimi i vendimeve gjyqësore:*

Ky veprim rrit transparencën e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e besimit të qytetarëve, individëve, palëve në proces për një gjykatë të pavaruar dhe të paanshme.

✓ *Mënyra e emerimit:*

Meritokracia duhet të jetë kryefjala e të gjithë emërimeve të gjyqtarëve në pozicionet konkrete, shmangia e emërimeve me ngjyrimet politike si dhe tolerancë “0” ndaj emërimeve me bazë nepotizmi.

Mënyra e emerimit të gjyqtarëve është një nga hapat për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit. Kushtetuta e vendit tonë si ligj themeltar synon të arrijë një pushtet gjyqësor të pavarur, po ashtu edhe një qendrushmeri midis tri pushteteve<sup>53</sup>.

Fakti që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar emërimin si mënyrën e vendosjes së gjyqtarëve në atë detyrë tregon për rëndësinë e lartë kushtetuese që i është dhënë garantimit të pavarësisë së gjyqësorit. Kushtetuta e vendit tonë i ndan gjyqtarët e për rrjedhojë gjyqësorin nga pushteti politik, një parim ky i njohur nga shtetet liberale.

Në vende të tjera që nuk përfshihen në grupin e shteteve kontinentale ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtete si Anglia, Uellsi, Australia dhe që përbëjnë atë që quhet *common law* pavarësia e gjyqësorit arrihet jo përmes elementëve ligjorë, kushtetues apo përmes procedurave burokratike siç shquhen vendet kontinentale por përmes elementëve të tillë si profesionalizmi, integriteti i lartë moral në ushtrimin e profesionit që lidhet me një kulturë të zhvilluar qytetare.

Ajo që vihet re është fakti se në ndryshim nga vendet e *common law*, vendet që përbëjnë bllokun kontinental, kanë përkrahur sistemin Francez i cili është një sistem i burokratizuar në kuptimin që parashikohet, të qenurit gjyqtar të emëruar, si rregull, përmes konkursit publik si dhe në parashikimin e elementëve kushtetues që lidhen me

---

<sup>53</sup>Sabino Cassese, “Corso di Diritto Amministrativo”, “Istituzioni di Diritto Amministrativo”, quarta edizione, Giuffrè Editore, Varese, Milano, 2012, fq. 24.

palëvizshmerine e gjyqtarëve si dhe pavarësinë dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të profesionit.

Nisur nga ajo që thamë më sipër, Kushtetuta e vendit tonë ka përkrahur modelin Francez në lidhje me mjetet dhe mënyrat e përdorura për garantimin e pavarësisë së gjyqësorit. Kushtetuta Republikës së Shqipërisë u ka siguruar gjyqtarëve autonomi dhe pavarësi në raport me organet e tjera.

Bazat kushtetuese dhe europiane për emërimin e gjyqtarëve, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka parashikuar se cilat janë organet kushtetuese që bëjnë emërimin e gjyqtarëve si dhe procedurën dhe mënyrën e emërimit të tyre, por këto jo në mënyrë të detajuar. Pjesa tjetër e rregullave proceduriale janë të parashikuara në ligj të posatshëm.

Në vitin 1985 Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)<sup>54</sup> ka miratuar parimet themelore për pavarësinë e organeve gjyqësore. Vlen të përmendet fakti se në këtë dokument OKB i bën thirrje shteteve të cilat miratojnë këtë dokument dhe parimet e sanksionuara në të, t'i marrin në konsideratë për përfshirje në legjislacionin e brendshëm apo kombëtar. Në këtë dokument janë përcaktuar në mënyrë specifike se çfarë cilësish duhet të ketë një gjyqtar për t'u emëruar si dhe procedurat që duhen ndjekur në përzgjedhjen e tyre. Vlen të përmendet fakti se shteti shqiptar, përmes organit ligjvënës, keto parime të vendosura në këtë dokument i ka bërë pjesë të sistemit të brendshëm ligjor.

---

<sup>54</sup>OKB, "Basic principles on the independence of the Judiciary", mbajtur në Milano, nga 26 gusht deri më 6 shtator 1985.

✓ *Ngritja në detyrë:*

Duhet të jetë e motivuar dhe absolutisht në bazë të rezultateve të suksesshme individuale në zgjidhjen e çështjeve dhe dhënien e drejtësisë.

✓ *Shkarkimi nga detyra:*

I bazuar në ligj dhe prova, janë dy faktorët kryesorë të cilët çojnë eprorët e mëdhenj për të ndërmarrë këtë veprim ndaj një gjyqtari.

### **3.3. Parimi i mbrotjes së interesave të ligjshme**

Në LGJA përfshihen si të drejtat subjektive ashtu edhe interesi i ligjshëm. Keto dy të drejta janë aq te ngjashme me njëra tjetrën saqë në praktikë ngatërrohen mes tyre duke qenë sinonime të njëra tjetrës. Dallimin midis këtyre dy të drejtave e ka bërë praktika por edhe doktrina juridike e cila i përshkruan këto të drejta në këtë mënyrë.

**Të drejtat subjektive** janë të drejta që lidhen ngushtësisht me subjektet e së drejtës.

Ndërsa **interesi i ligjshëm** është një e drejtë që nuk lidhet ngushtësisht me subjektet e së drejtës. Psh, një organ “x” i administratës publike nxjerr një akt administrativ individual drejtuar subjektit “y” me objekt “prishje e ndërtimit pa leje”. Në afërsi të kësaj ndërtese ndodhet një tjetër ndërtesë e cila mund të rrezikojë shembjen si rrjedhojë e prishjes së ndërtesës pa leje. Ndodhur përballë një fakti të tillë lind e drejta për të kundërshtuar këtë akt nga subjekti “xy”, pronar i ndërtesës që rrezikon shembjen dhe të drejtohet në organet kompetente për të kërkuar ndryshimin e aktit ose shfuqizimin e tij.

Siç e shikojmë, akti administrativ nuk iu drejtua subjektit “xy” por subjektit “y”, por duke qenë se nga ky akt preken interesat e tij, krijojnë atë që quhet interes i ligjshëm.

### **3.4. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor brenda afateve të arsyeshme**

E drejta për një proces të rregullt gjyqësor është një nga të drejtat më të rëndësishme të individëve, krahas asaj të jetës. Ajo është një e drejtë në të cilën përmbledhen një sërë të drejtash të individëve në lidhje me zhvillimin e një procesi gjyqësor. Kjo e drejtë është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe buron si e tillë nga neni 42 i saj ku thuhet shprehimisht dhe në mënyrë eksplicite se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Krahas Kushtetutës së vendit tonë shprehet edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut<sup>55</sup>. Në nenin 6 të kësaj Konvente thuhet se në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm, pavarësisht faktit se nga një interpretim që ne i bëjmë nenit 6 të Konventës del sikur nuk përfshihet e drejta për një proces të rregullt në lidhje me proceset gjyqësore administrative.

Në fakt, ka një vendim gjyqësor nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut se në lidhje me këtë dispozitë duhet bërë një interpretim i zgjeruar, nga i cili kanë dalë në përfundimin se pjesë e kësaj të drejte janë edhe proceset administrative<sup>56</sup>.

Në lidhje me këtë të drejtë shprehet edhe KPrC, i cili me përjashtim të disa dispozitave, gjen zbatim edhe në proceset gjyqësore administrative.

Duke u nisur nga përkufizimi i dhënë nga Kushtetuta dhe Konventa del se mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore në planin e brendshëm dhe në nivel evropian garantohet nga zhvillimi i një procedure gjykimi, e cila duhet të zhvillohet në mënyrë të drejtë e të paanshme.

---

<sup>55</sup> neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

<sup>56</sup> neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Për më tepër, për të konsoliduar zbatimin e ketij parimi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i njeh Gjykatës Kushtetuese kontrollin mbi garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Pjesë e pandarë e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor është zhvillimi i një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Siç shohim është një parim i cili nuk është bazuar në afate fikse dhe të prera.

Për këtë arsye ka patur edhe një abuzim nga gjykatat shqiptare në dhënien e drejtësisë duke zgjatur dhe stërzgatur proceset. Kjo për arsye nga më të ndryshmet që vetëm ligjore nuk mund të jenë. Për të treguar rëndësinë e kësaj të drejte mjafton të përmendet një thënie monumentale dhe historike për të drejtën dhe drejtësinë, "*drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar*".

Kjo e drejtë gjen shprehje në Kushtetutën e vendit tonë si edhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në Kushtetutë thuhet shprehimisht "*kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore,.... ka të drejtën e një gjykimi .... brenda një afati të arsyeshëm*".

Praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut ka treguar që, edhe pse afati i arsyeshëm është subjektiv, koha e shpenzuar është një fakt objektiv. Po sipas kësaj gjykate kur gjykohet asyeshmëria e afatit merren në konsideratë faktorë të tjerë si;

- a. Komplexiteti i çështjes
- b. Interesesi që mund të jetë cënuar
- c. Mënyra e shqyrtimit të çështjes nga autoriteti gjyqësor
- d. Sjella e kërkuesit.



### 3.5. Parimi i mospushimit të gjykimit nga mosparaqitja e palëve në proces

Futja e këtij parimi në ligjin për gjykatat administrative realizoi një devijim nga praktika e ndjekur deri tani nga gjykatat shqiptare. Kjo për faktin e thjeshtë se në KPrC të Republikës së Shqipërisë parashikohet se nëqoftëse paditësi nuk paraqitet në seancën gjyqësore për shkaqe të paarsyeshme ose jo, për shkaqet të cilat lejojnë mungesën në gjykim, bën që gjykata të pushojë çështjen. Me riformulimin e kësaj dispozite, në LGJA është parashikuar se mungesa e palëve në proces nuk sjell pushimin e gjykimit.

Ajo që vlen të përmendet është fakti se ky parim është i vlefshëm vetëm për aktet shkresore. Me këtë do të kuptojmë se nuk do ndodhemi përpara pushimit të gjykimit si pasojë e mungesës së palëve në proces por vetëm për aktet të cilat kanë si formë juridike atë të shkruar, formë e cila shërben për vlefshmërinë e aktit të ndërmarrë. Duke u ndodhur përballë një fakti të tillë juridik ngre një pyetje; ***po aktet e ndërmara nga një organ i administratës publike jo në formë të shkruar, a i nënshtrohen këtij parimi?***

Nga një interpretim literal por edhe logjik që ne i bëjmë dispozitës në fjalë dalim në përfundimin se ky parim nuk vlen për aktet jo të shkruara të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme. Sipas kësaj, bërja e një padie ndaj një akti jo shkresor të ndërmarrë nga një organ i administratës publike dhe mos paraqitja e palës paditëse në proces pa shkaqe të arsyeshme bën që gjykata të pushojë çështjen. Një tjetër konstatim është fakti se për aktet e shkruara nuk do zbatohen rregullat e parashikuara nga KPrC për pushimin e gjykimit, kjo sepse janë dy parime bazë të cilat thonë;

- a. *Lex posterioris derogat lex anterioris* (ligji i mëvonshëm revokon ligjin e mëparshëm)

b. *Lex specialis prevalon mbi lex generalis* (ligji i veçantë prevalon mbi ligjin e përgjithshëm)

Ndërkohë për aktet e pashkruara do zbatohen rregullat e KPrC në lidhje me pushimin e gjykimit.

### 3.6. Parimet e gjykimit administrativ

- Gjykata në gjykimin administrativ siguron mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive e interesave kushtetuese dhe ligjore të subjekteve që realizohen ose çënohen si pasojë e ushtrimit ose jo të veprimtarisë administrative nga ana e organeve të administratës publike, brenda afateve të shpejta e të arsyeshme.
- Organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë bazueshmërinë e veprimit administrativ të kryer prej tij si dhe ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve në fushën e marrëdhënieve të punës.
- Gjykata Administrative, sipas natyrës së çështjes, gjykon edhe mbi aktet shkresore dhe mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.<sup>57</sup>

Të gjitha parimet që kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë dhe në veçanti në dispozitat e K.Pr.A duhet të merren parasysh nga organi kompetent gjatë procedimit. Sepse ato parime tregojnë edhe një herë vlerën e madhe që ka respektimi i të drejtave të individëve gjatë zhvillimit dhe shqyrtimit gjyqësor.

---

<sup>57</sup> neni 3 i LGJA

### ***3.6.1. Parimi i ligjshmërisë***

Ky parim kërkon që zyrtari të veprojë në përputhje me ligjin, të zbatojë rregullat dhe procedurat e vendosura në legjislacionin e komunitetit.

Zyrtari duhet të tregojë kujdes, në veçanti, që vendimet të cilat prekin të drejtat apo interesat e individëve, të jenë të bazuara në ligj dhe përmbajtja e tyre të jetë në përputhje me ligjin.

Parimi i ligjshmërisë kërkon që organi i administratës publike të zhvillojë veprimtarinë e tij në përputhje me Kushtetutën e R.SH, me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat ka aderuar Shqipëria si dhe me ligjet, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca.<sup>58</sup>

Ky parim lejon që në çështjet administrative çdo organ kompetent të ketë diskrecion për të vendosur sipas çmuarjes së tij të lirë, qoftë edhe pa autorizimin e shprehur të ligjit, me kusht që të mos jetë e ndaluar.

---

<sup>58</sup> Shih Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative

### **3.6.2. Parimi i barazisë**

Parimi i barazisë kërkon që në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike të mos privilegjojë ose të mos diskriminojë palët në proces për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare, filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, etj.<sup>59</sup>

---

<sup>59</sup> Shih Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative

### 3.6.3. *Parimi i mbrojtës së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë*

Gjatë zhvillimit të procedimit administrativ, organet e administratës publike, kanë detyrë që palëve t'ua bëjnë sa më të lehtë procedurën, t'i mbrojnë dhe t'i realizojnë të drejtat e tyre, duke patur parasysh që realizimi i këtyre të drejtave të mos dëmtojë dhe të mos jetë në kundërshtim me interesat publike.

Këto të drejta mund të kufizohen vetëm për arsye të zbatimit të parimit të proporcionalitetit.<sup>60</sup>

---

<sup>60</sup> Shih Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative

#### **3.6.4. Parimi i drejtësisë**

Parimi i së drejtës materiale.

Që një organ të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj duhet të respektojë parimin e drejtësisë. Ky parim e detyron organin vendimarrës që të vërtetojë vetëm gjendjen reale faktike.

Në procedimin administrativ kërkohet të vërtetohet gjendja e drejtë e çështjes dhe për këtë qëllim duhet të vërtetohen të gjitha faktet që kanë rëndësi për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë.<sup>61</sup>

---

<sup>61</sup> Shih Ligji Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative

### 3.6.5. *Parimi i dëgjimit të palëve*

E drejta për t'u dëgjuar është një nga parimet kryesore që karakterizon rregullshmërinë e një procesi ligjor. Ky është një parim kushtetues që shtrihet në të gjitha procedurat ligjore, qofshin këto të aspektit penal, civil apo administrativ.

E drejta për t'u dëgjuar lidhet ngushtë me të drejtën për t'u mbrojtur dhe me të drejtën për të zhvilluar një proces kontradiktor gjykimi, me qëllim që secila palë të ketë mundësi të paraqesë përpara organit kompetent të gjithë argumentet e nevojshme ose mjetet juridike që i vlejnë në zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes.

E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nuk mund të realizohen nëse nuk u jepet mundësia palëve për të shqyrtuar dokumentacionin aq herë sa është e nevojshme për mbrotjen e interesave të palëve.<sup>62</sup>

E drejta e dëgjimit të palëve të interesuara është një nga të drejtat procedurale me një rëndësi të veçantë në një procedim administrativ. Kjo është dhe arsyeja pse kjo e drejtë trajtohet në këndvështrim të GJED dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Neni Kodin e Procedurave Administrative, parashikohen modalitetet e të drejtës së dëgjimit gjatë procedimit administrativ<sup>63</sup>.

Duke vlerësuar në parantezë garancitë që kjo dispozitë ka në raport me të drejtën për t'u dëgjuar, parashtrimi i qëndrimeve jurisprudenciale të GJED dhe Gjykatës Kushtetuese, bëjnë që kjo dispozitë dhe mundësia për ta përmirësuar atë të jetë në fokus të diskutimeve të mëvonshme.

---

<sup>62</sup> Shih Ligjin Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative

<sup>63</sup> Shih Ligjin Nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative



GJED e ka lidhur në mënyrë organike të drejtën e palës për t'u informuar në mënyrë të plotë me dokumentacionin që lidhet në të me garantimin e të drejtës së mbrojtjes.

Pra, nëse subjekti argumenton se ai nuk ka marrë dijeni lidhur me një document dhe kjo sjell një impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e mbrojtjes, atëherë kjo nuk mund të **riparohet** nga gjykata pasi është një çështje administrative.

Në gamën e vendimeve të cilat kanë trajtuar parimin e të drejtës së dëgjimit po analizojmë çështjen Nr. 110/10, **Solvay v Komisionit**, ku është vendosur anulimi i Vendimit të Komisionit European të datës 13 dhjetor 2000, 2003/5/EC, lidhur me procedimin bazuar në nenin 81 të Traktatit. Kjo gjykatë arsyeton:

*“ ...E drejta e mbrojtjes është një e drejtë themelore, e cila formon një pjesë integrale të parimeve të përgjithshme që Gjykata garanton.... Respektimi i të drejtës së mbrojtjes gjatë një procedimi para Komisionit, në lidhje me vendosjen e një gjobe kundrejt një kompanie për shkelje të ligjit të konkurrencës, kërkon që vendimmarrja në fjalë të jetë e bazuar në fakte të bëra të njohura dhe në dokumentacionin ku Komisioni është bazuar dhe ku ka mbështetur pretendimet e tij se kemi shkelje të Traktatit...<sup>64</sup>*

*E drejta e aksesit në dokumentacion do të thotë që Komisioni t'i jape subjektit në fjalë mundësinë të shqyrtojë të gjitha dokumentet në dosjen hetimore që mund të jenë relevante për mbrojtjen e tij. Këto dokumente përfshijnë ato dokumente që lidhen apo nuk lidhen me të, pa çënuar sekretet tregtare të subjekteve të tjera, dokumente të brendshme të Komisionit dhe çdo informacion tjetër i konsideruar...*

---

<sup>64</sup> neni 81 i Traktatit

*Shkelja e të drejtës së aksesit në dokumentacion gjatë procedurës para se vendimi të miratohet, mund të çojë në parim, në anulimin e këtij vendimi, nëse subjekteve u është cënuar e drejta e dëgjimit... Në këtë rast, shkelja e ndodhur nuk mund të rregullohet duke lejuar akses gjatë procedurës gjyqësore. ...Në të vërtetë, shqyrtimi gjyqësor i kufizuar në objektin e kërkesës së depozituar, nuk ka për objekt dhe as efekt të zëvendësojë hetimin e plotësuar gjatë praktikës së një procedimi administrativ...*

*Njohja me vonesë e disa dokumenteve të lidhura me aktin nuk ka të bëjë me faktin se në cilën situatë do të gjendej subjekti dhe organi, por ka lidhje vetëm me faktet që duhet t'i parashtroheshin institucionit... Në qoftë se jemi para situates kur subjekti është njohur me dokumentacionin gjatë procesit gjyqësor, nuk është e detyrueshme për atë të provojë që mosnjohja me dokumentacionin do të sillte një vendim tjetër, por të argumentojë se ato dokumente do të ishin të dobishme për mbrojtjen e tij...”<sup>65</sup>*

**Gjykata Kushtetuese ka patur disa vendime në të cilat ajo ka arsyetuar lidhur me impaktin që ka në një vendimmarrje të caktuar mosrespektimi i parimit të dëgjimit duke e parë çështjen edhe në kontekstin e të drejtës së mbrojtjes.**

Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 17/2004 ka arsyetuar se:

*“...në referencë të rregullave proceduriale që parashikohen për zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit si dhe të konceptit kushtetues të individit për të gëzuar një proces të rregullt ligjor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkelur të drejtën e kerkueses për t'u dëgjuar dhe mbrojtur në kuptim të nenit 42 të*

---

<sup>65</sup> Çështja 110\10 Solvay v Komisionit

*Kushtetutes dhe të nenit 6 të KeDnJ.*<sup>66</sup>

*Në rastin konkret, nuk kanë ekzistuar raste teparashikuara në nenin 96 të KPA.*

*Në të njëjtën kohë, në këtë çështje Gjykata Kushtetuese është nisur nga kuptimi kushtetues që i është dhënë të drejtës për një proces të rregullt ligjor.*<sup>67</sup>

*Jurisprudenca e GJeDnJ dhe në veçanti ajo shqiptare, kanë pranuar se elementët thelbësorë të kësaj të drejte zbatohen si për procedurat gjyqësore, ashtu edhe për procedurat parlamentare dhe ato administrative.*

*E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasin kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit si dhe përbën njëkohësisht një detyrim për këto që të mos çënojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa u siguruar respektimi i procedurave të rregullta ligjore”.*<sup>68</sup>

**Ndërsa në vendimin interpretues Nr. 75/2002, Gjykata Kushtetuese, shprehet se:**

*“...njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, mematerialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementët bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cënimin e së cilës jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast si shkelje të Kushtetutës”.*<sup>69</sup>

---

<sup>66</sup> Neni 42 i Kushtetutes dhe neni 6 KEDNJ

<sup>67</sup> Kodi Procedurave Administrative

<sup>68</sup> Vendimi nr 17/2004

<sup>69</sup> vendimi nr 75/2002 i Gjykatës Kushtetuese

**Në vijim të paraqitjes së jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në vendimin Nr. 76/2002 ajo shprehet se:**

*“...Kuvendi, gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk i është përmbajtur pikërisht respektimit të këtyre standarteve. Kështu, Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena të gjitha akuzat e drejtura ndaj kërkuesit, duke u mbështetur vetëm në diskutimet e deputetëve, pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kërkuesin për përmbajtjen e materialit në ngarkim të tij, pa i dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe pa e dëgjuar atë për të parashtruar prapësimet rreth këtyre akuzave”.<sup>70</sup>*

---

<sup>70</sup> vendimi nr 76/2002

# KAPITULLI IV: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE ADMINISTRATIVE

## 4.1. Ngritja e Gjykatës Administrative dhe pasojat e para në praktikë

Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative hyri në fuqi në maj të vitit 2012, me klauzolën që do fillonte zbatimin pasi të ishte ngritur struktura me anë të një dekreti të Presidentit të Republikës.<sup>71</sup>

Më datë 4 nëntor 2013, me anë të dekretit filloi zbatimin ky ligj me startimin e punës të Gjykatave Administrative. Gjatë periudhës së lënë pezull nga moment i hyrjes në fuqi deri në momentin kur Gjykata Administrative filloi punën, çështjet administrative gjykoheshin nga seksionet administrative në gjykatën civile.

Puna e Gjykatës Administrative menjëherë pasi kishte filluar funksionimin u ndesh me disa probleme, të cilat çuan Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të dilnin me 2 Vendime Unifikuese, për të unifikuar këto problematika.

Ligji për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative ndryshe nga ligjet e tjera nuk kishte parashikuar dispozitat kalimtare të cilat të rregullonin çështjet në gjykim. Për të zgjidhur këtë vakum ligjor, Gjykata e Lartë u shpreh se: Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit Administrativ dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të krijuara me ligjin nr. 49, datë 03.05.2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, janë kompetente për shqyrtimin e të gjitha

---

<sup>71</sup>Neni 73 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”

çështjeve, të cilat sipas nenit 7 të këtij ligji përbëjnë mosmarrëveshje administrative, pavarësisht gjendjes, fazës apo shkallës së gjykimit.<sup>72</sup>

Këto gjykata janë kompetente për çështjet administrative për të cilat, padia, ankimi ose rekursi është depozituar përpara datës 04.11.2013, respektivisht në gjykatat e shkallës së parë, të apelit apo në Gjykatë të Lartë dhe deri në këtë datë, shqyrtimi në këto gjykata nuk ka përfunduar akoma.

Me anë të këtij vendimi, Gjykata e Lartë zgjidhi një vakum ligjor, por çështja që ngrihet është, a është kushtetues dhe a ka kompetencë për të gjykuar çështjen?

Për zgjidhjen e kushtetutshmërisë së vendimit, çështja është dërguar në Gjykatën Kushtetuese, e cila akoma nuk ka dalë me një vendim.

Vendimi gjithashtu solli reagime në rradhët e juristëve, pasi kishte çështje të cilat ishin në fazën ku ishte mbyllur shqyrtimi gjyqësor dhe pritej shpallja e vendimit dhe në bazë të këtij vendimi, gjykata është e detyruar të nxjerrë çështjen për inkompetencë. Si pasojë, çështja do fillojë gjykimin nga e para.

Po në rastet kur gjykata ka marrë vendimin, por ka lënë një datë për ta shpallur atë, a mund të gjykojë kompetencën kur vendimi tashmë është marrë? Edhe në këtë rast në bazë të Vendimit Unifikues gjykata ka deklaruar inkompetencën, duke e dërguar çështjen për gjykim në gjykatën administrative.

**Pavarësisht se në dukje Vendimi Unifikues ka zgjidhur një problem, mendoj që pasojat në praktikë janë shumë të rënda, pasi është cënuar parimi i sigurisë juridike, parimi i vazhdimësisë së gjykimit, ku një çështje duhet të niset dhe të**

---

<sup>72</sup>Neni 7 i ligjit nr.49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

**përfundohet nga e njëjta gjykatë dhe nga i njëjti trup gjykues, parimi i ekonomizimit të gjykatës, parimi i zgjidhjes së çështjes brenda një afati të arsyeshëm, etj.**

Gjithashtu në zbatim të këtij vendimi, gjykatat kanë nxjerrë çështjet jashtë kompetence, duke i vënë gjykatës administrative një ngarkesë të madhe, pasojat e së cilës vihen re në shkeljen e afateve brenda të cilave duhet të përfundojë një gjykim administrativ.

Një tjetër problem që është hasur ka të bëjë me shtrirjen e kompetencave të Gjykatës Administrative. Në nenin 7 dhe në nenin 17 të Ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative janë parashikuar rastet të cilat do të gjykohen nga kjo gjykatë. Problemi që është hasur në praktikë ka të bëjë me rastet kur një çështje administrative është e ndërthurur me një çështje civile.<sup>73</sup>

Për zgjidhjen e kësaj problematike Gjykata e Lartë ka dalë me një Vendim Unifikues duke u shprehur se kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i thjeshtë i tyre, atëherë referuar nenit 61 dhe 159 të K.Pr.Civile dhe 13 dhe 23 të Ligjit 49/2012, gjykata duhet të veçojë objektet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore duke ia kaluar ato gjykatës kompetente.<sup>74</sup>

Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i ndërvarur mes tyre,

---

<sup>73</sup> Neni 7 dhe neni 17 të LGJA

<sup>74</sup> Neni 61 dhe 159 të K.Pr.Civile

atëherë referuar nenit 55 të K.Pr.Civile dhe nenit 24 të Ligjit dhe zbatimit të parimit “*lex specialis derogat generali*”<sup>75</sup>, gjykata kompetente është si më poshtë:

- kur në objektin e gjykimit pala paditëse, ndër të tjera, ka për objekt kundërshtimin e një akti administrativ dhe nga pasojat e aktit prodhohen pasoja civile, në çdo rast kompetente është gjykata administrative,
- kur një ndër objektet e gjykimit është një kërkim me natyrë civile, por që është i lidhur ngushtë me aktin administrativ dhe pasojat e këtij akti kanë ardhur nga vullneti shtetëror, atëherë përsëri gjykatë kompetente është gjykata administrative,
- kur objektet e tjera të padisë jo të natyrës së mosmarrëveshjes administrative janë të ndërruarur nga pasojat e aktit administrative, edhe në këtë rast kjo të çon tek kompetenca e gjykatës administrative.<sup>76</sup>

Gjykata e Lartë ka arritur në këtë përfundim duke u bazuar në parimin “*lex specialis derogat generali*” si dhe sipas gjykates ligji për organizimin e gjykatës administrative nuk është thjesht një ligj material por dhe një ligj procedural.

Sipas vendimit të mësipërm do ndajmë dy momente, kur padia dhe kundërpadia mund të ndahen (fakt që bie në kundërshtim me aspektet procedurale, pasi kundërpadia ngrihet kur ka lidhje me objektin e padisë ose kur ka mundësi kompensimi) në këtë rast gjykata civile do jetë kompetente për gjykimin e padisë dhe gjykata administrative për gjykimin e kundërpadisë.

Ndërsa në rastet kur dy paditë nuk mund të ndahen gjykata kompetente do jetë gjykata administrative.

---

<sup>75</sup> Neni 55 të K.Pr.Civile

<sup>76</sup> neni 24, Ligji 49/2012



Nuk jam dakort në këtë pjesë me vendimin e Gjykatës së Lartë, pasi në nenin 55 të Kodit të Procedurës Civile rregullohet në mënyrë të posaçme kjo pjesë: *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”*<sup>77</sup>.

Duke u bazuar dhe në argumentimet e Gjykatës së Lartë që ligji për funksionimin e gjykatës administrative, nuk është thjesht një ligj material por edhe procedural, në këtë rast nuk mund të zbatohet parimi *“lex specialis derogat generali”*, pasi ky ligj nuk parashikon asnjë dispozitë për të rregulluar këtë situatë. Nëse do të pranohet të kundërtën do të ishim përballë një konflikti normash në mënyrë *“in abstractio”* ku nga njëra anë do kishim një normë procedurale e cila e ka rregulluar në mënyrë të qartë një situatë dhe nga ana tjetër një interpretim jurisprudencial bazuar në parime të përgjithshme.

Gjithashtu me anë të këtij vendimi janë vënë në diskutim institutet civile, ku qenia palë e një organi administrativ passjell që kjo çështje me natyrë të *“pastër”* civile të gjykohet nga gjykata administrative.

Gjykatat, bazuar në Vendimin Unifikues nr.4, kanë nxjerre çështje të ndryshme për inkompetencë.

Këto vendime janë ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila nuk është shprehur akoma.<sup>78</sup>

**Vendimet Unifikuese në dukje i kanë dhënë zgjidhje një sërë problemeve që u ngritën menjëherë pasi Gjykata Administrative filloi funksionimin, por në**

---

<sup>77</sup> Neni 55 i Kodit të Procedurës Civile

<sup>78</sup> Vendimi unikues nr. 4, datë 30.05.2011 i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë.

**praktikë mendoj që kjo do të vazhdojë të krijojë probleme, pasi vetë qëllimi i ngritjes së Gjykatës Administrative ishte një zgjidhje e shpejtë e çështjeve dhe brenda disa seancave.**

**Një risi që solli ligji ishte kalimi i barrës së provës drejt autoritetit publik.**

Por me kalimin e të gjitha çështjeve që nga natyra mund të jenë civile por që mund të përmbajnë edhe elemente administrative apo kur objekti i padisë është i ndërvarur nga pasojat e një akti administrativ do të duhet që procesi në dukje të marrë rrymën e një procesi civil, ku barra e provës do jetë e ndarë midis paditësit dhe të paditurit.

Kjo përbën një problem më vete pasi është konstatuar një mungesë vullneti e autoriteteve publike për të marrë pjesë në proces.

Ndryshe nga perceptimi që me fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative proceset do zgjidheshin brenda një afati të shkurtër, në fakt është konstatuar që proceset po zgjasin, kjo si pasojë edhe të mbingarkesës së gjykatës.

Nga ana tjetër, ngritja e gjykatave të specializuara autonome garanton që çështjet, të cilat i përkasin një fushe specifike të juridiksionit të gjykohen vetëm nga gjyqtarët e specializuar në këtë fushë. Duke u marrë shumë më shpesh me një gamë të kufizuar çështjesh, këta gjyqtarë mund të zhvillojnë dhe akumulojnë ekspertizën për të nxjerrë vendime me cilësi të lartë që nuk do të kenë nevojë të ndryshohen nga shkallët më të larta, nëse kundër tyre bëhet ankim.

Ata mund t'i gjykojnë këto mosmarrëveshje më me frytshmëri dhe shpejtësi, pasi atyre u duhet më pak kohë për të hetuar dhe reflektuar mbi elementet themelore të çështjes; pra, ata zhvillojnë praktika specifike për manaxhimin e çështjeve dhe ata mund t'i drejtojnë dhe orientojnë palët në fazat e para të gjykimit.

Autoriteti i gjyqtarëve të specializuar ka mundësi më shumë të pranohet nga palët dhe avokatët, sidomos nëse edhe këta të fundit janë të specializuar ose me përvojë në fushën përkatëse.

Transferimi i juridiksionit për sfera të caktuara të gjykatat e specializuara mund të rrisë edhe frytshmërinë e gjyqtarëve në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, pasi atyre nuk do t'u duhej të futeshin në sfera specifike ku do të ishte e vështirë për të gjykuar si duhet raste kaq të rralla.

### **Gjykatat e specializuara autonome kontribuojnë në njësimin e fushës përkatëse të juridiksionit.**

Gjyqtarët e specializuar ndikojnë në pakësimin e mospërputhjeve në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në fushën përkatëse në saj të ekspertizës së tyre dhe numrit të pakët të gjyqtarëve. Një praktikë gjyqësore më e qëndrueshme bën të mundur siguri ligjore, risjell besimin në shtetin ligjor dhe pakëson çështjet gjyqësore në të ardhmen. Gjykatat autonome të specializuara mund të jenë të dëshirueshme në lidhje me arritjen e një madhësie të përshtatshme për gjykatën.

Studimet shkencore në vendet e ndryshme të Europës Perëndimore nxorën përfundimin që frytshmëria optimale mund të arrihet nga gjykatat e një madhësie mesatare, ndërsa frytshmëria e gjykatave shumë të vogla si dhe e gjykatave shumë të mëdha çenohet nga mangësi – të ndryshme – për shkak të madhësisë përkatëse të vogël ose të madhe<sup>79</sup>.

Kështu, në vend të pasjes së gjykatave të njësuara, që janë shumë të mëdha, lindi nevoja e ngritjes së gjykatave të veçanta – me kusht që edhe gjykatat e specializuara të mund të kenë natyrisht një madhësi të mjaftueshme.

---

<sup>79</sup> Për më shumë hollësi shih “Rekomandim për Modelet e Ndryshme të Riorganizimit të Gjykatave të Rrethit” i EURALIUS-it, kapitulli III.

Po kështu, meqenëse ndërmjet juridiksionit të përgjithshëm dhe të specializuar në lidhje me rregullat procedurale, shkallët e gjykimit dhe për pasojë edhe në manaxhimin e çështjeve ka ndryshime thelbësore, ndarja mund të jetë një zgjedhje më e mirë për të arritur një frytshmëri optimale.

Ndërkohë që ka disa opinione kundër ngritjes së gjykatave të specializuara autonome.

Ndër arsyet kryesore mund të vecojmë:

Së pari, është e rëndësishme të theksohet që shkalla e dëshirueshme e specializimit të gjyqtarëve për rezultatet e pritshme pozitive nuk kërkon domosdoshmërisht ngritjen e gjykatave autonome të specializuara, megjithëse ajo do të ndihmohej nga kjo.

Pika vendimtare është pasja e gjyqtarëve të specializuar për gjykimin e çështjeve përkatëse. Nëse shkalla e dëshirueshme e specializimit mund të arrihet brenda sistemit të zakonshëm gjyqësor, kjo varet nga juridiksioni, sistemi gjyqësor, kodet procedurale dhe cilësi të tjera specifike të vendit përkatës dhe për çdo rast konkret duhet bërë verifikimi në lidhje me krijimin e mundshëm të gjykatave autonome të specializuara.

Rreziku kryesor i pasjes së gjykatave autonome të specializuara është ngushtimi ose edhe kufizimi i mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës<sup>80</sup>.

Numri i çështjeve në fushën specifike të juridiksionit zakonisht justifikon një numër më të pakët gjykatash nga sa janë në sistemin e zakonshëm gjyqësor. Për pasojë, palët nga zonat e largëta do të duhet të përballojnë shpenzime më të larta dhe barrën e udhëtimeve më të gjata, çka mund t'u privojë atyre mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës në varësi të rrethanave konkrete.

Ky problem mund të zgjidhet duke mbajtur gjykata në vende të ndryshme në të gjithë vendin (modeli i gjykatave në ditë të caktuara ose i “gjyqtarëve shëtitës”).

---

<sup>80</sup> Për hollësitë në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës shih “Rekomandim mbi Modele të Ndryshme të Riorganizimit të Gjykatave të Rrethit”, kapitulli II.

Megjithatë, nëse gjykata funksionon kryesisht si një gjykatë shëtitëse, frytshmëria administrative do të binte dhe cilësia e veprimeve apo vendimeve gjyqësore do të vuante.

Është specifike për sistemet gjyqësore që ata të përballen me luhatje të konsiderueshme në ngarkesën e çështjeve me kalimin e kohës në sfera të caktuara të ligjit dhe për më tepër është e pamundur që në ndonjë rast të parashikohet zhvillimi afatgjatë i ngarkesës.

Brenda një sistemi gjyqësor të njësuar këto luhatje mund të trajtohen më me lehtësi nëpërmjet transferimeve ose edhe komandimeve të gjyqtarëve të përgjithshëm në seksionin ose dhomën e specializuar dhe anasjelltas.

Ngritja e gjykatave autonome të specializuara mund të shkaktojë mosmarrëveshje në lidhje me kompetencën ndërmjet palëve si dhe ndërmjet gjykatave. Edhe nëse sfera ligjore e gjykatave të specializuara mund të ndahet nga pikëpamja teknike dhe lëndore nga sferat e tjera të ligjit, disa çështje me kompetencë të debatueshme nuk mund të shmangen. Këto mosmarrëveshje zakonisht shkaktojnë gjykime të ngadalta dhe shpenzime shtesë dhe, për pasojë, pengojnë rritjen e pritshme të frytshmërisë.

Krijimi i gjykatave të specializuara autonome kanë të dobësuar sistemin gjyqësor të zakonshëm. Në mënyrë të veçantë, frytshmëria e gjykatave të vogla të zakonshme është rrezikuar seriozisht nëse ngarkesa e tyre e çështjeve vazhdon të pakësohet. Për më tepër, mundësia e ndikimit të ndërsjellë pozitiv në dobi të gjykimit është shumë i ulët ndërmjet sistemeve gjyqësore të veçanta. Sa më shumë gjykata të specializuara autonome të krijohen, aq më shumë do të pakësohet juridiksioni i gjerë dhe i pasur i gjykatave të zakonshme, çka ka qenë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e së drejtës.

Ndarja e gjyqësorit në dy ose më shumë sisteme gjyqësore autonome ka mundësi që ta dobësojë pozitën e gjyqësorit brenda sistemit të balancës së pushteteve.

Gjyqësori përbëhet vetëm nga një numër i vogël njerëzish, që duhet të mos bëjnë *lobing* për shkak të dinjitetit dhe postit të tyre.

Për pasojë, është gjithmonë rreziku i nënvlerësimit ose neglizhimit nga pushtetet e tjera, pavarësisht garancive kushtetuese për pavarësinë e tij. Nëse gjyqësori duhet të ndahet në pjesë, ky rrezik rritet, veçanërisht në lidhje me sistemet e gjykatave të specializuara.

Në varësi të objektit të juridiksionit të specializuar, mund të jetë e vështirë të tërhiqen juristët e talentuar dhe të kualifikuar për gjykatat e specializuara pasi juridiksioni i gjykatave të zakonshme siguron një zhvillim profesional më fleksibël dhe shërbimi në këto gjykata konsiderohet të japë shanse më të mira për karrierën dhe pozitën e tyre në profesion.

Nëse gjykatat e specializuara ngrihen për fusha shumë të ngushta të juridiksionit, asnjëherë e gjykatave mund të kompromentohet nga zhvillimi i marrëdhënieve të ngushta dhe njohjeve vetjake ndërmjet gjyqtarëve të specializuar dhe avokatëve të specializuar që normalisht mbulojnë këto gjykata.

## 4.2. Efektet e gjykatave administrative mbi gjykatat e zakonshme

Në rastin e krijimit të gjykatave administrative autonome, ngarkesa e çështjeve në gjykatat e zakonshme do të bjerë përkatësisht. Rëndësia dhe cilësia e efektit mbi gjykatat e zakonshme varet si nga përqindja e çështjeve administrative, krahasuar me të gjitha çështjet, ashtu dhe nga ngarkesa e çështjeve që u mbetet atyre.

Po kështu, kjo llogaritje mund të bazohet vetëm mbi të dhënat e vitit të shkuar, por kjo është e mjaftueshme për të përfutur një ide në lidhje me pasojat e mundshme të një juridiksioni të veçantë administrativ.

Janë vetëm dy gjykata rrethi në Shqipëri me një përqindje të çështjeve administrative më të lartë se 10 për qind,<sup>81</sup> që janë Gjykata e Rrethit të Tiranës dhe Gjykata e Rrethit të Shkodrës. Të dyja ato janë gjykata shumë të mëdha dhe do të mbeten të tilla me gjithë pakësimin e ngarkesës së çështjeve. Për këto dy gjykata, lirimi nga gjykimi i çështjeve administrative mund të përbëjë një avantazh.

Nga ana tjetër, për gjykatat më të vogla me një ngarkesë çështjesh më të vogël se 1000 (në tërësi), një rënie e mëtejshme e numrit të çështjeve do të ishte pak a shumë e dëmshme. Numri i mbetur prej më shumë se 700 çështje në gjykatat e rretheve të Gjirokastrës, Lezhës, Matit dhe Sarandës mund të jetë e pranueshme, megjithëse një rënie prej më shumë se 8 për qind në gjykatat e Gjirokastrës dhe të Sarandës do t'i dobësonte shumë këto gjykata.

Ndërsa në lidhje me gjykatat e rrethit të Gjirokastrës dhe Lezhës, humbja pritet të kompensohet nëpërmjet përthithjes së gjykatave të vogla sipas riorganizimit gjyqësor të Ministrisë së Drejtësisë<sup>82</sup>.

---

<sup>81</sup> Burimi: Statistikorët e Ministrisë së Drejtësisë për vitet 2002-2006

<sup>82</sup> Riorganizimi i hyrë në fuqi në shtator 2007, ku 8 gjykata të cilësuar si të "vogla" iu bashkuan juridiksionit gjyqësor të gjykatave me të mëdha, respektivisht: Gjykata e Bulqizës iu bashkua gjykatës së Dibërës, Gjykata e Skraparit iu bashkua gjykatës së Beratit, Gjykata e Librazhdit dhe e Gramshit iu

Kjo vlen edhe për gjykatën e Rrethit të Dibrës, numri i çështjeve të së cilës tashmë është i ulët dhe do të bëhet një çështje edhe akoma më shqetësuese, nëse ajo do të humbte seksonin administrativ.

Për sa i takon Gjykatës së Rrethit të Tropojës, situata problematike e numrit të çështjeve që vështirë se mund të justifikojë mbajtjen e gjykatës, do të përkeqësohej, megjithëse numri absolut i 16 çështjeve administrative është i ulët dhe po kështu nuk është e lartë as edhe përqindja prej 5.91%. Megjithatë, pranohet përgjithësisht që kjo gjykatë duhet të mbetet në çdo rrethanë për shkak të gjendjes së veçantë gjeografike dhe infrastrukurore.

Për ta përmbledhur, krijimi i gjykatave administrative autonome mund të ketë një ndikim negativ mbi disa gjykata rrethi, por përgjithësisht jo thelbësor. Për pasojë, ky efekt nuk është një faktor përcaktues, por një aspekt që duhet të merret parasysh dhe të balancohet me argumentet e tjera pro dhe kundër.

Bie në sy që përqindja e çështjeve administrative është tepër i lartë në ato gjykata apeli që kanë një numër të plotë më të ulët çështjesh. Për pasojë, gjykatat më të vogla të apelit në Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë do të dobësoheshin edhe më tepër nëse atyre do t'u hiqeshin çështjet administrative. Kjo frytshmëri dhe ky efektivitet i shpenzimeve do të binte, duke lënë një numër çështjesh vjetore të ardhura më pak se 600 ose edhe 500.

Kështu, efekti negativ mbi gjykatat e zakonshme në nivelin e apelit është një argument shtesë kundër krijimit të një gjykate administrative autonome në nivelin e apelit.

---

bashkuan gjykatës së Elbasanit, Gjykata e Përmetit dhe Tepelenës iu bashkuan gjykatës së Gjirokastrës, Gjykata e Ersekës iu bashkua gjykatës së Korçës, Gjykata e Mirditës iu bashkua gjykatës së Lezhës.



Në lidhje me shkallën e tretë, efektet e mundshme mbi Gjykatën e Lartë, në rastin e krijimit të një gjykate administrative autonome të shkallës përkatëse, nuk mund dhe nuk duhet të diskutohet më tej për arsyet e dhëna më sipër.

### 4.3. Organizimi i gjykatës administrative

Ligji për ngritjen e Gjykatës Administrative e ka zanafillën që në vitin 2008.

Ndërsa që prej vitit 2009, drafti qëndroi në Kuvend për shkak të ngërçit politik, ndërsa u votua me konsensus të plotë para zgjedhjeve të qershorit 2013 dhe pas propozimit të Ministrit të Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë u vendos çelja e saj më datën 4-nëntor 2013.

Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe miratuar strukturat dhe organikat e reja të gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve, përfshirë edhe strukturat e 7 gjykatave administrative.<sup>83</sup>

Gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë mund të emërohet shtetasi që ka punuar për pesë vjet si gjyqtar dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.<sup>84</sup>

Ndërsa gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit mund të emërohet shtetasi që ka punuar jo më pak se 9 vjet si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të mos ketë masë disiplinore.<sup>85</sup>

Gjyqtarët administrativë të Gjykatës së Lartë duhet të jenë së paku 40 vjeç, të kenë arsim të lartë juridik, të kenë ushtruar për jo më pak se 15 vjet funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë ose 10 vjet funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, ose të ketë përvojë akademike 20-vjeçare në degë të së drejtës, që lidhen me gjykimin administrativ.

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe me drejtuesit e gjykatave të rretheve gjyqësore, në ambientet e të cilave do të vendosen gjykatat administrative, morën masat përkatëse për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme.

---

<sup>83</sup> Dispozitat e Ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me emërimin e gjyqtarëve dhe kriteret që duhet të plotësojnë.

<sup>84</sup>Neni 5/2 pika a e ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

<sup>85</sup>Neni 5/3 pika a,b e ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

Kështu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është sistimuar në një godinë ekzistuese të ish-Institutit të Kërkimeve Zooteknike tashmë të rikonstruktuar tërësisht, e cila ndodhet në “Rr. Don Bosko”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, është sistemuar në territorin ekzistues të Gjykatës së Apelit Tiranë, në ambjentet e ish - godinës së Gjykatës Ushtarake të Apelit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër është sistemuar në dy kate të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë është sistemuar në ambjentet e katit të parë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, godinë e cila është ndërtuar në vitin 2011.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë është sistemuar brenda ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në dy kate, me 12 zyra gjithsej, të cilat janë në gjendje pune dhe më parë janë shfrytëzuar nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë është sistemuar në dy kate të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë në 4 zyra të veçanta për gjyqtarët, dy zyra të përbashkëta për sekretaret gjyqësore dhe dy zyra të tjera për administratën në një sipërfaqe prej 132 m<sup>2</sup>.

Ndërkohë që Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, është sistemuar në godinën e Zyrës Rajonale të Përmbarimit Gjyqësor Durrës pranë Portit të Durrësit.

Siç edhe u tha më sipër, për të gjitha çështjet administrative të cilat shqyrtohen nga të gjitha Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka vetëm një Gjykatë Administrative të Apelit e cila është stacionuar në Tiranë. Praktika tregoi se ligji ka qenë i mangët në sanksionimin të vetëm një Gjykate Administrative Apeli sepse vërtet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e mer vendimin jo më vonë se 30 ditë nga data e ardhjes së Kërkesë Padisë, ama në Apelin

Administrativ shikojmë një ngërç tepër të madh si në efektivitetin e ligjit, efektivitetit të vendimeve ashtu edhe në efektivitetin e zgjidhjes së problematikave.<sup>86</sup>

LGJA u miratua, përveç të tjerash, sidomos për shkurtimin e kohës së gjyqësorit të çështjeve dhe jo të krijimit të ngërçit të ingranazhit gjyqësor duke sjellë kështu një përsëritje të problematikës që u has në gjykatën civile, problematikë e cila u bë “sebe” për krijimin e kësaj gjykate të posatshme.

---

<sup>86</sup> Sipas një ankete realizuar në muajin Dhjetor 2015 në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit u konkludua se të gjithë gjytarët e apelit administrative po shqyrtonin ende çështjet e ardhura në muajin Shtator 2014. Pra, siç shikohet, ngërçi ndodhet me më shumë se një vit mbrapa.

#### 4.4. Statusi i gjyqtarëve

Me status të gjyqtarit kuptojmë garancitë ligjore gjatë ushtrimit të detyrës.

Është e nevojshme që çdo gjyqtar gjatë ushtrimit të detyrës të ketë disa garanci në mënyrë që vendi i tij dhe ushtrimi i profesionit të mos çënohen nga ndërhyrje të karakterit subjektiv. Një ndër elementët është garancia e qendrimit në detyrë (palëvizshmëria). Në thelb qendron fakti se gjyqtarëve duhet t'i garantohet qendrimi në detyrë deri në momentin që do të dalin në pension.

Megjithatë fakti që garantohet qendrimi në detyrë nuk do të thotë se gjyqtarët nuk mund të shkarkohen nga detyra për shkaqe të parashikuara nga ligji.

Në Shqipëri ky parim është përkrahur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 138 të së cilit thuhet se: *“koha e qendrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet”*. Çka tregon për rëndësinë e lartë që kushtetuta i ka dhënë garancive që duhet të ketë një gjyqtar në ushtrimin e profesionit.

Me shkarkim nga detyra kuptojmë kryerjen e veprimeve procedurale për t'i dhënë fund ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.<sup>87</sup>

Në një shtet të së drejtës është llogjike që gjyqtarët të cilët nuk e ushtrojnë detyrën e tyre me pavarësi të plotë dhe në mënyrë të ligjshme duhet që ndaj tyre të merren masa disiplinore duke filluar nga masat më të lehta deri tek më të rëndat. Këto masa përcaktohen nga lloji i shkeljes ku rëndësia e shkeljes dhe dhënia e masës disiplinore përcaktohet në mënyrë të përgjithshme nga kushtetuta dhe në mënyrë specifike nga ligji i posatshtëm.

Pra, vëmë re se gjyqtari duhet të gabojë për t'u ndëshkuar.

---

<sup>87</sup> Neni 138 i kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Termi gabim nuk përcjell nocion të së drejtës e për rrjedhojë, as nocion juridik por me të duhet të kuptojmë aktet e rënda si, shkelje e ligjit, shpërdorim detyre, korrupsion, etj, elemente këto të cilat përkrahen nga shumë shtete të Europës në ligjet përkatëse.

Por pyetja që lind është; ***Kush duhet të ketë në kompetencë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore?***

Dy janë sistemet europiane: njëri që parashikon organe të pavarura dhe tjetri që ia lë këtë kompetencë organeve jo të pavaruara që mund të jenë edhe politike.

**Sistemi i parë është një sistem më i mirë për të garantuar një pavarësi të gjyqësorit sepse kemi thënë që nuk mund të kuptojmë një pavarësi të gjyqësorit pa shkëputje nga politika.**

Po legjislacioni shqiptar çfarë ka përkrahur?

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor kanë parashikuar se organi që ka në kompetencë shkarkimin e gjyqtarëve është KLD, por të drejtën për të inicuar fillimin e procedurave për shkarkim e ka Ministri i Drejtësisë.

**Pra ajo që vëmë re është fakti që legjislacioni shqiptar ka zgjedhur sistemin e dytë e për rrjedhojë ka parashikuar një organ politik për fillimin e procedurave të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve.**

Statusi për gjyqtarët synon që të sigurojë kompetencën, pavarësinë dhe paanësinë që çdo individ pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar të cilëve u besohet mbrojtja e të drejtave të individit. Ai përjashton çdo dispozitë dhe çdo

procedurë të një natyre që do të dëmtonte besimin në këtë kompetencë, këtë pavarësi dhe këtë paanësi.

#### **4.4.1. Emërimi i gjyqtarëve në Shqipëri**

Në lidhje me emërimin e gjyqtarëve të zakonshëm, Kushtetuta ka parashikuar institucione kushtetuese që bëjnë të mundur emërimin e gjyqtarëve.

- a. Presidenti,
- b. Këshilli Lartë i Drejtësisë.

Gjyqtarët e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatave Administrative të Apelit emërohen nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe emërohen për një periudhë kohe të pakufizuar.

Të gjithë keto gjyqtarë e vazhdojnë detyrën deri në momentin që japin dorëheqjen apo shkarkohen nga detyra për një nga rastet e parashikuara për shkarkimin e gjyqtarit.

Kufizimi i vetëm që vjen për ushtrimin e profesionit të gjyqtarit që është sa ligjor aq edhe kohor është mbushja e moshës 65 vjeç që bën të mundur daljen në pension.

Ajo që bie në sy në këto emërimet dhe që ka hapur diskutime të shumta është prania e ekzekutivit në KLD, përfaqësuar nga Ministri i Drejtësisë.

Prania e ekzekutivit në KLD passjell ndikime politike, shtoi faktin që Ministri i Drejtësisë ka kompetencën ekskluzive të fillimit të procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Dhënia e kësaj kompetence dhe prania e ministrit të drejtësisë në KLD mund të shkaktojë presion politik tek gjyqtarët përmes fillimit të procedurave disiplinore që mund të jenë edhe abuzive.

Ndodhur përballë një fakti të tillë ngre pyetjen; *A mundet një gjyqtar i gjykatës administrative të bëjë një gjykim të paanshëm nëse si objekt gjykimi do ketë*



*pavlefshmërinë e një kontrate publike me vlerë X milion lekë lidhur midis  
Ministrisë së Drejtësisë dhe një subjekti X?*

Mendoj se përgjigja e kësaj pyetje do vijë nga praktika gjyqësore. Duke qenë se Këshilli Lartë i Drejtësisë është organi që mundëson garantimin e pavarësisë së gjyqësorit do bëjmë një analizë me qëllim për të parë a është KLD një organ tërësisht kushtetues apo jo.

Nëe jo, atëherë si mund të kemi një pavarësi të gjyqësorit?

Këshilli Lartë i Drejtësisë është një institucion krijimi i të cilit parashikohet nga Kushtetuta dhe se në përbërjen e tij ka 15 anëtarë, prej të cilëve 9 emërohen nga Konferenca e Gjyqësorit, 3 të tjerë janë *ex officio* dhe 3 të tjerë emërohen nga Parlamenti.

Fakti që në përbërjen e tij ka 9 gjyqtarë tregon se mënyra e formimit të këtij institucioni është konform nenit 1.3 të Kartës Europiane për Statusin e Gjyqtarit;

*“1.3. Lidhur me çdo vendim që ndikon në përzgjedhjen, rekrutimin, emërimin, përparimin në karrierë ose pushimin e funksioneve të një gjyqtari/eje, statuti parashikon ndërhyrjen e një autoriteti të pavarur nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, brenda të cilit të paktën gjysma e atyre që marrin pjesë të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, duke ndjekur metoda që garantojnë përfaqësimin më të gjerë të gjyqësorit”.*<sup>88</sup>

E vetmja dobësi që ka mënyra e formimit të KLD është fakti që nuk përfshin në të, profesionistë të së drejtës që qendrojnë jashtë sistemit gjyqësor. Për të dhënë një

---

<sup>88</sup> Neni 1.3 i Kartës Europiane për statusin e gjyqtarit

argument mjafton të përmendin rastin e Italisë<sup>89</sup> ku në përbërje të Këshillit të Lartë të Magjistraturës ka avokatë me eksperiencë pune 15 vjeçare si dhe pedagogë të së drejtës. Kjo sepse çështjet e emërimit të gjyqtarëve janë çështje të rëndësishme kushtetuese ku duhet të jepet një mendim më i gjerë se ai që vjen nga një trup gjyqtarësh duke qenë se këto kanë edhe shumicën dërrmuese.

Për të konkluduar atë që thamë më lartë shohim që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë por edhe ligji për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në vendin tonë janë munduar të krijojnë një sistem gjyqësor të pavarur duke mbajtur larg ndërhyrjet e politikës (përjashto rastin e mbivendosjes së kompetencave dhe prania e ministrit të drejtësisë në KLD) në çështjet e emërimit të gjyqtarëve.

Pyetja që ngrihet është; po për Kolegjin Administrativ në Gjykatën e Lartë a mund të flasim për një pavarësi nga politika duke qenë se jemi në çështjen e emërimit?

Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Lartë është i ndryshëm nga ai i gjykatave të tjera përse i përket strukturës ligjore. Rrjedhojë e kësaj logjike juridike është fakti që edhe mënyra e emërimit është e ndryshme për sa kohë bëhet mbi bazën e një ligji të veçantë nga ai i përgjithshëm.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë por edhe në ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë është i shprehur fakti se anëtarët e GJL emërohen nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me pëlqimin e Kuvendit.

Siç e shikojmë kemi një ndërhyrje të politikës për sa kohë bëhet me pëlqimin e Kuvendit.

---

<sup>89</sup>G. Ugo Rescigno, “*Corso di diritto pubblico*”, undicesima edizione 2007/2008, Bologna

Mendohet se forma më e mirë e emërimit të gjyqtarëve do të ishte nëse do të bëhej nga KLD sepse rreziku për një ndërhyrje të politikës është më i ulët.

Por krahas kësaj forme mendohet se edhe emërimi momental mund të jetë më i drejtë dhe më objektiv nëse shumica e kërkuar për emërimin e tyre do ishte 84 vota dhe jo 71 vota. Kjo, për një arsye të vetme, pasi 71 vota është një shumicë lehtësisht e arritshme, sepse një vullnet konsensual të jep premisa që emërimi i bërë nuk është i njëanshëm e për rrjedhojë tërësisht politik.

Një tjetër element kyç kur flasim për emërimin e gjyqtarëve të GJL është edhe mandati 9 vjeçar i tyre pa të drejtë riemërimi. Në lidhje me mandatin kufizues ka debate dhe mendime të ndryshme nëse duhet të jetë kufizues apo jo dhe për secilën jepen argumentat si më poshtë.

### **1- Argumentat pro mandatit 9 vjeçar.**

- ❖ Mandati kufizues bën që një gjyqtar të ushtrojë profesionin e tij dhe detyrën në mënyrë të pavarur për faktin se nuk ka se çfarë të presë më në të ardhmen nga forca politike që e emëroi.
- ❖ Kjo mënyrë ndiqet edhe për anëtarët e gjykatës kushtetuese.

### **2- Argumentat kundër mandatit 9 vjeçar.**

- ❖ Një mandat kufizues mund të nxjerrë një individ shumë shpejt nga rruga e drejtësisë së dhënë.
- ❖ Nqse juristët që përkrahin argumentin se këtë formë e ndjekin edhe për anëtarët e Gjykatës Kushtetues atëherë na duhet të përmendim faktin që Kelzeni ka thënë përmes një shprehjeje të tijën “*Gjykata Kushtetuese është një ligjvënës negativ*”.

Pyetja që ngrihet është; *a është Gjykata e Lartë një ligjvënës negativ e për rrjedhojë një institucion politik?*

Duke qene se po flasim për mënyrën se si mund të arrihet më mirë pavarësia e gjyqësorit mendohet se mandati kufizues është më eficient për të vetmen arsye të sipër përmendur, se gjyqtari nuk ka çfarë të presë më nga politika.

Megjithatë, mandati i kufizuar mund të bëjë që një gjyqtar të dalë shumë shpejt nga sistemi i drejtësisë së dhënë. Kjo gjë ndodh në ato vende (përfshirë Shqipërinë) të cilat emërimin e gjyqtarëve në GJL e bëjnë jo duke kaluar nga një shkallë në një shkallë tjetër me afate kohore në mes, por me emërimet duke kaluar nga gjykata e shkallës së parë në atë më të lartën.

Në rast se një emërim do të bëhet nga shkalla e parë në të dytën dhe më pas në gjykatën e lartë, këto subjekte nuk do dalin shpejt nga sistemi i drejtësisë së dhënë.

Për këtë mjafton të përmend rastin e sistemit Italian në të cilin mundet që një gjyqtar të shkojë në GJL vetëm pas një eksperience 11 vjeçare në gjykatën e shkallës së parë si dhe 8 vjeçare në gjykatën e apelit.

#### 4.4.2. Specializimi i gjyqtarëve

Në lidhje me të drejtën administrative, nevoja e specializimit është njohur pothuajse kudo dhe mbi këtë ide mbështeten dispozitat e kuadrit ligjor përkatës në Shqipëri që parashikojnë seksionet administrative në gjykatat e rrethit dhe gjyqtarë të specializuar që marrin pjesë në çështjet përkatëse në gjykatat e apelit.

Megjithatë, është e dukshme që në shumicën e gjykatave shqiptare, me gjithë këto dispozita, një masë e konsiderueshme e specializimit në të drejtën administrative mbetet teorike.

Megjithëse juridiksioni administrativ është përqendruar në 17 nga 21 gjykata rrethi, janë 6 gjykata rrethi që në katër vjet kanë mesatarisht më pak se 36 çështje administrative të ardhura në vit, d.m.th., më pak se 3 në muaj dhe vetëm 4 gjykata rrethi që në 4 vjet arrijnë një mesatare prej më shumë se 120 çështje administrative të ardhura në vit, d.m.th, më shumë se 10 në muaj<sup>90</sup>.

Nëse gjykimi i çështjeve administrative është vetëm një pjesë e vogël e punës së gjyqtarëve, ata vështirë se do ta arrijnë përvojën e gjerë dhe ekspertizën e dëshiruar në këtë fushë të ligjit dhe është e vështirë të përqipen vazhdimisht për të thelluar dhe përditësuar njohuritë e tyre përkatëse.

Në lidhje me gjykatat e apelit, numri i çështjeve administrative nuk është më i lartë e parë në përpjesëtim me madhësinë. Pasi të gjithë gjyqtarët në gjykatat e apelit duhet të shqyrtojnë çështje administrative dhe një numër të madh të çështjeve të tjera, asnjëri prej tyre nuk mund të specializohet realisht në këtë fushë.

Për sa i takon Gjykatës së Lartë, specializimi i gjyqtarëve në të drejtën administrative as është parashikuar me ligj dhe as kryhet.

---

<sup>90</sup> Gjykatat me numër të vogël çështjesh administrative janë: Dibër, Krujë, Kukës, Lezhë, Mat e Tropojë. Gjykatat me numrin më të madh të çështjeve janë: Korçë, Shkodër, Tiranë e Vlorë. Dhe ndër gjykatat me numër të konsiderueshëm çështjesh janë ato të Durrësit, Elbasanit dhe Gjirokastrës. (burimi: Statistikori i Ministrisë së Drejtësisë në vitet 2002- 2006)

Megjithatë, mungesa e mundësisë për specializim mund të jetë më pak dëmprurëse në Gjykatën e Lartë si shkalla e rekursit, pasi ajo përqëndrohet vetëm në çështjet ligjore.

Për më tepër, shkalla eventualisht e ulët e njohjes së çështjeve specifike ligjore mund të kompensohet nga shkalla e lartë e ekzaminimit me të cilën çdo çështje e veçantë shqyrtohet në Gjykatën e Lartë si dhe nga shkalla e lartë e kualifikimit dhe përvoja profesionale afatgjatë që pritet të kenë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Si përfundim, arritja e një shkalle më të lartë specializimi të gjyqtarëve në të drejtën administrative ka kërkuar masa organizative, duke ia ngarkuar juridiksionin përkatës, të paktën në shkallët e faktit, një numri të kufizuar gjyqtarësh që mund të përqëndrohen plotësisht ose të paktën kryesisht në këtë fushë të së drejtës.

Nga ana tjetër, nga ndryshimet e fundit ligjore në LGJA, gjyqtarëve të gjykatave administrative iu janë shtuar Ndhmësit Ligjorë të cilët si kompetencë kryesore kanë sistemimin dhe seleksionimin e çështjeve të ardhura në gjyqësinë administrative duke i lehtësuar jo vetëm procedurat por edhe punën e vet gjyqtarëve.

#### 4.4.3. Kriteret në përzgjedhjen e trupës së gjyqtarëve

Me ndryshimet e reja, në ligjin për Gjykatën Administrative, Shkolla e Magjistraturës nuk do të jetë kriter për përzgjedhjen e kandidatëve të trupës gjyqësore. Sipas ligjit, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë mund të emërohet shtetasi që ka punuar për 5 vjet si gjyqtar dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.<sup>91</sup>

Ndërsa gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit mund të emërohet shtetasi që ka punuar jo më pak se 9 vjet si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të mos ketë masë disiplinore.<sup>92</sup>

Gjyqtarët administrativë të Gjykatës së Lartë duhet të jenë së paku 40 vjeç, të kenë arsim të lartë juridik, të kenë ushtruar për jo më pak se 15 vjet funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë ose 10 vjet funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, ose të ketë përvojë akademike 20 vjeçare në degë të së drejtës, që lidhen me gjykimin administrativ.

Gjyqtarët do të zgjidhen me dekret të Presidentit, me propozim të ministrit të Drejtësisë.

Në KLD paraqiten të gjitha kërkesat e kandidatëve të interesuar për t'u emëruar si gjyqtarë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe të Apelit.

KLD-ja pasi shqyrton të gjitha kërkesat, verifikon përmbushjen e kriterëve ligjore. Më tej, KLD-ja konkludon me një listë përfundimtare për secilën shkallë gjykimi që i përcillet Shkollës së Magjistraturës për të vijuar procesin e testimit.

---

<sup>91</sup>Neni 5/2 pika a,b e ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

<sup>92</sup>Neni 5/3 pika a,b e ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative

Testimi administrohet nga një komision prej 5 anëtarësh, i përbërë nga;

- një përfaqësues i zgjedhur me shumicë votash nga KLD-ja,
- një përfaqësues i zgjedhur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës,
- një anëtar i Gjykatës së Lartë i zgjedhur nga mbledhja e përbashkët e gjyqtarëve të saj
- dy përfaqësues nga institucione ndërkombëtare që asistojnë ose bashkëpunojnë me sistemin e drejtësisë të përzgjedhur nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës.<sup>93</sup>

Testimi përbëhet nga jo më pak se 30 pyetje me shkrim dhe konsiderohen se kanë kaluar me sukses testimin seleksionues kandidatët që marrin jo më pak se 70% të totalit të pikëve.<sup>94</sup>

---

<sup>93</sup>Neni 5/4 i ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

<sup>94</sup>Shtojca për Organizimin e testimit kualifikues për emërimin e Gjyqtarëve Administrativë të Shkollës së parë dhe të Apelit



#### **4.4.4. Masa e vlerësimit të gjyqtarëve**

Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave, të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

Gjykata shqyrton nëse zgjedhja nga organi publik është bërë në përputhje me objektivin dhe qëllimin e ligjit, ndërsa për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punësimit, gjykata zbaton rregullat e masës së vlerësimit të Kodit të Punës.

Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative që shqyrtojnë padi për dënimet me gjobë me vlerë më të vogël se tridhjetëfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.<sup>95</sup>

Pikërisht këtu do të shikojmë një kontradiktë të cilën LGJA nuk e ka arsyetuar në mënyrë të qartë e të argumentuar. Konkretisht, nga njëra anë kemi të drejtën që ligji përdor për të mos investuar gjykatën e apelit administrativ për gjobat me vlera të vogla por nga ana tjetër mund të shikohet edhe si cënim i të drejtës për të ankimuar një vendim për të cilin secili subjekt mendon që edhe nëpërmjet vendimit të shkallës së parë sërish i është mohuar e drejta.

---

<sup>95</sup>Neni 45 i ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është shqyrtimi i Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i cili këtu e më poshtë do të përdoret i shkurtuar si LGJA (Ligji për Gjykatën Administrative).

LGJA përmban dispozita procedurale që plotësojnë organizimin dhe gjykimin dy e tri shkallësh të konflikteve administrative, si edhe garantojnë mundësinë maksimale të gjyqimit objektiv të ankimit administrativ të shtetasve dhe subjekteve të ndryshme kundër akteve dhe veprimeve të administratës publike.

Nga ana tjetër, gjate studimit të LGJA do të shohim se, përveç risive në gjyqësinë administrative, ai ka sjellë risi edhe sa i takon mënyrës se si administrata publike ushtron veprimtarinë e saj<sup>96</sup>.

Së pari është sqaruar saktë kuptimi i *mosveprimit administrativ*, *veprimit tjetër administrativ* si dhe koncepti i *veprimit administrativ*. Të tre këto forma të reja janë derivat i LGJA<sup>97</sup> në funksion të administratës publike dhe akteve të dala prej saj që mund të jenë në të ardhmen objekt i proceseve gjyqësore administrative.

Gjithashtu përmban edhe dispozita materiale, të cilat me ndikimin e tyre përmirësuan dukshëm dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative duke sjellë miratimin e Kodit të Ri të Procedurave Administrative, Ligjit Nr. 44/2015.

Megjithë konsideratat e larta juridike, LGJA mbart disa probleme të drejtësisë administrative, që mund të përmirësohen nëpërmjet ndryshimeve të domosdoshme, veçanësisht në procesin gjyqësor administrativ.

---

<sup>96</sup>Grup autorësh (Ermir dobjani, Elsa Toska, Erlir Puto, Erajd Dobjani), “E drejta administrative (Kontrolli mbi Administratën Publike)”, Shtëpia Bptuese “Emal”, Tiranë, 2013, fq. 66.

<sup>97</sup>Po aty

#### **4.5. Kontrolli dhe procesi gjyqësor administrativ**

Në shtetin e së drejtës, ushtrimi i të gjitha funksioneve shtetërore bazohet në parimin e ligjshmërisë. Pushteti që i është dhënë organeve administrative duhet të ushtrohet vetëm në mënyrën e parashikuar me ligj dhe aktet e tjera nënligjore.

Me nënshtrimin e administratës nga ligji sigurohet sundimi i ligjit dhe përjashtohet arbitrariteti. Që të realizohet ligjshmëria në punën e administratës shtetërore ajo duhet t'i nënshtrohet kontrollit.

Kontrolli mbi administratën paraqitet në forma të ndryshme si, politik, parlamentar, gjyqësor dhe ai administrativ. Secili prej këtyre kontrolleve ka specifikën e tij që kryhet nga organe të ndryshme.

Psh, **“Kontrolli Politik”** arrihet nëpërmjet emërimit të eksponentëve partiakë në poste të larta drejtuese të njohura ndryshe si Poste Politike. Mund të përmendet këtu pozicioni i Ministrit të një dikasteri, puna dhe funksioni i të cilit qendron në përcaktimin e politikave dhe reformave të mëdha dhe afatgjata që duhen ndërmarrë. Bazuar në ato politika dhe reforma, veprimtaria e administratës orientohet dhe në këtë mënyrë kemi një “kontroll” të hapave dhe orientimeve që dikasteri përkatës realizon gjatë punës së administratës publike.

**“Kontrolli Parlamentar”** realizohet nëpërmjet organeve të pavarura ku këto të fundit raportojnë në Parlament duke arsyetuar çdo veprim të ndërmarrë gjatë punës dhe kontrolleve të ushtruara në administratën publike. Mund të përmendim kontrollin që realizon Kontrolli i Lartë i Shtetit, institucion ky i cili raporton vetëm përpara Parlamentit.

**“Kontrolli Gjyqësor”** mbi administratën publike, sipas juristit francez Pierre Sandevair<sup>98</sup>

por edhe sipas studimit të Erajd Dobjani<sup>99</sup> ushtrohet duke u bazuar mbi parimin “*të gjykosh administratën publike do të thotë të administrosh edhe më shumë*”.

Pikërisht ky parim shpreh në mënyrën më të mirë të mundshme kontrollin gjyqësor realizuar ndaj ushtrimit të kompetencave nga administrata publike.

Kontrolli Administrativ ushtrohet nga vet organi administrativ nëpërmjet Drejtorive në strukturën e vet të njohura ndryshe si Drejtori` Auditi. Në fakt ky kontroll nuk është shumë eficient për vet faktin pasi kryhet nga vet organi administrativ. Por ajo që nuk duhet lënë në harresë është fakti se kontrolli administrativ është një ndër format kryesore të realizimit të kontrollit e cila realizohet në dy mënyra:

*Mënyra e parë*, organi hierarkik më i lartë me anë të nismës së vet ushtron kontroll ndaj veprimtarisë së organit më të ulët, ajo që u shpeguar më sipër, *dhe*,

*Mënyra tjetër*, nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit administrativ.

Ankimi administrativ është një mjet juridik i subjektit, nëpërmjet të cilit kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ. Ai përbën një instrument të rëndësishëm kontrolli të veprimtarisë administrative. Nëpërmjet ankimit, çdo palë e interesuar kundërshton paligjshmërinë ose parregullsinë e një akti administrativ si dhe refuzimin e paligjshëm të organit administrativ për nxjerrjen e aktit.

**E drejta e ankimit është një parim i rëndësishëm kushtetues.**

---

<sup>98</sup>P. Sandevair, “Etudes sur le recours de pleine juridiction”, Paris, 1964.

<sup>99</sup>E. Dobjani, “Kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë administrative”, Tiranë, 2013.

Në të vërtetë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk parashikon shprehimisht të drejtën e individit për të ushtruar ankimin administrativ. Dispozitat më të afërta me këtë parim janë nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës, në të cilat gjejnë pasqyrim dy parime të rëndësishme që kanë të bëjnë me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe të drejtën për rehabilitim a zhdëmtim nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve shtetërore.<sup>100</sup>

Po kështu, edhe KEDNJ në nenin 13 parashikon shprehimisht të drejtën e kujt do për të bërë një ankim efektiv ndaj shkeljeve të kryera nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve zyrtare.<sup>101</sup>

### **E drejta e ankimit ka lidhje edhe me vet parimin e shtetit të së drejtës.**

Parimi i shtetit të së drejtës, mes të tjerave, kërkon që të garantohet mbrojtja e plotë e individit dhe personave juridikë kundrejt cënimit të sferës së të drejtave të tyre nga ndërhyrjet e pushtetit publik. Kjo mbrojtje përfshin edhe parashikimin e qartë nga ligji të rregullave të sjelljes së administratës publike dhe individëve, të së drejtës (por edhe detyrimit) të këtyre të fundit për të kërkuar realizimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme si dhe për t'u ankuar me mjete efektive nëse këto të drejta u cënohen apo u kufizohen pa respektuar ligjin dhe në mënyrë të paarsyeshme.

Parimet nga të cilat udhëhiqet legjislacioni në fuqi që rregullon veprimtarinë e administratës publike parashikon se organet administrative dhe veprimtaria e tyre i nënshtrohen jo vetëm kontrollit administrative por edhe atij gjyqësor.

Ky kontroll i shërben ecurisë normale të veprimtarisë administrative dhe mbi të gjitha përbën një garanci për moscënimin e të drejtave të individëve dhe subjekteve juridike.

---

<sup>100</sup> Nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

<sup>101</sup> Neni 13 KEDNJ

Kushtetuta u ka ngarkuar edhe gjykatave misionin e mbrojtjes, garantimit dhe respektimit të këtyre parimeve themelore kushtetuese dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Ky mision i gjykatave mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i ligjit nga hallkat e pushtetit ekzekutiv, nëse ato ndërhyjnë në sferën e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, është i kontrollueshëm nga gjykatat.

Kontrolli gjyqësor dhe, anasjelltas, e drejta e individëve dhe personave juridikë për t'iu drejtuar gjykatës, lidhet jo vetëm me ekzistencën e parimeve të përgjithshme, por edhe me përcaktimin e qartë e konkret, të treguar shprehimisht në ligjet e posaçme, të rrethanave, kushteve e procedurave konkrete për investimin e mundshëm a të detyrueshëm të juridiksionit administrativ dhe, në çdo rast, të juridiksionit gjyqësor, për pranimin, marrjen në shqyrtim dhe dhënien e vendimit përkatës mbi një mosmarrëveshje, mbi një kërkesë apo ankesë të të interesuarve që ka për subjekt realizimin a mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre.

Por për shkak të rasteve të formulimit të paqartë të dispozitës ligjore, në praktikën gjyqësore konstatohen qëndrime konfuze dhe kundërshti rreth çështjes nëse ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është një e drejte e tij apo është një detyrim.

Për këtë arsye, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës kanë ndërhyrë disa herë duke u munduar të qartësojnë këtë kusht dhe të shmangin qëndrime konfuze të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Në këtë këndvështrim ky punim do të jetë një përpjekje për të sqaruar kur ndjekja e rrugës administrative është e detyrueshme për t'iu drejtuar gjykatës edhe kur ajo është vetëm një e drejtë e individit.<sup>102</sup>

Punimi mbështetet kryesisht në dispozitat ligjore dhe në jurisprudencën e gjykatave shqiptare.

---

<sup>102</sup> Neni 141/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

#### 4.6. Gjykimi administrativ në të tre shkallët

**Ligji në fuqi parashikon një sistem miks kompetencash të gjykimit administrativ.**

Sipas LGJA, shumica e konflikteve administrative do të gjykohet në tri shkallë, në Gjykatat Administrative të Shkalles së Parë, në Gjykatën e Apelit Administrativ si dhe në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Një pakicë e tyre, ato që janë më të rëndësishmet dhe që kanë të bëjnë me konfliktet, të cilat lidhen me aktet nënligjore normative të organeve qendrore apo organeve të njësisve të qeverisjes vendore do të gjykohe në dy shkallë, në Apelin Administrativ dhe Kolegjin Administrativ.

**Në fakt duhej të kishte ndodhur e kundërta, shumica e konflikteve me dy shkallë dhe pakica me tri shkallë gjykimi.**

Sidoqoftë, rëndësi merr fakti që ligjvënësi ka pranuar sistemin dy dhe tri shkallësh, më tej çdo gjë është e rregullueshme juridikisht.

Por, me organizimin e deritanishëm të sistemit dhe të kompetencave mendohet se nuk arrihet qëllimi apo objektivi kryesor i ngritjes së gjykatave administrative, që është shqyrtimi i mosmarrëveshjeve të një natyre të tillë në afat kohor sa më të shkurtër ose ulja e kohëzgjatjes totale të shqyrtimit të tyre gjyqësor në dy apo tri shkallët e gjykimit administrativ.



#### 4.7. Gjykimi në shkallë të parë

Për gjykimin e çështjeve administrative të shkallës së parë janë krijuar<sup>103</sup> 6 gjykata qarku, duke pasur juridiksion të zgjeruar territorial me qëllim që të mbulojnë zonat e gjykatave të tjera të rrethit. Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të caktuar në seksionet administrative të gjykatave të qarkut nuk mund të konstatohej nga dekreti për ngritjen e Gjykatave Administrative<sup>104</sup>.

Gjithsesi, numri i gjyqtarëve tashmë është rritur pasi aktualisht (viti 2016) veprimtaria e Gjykatës Administrative ndodhet në vitin e saj të tretë të punës, çfarë do të thotë se numri i çështjeve është rritur, rrjedhimisht edhe numri i gjyqtarëve gjithashtu.

Në Gjykatën e Rrethit të Tiranës çështjet administrative gjykoheshin ekskluzivisht nga seksionet administrative që përbëhej nga 8 gjyqtarë<sup>105</sup> të cilët duhet të gjykonin vetem çështjet administrative dhe ishin të përjashtuar nga gjykimi i çështjeve civile dhe penale.

Në Gjykatën e Rrethit të Shkodrës çështjet administrative gjykoheshin ekskluzivisht nga seksioni administrativ që përbëhej nga vetëm 3 gjyqtarë<sup>106</sup>.

Në pjesën më të madhe të gjykatave, gjyqtarët e seksioneve administrative nuk duhej të shqyrtonin çështje joadministrative.

Në disa nga gjykatat e rrethit, veçanërisht në gjykatat më të vogla, të gjitha çështjet shpërndaheshin ndërmjet të gjithë gjyqtarëve me gjithë ekzistencën formale të një seksioni administrativ, me qëllim që të arrihej një shpërndarje e barabartë e ngarkesës së punës<sup>107</sup>.

---

<sup>103</sup>Sipas Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë këto shifra mungojnë.

<sup>104</sup> Siç kërkohet nga Neni 320/a KPC shih: Dekreti i Presidentit Nr. 1501, datë 29 maj 1996 “Mbi Krijimin e Seksioneve Administrative, Tregtare dhe Familjare në Gjykatat e Rrethit”

<sup>105</sup> Informacion i marrë në faqen e internetit të gjykatës Tiranë

<sup>106</sup> Informacion i marrë në faqen e internetit të gjykatës Shkodër

<sup>107</sup>Ky informacion është marrë nga kontaktet me kancelarët e gjykatave në të gjithë vendin.

#### 4.8. Veprimet përgatitore gjatë fazës së gjykimit të çështjes

Faza e gjykimit konsiston në tre momente;

- në veprimet përgatitore para shqyrtimit gjyqësor,
- në momentin e zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor,
- në momentin e veprimeve gjyqësore të mëtejshme që pasojnë shqyrtimin gjyqësor.

Veprimet përgatitore fillojnë që në momentin kur në sekretarinë e gjykatës administrative paraqitet padia nga ana e palës së dëmtuar nga akti administrativ, veprimi ose mosveprimi i organit administrativ dhe vijon deri në momentin kur kryetari i seancës gjyqësore në prani ose në mungesë të palëve çel seancën gjyqësore.<sup>108</sup>

Në ligj janë parashikuar veprimet përgatitore që paraprijnë fillimin e gjykimit të çështjes administrative. Veprimet përgatitore fillojnë me shqyrtimin e padisë nga gjyqtari kryesues ose nga kryetari i trupit gjykues për të verifikuar nëse dosja e gjykimit është ndërtuar në rregull sipas parashikimeve të ligjit. Gjyqtari kryesues, pasi sigurohet për kryerjen e të gjitha veprimeve përgatitore menjëherë nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore. Në rastin e padisë me të meta, ky afat është jo më vonë se 7 ditë nga data e plotësimit të të metave.<sup>109</sup>

Për keto të meta padia mbetet pa vepruar. Kur i plotëson ato brenda afatit, ajo quhet e pranuar që nga dita e paraqitjes dhe që nga kjo ditë fillojnë pasojat juridike. Në rastin

---

<sup>108</sup>Neni 25 i ligjit

<sup>109</sup>Neni 25/1 i ligjit

kur nuk i plotëson në afat të metat, padia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit së bashku me aktet e tjera.

Paraqitja e padisë pasi të kete kaluar afatin (7 ditë) i përcaktuar në ligj, konsiderohet padi e re dhe regjistrohet ditën që është plotësuar, për rrjedhojë nuk fillon asnjë efekt para kësaj date. Nëse padia është pa të meta ose të metat e saj janë plotësuar në afat, në veprimet paraprake gjyqtari urdhëron që ajo të rregjistrohet dhe një kopje së bashku me aktet e saj i njoftohet të paditurit.

Me depozitimin e padisë në sekretari bëhet edhe rregjistrimi përkatës i saj, hapet dosja ku futet padia, akt njoftimi i të paditurit për pjesëmarrjen e tij në proces, provat shkresore dhe caktohen dokumentat që palët kanë paraqitur lidhur me çështjen. Ato kanë të drejtë, me leje të gjyqtarit kryesues të njihen me përmbajtjen e tyre.

Sipas ligjit, Urdhëri për caktimin e seancës gjyqësore përmban:

- Datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës gjyqësore;
- Palët,
- Dhe, sipas rastit, dëshmitarët dhe ekspertët e kërkuar nga palët, që duhet të marrin pjesë në seancë gjyqësore;
- Ekspertët e caktuar nga gjyqtari;
- Njoftimin dhe mënyrën e njoftimit të palëve dhe të personave që duhet të marrin pjesë në seancë përveç rregullave të përgjithshme që parashikohen nga KPrC.

Ligji, ka sjellë një risi, pasi ai parashikon edhe njoftimet nëpërmjet telefonit dhe njoftimet nëpërmjet adresës elektronike të cilat i bashkangjiten provave në dosjen

gjyqësore. Por, për njoftimet telefonike duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen numri i telefonit në të cilin të bëhet njoftimi, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon nëpunësi gjyqësor dhe qëllimi i njoftimit.<sup>110</sup>

Procesverbali hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe nëpunësit gjyqësor të ngarkuar me kryerjen e njoftimeve. Ndërsa mënyra e komunikimit elektronik bëhet në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike.

Në këtë mënyrë palëve mund t'u komunikohen edhe dokumente. Palët dhe përfaqësuesit e tyre, me lejen e gjykatës kanë të drejtë të njihen dhe të marrin kopje me shpenzimet e veta të dokumentacionit të paraqitur në sekretarinë gjyqësore.

Gjykata mund të refuzojë një kërkesë të paraqitur në rastet kur shqyrtimi gjyqësor mund të zhvillohet me dyer të mbyllura. Deri në datën e caktuar për gjykim, palët, mbrojtësi dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtën që të shikojnë sendet e sekuestruara, të shqyrtojnë në sekretari dokumentat e mbledhura në dosjen gjyqësore si dhe të nxjerrin kopjen e tyre.<sup>111</sup> Palët mund të shqyrtojnë dosjen gjyqësore në fazën e shqyrtimit gjyqësor administrativ në mënyrë që të përgatitet dhe të zhvillohet më me shpejtësi gjykimi që të përfundojë në një kohë sa më të shkurtër.<sup>112</sup>

Po kështu në fazën e veprimeve përgatitore pala që kërkon pyetjen e dëshmitarëve dhe ekspertëve duhet që të depozitojë në sekretarinë e gjykatës të paktën pesë ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, listën e dëshmitarëve dhe ekspertëve.

---

<sup>110</sup>Neni 27 i ligjit

<sup>111</sup>Neni 28 i ligjit

<sup>112</sup>Neni 34 i ligjit

Përsa i përket llojit të vendimeve që merr gjyqtari kryesues gjatë veprimeve përgatitore dhe ankueshmërisë së tyre mund të themi sa vijon:

- Gjyqtari merr vendimin për plotësimin e kërkesë padisë me të gjitha elementet e nevojshme të parashikuara nga neni 25 i LGJA, i cili në bazë të nenit 25/1 merr një vendim jopërfundimtar. Ndaj këtij të fundit lejohet ankim i veçantë për kthimin e padisë dhe akteve, që i bashkëlidhen asaj në rastet që paditësi nuk plotëson të metat e konstatuara brenda 10 ditëve.<sup>113</sup>
- Njoftimi i të paditurit për t'u njohur me padinë dhe aktet shoqëruese të saj në mënyrë që të sigurohet respektimi i parimit të një gjykimi sa më të drejtë si dhe për t'i dhënë mundësinë të paditurit të organizojë mbrojtjen e tij dhe paraqitjen e prapësimeve. Në nenin 25/b sanksionohet së ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se 10 ditë dhe në rastin e padisë me të meta, gjyqtari e dërgon këtë njoftim për të paditurin, në datën e plotësimit të të metave nga paditësi. Mosparaqitja e palëve në veprime përgatitore nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit të çështjes, edhe kur ata janë thirrur dhe njoftuar rregullisht. Njoftimi drejtuar dëshmitarëve dhe ekspertit duhet të përmbajë paralajmërimin, për sanksione, sipas ligjit, për mosparaqitje në seancë, pa shkak të ligjshëm. Ndërkohë që në ligjin për gjykatën administrative rregulli i kundërt zbatohet në lidhje me mosparaqitjen e provave, njoftimi drejtuar palëve duhet të përmbajë paralajmërimin që, **mosparaqitja e provave përpara seancës së parë gjyqësore shkakton mospranimin e tyre.**

---

<sup>113</sup>Neni 25; 25/1; 25/b i ligjit

- Kryen edhe veprime të tjera të parashikuara nga neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile në lidhje me pezullimin, pushimin, bashkimin, kompetencën, moskompetencën si dhe të gjitha veprimet përgatitore të përmendura me lart, për aq sa ato janë të pajtueshme me nenet e këtij ligji.<sup>114</sup>
- Gjyqtari vendos pushimin e gjykimit të çështjes kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë dhe në rastet e tjera të parashikuar nga ky ligj. Gjyqtari kryesues vendos për bashkimin e padive në një gjykim të vetëm kur ka të njëjtin objekt, palë dhe i drejtohet të njëjtës gjykatë.

Gjyqtari kryesues **vendos pezullimin e gjykimit** të çështjes kur:

- i. Çështja e shtruar për zgjidhje ka lidhje me një çështje tjetër penale ose civile që nuk është zgjidhur ende,
- ii. Njëra nga palët nuk ka ose ka humbur zotësinë për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme të emërohet një përfaqësues ligjor,
- iii. Kur të dyja palët kërkojnë pezullimin e gjykimit,
- iv. Njëra nga palët vdes ose personi juridik mbaron.

Gjyqtari kryesues vendos për moskompetencën e gjykatës kur çmon se hyn në kompetencën e një gjykate tjetër dhe i dërgon asaj padinë bashkë me aktet e paraqitura. Kundër vendimit të gjyqtarit kryesues, me të cilin vendoset pezullimi i gjykimit e moskompetenca e gjykatës, mund të bëhet ankim i veçantë në një gjykatë më të lartë. Gjyqtari kryesues vendos nëse çështja e paraqitur për gjykim është nën juridiksionin administrativ apo civil dhe kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në një gjykatë më të lartë.<sup>115</sup>

---

<sup>114</sup>Neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile

<sup>115</sup>Neni 13 i ligjit

Të gjitha këto veprime të gjyqtarit kryesues kryhen me vendime të ndërmjetme dhe dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhen prej të dyve.<sup>116</sup>

Gjyqtari kryesues cakton ditën dhe orën e gjykimit të çështjes, veprimet përgatitore firmosen në fund nga gjyqtari kryesues si dhe nga palët. Veprimet përgatitore bashkë me padinë i dorëzohen sekretarisë gjyqësore e cila zbaton kërkesat që pasqyrohen në këto veprime.

---

<sup>116</sup>Neni 25/2 i ligjit

#### 4.9. Kryerja e ekspertimit

Gjyqtari kryesues merr vendimin për kryerjen e ekspertimit në lidhje me mosmarrëveshjet që kërkojnë njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit.

Thirrja e ekspertit ka për qëllim të plotësojë njohuritë e gjykatës kur për perceptimin ose vlerësimin e një prove që ka lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi janë të domosdoshme njohuritë e posaçme të cilat nuk i ka gjykata.<sup>117</sup>

Për këtë arsye LGJA ka parashikuar thirrjen e një ose më shumë ekspertëve të cilët ndihmojnë gjykatën me mendime, relacione ose raporte me shkrim.

Kërkesa për të thirrur ekspert mund të parashtrohet si nga palët ashtu edhe nga gjykata ndërkohë që vendimi jepet nga gjyqtari kryesues për thirjen ose jo të tij/tyre.

Zakonisht si ekspert caktohet personi që ndodhet në listat e profesionistëve të lirë të afishuar në gjykatë. Gjykata përpara se eksperti të fillojë nga kryerja e detyrës i kujton atij rëndësinë e funksioneve për të cilat është thirrur për t'i përmbushur dhe e fton të bëjë betimin.<sup>118</sup>

Njoftimi drejtuar ekspertëve të caktuar nga gjyqtari duhet të përmbajë detyrimin e ekspertit, për të paraqitur aktin e ekspertimit, me shkrim, pesë ditë përpara seancës gjyqësore. Eksperti duhet të kryejë funksionin dhe detyrat e tij në mënyrë të paanshme që do të thotë se nuk duhet të ketë interes të drejtpërdrejtë me objektin e gjykimit e as të ketë lidhje gjaku apo familjare me palët ndërgjyqësore.

---

<sup>117</sup>Neni 25 pika ç

<sup>118</sup>Neni 226 i K.Pr.C



Gjthashtu eksperti ka përgjegjësi sipas Kodit Penal në rast se kundërshton të kryejë detyrën që i ngarkohet ose kryen ekspertim të rremë.

#### 4.10. Sigurimi i padisë

Gjatë kohës që kalon midis qëllimit për të filluar një proces gjyqësor dhe fillimit e mbarimit të tij, ose kohës që kalon gjatë zhvillimit të procesit dhe përfundimit të tij, mund të ndodhë që e drejta që kërkohet të njihet nëpërmjet procesit të gjykimit, të jetë e kërcënuar prej një dëmi të menjëhershëm e të pariparueshëm.

Në këto raste gjyqtari kryesues merr masa për sigurimin e objektit të padisë ose për sigurimin e një prove që ka rrezik të zhduket<sup>119</sup>. Pra, ekzistenca e një urgjence në mënyrë për të shmangur ardhjen e një dëmi serioz dhe të pariparueshëm që mund t'i shkaktohet paditësit detyron gjykatën të marrë një masë të tillë siç është sigurimi i padisë<sup>120</sup>.

Nëpërmjet sigurimit të objektit të padisë dhe sigurimit të provës ekzistojnë ndryshime që konsistojnë në këto drejtime kryesore: me sigurimin e objektit të padisë duhet të kuptojmë sigurimin e mjeteve materiale që hyjnë në objektin e kërkimit të padisë, në mënyrë që ato mos të zhduken nga i padituri ose persona të tretë. Sigurimi i provave ka për qëllim që të ruajë provën ose vlerën provuese të saj deri në momentin e gjykimit. Kjo shqyrtohet nga vet gjyqtari kryesues brenda 5 ditëve, në prani ose në mungesë të palëve.

Nëse shikohet e arsyeshme, mund të bëhet me kërkesë të paditësit gjatë seancës gjyqësore ose para ngritjes së padisë nëse e lejon gjykata, në rast të kundërt brenda 10 ditësh pala duhet të ngrëjë padi.<sup>121</sup> Në këtë rast, kërkesa për sigurimin e padisë duhet të jetë gjithmonë e lidhur me një marrëdhënie funksionale dhe plotësueshmërie me

---

<sup>119</sup>Neni 28 i ligjit

<sup>120</sup>S. Sadushi, "Gjykata Administrative dhe kontrolli Ligjor mbi Administratën", Botimet "Toena", Tiranë, 2014, fq. 274.

<sup>121</sup>Neni 28/2 i ligjit

padinë e ngritur ose që do të ngrihet së shpejti. Kjo marrëdhënie jepet dhe përcaktohet nga fakti, që sigurimi që kërkohet, ka për qëllim të garantojë rezultatin e dobishëm të padisë.

Por kërkesa për sigurimin e padisë është një kërkim i veçantë që mund të pranohet ose të rrezohet nga gjyqtari kryesues sipas bindjes së tij të brendshme dhe sipas bazueshmërisë. Megjithatë, që të pranohen të gjitha masat për sigurimin e padisë duhet të plotësojnë disa kushte të veçanta të parashikuara nga ligji si:

**a) ekziston dyshimi i arsyeshëm**, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin. Sipas kësaj pike nuk bëhet fjalë për të vertetuar ekzistencën e të drejtës që është pikërisht objekt i procesit të gjyqimit të themelit të padisë, por vetëm për të formuluar një gjykim në lidhje me mundësinë e ekzistencës së saj mbi bazën e një njohje të shpejtë dhe të sipërfaqshme.

Për këtë arsye një nga kushtet është që padia të mbështetet në prova e shkresa pasi prova shkresore më shumë se çdo provë tjetër i lejon gjykatës një njohje më të shpejtë të së drejtës të pretenduar si të shkelur.

**b) nuk cenohet rëndë interesi publik.** Sipas kësaj pike duhet hetuar në lidhje me vërtetësinë e rrezikut që mund të vijë nga vendosja e masës së sigurimit mbi një kategori të drejtash që çenojnë interesin publik.

**c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci**, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Kjo pikë i referohet dhënies së garancisë nga ana e paditësit për dëmet e mundshme që mund t'i

shkaktohen të paditurit. Megjithatë kërkitimi i garancisë është lënë në diskrecion të gjykatës e cila cakton masën dhe llojin e saj si dhe afatin brenda të cilës garancia duhet të jepet.<sup>122</sup>

Në fund të shqyrtimit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, gjykata shprehet me vendim (të ndërmjetëm) për pranimin ose rrëzimin e saj.

Kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit mund të rrëzohet për shkaqe procedurale si psh, në rastin e moskompetencës ose kur është kërkuar para ngritjes së padisë ose i mungojnë kushtet formale, ashtu edhe për shkaqet e themelit.

Vendimi për rrëzimin e sigurimit të padisë për shkaqe procedurale nuk ndalon ringritjen e saj, gjithmonë pasi të jenë plotësuar të metat procedurale që kanë shaktuar mospranimin e saj ndërkohë që e kundërta ndodh në rastet që padia për sigurimin e padisë rrezohet për shkaqe të themelit. Në këtë rast paditësi nuk mund ta ringrejë këtë padi.<sup>123</sup>

**Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë.** Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi jepet nga gjykata, pranë së cilës ndodhet padia.

Sic e thamë më sipër, vendimi për sigurimin e padisë është një vendim i ndërmjetëm dhe si çdo vendim i ndërmjetëm i dhënë nga gjykata administrative e shkallës së parë mund të ndryshohet ose të tërhiqet gjatë gjykimit.

---

<sup>122</sup> Neni 29 i ligjit

<sup>123</sup> Neni 28 i ligjit

Ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm, që mund të sjellë vendosjen e masës së sigurimit, ndryshimin ose heqjen e masës së sigurimit, LGJA në nenin 32 ka parashikuar që mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën më të lartë.<sup>124</sup>

Kur procesi i shqyrtimit të padisë arrin fundin, gjyqtari kryesues ka dy zgjidhje;

- ose të njohë dhe të pranojë se e drejta e paditësit duhet përmbushur, gjë që sigurohet nëpërmjet ligjërit të masës së sigurimit të padisë;
- ose të deklarojë të drejtën inekzistente duke rrëzuar sigurimin e padisë.

Në rastin e parë kur e drejta njihet, pala mund të kërkojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Kjo e drejtë e fituar njihet palës edhe në rastin kur çështjet që formojnë objekt gjykimi paraqesin një karakter të tillë urgjence, që nuk mund të presë përfundimin e procesit. Nga ana tjetër, dhe në rastet e parashikuara nga ligji për këto çështje, mund të merren masa të përkohshme që do t'i japin zgjidhje provizore deri në çastin e dhënies së vendimit.

Për sa i përket llojit të masave për sigurimin e padisë, neni 30 i LGJA parashikon se sigurimi i padisë bëhet ndaj:

**a) pezullimit të zbatimit të aktit administrativ**, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ. Siç vërehet nga kjo pikë e ligjit rëndësi të veçantë si lloj e masave të sigurimit të padisë merr pezullimi i zbatimit të aktit administrativ, kontratës së punës ose veprimit tjetër administrativ.

**b) marrjes edhe të masave të tjera të përshtatshme** nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme. Duke qenë se llojet e tjera të masave të

---

<sup>124</sup>Neni 32 i ligjit

sigurimit duhet të jenë të përshtatshme e të dobishme për të mbrojtur të drejtat e paditësit del se kufijtë e vendosjes së këtyre masave do të duhet të kërkohen në marrëdhëniet midis këtyre masave dhe vendimit gjyqësor të themelit që do të duhet të jepet. Kjo do të thotë se ato do të varen nga objekti i mosmarrëveshjeve të gjykimit duke nënkuptuar vetë të drejtën që pretendohet në gjykim, e drejtë që mund të çënohet nga kohëzgjatja e domosdoshme ose nga vonesat procedurale të zhvillimit të gjykimit dhe jo nga një fakt i jashtëm qoftë ky që i ngarkohet të paditurit.<sup>125</sup>

---

<sup>125</sup>Neni 30 i ligjit

#### 4.11. Shqyrtimi gjyqësor

Në Shqipëri, shqyrtimi gjyqësor i përket asaj pjese të fazës së gjykimit ku organi administrativ parashtron rrethanat e faktit dhe provat që kërkohen të shqyrtohen, kurse paditësi parashtron argumentat që do të provojë. Kjo është faza ku shqyrtohen provat dhe debatohet lidhur me to si dhe lidhur me vlerësimin e tyre.

Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet në seancë gjyqësore dhe në përputhje me rregullat procedurale administrative gjithmonë duke u mbështetur edhe tek ato civile për shkak të boshllëqeve ligjore që mund të paraqesë ligji për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative.<sup>126</sup>

Sipas nenit 20/1 të LGJA, seancat gjyqësore janë publike, përndryshe quhen të pavlefshme.

Por, në raste të veçanta, gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e mediave dhe të publikut në seancë gjyqësore ose në një pjese të saj, me arsyetimin e mbrojtjes së moralit publik, rendit publik, të sigurisë kombëtare, të sekretit tregtar, të së drejtës së jetës private ose të të drejtave vetjake dhe si rezultat i tyre seanca zhvillohet me dyer të mbyllura.<sup>127</sup>

Drejtimi i seancës gjyqësore bëhet nga kryetari, urdhërat e kryetarit të trupit gjykues apo të gjyqtarit kryesues për ruajtjen e rregullit dhe qetësisë në seancë janë të detyrueshme për palët dhe pjesëmarrësit në seancën gjyqësore si dhe të zbatueshme nga organet e policisë së shtetit.

---

<sup>126</sup> Neni 34i ligjit

<sup>127</sup> Neni 20/1 e ligjit

### **Në ligj është parashikuar zhvillimi i gjykimit të pandërprerë.**

Sipas kësaj dispozite kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë gjykimin në ditën e pasme të punës.

Në praktikën gjyqësore është e vështirë të konstatohet ndonjë rast kur gjykimi ka përfunduar brenda një seance të vetme. Po kështu, rastet kur shqyrtimi gjyqësor shtyhet në ditën e mëpasme të punës janë të rralla, për shkak të ngarkesës së çështjeve, kryerjes së njoftimeve për ekspertët apo veprime të tjera të kësaj natyre.

Shqyrtimi i akteve administrative më parë ka qënë nën kompetencën e sistemit gjyqësor të zakonshëm. Me miratimin e ligjit të ri të pushtetit gjyqësor në shtator të vitit 2013 është parashikuar ngritja e gjykatave administrative, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me ligjin Nr. 49/2012 <sup>128</sup>.

Shqyrtimi i çështjes para gjykatës bëhet verbalisht por palët mund të parashtrojnë me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre rreth çështjes në gjykim. Në seancë mbahen procesverbale ku paqyrohen shpjegimet e palëve, provat që merren si dhe vendimet dhe urdhërat që shpall gjykata.

### ***Çelja dhe zhvillimi i seancës gjyqësore.***

Për efekte studimore, seancën e ndajmë në tri faza:

- a. Pjesa hyrëse
- b. Hetimi gjyqësor
- c. Dhenia e vendimit

---

<sup>128</sup> Neni 7 i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetitgjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.



Pjesa hyrëse ka të bëjë kryesisht me veprimet që synojnë të parapërgatisin çështjen për gjykim dhe kur është e mundur të zgjidhin çështjen me pajtim.

Në këtë pjesë gjykata trajton këto problematika:

- Në ditën dhe orën e caktuar palët apo përfaqësuesit e tyre janë të detyruar të njoftojnë gjykatën për praninë e tyre.
- Përpara se të fillojë seanca gjyqësore, sekretari ose nënpunësi gjyqësor thërret palët ose përfaqësuesit e tyre dhe i fton ata të zënë vendet e caktuara.
- Me t'u paraqitur në seancë gjyqësore, kryesuesi i gjykimit, me solemnitet deklaron çeljen e gjykimit.
- Merret në shqyrtim çështja X që u përket palëve ndërgjyqëse – Paditësi A kundër të paditurit B, me objekt “.....”.

Kështu, gjyqtari kryesues fton pjesëmarrësit në seancë gjyqësore dhe merr identitetin e plotë të tyre. Kur palët kanë përfaqësues ligjor, verifikohet ligjshmëria e përfaqësimit.

Gjykata heton mbi shkaqet e moparaqitjes së palëve dhe fillimin e gjykimit në mungesë të tyre në rast të mosprezencës. Gjykata verifikon legjitimitetin e palëve, kur është rasti i fton ato të plotësojnë dokumentat që janë me të meta duke u caktuar palëve një afat.

Gjyqtari kryesues kujdeset për ruajtjen e rregullit dhe të qetësisë në seancë. Ai ka të drejtë të urdhërojë largimin nga salla e gjyqit të personave që prishin rregullin dhe qetësinë e zhvillimit të seancës gjyqësore.

Pas marrjes së identitetit, drejtuesi i trupit gjykues shpall përbërjen e trupit gjykues dhe nese një nga të pranishmit - palë gjykimi ka kundërshtim për përbërjen e tij atëherë për arsye të parashikuara në ligj, mund të bëjë kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit konkret.

Nëse palët janë dakord për përbërjen e tij, atëherë kryetari i trupit gjykues bën përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim. Kur palët bien dakord që çështjen ta zgjidhin me pajtim, mbahet procesverbal ku fiksohen në mënyrë të plotë të gjitha kushtet e pajtimit.

Ky procesverbal firmoset nga pjesëmarrësit në gjykim dhe gjyqtari jep vendimin për miratimin e tij ku në çdo rast nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligjin.

Kur çështja nuk zgjidhet me pajtim, gjyqtari kryesues kalon në leximin e padisë.

Pas kësaj i kërkohen shpjegime të hollësishme paditësit lidhur me përmbajtjen e padisë. Në këtë moment paditësi ka të drejtë:

- a. Të shtojë ose pakësojë objektin e padisë
- b. Të ndryshojë shkakun e padisë, por në asnjë mënyrë paditësi në këtë fazë nuk mund të ndryshojë njëkohësisht objektin dhe shkakun e padisë sepse ndryshimi i tyre bën që të jemi para një padie të re. Në këtë moment të gjykimit paditësi mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë e në këtë rast gjykata duhet të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes. Pushimi nuk e zgjidh çështjen në themel por i jep mundësi paditësit që me këtë shkak objekti të ngejë një padi të re.

- c. Të heqë dorë nga e drejta e padisë. Në këtë rast gjykata duhet të vendosë rrezimin e padisë. Vendimi që rrezon padinë është vendimi që e zgjidh çështjen në themel, prandaj padia e rrëzuar me këtë vendim, nuk mund të ngrihet kurrë më. Heqja dorë nga e drejta e padisë para apelit ka si rrjedhim prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe rrezimin e padisë nga ana e kësaj gjykate.
- d. Të bëjë zëvendësimin e tij ose të të paditurit me një person tjetër, kur gjatë gjykimit del se padia është ngritur nga një person që nuk ka të drejtë ta ngrejë ose kundër një personi juridik që nuk duhej të ngrihej. Për zëvendësimin e palëve në procesin gjyqësor gjykata merr pëlqimin e palëve dhe personave që hyjnë në vend të tyre.
- e. Në këtë moment të gjykimit paditësi ka të drejtë të shtrijë padinë e tij edhe kundër ndonjë personi tjetër ose të thërrasë në gjykim një person të tretë në ndihmë të tij ose me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen ose nga i cili mund të kërkohet garanci ose shpërblim që lidhet me përfundimin e çështjes. Personi i tretë thërritet me kërkesë të shkruar që paraqitet në sekretarinë e gjykatës. Gjyqtari urdhëron të njoftohet personi i tretë. Ai gjithashtu mund të thërrasë personat e interesuar.

Pasi merren nga paditësi në mënyrë të hollësishme të gjitha të dhënat e duhura, i jepet fjala organit administrativ që të shpjegojë pretendimet e ngritura kundër tij.

Organit administrativ i takon barra e provës dhe ka të drejta të plota të kundërshtojë pjesërisht apo plotësisht pretendimet e paditësit apo edhe të bëjë kërkime ndaj tij. Këto kërkime mund t'i bëjë në formën e prapësimit apo kundërpadisë.

Ai mund të thërrasë në gjykimin e çështjes një person të tretë apo të interesuar.

Mosmarrëveshjet administrative mund të paraqiten në shqyrtim gjyqësor, nëse:

- organi administrativ ka vepruar në cilësinë e tij si ushtrues i të drejtave sovrane/autoritetit shtetëror;
- paditësi kërkon anulimin ose ndryshimin e aktit administrativ ose kundërshton refuzimin e organit administrativ për nxjerrjen e një akti administrativ ose mosshqyrtimin nga organi administrativ të ankesës së paditësit brenda afatit të caktuar, dhe
- paditësi argumenton që akti administrativ është i paligjshëm dhe kjo cënon interesat dhe të drejtat e tij.<sup>129</sup>

Përveç paditësit dhe të paditurit, kushdo mund të ndërhyjë ndërmjet tyre kur pretendon për vete pjesërisht apo tërësisht, një të drejtë që është objekt i padisë në shqyrtim ose që lidhet me përfundimin e gjykimit.

Kjo ndërhyrje bëhet duke i paraqitur gjykatës kërkesën me shkrim dhe këtu gjendemi para ndërhyrjes kryesore. Gjthashtu, kushdo mund të ndërhyjë në një proces gjyqësor që zhvillohet mes personave të tjerë, kur ka interes për të mbështetur njërin ose tjetrën palë me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë.

Gjykata pranon marrjen pjesë të personit të tretë në gjykimin administrativ me vendim të ndërmjetëm. Kundër vendimit për marrjen pjesë të personit të tretë mund të ushtrohet ankimi i veçantë.<sup>130</sup>

---

<sup>129</sup> Neni 35 i ligjit

<sup>130</sup> Neni 16/ç i ligjit

**Megjithatë, para paraqitjes së çështjes në gjykatë, paditësi duhet të kërkojë vendimin e organit më të lartë administrativ që shqyrton ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë<sup>131</sup>.**

**Organi administrativ kompetent që ka nxjerrë ose nuk ka nxjerrë aktin administrativ kundër të cilit është bërë ankimi duhet të vendosë mbi ankimin administrativ brenda një muaji nga paraqitja e tij. Nëse ai nuk e pranon ankimin, ai është i detyruar ta transferojë ankimin tek organi epror, i cili duhet të vendosë në lidhje me ankimin brenda dy javësh. Nëse organet administrative nuk u përmbahen afateve, ankimesi mund t'i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës<sup>132</sup>.**

Shqyrtimi i efektshëm gjyqësor i akteve administrative është një element thelbësor i sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në të njëjtën kohë është një instrument i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë administrative dhe për të siguruar një qeverisje të mirë.

Për më tepër, është një kërkesë e një ekonomie në zhvillim, pasi siguria e tregtisë dhe investimeve ndërkombëtare kërkojnë organe publike vendim-marrëse që t'u nënshtrohen mjeteve të efektshme të mbrojtjes<sup>133</sup>. Kjo ide themelore është pranuar nga të gjithë vendet europiane në këto dekadat e fundit, pavarësisht qëndrimeve të ndryshme në lidhje me krijimin dhe organizimin e juridiksionit administrativ.

---

<sup>131</sup> Shih Nenin 328 të KPC; për hollësi procedurale brenda administratës, shih Kodin e Procedurave Administrative (KPA).

<sup>132</sup> Nenet 137, 141, 142 CAP në lidhje me Nenin 328, paragrafi 2 i KPC

<sup>133</sup> Jean-Marie Woehrling, Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në Europë: Drejt një modeli të përbashkët, i redaktuar nga SIGMA (një iniciativë e përbashkët e OSBE-së dhe BE-së)

Edhe pse ky zhvillim bazohet në tradita të ndryshme dhe fusha e gjykimeve administrative ndryshon shumë në sistemet ligjore të shteteve të ndryshme, sërish po ngrihet një kuadër përherë e më i qëndrueshëm i parimeve të përbashkëta.

Me qëllim që të arrihet një unitet më i madh ndërmjet anëtarëve të tij në lidhje me praktikën dhe për të siguruar mundësinë e efektshme për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative, Këshilli i Europës – Komiteti i Ministrave – ka miratuar “*rekomandimin për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative*” më 15 dhjetor 2004<sup>134</sup>. Ky i fundit nuk përcakton se si duhet të organizohet shqyrtimi gjyqësor por parashikon rregullat e përgjithshme që duhet të respektohen nga shtetet anëtare në organizimin e shqyrtimit gjyqësor të akteve administrative. Pra, ai reflekton gjendjen e tashme të “*standardeve europiane*”, të cilat duhet të respektohen.

Në kuadrin e këtij diskutimi, vlejné parimet e mëposhtme:

(a) *Shqyrtimi gjyqësor duhet të kryhet nga një gjykatë e ngritur me ligj, pavarësia dhe paanësia e të cilës garantohen në kushtet e Rekomandimit për Pavarësinë, Efikasitetin dhe Rolin e Gjyqtarëve (Nr.R (94) 12).*

Ky parim konfirmon që zgjidhja e një mosmarrëveshjeje administrative është çështje e një gjykate të ngritur me ligj në pajtim me kërkesat e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse kjo e fundit fillimisht mendohej të zbatohet në fushën administrative, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e ka konsideruar atë të zbatueshme për çështjet administrative qysh nga viti 1971.<sup>135</sup> Ndarja e juridiksioneve administrative është e një rëndësie të veçantë. Meqenëse u kërkohet të zgjidhin mosmarrëveshje, ku përfshihen organe publike, gjyqtarët e çështjeve administrative

---

<sup>134</sup> Rec (2004)20

<sup>135</sup> Shih: Vendimin Ringeisen v. Austria, 16 korrik 1971 Seria A Nr. 13; Gilles Dutertre, Pjesë nga çështjet kryesore, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut 2003, f. 174-180

janë të ekspozuar përballë një rreziku të lartë të të qenit të ndikuar apo që konsiderohen sikur janë të ndikuar nga pushteti ekzekutiv. Kështu, juridiksionet e veçanta japin të njëjtat garanci të paanësisë dhe pavarësisë si dhe gjykatat e zakonshme. Gjyqtarët e çështjeve administrative nuk duhet të jenë nëpunës civilë që pak a shumë shqyrtojnë ankesa administrative formale, por gjyqtarë të vërtetë dhe plotësisht të pavarur.

**(b)** *Një gjykatë administrative është pjesë e sistemit të zakonshëm gjyqësor.*

Ky parim plotëson të mëparshmin, duke përcaktuar karakteristikat e organit përgjegjës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative. Ky u referohet të dy modeleve që ushtrohen tradicionalisht në vendet europiane, d.m.th. një juridiksion administrativ që është autonom dhe një që është i integruar në sistemin gjyqësor të zakonshëm. Këto modele shpesh janë vendosur kundrejt njëri-tjetrit duke e specifikuar të parin si një juridiksion administrativ “*të specializuar*”. Megjithatë, kjo kundërvënie nuk korrespondon domosdoshmërisht me ndonjë ndryshim thelbësor, pasi edhe sistemi gjyqësor i zakonshëm mund të sigurojë një shkallë të lartë specializimi duke krijuar dhoma ose seksione të çështjeve administrative ashtu siç kanë bërë shumica e vendeve që kanë ruajtur unitetin e juridiksionit<sup>136</sup>. Sidoqoftë, për sa i takon përputhshmërisë me standardet europiane, të dy modelet janë të barabarta.

**(c)** *Vendimi i gjykatës që shqyrton një akt administrativ, të paktën në çështjet e rëndësishme, duhet t’i nënshtrohet ankimit në një gjykatë më të lartë, përveç kur çështja i dërgohet drejtpërdrejt gjykatës më të lartë administrative në pajtim me legjislacionin vendas.*

---

<sup>136</sup> Për më shumë hollësi shih: Jean-Marie Woehrling, Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në Europë: Drejt një modeli të përbashkët, i redaktuar nga SIGMA (një iniciativë e përbashkët e OSBE-së dhe BE-së)

Megjithëse në bazë të Konventës për të Drejtat e Njeriut mjetet e ankimit nuk janë detyruese, rekomandimi kërkon një të drejtë ankimi në shumicën e rasteve me mendimin që mbrojtja e përshtatshme gjyqësore përfshin të drejtën për një gjykim të dytë. Megjithatë, është në kompetencën e Shtetit të vendosë kufirin brenda të cilit mund të bëhen ankime te gjykatat më të larta dhe të specifikojnë juridiksionin e organit të ankimit. Meqenëse përfshirja e një instance më të lartë në gjykimin administrativ është thelbësore, për të garantuar njëtrajshmërinë e praktikës gjyqësore administrative, parimi nuk zbatohet nëse një çështje i dërgohet drejtpërdrejt gjykatës më të lartë në pajtim me ligjin e brendshëm<sup>137</sup>.

*(d) Personave fizikë dhe juridikë mund t'u kërkohe të ushtrojnë mjetet mbrojtëse të parashikuara nga ligji i brendshëm para se të kenë të drejtën e shqyrtimit gjyqësor.*

Procedura e ushtrimit të këtyre mjeteve mbrojtëse nuk duhet të jetë e tejzgjatur. Ushtrimi i mjeteve të tjera mbrojtëse para kërimit të shqyrtimit gjyqësor bën të mundur parandalimin e ngarkesës së tepërt të punës për gjykatat duke ndikuar në efikasitetin gjyqësor. Kjo është në interes të gjyqësorit dhe administratës dhe mund të kontribuojë në pakësimin e shpenzimeve procedurale për individin. Megjithatë, ky detyrim nuk duhet të ndalojë personat fizikë dhe juridikë të kërkojnë shqyrtimin gjyqësor të aktit administrativ duke e zgjatur gjykimin në tërësi në mënyrë të parregullt.<sup>138</sup>

Organizimi i mëparshëm i shqyrtimit administrativ të akteve administrative në Shqipëri përputhej me standardet europiane në lidhje me kompetencën e gjykatave të zakonshme, mjeteve ligjore të mbrojtjes dhe kërkesën për të kërkuar vendimin e një

---

<sup>137</sup> Rec (2004)20 Memorandum shpjegues për parimin 4.i

<sup>138</sup> Rec (2004)20 Memorandum shpjegues për parimin 2.b



organi më të lartë administrativ para se të vihet në lëvizje gjykata që nuk e zgjat gjykimin në mënyrë të parregullt. Megjithatë, ngritja e një sistemi gjyqësor administrativ të veçantë do të përputhet gjithashtu me standardet europiane, nëse do të garantohet pavarësia dhe paanësia e gjykatës administrative dhe nëse do të respektohet ankimi i paktën në çështjet më të rëndësishme ose nëse çështjet do të dërgohen drejtpërdrejt në një gjykatë më të lartë.

Nëse kërkesa për marrjen e një vendimi nga një organ më i lartë administrativ respektohet, duhet të kërkohet, gjithashtu, të sigurohen garancitë përkatëse për mënjanimin e zgjatjes së tepërt të gjykimeve.

Pasja e një gjykate të veçantë administrative në Shqipëri ka qënë diskutuar prej kohësh, për të cilën është hartuar fillimisht një projektligj dhe tashmë është ligji i veçantë që ka rregulluar organizimin dhe funksionimin e saj<sup>139</sup>.

Kjo analizë praktikisht është fokusuar në zbërthimin e realitetit që tentohet të ndryshohet, natyrisht, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave legjitime të subjekteve të së drejtës.

Në fakt historia e së Drejtës Administrative mund të shkruhet ndryshe si një histori e autoritetit dhe mënyrës së ushtrimit të tij të formave të ushtrimit të pushtetit dhe transformimet e tij.

Akti administrativ nuk është vetëm formë e ushtrimit të veprimtarisë administrative por është edhe masa për të kufizuar këtë autoritet dhe liritë e të tjerëve.

Pikërisht për këtë është garanci për lirinë e kujtudo në marrëdhënien e rregulluar.

Për këtë arsye, procedimi mund të konsiderohet si një instrument kryesor për një bashkëjetesë sociale dhe politike.

---

<sup>139</sup> Në Shqipëri ka filluar të flitet për procedimin administrativ vetëm pas miratimit të Kodit të parë të Procedurave Administrative në 1999.

Shqyrtimi gjyqësor i akteve administrative duhet të shtrihet për:

- Çdo akt normativ (nënligjor) të lëshuar nga një autoritet publik (që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe/ose interesat e ligjshme);
- Çdo akt individual administrativ i lëshuar nga një autoritet publik, që krijon, modifikon ose shfuqizon një marrëdhënie juridike;
- Çdo akt real, veprim material ose akt i brendshëm (që prek drejtpërdrejt të drejtat dhe/ose interesat e ligjshme);
- Çdo mosveprim apo refuzim nga ana e autoritetit publik për të vepruar në rastet kur autoriteti publik ka detyrim për të vepruar;
- Çdo proces gjyqësor lidhur me marrëdhëniet e punës që ka për palë autoritetin publik dhe punonjësit e vet;
- Çdo proces gjyqësor që ka të bëjë me lidhjen, interpretimin, ekzekutimin dhe zgjidhjen e kontratave që kanë për palë autoritetet publike;
- Kompensimin e dëmeve me natyrë monetare ose jo.

Ndërsa në lidhje me legjitimitimin njihen tri koncepte për akses në procedurat gjyqësore administrative:

- Çdokush ka të drejtë për të kundërshtuar çdo veprim administrativ pa kërkesa të mëtejshme (*actio popularis* - nuk është shumë i përhapur në Europë);
- Paditësi duhet të ketë një interes të ligjshëm të kualifikuar për të kundërshtuar një veprim administrativ (modeli francez, precedentë të Gjykatës së Drejtësisë);
- Aksesin në gjykatë lejohet vetëm kur ka një pretendim për shkelje të të drejtave subjektive (modeli gjerman).<sup>140</sup>

---

<sup>140</sup>Po aty

**Një kombinim i sistemit gjerman (e drejta subjektive individuale) dhe francez (interes ligjor i kualifikuar) është çelësi për vendosjen e një koncepti të barazpeshuar për palën e interesuar.**

Ata që nuk preken në të drejtat e tyre subjektive ose interesat ligjore, nuk kanë të drejtën të ngrenë një padi administrative (*legjitimiteti aktiv*).

**Një institucion publik që padit një tjetër institucion publik nuk duhet të ketë të drejtën e padisë kur ato i përkasin të njëjtës varësi administrative.**

Nëse një numër aplikantësh ndajnë të njëjtin interes, pranohen paditë e përbashkëta (ligji francez). Për rrjedhojë, shqyrtimi ligjor i akteve administrative nga gjykata të pavarura do të synojë të krijojë mundësinë për kontrollin e të gjitha akteve për infrastrukturën që kalojnë përmes një procesi licencimi. Njëkohësisht, rrit gjithashtu transparencën e vendimeve administrative dhe luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

**Krijimi i gjykatës administrative ka shërbyer si forcë stimuluese për modernizimin e administratës publike, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të administratës dhe rritjen e besimit të qytetarëve për institucionet shtetërore.**

Ajo që është edhe më e rëndësishme është kontributi për të siguruar rendin kushtetues, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administratës publike.

#### 4.12. Veprimet paraprake

Më çeljen e seancës së parë gjyqësore, ku përshkruhet vendi, data dhe ora e seancës, kryetari verifikon paraqitjen e palëve. Fillimisht verifikohet nëse janë kryer njoftimet e nevojshme, nëse ato janë kryer në formën e kërkuar nga ligji dhe më pas nëse palët janë paraqitur.

Në rast se palët janë paraqitur, pavarësisht parregullshmërisë së njoftimeve, vijon më tej seanca gjyqësore.

Në nenin 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore përcaktohet se *“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë dhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij...”*.<sup>141</sup>

Këto dispozita, jo vetëm që garantojnë thelbin e të drejtave të parashikuara nga Konventa, por, para së gjithash, përcaktojnë përgjegjësinë kryesore të shteteve për të garantuar gëzimin e të drejtave të parashikuara nga Konventa përpara vetë institucioneve të tij të brendshme.

Neni 35/1 i Konventës ka përcaktuar se *“Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme ligjore, sipas kuptimit dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej 6 muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm.”*.<sup>142</sup> Nëpërmjet kësaj dispozite synohet që shteteve t’u jepet mundësia që ta zgjidhin çështjen ose të vënë në vend të drejtën e shkelur brenda juridiksionit të tyre.

---

<sup>141</sup> Neni 13 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

<sup>142</sup> Neni 35/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Në rast se shtetet rezultojnë të dështuar në venien e së drejtës së shkelur në vend, atëherë subjektet mund t'i drejtohen Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

**Nisur nga kriteret e pranimit së kërkesave pranë Gjykatës së Strasburgut dhe pikërisht nga kriteri sipas të cilit kërkesa duhet të bëhet pasi të gjitha rrugët e brendshme të ankimit janë shteruar, subjektet nuk mund të ankohen pa përfunduar procedurat ankimore brenda vendit.**

Por, ashtu siç do të shohim më poshtë në analizën e legjislacionit shqiptar për ankimin, këtyre subjekteve, në shumicën e rasteve nuk u njihet e drejta për t'u ankuar sipas legjislacionit të brendshëm. Lind pyetja: *A duhet të konsiderohen këto raste si shterim të së drejtës së ankimit brenda vendit?*

Subjekteve të interesuar u lind e drejta që të ankohen në organin kompetent për aktin administrativ që i ka cënuar ata si dhe për të kërkuar revokimin, shfuqizimin ose ndryshimin e aktit. Subjekteve u lind e drejta e ankimit në rastin kur nuk janë dakord me aktin administrativ që ka nxjerrë një organ administrativ si dhe kur organi refuzon të nxjerrë një akt, megjithëse obligohet nga ligji për nxjerrjen e tij.

Ashtu siç parashikohet edhe në Kodin e Procedurave Administrative, ankimi ndaj paligjshmërisë së një akti administrativ mund të drejtohet pranë organit që e ka nxjerrë atë, si dhe në organin epror të organit që ka nxjerrë aktin administrativ<sup>143</sup>.

KPrA synon të parashikojë rregulla të përgjithshme mbi ankimin administrativ. Referuar hierarkisë së akteve juridike, sipas Kushtetutës, ky Kod lë hapësira që çështja e ankimit administrativ të rregullohet nga ligje të posaçme që normojnë marrëdhënie të caktuara juridike në një fushë të caktuar, si për shembull, licencimi, etj.

---

<sup>143</sup> Ligji Nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative

**Pra, duhet patur parasysh që për çdo rast konkret është një ligj i posaçëm që rregullon marrëdhënien e caktuar, i cili përcakton mënyrën e ankimit dhe afatin brenda të cilit paraqitet ankimi, gjykatën kompetente që do të shqyrtojë ankimin, afatin e shqyrtimit të tij dhe çështje të tjera të veçanta që mund të lidhen me ankimin.**

Sipas doktrinës juridike, ky delegim, pra, lënia e hapësirës për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me ankimin administrativ ligjeve të posaçme, konsiderohet si i drejtë.

Në fakt, në praktikë zbatohet vetëm në disa raste pasi për shumë çështje, kriteret për kryerjen dhe shqyrtimin e ankimeve bëhen me urdhra ose udhëzime të titullarëve të institucioneve, pra, me akte nënligjore.

Duke iu kthyer edhe njëherë hierarkisë së akteve juridike dhe efekteve juridike që ato prodhojnë, aktet me karakter rregullator të brendshëm, si për shembull; urdhërat dhe udhëzimet; janë të detyrueshme, pra krijojnë efekte juridike, vetëm brenda njësisë administrative ose njësie që varen prej tyre. Pra, nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individë ose subjekte të caktuara.

**Ankimi administrativ është një mjet juridik i plotë që ka për qëllim shfuqizimin, ndryshimin ose modifikimin e një akti administrativ.**

Nëpërmjet këtij ankimi kërkohet detyrimisht një procedurë e veçantë shqyrtimi.

Ankimi administrativ ndaj veprimtarisë dhe akteve të organeve të administratës publike është mjaft i rëndësishëm për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të subjekteve të së drejtës pasi nëpërmjet tij realizohet edhe kontrolli i brendshëm administrativ.

#### 4.13. Gjykimi në mungesë

Zhvillimi i gjykimit në mungesë ka qenë dhe mbetet një çështje shumë e debatueshme edhe në vendin tonë. Diskutimet kanë qenë të lidhura në pyetjen nëse duhet të ekzistojë ky lloj gjykimi, nëse ky lloj gjykimi respekton të drejtat e palëve, nëse i garantohet atyre e drejta për t'u mbrojtur apo për të bërë ankim kundër vendimit gjyqësor.<sup>144</sup>

Legjislacionet procedurale të disa vendeve si në Zvicër, Greqi etj, nuk e kanë parashikuar zhvillimin e gjykimit në mungesë, ndërsa ligji ynë administrativ, ashtu sikurse edhe i shumë shteteve të tjera, kanë parashikuar mundësinë e zhvillimit të gjykimit në mungesë të Organit Administrativ.<sup>145</sup>

Sigurisht që, e drejta për të qënë e pranishme në gjykim si dhe e drejta për t'u mbrojtur, janë aspekte të rëndësishme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuara këto në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane së të Drejtave të Njeriut (K.E.D.NJ).<sup>146</sup>

Seanca gjyqësore zhvillohet edhe në mungesën e palëve në seancë, pavarësisht njoftimit të rregullt dhe nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit.

**Shqyrtimi i çështjes nga gjykata në seancë gjyqësore bëhet me shkrim, por palët mund të kërkojnë të parashtrojnë, me gojë, shpjegimet e tyre.**

---

<sup>144</sup>Neni 42 të Kushtetutës

<sup>145</sup>Neni 3/4 i ligjit

<sup>146</sup>Neni 6 të Konventës Europiane së të Drejtave të Njeriut (K.E.D.NJ)

Në këtë rast gjykata udhëzon palët që të citojnë vetëm çështjet faktike dhe ligjore që sipas opinionit të saj janë të rëndësishme për dhënien e vendimit edhe nëse ato nuk ishin referuar në kërkesë padinë e paraqitur më parë.

Eksperti i kërkuar nga palët paraqitet në seancën gjyqësore për të shpjeguar me gojë njohuritë e tij të posaçme për natyrën e mosmarrëveshjes. Ai i përgjigjet pyetjeve të bëra nga palët dhe gjykata. Për të ndihmuar kujtesën, eksperti mund të lexoje dokumentet e hartuara prej tij.

Në raste të veçanta dhe të ndërlikuara, gjykata mund të vendosë që eksperti të paraqesë, me shkrim, shpjegimet e tij, brenda një afati jo më të gjatë se 10 ditë.<sup>147</sup>

Eksperti i caktuar nga gjykata paraqitet në gjykim me aktin e përgatitur me shkrim, sipas detyrave të caktuara nga gjyqtari kryesues në veprimet përgatitore. Ai i përgjigjet me gojë pyetjeve të bëra nga palët dhe gjykata.

Në rast se gjykata ka caktuar afat për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare me shkrim të palëve, mosparaqitja me shkrim e tyre brenda afatit të caktuar, nuk përbën shkak për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor.<sup>148</sup>

---

<sup>147</sup>Neni 34/4 i ligjit

<sup>148</sup>Neni 34/5 i ligjit



#### **4.14. Marrja dhe paraqitja e provave**

**Faza e marrjes së provave është një fazë tepër e rëndësishme e shqyrtimit gjyqësor.**

Deri në këtë moment procedural gjykata është njohur vetëm me parashtrimin hyrës të bërë nga paditësi ose argumentat e dhëna nga pala mbrojtëse por me marrjen e provave si dhe nënshtrimin e tyre ndaj debatit gjyqësor gjykata krijon bindjen e saj lidhur me ekzistencën e faktit. Në procesin gjyqësor administrativ provat merren sipas një radhe të caktuar dhe në seancën e parë gjyqësore, palët dhe gjyqtari duhet të njihen me të gjitha aktet dhe provat e paraqitura nga organi publik.

Ligji për Gjykatat Administrative, si mënyrë e zgjidhjes gjyqësore të mosmarrëveshjeve administrative, është komponent thelbësor reformues i dy fushave: sistemit gjyqësor dhe procesit administrativ.

Në të parin, ligji krijon një degë të specializuar të sistemit gjyqësor, në shkallën e parë e të dytë, për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative e, njëkohësisht, një procedurë të dedikuar gjyqësore për kësi çështjesh: e shpejtë, e bazuar në hapa metodologjikë të qartë e të sigurtë, për më tepër, ia kalon barrën e provës së ligjshmërisë së akteve me natyrë ndëshkuese, si gjoba a detyrime, organit administrativ.

**Krijimi i kësaj gjykate në Shqipëri sjell një risi në kuadër të gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, lidhur me detyrimin e organeve publike për të paraqitur provat, që kanë mundësuar nxjerrjen e akteve apo kryerjen e**

**veprimeve administrative të cilat më pas kanë sjellë cënimin e të drejtave të ligjshme të personave.**

Me barrë prove kuptojmë detyrimin e një subjekti të caktuar për të provuar atë që kërkon në objektin e padisë.

Ky përkufuzim i dhënë është dhe përbën parim të zbatueshëm në të drejtën administrative por jo vetëm<sup>149</sup>.

Në shtete si Franca, Gjermania, Italia, Holanda, në thelb qëndron fakti se subjekti që ka detyrimin ligjor për të provuar atë që kërkon në objektin e padisë është paditësi.

Por në ligjin për gjykatat administrative thuhet se si rregull barrën e provës e ka organi që kë nxjerrë aktin administrativ.

Pra, siç e shohim, ky parashikim bën një ndryshim substancial dhe thelbësor të parimit se barra e provës i përket paditësit. Më sipër përmenda faktin se si rregull barra e provës i përket organit të administratës publike që ka nxjerrë aktin.<sup>150</sup>

**Pyetja që ngre është; po përjashtimi nga rregulli cili është?**

Kjo sepse përsa kohë thuhet rregulli, duhet të ketë edhe përjashtimin, por në asnjë rast dhe asnjë dispozitë të këtij ligji nuk thuhet se barra provës i takon paditësit, gjë që do të përbënte edhe përjashtimin.

Megjithatë, ekziston një teori e cila thotë se rregullimi i marrëdhënieve në mënyrë specifike bëhet nga një organ kushtetues i autorizuar nga ligji, por ligji në fjalë nuk

---

<sup>149</sup>Neni 35 i ligjit

<sup>150</sup>Po aty

parashikon asnjë organ kushtetues që të nxjerrë akte nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

Kjo do të thotë se në bazë të nenit 118 të Kushtetutës, që një organ duhet të nxjerrë akte nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit duhet të jetë i autorizuar nga ligji<sup>151</sup>.

Mungesa e një autorizimi të tillë nuk legjitimon asnjë organ të ushtrojë një kompetencë të tillë, për rrjedhojë duke vazhduar me logjikën e mësipërme themi që sërish barra e provës nuk mund të ndryshohet në raste të veçanta.

Kjo sepse ligji nuk parashikon organin që do nxjerrë akte nënligjore, gjë e cila perbën një problem më vete sepse ligji asnjëherë nuk parashikon në mënyrë specifike rregullimin e marrëdhënieve juridike. Ndaj qendron teoria e akteve nënligjore që mbulojnë atë fushë të cilën ligji nuk e mbulon. E gjithë kjo realizohet duke respektuar frymën e ligjit dhe pa e tejkaluar atë gjatë krijimit të normave të reja.

Paraqitja e provave nga palët bëhet, në çdo rast, përpara seancës së parë gjyqësore.

Kur nuk respektohet afati i parë i caktuar nga gjykata, palëve i jepet një afat i dytë, që duhet të mbarojë jo më vonë se pesë ditë përpara datës së seancës gjyqësore.<sup>152</sup> Në rast të mosparaqitjes së dokumenteve edhe brenda afatit të dytë të caktuar, shqyrtimi i çështjes vazhdon vetëm mbi aktet e paraqitura.

Shkelja e pajustificuar e detyrimit për të paraqitur dokumentet nga organi publik edhe brenda afatit të dytë të caktuar perbën shkak që gjykata me kërkesë të palës të caktojë gjobë ndaj titullarit të organit publik.

---

<sup>151</sup> Neni 118 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

<sup>152</sup> Neni 26 i ligjit

Masa e gjobës është e barabartë me 20% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo ditë vonese.

#### **4.15. Barra e provës**

##### **Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ.**

Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës, nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi.<sup>153</sup>

Në rastet e tjera, paditësi ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj.

Por edhe në këto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik, kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkresë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje, fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.<sup>154</sup>

---

<sup>153</sup>Neni 35/1 i ligjit

<sup>154</sup>Neni 35/3 i ligjit

#### 4.16. Diskutimi përfundimtar

Në përfundim të marrjes së provave të kërkuara nga palët apo të provave të marra kryesisht nga ana e gjykatës, pasi zhvillohet debati gjyqësor lidhur me pranueshmërinë, vlefshmërinë, përdorshmërinë dhe vlerën e tyre provuese, zhvillohet diskutimi përfundimtar i palëve në procesin gjyqësor.<sup>155</sup>

Fillimisht diskutimi apo konkluzionet përfundimtare parashtrihen nga pala paditëse, më pas nga pala e paditur si dhe palët private në procesin gjyqësor, nëse këto të fundit janë pjesë e procesit gjyqësor.

Diskutimi përfundimtar i palëve nga ana formale duhet të përmbajë;

- faktin,
- provat e shqyrtuara në seancë gjyqësore,
- vlerën provuese të secilës prej tyre, dhe
- vlerën provuese të tyre në tërësi.
- Njëkohësisht duhet që detyrimisht të përmbajë se cilat kanë qënë provat dhe pretendimet e kundërta të mbrojtësit të të paditurit,
- argumentimin se për çfarë arsye ato nuk qëndrojnë dhe nuk çënojnë vlerën provuese të provave të organit administrativ.

Pas deklarimit të provave gjyqësore, me vendim të ndërmjetëm, kalohet në fazën e dytë të seancës gjyqësore, *në fazën e hetimit*.

Me këtë vendim, gjykata duhet të përcaktojë provat që do të administrohen në gjykim, mënyrën e administrimit të tyre si dhe rradhën e administrimit të çdo prove.

---

<sup>155</sup>Neni 40 i ligjit

**Gjatë hetimit merret në administrim çdo prove veç e veç.**

Çdo provë e paraqitur nga gjykata duhet që me anë të pyetjeve, të vihen në dukje të gjitha aspektet e provës. Çdo provë në mënyrë individuale i nënshtrohet debatit gjyqësor, pra pyetjeve e kërkesave të paditësit dhe të paditurit.

**Pasi ka administruar të gjitha provat gjykata i jep fund hetimit gjyqësor duke marrë mendimin e palëve nëse dëshirojnë t'i japin fund hetimit gjyqësor.**

Paraqitja e provave bëhet gjatë seancës së parë gjyqësore. Në rast se organi publik nuk i paraqet në kohë të gjitha provat, ai ka të drejtë që nëpërmjet një shkrese të motivuar të kërkojë një afat të dytë që duhet të mbarojë jo më vonë se 5 ditë përpara seancës gjyqësore.

Në rast të mosparaqitjes së provave edhe në afatin e dytë të përcaktuar, shqyrtimi gjyqësor do të realizohet vetëm mbi aktet e paraqitura.<sup>156</sup>

Pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat që gjykata ka pranuar të merrren, pyeten palët nëse kanë kërkesa të tjera në dobi të gjykimit të çështjes.

Gjykata i jep fund hetimit gjyqësor me vendim të ndërmjetëm, fton palët të parashtrajnë pretendimet përfundimtare të tyre rreth çështjes në gjykim, të cilat si rregull i paraqiten gjykatës me shkrim.<sup>157</sup>

Me kërkesën e palëve, kur kjo shihet me vend, gjykata i jep atyre një afat deri në 5 ditë për të përgatitur parashtrimet e tyre.

---

<sup>156</sup>Neni 26/1

<sup>157</sup>Neni 39/2 i ligjit

#### **4.17. Marrja e vendimit përfundimtar**

Gjykata pasi dëgjon pretendimet e paditësit dhe të paditurit (organit administrativ), tërhiqet në dhomën e këshillimit për të dhënë vendimin përfundimtar.

Në dhomën e këshillimit kur bisedohet çështja e përpilohet vendimi qëndrojnë vetëm gjyqtarët që përbëjnë trupin gjykues.<sup>158</sup>

Nuk lejohet që gjatë bisedimit të hyjnë dhe të qëndrojnë aty sekretari i seancës gjyqësore, eksperti apo persona të tjerë. Në dhomën e gjykimit në rastin e çështjeve të gjykuar nga trup gjykues, të tre gjyqtarët kanë të drejta të barabarta.

#### **Ata duhet të marrin në analizë cdo provë në veçanti.**

Të dhënat që rrjedhin nga një provë duhen krahasuar me të tjerat. Kur gjatë analizës së provave gjyqtarët konstatojnë se në hetim ka të meta e se me provat e administruara prej tyre nuk mund të nxjerrin konkluzion përfundimtar, kanë të drejtë të dalin në seancë gjyqësore e me vendim të revokojnë vendimin e ndërmjetëm që ka mbyllur hetimin e po me vendim të ndërmjetëm e riçelin hetimin gjyqësor duke përcaktuar provat e reja që duhet të marrin në gjykim dhe për këtë caktojnë një seancë gjyqësore të re.

Pasi bisedojnë për të gjitha çështjet që janë në shqyrtim gjatë gjykimit, kalohet në votim për të dhënë vendimin që duhet bazuar në konkluzione bindëse të mbështetura në ligj, si fillim dy gjyqtarët e trupit gjykues dhe së fundmi kryetari i seancës.

---

<sup>158</sup>Neni 40 i ligjit



Asnjë nga gjyqtarët nuk mund të abstenojë nga vendimi. Vendimi i gjyqtarit i mbetur në pakicë i parashtruar me shkrim, i bashkohet në fund vendimit.

Nëse për çështjen propozohen disa zgjidhje e nuk krijohet shumica në votimin e parë, kryetari i hedh në votë dy zgjedhje për të përjashtuar njëren e me rradhë derisa zgjidhje të mbeten vetëm dy për të cilat bëhet votimi përfundimtar.

Vendimi duhet nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. Arsyetimi bëhet nga gjyqtari kryesues, në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë.<sup>159</sup>

**Vendimi mbështetet në të dhëna që ndodhen në aktet që janë shqyrtuar në seancë.**

Gjykata administrative çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes sipas bindjes së saj të formuar nga shqyrtimi i të gjithave rrethanave në tëresinë e tyre.

Gjykata Administrative, e cila ka për qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave, nëpërmjet procesit të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme rrit transparencën e vendimeve administrative.

Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore.<sup>160</sup>

---

<sup>159</sup>Neni 41/a i ligjit

<sup>160</sup>Neni 42/3 i ligjit

#### **4.18. Publikimi i vendimeve gjyqësore**

Publikimi i vendimeve gjyqësore është një parim tepër i rëndësishëm kushtetues por edhe ligjor, i detyrueshëm për t'u zbatuar nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

Ky parim kushtetues ka rëndësi jo vetëm sepse përmes tij arrihet pavarësia e gjyqësorit që konkludohet me arsyetimin e vendimit por edhe sepse përmes këtij publikimi bëhet i mundur që subjektet që ndodhen në procesin gjyqësor administrativ të bëjnë ankimin në gjykatën më të lartë brenda afateve ligjore.<sup>161</sup>

---

<sup>161</sup>Neni 43 i ligjit

#### **4.19. Ekzekutimi i vendimit**

Ekzekutimi është procesi që rregullon vënien në vend të së drejtës së shkelur, përmbushjen e një detyrimi, kryejn e një veprimi kundrejt titullarit të së drejtës (kreditorit) nga subjekti që ka detyrimin për të bërë një gjë të tillë (debitori).

Ekzekutimi përbën fazën e fundit të procesit gjyqësor, pra, realizon materialisht dhe faktikisht të drejtën legjitime të subjektit të së drejtës të njohur nga gjykata administrative. Në të vërtetë, procesi i ekzekutimit nuk ka të bëjë me vërtetimin e fakteve të kërkuara apo të së drejtës së detyrimit të shkelur.<sup>162</sup> Të gjitha këto përbëjnë një fazë tjetër të procesit gjyqësor.

Ekzekutimi fillon si proces në bazë të së drejtës së njohur, të vërtetuar nga gjykata administrative në llogari të mbrojtësit legjitim të saj. Kjo e drejtë është e sigurt dhe e saktë me anë të së cilës kërkohet që të realizohet vetëm materialisht dhe forcërisht kjo e drejtë e saktë.

**Ekzekutimi i detyrueshëm është një proces i përbërë nga një tërësi rregullash procedurale që strukturojnë veprimet e ndërmarra nga autoritetet e ligjituara nga ligji (Përmbaruesit gjyqësorë) për të vendosur një të drejtë në kuadër të një dokumenti të quajtur Titull Ekzekutiv.**

Si proces ka disa karakteristika specifike.

Palët në këtë proces nuk janë më me emërtimet e zakonshme si paditësi dhe i padituri.

Palët në këtë proces individualizohen me cilësimin si **Debitor** dhe **Kreditor**.

---

<sup>162</sup>Alqiviath Lamani "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë" fq ,232,Tirane

**Kreditori** është subjekti që kërkon vënien në jetë të Titullit Ekzekutiv, me anë të mjeteve ligjore të garantuara nga ligji për përmbushjen e detyrimit ndaj tij, pra kërkon një të drejtë legjitime. Ndërsa **debitori** është subjekti që ka detyrimin e vetëm "*të përmbushë detyrimin*", vullneti i të cilit nuk ka rëndësi për ligjin dhe organet që e zbatojnë atë.

Këtu shfaqet dhe një subjekt tjetër që është Përmbaruesi Gjyqësor<sup>163</sup> (privat apo shtetëror) i cili merr përsipër ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit duke bërë të mundur që të arrihet efektivisht qëllimi i ekzekutimit.

Mbi këtë subjekt rëndon një detyrë themelore që është ekzekutimi material i detyrimit, ku veprimet e tij procedural, si ato ku ai ka diskrecion, ashtu edhe ato veprime të cilat janë të përcaktuara rreptësisht nga ligji dhe të cilat ndikojnë në ecurinë e ekzekutimit.

Gjykata është subjekti tjetër që merr pjesë në procesin e ekzekutimit.

Detyra e saj në këtë fazë të dytë të procedimit është të kontrollojë ligjshmërinë e Titullit Ekzekutiv nëpërmjet lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit.

Ajo ka për detyrë të kontrollojë ligjshmërinë e veprimeve të përmbaruesit gjatë ekzekutimit, konstaton të drejtat e personave të tretë të cënuar nga ekzekutimi dhe nëpërmjet vendimit të saj vë në vend të drejten e kërkuar prej tyre.

---

<sup>163</sup>Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.6, datë .31.03.2006 u shpreh se "gjykimi për realizimin e një të drejte, në vetvete përbëhet nga dy faza të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. **Faza e parë** ose gjykimi në kuptimin e ngushtë ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e të drejtës, që përfundon kur vendimi merr formë të prerë. **Faza e dytë** ndërhyrja, qoftë marrja e masave shtrënguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi idrejtësisë", fq.63, "Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese", viti 2006.

Gjatë procesit të ekzekutimit gjykata ka detyrimin ligjor të shqyrtojë çdo ankesë të subjekteve pjesmarrëse në ekzekutim për parregullsi dhe për papajtueshmëri për vendimin e gjykatës (në këtë rast shqyton gjykata e apelit ankimin e vecantë).

Roli i gjykatës në fazën ekzekutive është i dukshëm dhe i domosdoshëm sepse respektimi i ligjit dhe i së drejtës duhet të garantohet në cdo fazë të procedimit administrativ dhe gjykata është garanci e shtetit ligjor.

Ekzekutimi si proces parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në të cilën thuhet se "*organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore*".

Vendimet gjyqësore janë një nga kategoritë e Titujve Ekzekutiv.

### **Të mos ekzekutosh një vendim gjyqësor është të shkelësh një parim kushtetues.**

Ky parim shihet sidomos nga subjekti që ka për detyrimin të<sup>164</sup> ekzekutojë vendimet gjyqësore i cili është Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor, për të cilin është një nga kërkesat kryesore të respektojë ligjin themelor të një shteti.

Vendimet gjyqësore jepen për të dhënë drejtësi. Për subjektin në favor të së cilës është dhënë vendimi i ekzekutimit ky parim kushtetues kthehet në një të drejtë themelore, në një të drejtë kushtetuese legjitime, cënimi i së cilës sjell një të drejtësi joefektive.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut e cila ndryshoi dhe atë të rendit tonë ligjor, parashikohet:

*"e drejta e njohur ligjërish do të ishte iluzionare , nëse një sistem i brendshëm do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej joveprues në dëm të një pale . Do të ishte e pakonceptueshme që ligji*

---

<sup>164</sup>Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 16.10.2007, fq.341 "Përmbledhje e vendime të Gjykatës Kushtetuese", viti 2007

*të përshkruajë garacitë procedurale të njohura në procesin gjyqësor —procedime të ndershme, publike dhe të shpejta — pa mbrojtur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga gjykata duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor sipas qëllimit të neni 6 të KEDNj. Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor".*

Në bazë të kësaj jurisprudence, ekzekutimi është pjesë e procesit të rregullt ligjor, pra faza e fundit e këtij procesi.

Më parë, ekzekutimi nuk cilësohej si pjesë e tij dhe mosekzekutimi i<sup>165</sup> një vendimi nuk çenonte procesin gjyqësor. Pra, ai konsiderohej si parregullsi dhe ishte më tepër si derivat i procesit por kurrsesi jo pjesë e tij. Në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj edhe jurisprudenca jonë e brendshme vendosi një praktikë të tillë gjyqësore ku u shpreh se:

*" Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vete nocionit të gjykimit të drejtë dhe se asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masa për zbatimin e tyre".*

Praktika e vendosur prej saj është në përputhje të plotë me frymën kushtetuese dhe me konventën ku një interpretim i tillë zgjerues bën të mundur që të arrihet qëllimi i

---

<sup>165</sup>Alban Abaz Brati, "Procedura Civile" fq. 32, Botimet Dudaj, 2008

garancive që gëzon një palë në një proces gjyqësor. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është reaksioni zinxhir që sjell një proces i rregullt ligjor.

Subjektet gjatë një procedimi duhet të gëzojnë të gjitha mjetet ligjore të ofruara nga Kushtetuta, Konventa por edhe nga ligji i brendshëm. Ky rend jurik i brendshëm duhet të garantojë të drejtat kushtetuese dhe të jetë efektiv për subjektet kur konstastohet, deklarohet një e drejtë apo urdhërohet të vihet në vend një e drejtë.<sup>166</sup>

Kjo hallkë është pikërisht ekzekutimi i vendimeve që nuk është gjë tjetër vecse një "e drejtë e vënë në vend" por njëkohësisht një parim. Kjo vë në dukje që vet procesi i rregullt ligjor përbën bazën e një drejtësie efektive të një shteti ligjor i bazuar në parime ligjore.

Nga sa u parashtrua më lart kuptohet se procesi i rregullt gjyqësor vihet në lëvizje nga të drejta kushtetuese, konkretisht neni 42/2 i Kushtetutës "*Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*".<sup>167</sup>

Gjykata shprehet në lidhje me ankimin e subjekteve që ngrenë pretendime duke u dhënë të drejtë ose jo. Shprehja e vullnetit të gjykatës është vendimi që në fund të fundit është shprehje e shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës.

Bazuar në parimet e të drejtat kushtetuese të lartpërmendura arrihet në përfundimin se procesi i rregullt ligjor përfundon, po me një parim kushtetues që përben thelbin e vet

---

<sup>166</sup>Në bazë të neni 116 /1 të kushtetutës është në hierarkinë e II pas saj. Konventa ka një vend disi të vecantë në rendin e brendshëm kur kufizohen të drejtat e liritë themelore. Në bazë të Kushtetutës Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut thirret drejtpërdrejt nga ajo dhe e bën pjesë të saj të brendshme e duket sikur Kushtetuta çiftëzohet në konventën e cila merr fuqi kushtetuese në Shqipëri përsa i përket kufizimit të të drejtave e lirive themelore

<sup>167</sup>Neni 42/2 i Kushtetutës

së drejtës<sup>168</sup> (rivendosje faktike të së drejtës), ekzekutimi i detyrueshëm ku Kushtetuta parashikon detyrimin e organeve shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

---

<sup>168</sup>Neni 15/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë



#### **4.20. Veprime të tjera të gjykatës gjatë ekzekutimit të vendimit**

Vendimi i gjykatës së apelit administrativ apo i gjykatës administrative të shkallës së parë, i paankimuar brenda afatit, vihet në ekzekutim me lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

Urdhri i ekzekutimit lëshohet nga gjykata, brenda pesë ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Në këtë urdhër, gjykata cakton afatin dhe mënyrën e ekzekutimit. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se dhjetë ditë nga data e lëshimit të urdhrit. Në raste të veçanta dhe të ndërlikuara, gjykata mund të caktojë një afat më të gjatë, duke motivuar shkaqet.

Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues që ka dhënë vendimin nxjerr urdhra për kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme. Ai përcakton në to, afatet e mënyrat e kryerjes së veprimeve si dhe masat e kërkuara.

Procedura e ekzekutimit, sipas këtij ligji, nuk i nënshtrohet asnjë tarife shërbimesh. Urdhri i ekzekutimit dhe urdhrat e posaçëm zbatohen nga përmbaruesi gjyqësor. Zyrat e përbarimit përcaktojnë listën emërore të përmbaruesve, në dispozicion të gjykatës, të cilën ia njoftojnë gjykatës kompetente.

Përmbaruesi gjyqësor, në përfundim të afatit të ekzekutimit të detyrueshëm të caktuar nga gjyqtari, njofton, me shkrim, gjyqtarin për veprimet e kryera nga organi publik debitor.

Në rast të moskryerjes së detyrimeve sipas vendimit apo urdhrave të gjykatës, pa shkaqe të përligjura, gjyqtari vendos gjobë ndaj titullarit të organit publik debitor.

Masa e gjobës është e barabartë me 20% të pagës minimale, në shkallë vendi për çdo ditë vonesë në ekzekutim. Gjyqtari mund të vendos edhe për kallëzim penal.

Veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, ankimohen.

Refuzimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit mund të ankimohet në gjykatën e apelit administrativ. Gjykata e apelit administrativ jep vendim brenda 5 ditëve nga data e ardhjes së ankimit dhe e akteve shoqëruese.

#### 4.21. Gjykimi në Gjykatën e Apelit

Instituti i ankimit përveç se është një institut procedural është në të njëjtën kohë edhe një e drejtë kushtetuese. Kushtetuta në nenin 43 të saj parashikon se kushdo ka te drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç se kur vetë në Kushtetutë është parashikuar ndryshe.<sup>169</sup> Ndërkohë që edhe në LGJA është parashikuar se mjetet e ankimit janë apeli dhe rekursi.

Në kontekstin historik instituti procedural i ankimit ka lindur në mesjetë, kohë kur gjyqtarët u bënë nëpunës të aparatit shtetëror. Ai bazohej në të drejtën e perandorit për të ndërhyrë në veprimet e nëpunësve të varur prej tij. Lutja që i bëhej perandorit për të ndërhyrë quhej “*apellatio*”, d.m.th apel, që kishte kuptimin e të drejtuarit dikujt më fjalë për të goditur vendimin e një gjyqtari më të ulët përpara gjykatës më të lartë.

Pas Revolucionit Francez u pranua parimi procedural i gjykimit në dy shkallë, i bazuar jo në varësinë e gjyqtarit më të ulët nga ai më i lartë, sepse gjyqtarët varen vetëm nga ligji, por në dhënien e vendimeve sa më të mira.

Gjykimi në dy shkallë do të përbënte një garanci për zhdukjen ose pakësimin e gabimeve në dhënin e drejtësisë, në mënyrë që në përfundim të të gjithë këtij procesi të arrihej që të merrej një vendim sa më i drejtë.

Sistemi i gjykimit në shkallë të dytë konsiderohet se është dy llojesh;

a) **Gjykimi i Apelit**, në të cilin gjykimi përsëritet si në gjykatën e shkallës së parë, duke marrë tërësisht apo pjesërisht provat e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë si dhe duke marrë edhe prova të reja, dhe,

---

<sup>169</sup> Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

b) **Gjykimi i Revizionit**, në të cilin gjykata e shkallës së dytë kufizohet në kontrollin e veprimeve gjyqësore të gjykimit në shkallë të parë, pa përsëritur gjykimin e mëparshëm dhe pa marrë prova të reja.

KPrA ka pranuar llojin e parë të gjykimit në shkallë të dytë, pra, në gjykimin e apelit mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

Por, njëkohësisht është pranuar edhe rekursi apo kërkesa për rishikim të vendimit, të cilat janë mjete ankimi që shqyrtohen me procedura të vecanta.

Gjykimi në gjykatën e apelit, si rregull është një gjykim “*shkresor*”, ku gjykata “*lexon*” aktet e dosjes gjyqësore të gjykatës që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë, brenda kufijve dhe brenda shkaqeve që kanë parashtruar palët në ankimet e tyre dhe zakonisht në të shumtën e rasteve gjatë gjykimit në gjykatën e apelit nuk merren prova.

Në këtë mënyrë, shmanget gjatë gjykimit në apel, parimi i oralitetit, parim i cili zëvendësohet me leximin e proces verbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara në gjykimin e shkallës së parë. Kështu që, humbet në këtë gjykim, në një masë jo të vogël, niveli psikologjik i testimin të palëve, sidomos në një proces që duhet të ishte i

vendosur në qendër të debatit dhe kontradiktoritetit<sup>170</sup> midis palëve përpara trupit gjykues.

Për më tepër, procesi gjyqësor në gjykatën e apelit, për kufizimin që i bëhet kontradiktoritetit dhe për kthimin e tij vetëm në leximin e akteve, përfaqëson mangësi në krahasim me gjykimin në shkallë të parë, në të cilin gjyqtari ka një kontakt të drejtëpërdrejtë me marrjen e provave dhe burimin e tyre.

Pavarësisht këtyre cilësive, është e rëndësishme që të vëmë në dukje dhe garancinë që përfaqëson gjykimi në apel për palët. Kjo sepse, vendimi në përfundim të gjykimit do të merret nga gjyqtarë të ndryshëm nga ata që kanë gjykuar çështjen administrative në shkallë të parë, që janë gjithmonë trupë gjyqësore dhe që njëkohësisht kanë pushtetin që të procedojnë edhe kryesisht lidhur me veprime të caktuara procedurale.

Në fakt, në krahasim me gjykimin në shkallë të parë, në gjykimin në apel gjykata mundet të ndreqë gabimet e mundshme të bëra nga gjykata e shkallës së parë lidhur me kompetencën dhe juridiksionin, lidhur me papërdorshmërinë e provave, pavlefshmërinë absolute apo atë relative të akteve dhe veprimeve procedurale.

Çdo gjykatë më e lartë kishte të drejtë të rishikonte çështjen duke dhënë një vendim të ri. Në këtë mënyrë lutja që i bëhej perandorit ose mbretit për të ndërhyrë në vendimin e gjyqtarit shërbente për shqyrtimin e çështjes nga një autoritet më i lartë dhe u bë mjet i rëndësishëm për formimin e së drejtës.

Në gjykatat e apelit, gjyqtarët e specializuar për çështjet administrative duhet të marrin pjesë në trup gjykues<sup>171</sup>. Praktikisht, të gjithë gjyqtarët e gjykatave të apelit që

---

<sup>170</sup>Sabino Cassese, "Corso di Diritto Amministrativo", "Istituzioni di Diritto Amministrativo", quarta edizione, Giuffrè Editore, Varese, Milano, 2012, fq. 20.

kanë ndjekur trajnime shtesë për çështjet administrative, konsiderohen të specializuar në këtë fushë dhe marrin pjesë në gjykimin e çështjeve administrative.<sup>172</sup>

Çështjet gjykohen nga trupa gjykuese të përbëra nga tre gjyqtarë.

---

<sup>171</sup> Neni 333 i KPC

<sup>172</sup> Informacioni i marrë gojarisht nga kryetarët / kancelarët e gjykatave të apelit.

#### **4.22. Palët që mund të bëjnë ankim, forma dhe afati**

E drejta për të bërë ankim në gjykatën e apelit iu përket palëve që kanë marrë pjesë në gjykimin e shkallës së parë dhe që janë palët e procesit administrativ.

Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet, që i bashkëlidhen atij, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në LGJA.<sup>173</sup> Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.<sup>174</sup>

Ankimi administrativ përbën një mjet juridik, që subjektet mund ta përdorin në rastet e mospranimit të vendimit të shkallës së parë për shkaqe të përligjura.

Që kjo të funksionojë, pra, që subjektet të kenë mundësi të realizojnë një të drejtë, duhet që kjo e drejtë t'u njihet ose më saktësisht, të parashikohet shprehimisht nga ligji.

Realizimi i së drejtës së ankimit është një e drejtë kushtetuese e subjekteve të së drejtës që i detyron këto organe të administratës shtetërore të shqyrtojnë ankimin. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme dhe të patjetërsueshme dhe qëndrojnë në themel të gjithë rendit juridik.

---

<sup>173</sup>Neni 44 i ligjit

<sup>174</sup>Neni 48/2 i ligjit

## Forma e ankimit

Ligji ka sanksionuar anën formale të ankimeve administrative, sipas të cilit ankimi duhet që të jetë në formë të shkruar, duhet që të tregohet vendimi i ankimuar, numri dhe data e tij, gjykatën që e ka dhënë, pikat e vendimit që kundërshtohen, shkaqet e ankimit, bashkë me ankimin përveç formës duhet të bashkëlidhen të gjitha aktet dhe dokumentat në aq kopje sa janë palët në proces gjyqësor, aktin e përfaqësimit si dhe çfarë kërkohet me ankimin nga gjykata më e lartë.

Mosrespektimi i anës formale të ankimit përbën shkak që gjykata që shqyrton ankimin të vendosë mospranimin e ankimit, pra vendos mospranimin pa e shqyrtuar çështjen në themel, por vetëm sa konstaton mangësitë në ankimin e paraqitur<sup>175</sup>.

Mospranimi i ankimit, pa e shqyrtuar fare çështjen në themel vendoset edhe atëherë kur ankimi është paraqitur nga personi që nuk është i legjitimuar ose dhe kur vendimi është i paankimueshëm për paditë me objekt:

- kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore,

---

<sup>175</sup>Neni 46 i ligjit



ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale<sup>176</sup>.

Kur ankuesi nuk plotëson ose nuk ndreq të metat brenda afatit, ankimi quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet ankuesit me vendim, së bashku me aktet e tjera të paraqitura prej tij. Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm për kthimin e ankimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit, kur nuk janë respektuar dispozitat lidhur me paraqitjen, dërgimin dhe njoftimin e ankimit si dhe kur është hequr dorë nga ankimi<sup>177</sup>.

Afati i paraqitjes së ankimit është dhjetë ditë, afat i cili fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit ose e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Ankimi paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin dhe kopja e ankimit të bërë nga njëra palë në procesin gjyqësor i njoftohet edhe palës tjetër, njoftim i cili kryhet nga sekretaria e gjykatës e cila ka dhënë vendimin dhe ku është paraqitur edhe ankimi.

---

<sup>176</sup>Neni 45 i ligjit

<sup>177</sup>Po aty

#### **4.23. Shkaqet e apelit**

Ligji nuk ka vendosur ndonjë kufizim lidhur me faktin se për çfarë shkaqesh mundet të bëhet apel në gjykatën e apelit duke lënë kështu të hapur mundësinë që palët pjesëmarrëse në gjykimin e shkallës së parë të mund të bëjnë apel për çdo arsye që ata besojnë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka qënë i pabazuar në prova dhe në ligj, plotësisht apo pjesërisht.

Kjo lidhet edhe me faktin se gjykatat e apelit janë gjykata që shqyrtojnë si kundërshtimet lidhur me ligjin ashtu edhe kundërshtimet lidhur me provat, me marrjen, çmuarjen, vlerësimin e tyre si dhe përcaktimin e vlerës së tyre provuese.

Palët mundet të bëjnë apel kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë në çdo rast kur ai mendon se gjykata ka gabuar lidhur me marrjen e vendimit përfundimtar ose lidhur me ndonjë vendim të ndërmjetëm i cili në këtë rast kundërshtohet bashkë me vendimin përfundimtar.

#### **4.24. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit**

Për shkak të natyrës së gjykimit në gjykatën e apelit, e cila është një gjykatë që e shqyrton çështjen si nga pikëpamja e ligjit ashtu edhe e faktit dhe që ka për synim ndreqjen e të gjitha mangësive të mundshme që mundet të jenë shkaktuar apo lejuar në gjykimin në shkallë të parë, gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm në shkaqet e ngritura dhe të paraqitura në apel.

Sigurisht, gjykata e apelit është e detyruar të shqyrtojë dhe të vlerësojë të gjitha shkaqet e kundërshtimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të arsyetojë bazueshmërinë e tyre, por gjykata e apelit mundet të shqyrtojë edhe rrethana të tjera lidhur me çështjen në gjykim, rrethana të cilat mundet të mos jenë ngritur si shkaqe apeli por që mundet të ndikojnë në marrjen e vendimit përfundimtar në gjykatën e apelit lidhur me vetë apelin e paraqitur nga palët.

**Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarisë së organeve qeverisëse e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit.**

Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë.

Qëllimi i kufijve të shqyrtimit gjyqësor synon të përfshijë brenda juridiksionit të gjykatave administrative të gjitha ankimet që lidhen me çështje administrative dhe po ashtu të sigurojë një mbrojtje të gjerë ligjore ndaj të gjitha veprimeve administrative, pavarësisht formës së tyre si akte individuale, normative ose kontrata administrative<sup>178</sup>.

---

<sup>178</sup> neni 45 i ligjit

Kontrolli, si i “akteve të qeverisë” ashtu edhe i akteve të bazuara në diskrecion nga gjykata e apelit, si shkallë e parë si dhe shmangia e konflikteve të kompetencës me gjykatat e zakonshme duke i transferuar paditë që paraqiten gabim në gjykatën kompetente të cilës i përket çështja, janë një faktor shumë i rëndësishëm efektiviteti.

Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor të veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve por edhe të mbrojë interesin publik dhe rendin ligjor.

Sshqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjeve administrative përbën hallkën e fundit të procesit administrativ, që fillon me aktin e nxjerrë nga organi administrativ e që vazhdon me shqyrtimin administrativ të ankimeve brenda strukturës së administratës shtetërore, qendrore a vendore. Ndaj, me cilësitë e saj, gjykata administrative, përbën jo vetëm një zhvillim pozitiv gjyqësor por edhe një faktor presioni për përmirësimin e procesit dhe aktit administrativ brenda sistemit të administratës shtetërore.

#### **4.25. Veprimet procedurale gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit**

Parimet dhe mënyra e zhvillimit të gjykimit në gjykatën e apelit janë përgjithësisht po ato të gjykimit në shkallë të parë, me përjashtim të disa ndryshimeve të parashikuara posaçërisht për procedurën e gjykimit në apel.<sup>179</sup>

Ndryshimet konsistojnë në kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit si dhe në mënyrën e zgjidhjes së çështjes me vendimin përfundimtar në varësi të rrethanës së cila nga palët ka paraqitur ankimin.

Edhe në gjykatën e apelit gjykimi bëhet me trup gjykues dhe zbatohen të njëjtat rregulla për përjashtimin e gjyqtarëve. Kolegji i gjykatës së apelit zbaton të njëjtat rregulla për njoftimin e palëve të pranishëm në gjykim apo në mungesë, ashtu sikur dhe veprohet gjatë gjykimit në shkallë të parë<sup>180</sup>.

Edhe në gjykatën e apelit kryhen të gjitha veprimet procedurale për njoftimin e palëve në mungesë në gjykim si dhe lidhur me vendimet e ndërmjetme për deklarimin e mungesës së palëve apo për zëvendësimin e mbrojtësit kur janë shkaqet që justifikojnë një veprim të tillë si dhe në gjykimin në shkallë të parë.

Pasi kryhen veprimet paraprake të gjykimit dhe sigurohet prania e palëve në seancë gjyqësore gjykimi vijon më tej me relatimin e çështjes nga ana e trupit gjykues që gjykon çështjen në shkallë të dytë.

Një nga anëtarët e trupit gjykues, që quhet ndryshe Relatori i Çështjes, relaton në seancë gjyqësore duke lexuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe duke

---

<sup>179</sup> neni 44 i LGJA

<sup>180</sup> për përjashtimin e gjyqtarëve si dhe për njoftimin e palëve zbatohen të njëjtat rregulla si në gjykimin në shkallë të parë të parashikuar nga neni 52 i LGJA si dhe nga dispozitat e KPrC.

përshkruar palën që ka bërë ankim, sipas rastit, apo palën tjetër që nuk ka bërë apel por mund të ketë paraqitur apel kundërshtues.<sup>181</sup>

Më pas, procedura e gjyqimit vijon me parashtrimin e palës që ka bërë apel, e cila paraqet para trupit gjykues shkaqet dhe arsyet e kundërshtimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë si dhe çfarë kërkon nga gjykata e apelit.

Pala që nuk ka paraqitur apel ose që ka paraqitur apel kundërshtues, parashtron gjithashtu arsyetimet e veta dhe qëndrimin ndaj vendimit gjyqësor të apeluar.

Mund të ndodhë që të dy palët të bëjnë apel dhe të dyja palët mundet të kundërshtojnë vendimin gjyqësor për arsye të ndryshme.<sup>182</sup>

---

<sup>181</sup> Neni 49 i ligjit

<sup>182</sup> Neni 47 i ligjit

#### 4.26. Marrja e vendimit

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, shqyrtim i cili bëhet në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim, kryhet diskutimi përfundimtar i palëve dhe gjykata tërhiqet për të marrë vendimin përfundimtar.<sup>183</sup>

Dhënia e vendimit nga Gjykata e Apelit bazohet në provat e marra nga gjykata e shkallës së parë dhe të verifikuara gjatë gjykimit në apel si dhe bazuar në provat e reja të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor duke iu përmbajtur kufijve ligjorë të përcaktuar në ligj, të cilat lidhen me subjektin që ka bërë ankimin.

Duke iu referuar LGJA, Gjykata e Apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos në njëërën nga mënyrat e mëposhtme;

- mospranimin e ankimit në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë;
- lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;
- ndryshimin e vendimit;
- prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit;
- prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes në rastet kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte.

-

---

<sup>183</sup> neni 50 i ligjit

Rasti i dytë, rasti i katërt dhe i pestë i vendimmarrjes së gjykatës së apelit janë të qarta dhe nuk po vazhdojmë më tej me trajtimin e tyre.<sup>184</sup>

Për sa i përket rastit kur gjykata e apelit vendos ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë<sup>185</sup>, kjo mund të kryhet nga gjykata e apelit në rastet kur ajo konstaton në përfundim të shqyrtimit gjyqësor se vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe në prova. Kjo vendimmarrje e gjykatës së apelit lidhet më tepër me anën thelbësore të gjykimit, të interpretimit të ndryshëm që mund t'i bëjë gjykata e apelit rrethanave të çështjes si dhe me mënyrën e ndryshme të çmuarjes së vërtetësisë dhe vlerës provuese të provave të paraqitura në gjykimin e shkallës së parë si dhe atyre që mundet të merren me anë të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor në gjykimin në apel.

Në këto raste prezumohet se dispozitat procedurale gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë janë zbatuar drejt, vetëm se gjykata e apelit krijon një bindje të ndryshme nga ajo e shkallës së parë lidhur me faktin dhe provat e shqyrtuara.

E ndryshme është situata kur gjykata e apelit vendos prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë administrative, për rastet e parashikuara nga neni 50/ç i LGJA<sup>186</sup>. Kthimi i akteve për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë administrative kryhet nga gjykata e apelit për raste taksativisht të parashikuara nga dispozita e mësipërme.

---

<sup>184</sup> neni 50 pika c,d e ligjit.

<sup>185</sup> Neni 50 pika c

<sup>186</sup> neni 54\c i ligjit



Të gjitha rastet e parashikuara në këtë dispozitë bëjnë fjalë për shkelje procedurale të kryera gjatë gjykimit në shkallë të parë të cilat passjellin cënimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë vijë arsytimi gjykata e apelit nuk mund të vendosë prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim për kryerjen e veprimeve konkrete procedurale që mund të kenë të bëjnë me marrjen apo vërtetësinë e provave apo për të plotësuar hetimin gjyqësor, gjithmonë nëse këto nuk krijojnë ndonjë shkak nga ato të parashikuara nga neni 54 i LGJA<sup>187</sup>.

Nëse gjykata e apelit nuk konstaton ndonjë nga shkeljet procedurale të parashikuara nga neni 54 i ligjit, atëherë ajo duhet ta zgjidhë vetë çështjen duke përsëritur tërësisht apo pjesërisht shqyrtimin gjyqësor dhe pa e kthyer çështjen për rigjykim.

Jo pa qëllim, në asnjë dispozitë që bën fjalë për procedurën e gjykimit në Gjykatën e Apelit, nuk është parashikuar që gjykata e apelit të detyrohet për t'u kryer në gjykatën administrative të shkallës së parë në rigjykimin e çështjes.

Kjo për arsyen se gjykata e apelit si gjykatë ligji dhe fakti dhe jo si një gjykatë revizioni, sikurse ka qënë para hyrjes në fuqi të LGJA, i ka të gjitha mundësitë procedurale që të korrigjojë dhe të ndreqë gabimet e mundshme të kryera gjatë gjykimit në shkallën e parë, i ka mundësitë që të plotësojë hetimin gjyqësor dhe marrjen e provave dhe në bazë të tyre të marrë një vendim të drejtë lidhur me zgjidhjen e çështjes.

---

<sup>187</sup> neni 54 i ligjit

Në rast të pranisë së shkaqeve të parashikuara nga neni 54 i LGJA, që sjellin si pasojë pavlefshmërinë e vendimit të apeluar duke qënë se këto pavlefshmëri nuk mund të ndreqen në gjykimin në apel, gjykata e apelit nuk mund të vazhdojë gjykimin duke përsëritur tërësisht apo pjesërisht shqyrtimin gjyqësor apo siç quhet ndryshe duke e gjykuar çështjen në fakt<sup>188</sup>.

Për sa kohë gjykata e apelit do të vendoste me vendim të ndërmjetëm që të përsëriste shqyrtimin gjyqësor, atëherë kjo presupozon faktin se gjykata e apelit paraprakisht ka vlerësuar se nuk ekziston ndonjë nga shkaqet e kthimit të çështjes për rigjykim sipas nenit 54 të ligjit. Pra, me fjalë të tjera, nuk është konstatuar në një rast të tillë ndonjë mangësi e gjykimit në shkallë të parë që nuk mundet që të korrigjohet në gjykimin në apel. Ama, nëse gjykata e apelit ka pranuar një situatë të tillë, atëherë kjo gjykatë në përfundim të përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor duhet ta zgjidhë çështjen në themel dhe jo të vendosë rigjykimin e çështjes edhe pasi ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor<sup>189</sup>.

Në rastet kur gjykata e apelit vendos kthimin e akteve në gjykatën e shkallës së parë, në të njëjtin vendim, gjykata e apelit urdhëron që rigjykimi i çështjes të bëhet nga një kolegji tjetër i së njëjtës gjykatë.

Nëse gjykata e apelit vendos lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë apo ndryshimin e tij, atëherë pavarësisht faktit nëse paraqitet rekurs nga palët në Gjykatën e Lartë vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

---

<sup>188</sup> neni 54 e ligjit

<sup>189</sup> po aty

LGJA parashikon që ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundim të gjykimit në gjykatën e apelit. Ndërsa kur vendimet e gjykatës së shkallës së parë kanë të bëjnë me liritë personale, sic janë vendimet për caktimin, zëvendësimin, shuarjen apo revokimin e masave të sigurimit, janë menjëherë të ekzekutueshme që në momentin që ato jepen në gjykatën e shkallës së parë.

Trupi gjykues pasi njihet edhe me aktet në dosjen gjyqësore mundet që t'ju bëjë pyetje palëve në gjykim lidhur me pretendimet e tyre dhe të kërkojë sqarime plotësuese lidhur me rrethanat e pretendimeve të tyre.

Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

- për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të LGJA;
- vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;
- me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë.<sup>190</sup>

Nëse gjykata e apelit çmon se nuk duhet të përsëritet shqyrtimi gjyqësor, atëherë ftohen palët që të paraqesin diskutimet e tyre përfundimtare dhe më pas trupi gjykues tërhiqet për të marrë vendimin përfundimtar.

---

<sup>190</sup> neni 47 i ligjit

#### **4.27. Gjykimi në kolegjin administrativ të Gjykatës së Lartë**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, kanë parashikuar që Gjykata e Lartë është autoriteti më i lartë gjyqësor në vend. Gjykata e Lartë kontrollon vetëm atë pjesë të gjykimit dhe vendimit gjyqësor të gjykatës më të ulët, që ka të bëjë me zbatimin e ligjit material apo procedural, siç mundet të jetë, struktura e faktit, cilësimi ligjor i saj dhe/ose interesi i ligjshëm që është cënuar.

Gjykata e Lartë, si organi më i lartë gjyqësor në Shqipëri, ushtron disa funksione. Me anë të vendimeve gjyqësore të saj, Gjykata e Lartë;

- siguron ruajtjen e interpretimit të njëjtë të ligjit material dhe procedural administrativ,
- siguron unitetin e së drejtës objektive shtetërore,
- siguron respektimin e kufijve të juridiksioneve të ndryshme dhe rregullon mosmarrëveshjet për kompetencën që mund të kenë gjykatat më të ulëta, si dhe,
- përmbush edhe detyra të tjera të parashikuara në norma ligjore të veçanta.<sup>191</sup>

#### **Gjykata e Lartë gjykon në trupa gjyqësore të përbërë nga pesë gjyqtarë.**

Kur lind nevoja për njehsimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë mund të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet administrative çështje të ardhura për gjykim në Kolegjin administrativ të kësaj gjykate.

Tërheqja e çështjeve administrative në Kolegjet administrative mundet që të bëhet me vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë ose me vendimit të Kolegjit Administrativ.

---

<sup>191</sup> Ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykatat më të ulëta në çështje të tjera të ngjashme.

Në lidhje me Gjykatën e Lartë nuk ka dispozita që të kërkojnë specializim. Praktikisht, çështjet administrative shqyrtohen nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit administrativ. Çështjet gjykohen me trup gjykues me pesë gjyqtarë. Nuk ka të dhëna mbi numrin e çështjeve administrative në Gjykatën e Lartë.<sup>192</sup>

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë bëjnë një rregullim vetëm brenda kufijve të çështjes konkrete që gjykohet, brenda hapësirës së përmbajtjes së normave juridike dhe nuk mundet që të krijojnë një normë të re, gjë të cilën mundet ta bëjë vetëm pushteti ligjvënës.

---

<sup>192</sup> Informacion i marrë gojarisht nga Kancelari i Gjykatës së Lartë.

#### **4.28. Shkaqet e rekursit administrativ në Gjykatën e Lartë, forma, afati**

Rekursi është mjete i ankimit, nëpërmjet të cilit palët në procesin gjyqësor administrativ, pra, palët që marrin pjesë në gjykimin administrativ, i drejtohen Gjykatës së Lartë dhe ku pretendojnë se vendimet e gjykatave më të ulëta janë vendime që vijnë në kundërshtim me ligjin material apo procedural administrativ ose janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit administrativ. Rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mundet të bëhet për çdo lloj shkak apo arsye për të cilat palët mund të kundërshtojnë vendimet e gjykatave më të ulëta.

Shkaqet për të cilat mundet të bëhen rekurs duhet domosdoshmërisht që të jenë shkaqe ligjore dhe jo kundërshtime që lidhen me faktin apo me të provuarin gjatë një gjykimi të caktuar. Kemi të bëjmë me dy lloje të rekurseve;

- rekursi i drejtëpërdrejtë, pra kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë,
- rekursi kundër vendimeve të formës së prerë, pra kundër vendimeve të gjykatës së apelit.

Rekurs i drejtëpërdrejtë ka kuptimin që vendimet e gjykatës së shkallës së parë ankohen nga palët në procesin gjyqësor drejtëpërdrejtë në Gjykatën e Lartë pa qënë nevoja që të gjykohen në gjykatën e apelit.

**Objekt rekursi të drejtëpërdrejtë** mundet të jenë vendimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mosmarrëveshjet me juridiksionin, kompetencat lëndore apo tokësore si dhe në raste të tjera të veçanta, kur vetë ligji procedural ka parashikuar një mundësi të tillë. Një nga këto raste është parashikuar në LGJA, sipas të cilit “*Gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, ngre çështjen e mosmarrëveshjes me vendim të*

*arsyetuar, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj. Gjykata, që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje.*

*Vendimi për ngritjen e mosmarrëveshjes, së bashku me aktet, i dërgohet Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve”<sup>193</sup>, ose vendimet në lidhje me juridiksionin “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent ”<sup>194</sup>.*

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kolegji vendos në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve nëse çështja përfshihet ose jo në juridiksionin gjyqësor. Nëse ndodhemi në rastin e mosmarrëveshjes lidhur me kompetencën atëherë ligji e ka bërë përkufizimin se kur kemi të bëjmë me mosmarrëveshje ndërkohë që në rastin e juridiksionit nuk është bërë një përkufizim i tillë.

Duke qënë se ekzistojnë tre lloj juridiksionesh, penal, civil dhe administrativ si dhe duke iu referuar edhe llogjikës juridike, atëherë do të ndodheshim para një mosmarrëveshjeje lidhur me juridiksionin pikërisht në rastin kur gjykatat që do përfaqësojnë secilin prej juridiksioneve dhe ku në të njëjtën kohë do të merrnin ose nuk do të pranonin të merrnin në shqyrtim të njëjtën çështje.

Nëse flasim për rekurset e drejtëpërdrejta lidhur me kompetencën dhe juridiksionin duhet që t’ju referohemi rasteve të mosmarrëveshjeve midis gjykatave lidhur me

---

<sup>193</sup> Neni 13\5 i ligjit

<sup>194</sup> Neni 9 i ligjit

kompetencën dhe juridiksionin. Nga ana tjetër, nuk mundet të bëhet rekurs i drejtëpëdrejtë për çdo vendim të gjykatës së shkallës së parë apo të gjykatës së apelit që vendos të deklarojë moskompetencën tokësore apo lëndore ose mungesën e juridiksionit.

Siç edhe e përmëndëm më sipër, rekursi për në Gjykatën e Lartë bëhet vetëm për shkaqe të caktuara, të parashikuara shprehimisht në nenin 58 të LGJA dhe nuk mundet të jetë për cdo lloj shkak<sup>195</sup>.

Në bazë të nenit 58 të LGJA, rekursi mundet që të bëhet për këto shkaqe:

- a. ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kur përmendet ligji kemi parasysh Kodin e Procedurës Administrative, dispozita administrative të parashikuara në ligje të tjera apo norma juridike që janë të lidhura dhe që duhet të mbahen parasysh për zbatimin e ligjit administrativ. Shkaku i rekursit për mosrespektim ose zbatim të gabuar të LGJA bën fjalë për ato raste kur palët pretendojnë interpretim të gabuar të dispozitave administrative të bëra nga gjykatat më të ulëta.
- b. ka shkelje të rënda të normave procedurale me pasoje pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit. Në LGJA janë të parashikuara shprehimisht rastet e pavlefshmërisë absolute e cila nuk mundet që të recuperohet gjatë shkallëve të tjera të gjykimit. Kjo sidomos kur nuk janë respektuar dispozitat lidhur me; kushtet për të qënë gjyqtar në çështjen

---

<sup>195</sup> Neni 58 i ligjit



konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në ligj.

- c. ka shkelje të rënda procedurale të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Lidhur me ekzistencën e këtij shkak, dispozita sic shihet ka parashikuar që duhet të ekzistojnë shkeljet procedurale por që edhe të kenë ndikuar në dhënin e vendimit (në kuptimin që nëse shkeljet nuk do të ishin kryer gjatë gjykimit, vendimi përfundimtar i gjykatës më të ulët do mund të ishte i ndryshëm nga ai për të cilin bëhet rekurs). Shkelje të tilla procedurale mundet të jenë nga më të ndryshmet. Si shkelje procedurale në këtë rast mund të jetë edhe mungesa e arsytimit të vendimit gjyqësor. Kur flasim për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor do kuptojmë jo vetëm rastin kur mungon edhe formalisht arsytimi por edhe në rastet kur një vendim mund të jetë formalisht i arsytuar madje me shumë faqe, por është jo llogjik dhe manifeston kontradita llogjike lidhur me mënyrën se si gjykata ka arritur në përfundime të caktuara.

Po kështu, mundet të pretendohet edhe fakti se në arsytimin e vendimit mungon kontradiktoriteti procedural në kuptimin që gjykata nuk ka mundur të bëjë një arsytim të plotë të provave të paraqitura në gjykim, t'i ballafaqonte ato me njëra tjetrën dhe të arrinte të shpjegonte arsyet që gjykata nuk i ka marrë parasysh provat e kundërta. Në të tilla raste duhet të bëhet dallimi midis dy momenteve, elementëve të të provuarit dhe rezultatit të provave.

Për shkak të natyrës së gjykimit në Gjykatën e Lartë, e cila është një gjykatë ligji dhe jo fakti, nuk konsiderohet si një shkallë e tretë e gjykimit, por ajo kontrollon ligjshmërinë e gjykimeve të zhvilluara në dy shkallët e mëparshme.

Kështu që, nëse Gjykata e Lartë konstaton shkelje procedurale në mënyrën e marrjes së provave, të besueshmërisë dhe mënyrës së drejtë të vlerësimit të tyre, mungesën e një arsytimi llogjik të vendimit gjyqësor dhe mungesën e kontradiktoritetit procedural të provave në analizën që iu kanë bërë atyre gjykatat me të ulëta administrative, ajo vendos prishjen e vendimit për të cilën është bërë rekurs për ndonjëherë prej këtyre arsyeve dhe më pas dërgon çështjen në gjykatën e faktit në mënyrë që kjo e fundit të bëjë një vlerësim të ri të rezultatit të të provuarit, gjë që nuk mundet ta bëjë vetë Gjykata e Lartë.

Afati për të paraqitur rekursin është 30 dita nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Nëse në rastin e apelit afati 10 ditor fillonte nga dita e nesërme e shpalljes apo njoftimit të vendimit në rastet e gjykimit në mungesë, në rastin e rekursit dispozita e mësipërme ka bërë një rregullim tjetër, duke saktësuar që afati fillon nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, që në fakt është dita kur shpallet vendimi në gjykatën e apelit. Pra, në rastin e rekursit, fillimi i afatit të ankimit nuk lidhet me momentin e njoftimit të vendimit apo marrjes dijeni për vendimin e gjykatës së apelit por vetëm me shpalljen e tij në seancë gjyqësore.

Në rast se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që u parashtruan më sipër apo edhe pretendohen shkaqe të tjera të cilat nuk janë parashikuar si shkaqe për të cilat mundet të ankimohen vendimet e gjykatës së apelit, si:

- a. kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;

- b. kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- c. kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- d. mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.<sup>196</sup>

atëherë, Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit, pa e gjykuar çështjen në themel.

Mospranimi i rekursit është një vendim që merret nga Kolegji Administrativ në dhomën e këshillimit dhe pa pjesëmarrjen e palëve në gjykim. Në këtë vendim analizohet nëse rekursi është bërë për shkaqe të parashikuara nga neni 56 i ligjit, ose jo. Nga ana tjetër, Kolegji administrativ nuk mundet të shprehet lidhur me themelin e çështjes dhe të bazueshmërisë së vendimit për të cilin është bërë rekurs, pasi ky është një përfundim që arrihet vetën në rastin kur është bërë gjykimi në Gjykatën e Lartë në prani të palëve në procesin gjyqësor.<sup>197</sup>

Akti i rekursit, detyrimisht duhet të jetë në formë të shkruar dhe duhet të tregojë saktë shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi gjyqësor në Gjykatën e Lartë.

---

<sup>196</sup> neni 58 i ligjit

<sup>197</sup> neni 56 i ligjit

Në nenin 57/b të LGJA është parashikuar që akti i rekursit duhet të përfshijë aktin e përfaqësimit nëse ky akt është pjesë e dosjes së gjykimit<sup>198</sup>.

Gjykata e Lartë, i krijon mundësinë palëve të ndreqin në kohë dhe brenda afatit 7 ditor nga dita kur vendimi gjyqësor i ankimuar ka marrë formë të prerë, mangësitë e aktit të rekursit duke shmangur kështu një vendim mospranimi të rekursit në dhomën e këshillimit nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Për paraqitjen e rekursit, njoftimin e tij palës tjetër, paraqitjen e tij në gjykatën që ka dhënë vendimin, të personave që iu përket e drejta e ankimit si dhe të anës së tij formale, janë të zbatueshme dispozitat e parashikuara në nenin 61 të LGJA, rregulla të përgjithshme mbi ankimet, për të cilat kemi folur, në gjykimin në apel.<sup>199</sup>

Të njëtat rregulla të përgjithshme janë të zbatueshme edhe për rekursin në Gjykatën e Lartë, për sa kohë që nuk është parashikuar ndryshe në dispozitat e nenit 56 të LGJA që bëjnë fjalë për gjykimin në Gjykatën e Lartë.

Ankimohen me recurs, pranë Kolegjit Administrativ në Gjykatën e Lartë vendimet e shpallura nga Gjykata e Apelit Administrativ.

Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon rekursin në Kolegjin Administrativ pranë Gjykatës së Lartë së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij.<sup>200</sup>

---

<sup>198</sup> neni 57\b i ligjit

<sup>199</sup> neni 61 i ligjit dhe Seksioni II i këtij punimi

<sup>200</sup> neni 56 i ligjit

#### **4.29. Shqyrtimi në Gjykatën e Lartë**

Në rast se Kolegji Administrativ nuk vendos mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, atëherë çështja kalon për gjykim në seancë gjyqësore.

Për sa iu përket rregullave lidhur me publicitetin e seancës, mbajtjen e rregullit në seancë si dhe me drejtimin e diskutimit, të cilat janë të zbatueshme gjatë gjykimeve në gjykatën e shkallës së parë dhe të apelit, janë gjithashtu të zbatueshme edhe në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, për aq sa ato mundet të jenë të zbatueshme.

Në gjykimin në Gjykatën e Lartë veprimet paraprake për përgatitjen e gjykimit i drejton Kryetari i Kolegjit Administrativ. Ky i fundit cakton datën për shqyrtimin e rekursit si dhe kryen studimin e akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore. Në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit e shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs.

Në këtë mënyrë Gjykata e Lartë merr në shqyrtim të gjitha shkaqet dhe kundërshtimet ndaj vendimit të gjykatës së apelit, të ngritura në rekurs dhe brenda këtyre kufijve shqyrtohet edhe çështja konkrete në këtë gjykim.

Megjithatë, Gjykata e Lartë për çështje ligjore të cilat duhet të shihen edhe kryesisht nga gjykata në çdo gjendje e shkallë të procedimit dhe që nuk janë parë nga gjykatat më të ulëta, mund t'i marrë edhe ato në shqyrtim dhe në varësi të tyre të marrë vendimin përfundimtar lidhur me çështjen në gjykim.

Në fillim të seancës gjyqësore, Kryetari i Kolegjit Administrativ bën verifikimin e legjitimitetit të palëve, të rregullshmërisë së kryerjes së njoftimeve si dhe verifikimin nëse njoftimet janë realizuar. Shqyrtimi gjyqësor më pas vijon me relatimin e çështjes.

Në kushtet e mbingarkesës së Gjykatës së Lartë për gjykimin e çështjeve administrative të vonesave 90 ditë e më shumë në shqyrtimin e tyre dhe e mungesës së kolegjit administrativ të profilizuar, LGJA parashikon ankimimin me rekurs në Gjykatën e Lartë kundër të gjitha vendimeve të shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit.

Duke pasur parasysh që në apel lejohet ankimi kundër të gjitha vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë, lehtësisht kuptohet që në Gjykatën e Lartë do të përqendrohen për gjykimin final të gjitha konfliktet administrative, pa bërë asnjë kufizim dhe vlerësim ligjor të tyre, duke ditur se janë të shumtë në numër, lloje dhe vlerë.

Kjo do të dëmtojë dhe vonojë padrejtësisht së tepërmi gjykimin administrativ. Ashtu si për çështjet civile, edhe për gjykimin në shkallë të tretë të mosmarrëveshjeve civile, duhet të kufizohen kompetencat e Gjykatës së Lartë, siç parashikohet në Kushtetutë.

Për të arritur në këtë përfundim, i referohem edhe komenteve të ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët nëpërmjet rekomandimeve të vlefshme për paraprosjektligjin kanë këshilluar: *“Fushëveprimi i Gjykatës së Lartë në çështjet administrative duhet të kufizohet qartësisht (krahasuar me situatën aktuale) vetëm në çështje specifike të shkeljes së ligjit dhe për të lejuar unifikimin e praktikës gjyqësore, sikurse kërkohet nga Kushtetuta. Kjo është e këshillueshme për dy arsye kryesore: Gjykata e Lartë duhet të rigjejë rolin e saj të shkallës së veçantë të juridiksionit, dhe një shtrirje e gjerë e Gjykatës së Lartë do ta zgjaste së tepërmi procesin administrativ, duke penguar kështu efektshmërinë e shqyrtimit gjyqësor”*.

Për të shkurtuar afatgjatjen e përgjithshme të procesit dhe për të rritur efektshmërinë e gjykimit administrativ në kohë, kompetencat lëndore dhe funksionale të Gjykatave Administrative si dhe të Kolegjit Administrativ mund të ndryshohen, si më poshtë:

1. Të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit, kur kjo e fundit shqyrton në shkallë të parë mosmarrëveshjet administrative sipas kompetencave që lidhen me aktet nënligjore normative. Kjo kompetencë të mbetet e pandryshuar ashtu siç është në ligj, për faktin se këto akte parashikojnë urdhërime për grupe individësh ose organizimesh dhe e shtrijnë efektin juridik në territore të njësisive të qeverisjes vendore apo fusha të caktuara të veprimtarisë që mbulohen nga ministritë e linjës.
2. Vendimet e gjykatës administrative të apelit që shqyrtojnë ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë, e cila gjykon shumicën e konflikteve administrative, duhet të jenë të formës së prerë dhe përfundimtare, ndaj të cilave nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kështu, gjykata administrative e apelit krahas së qenit unike kthehet edhe në një minigjykatë supreme administrative.

Në këtë mënyrë thjeshtohet dhe shkurtohet gjykimi administrativ. Kjo skemë e kompetencave mendoj që do të japë rezultate pozitive, së paku në pesë drejtime kryesore:

1. Ulet ndjeshëm mbingarkesa e Gjykatës së Lartë në gjykimin e konflikteve administrative;
2. Gjykatës së Lartë i jepen më tepër mundësi funksionale dhe kohore për të bërë unifikimin e praktikës gjyqësore për konfliktet administrative;

3. Rritet autoriteti dhe përgjegjshmëria e gjykatës administrative të apelit;
4. Përshejtohet procesi i përfundimit të gjykimit administrativ në një afat kohor sa më të shkurtër;
5. Rritet ndjeshëm efektiviteti i gjykimit administrativ në shërbim të publikut shqiptar.

Shqyrtimi gjyqësor më pas vijon me relativitetin e çështjes nga njëri prej anëtarëve të Kolegjit administrativ dhe më pas kalohet në diskutimet e palëve në procesin gjyqësor.

Radha e diskutimit në këtë rast fillon nga pala që ka paraqitur rekursin dhe më pas nga pala tjetër. Nuk lejohet replika pas kryerjes së diskutimeve nga palët.

Me mbarimin e diskutimeve të palëve në procesin gjyqësor, me përfundimin e pyetjeve apo të sqarimeve të mëtejshme që mundet të ketë ndonjë nga anëtarët e Kolegjit administrativ, trupi gjykues tërhiqet për të marrë vendimin përfundimtar.



#### **4.30. Marrja e vendimit përfundimtar**

Vendimi përfundimtar në gjykimin në Gjykatën e Lartë, si rregull, merret menjëherë pas mbarimit të seancës. Megjithatë, në raste të vecanta kur për shkak të natyrës së ndërlikuar të çështjes ose të rëndësisë së çështjes, trupi gjykues mund të shtyjë marrjen e vendimit për aq ditë sa është e nevojshme.

Në nenin 63 të LGJA është parashikuar që Gjykata e Lartë në përfundim të shqyrtimit të çështjes mundet të vendosin në njërën nga mënyrat e mëposhtme;

- a) mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i LGJA;<sup>201</sup>
- b) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë; Ky vendim i Gjykatës së Lartë merret në rastet kur gjykata e apelit në mënyrë të gabuar ka ndryshuar apo prishur vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ky i fundit vlerësohet si i drejtë nga Gjykata e Lartë. Në rastet kur Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, sic dhe u përmend më sipër, detyrat dhe konkluzionet e arritura lidhur me çështjen në fjalë nga kjo gjykatë, janë të detyrueshme për gjykatën që rigjykon çështjen. Megjithatë, ndonëse ky detyrim i gjykatës që rigjykon çështjen është mëse i qartë, në praktikën gjyqësore nuk kanë munguar rastet kur gjykatat që kanë rigjykuar çështjet në mënyrë të gabuar nuk kanë kryer detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë duke u bërë kështu shkak për prishjen e vendimit të ankimuar dhe rikthimin e çështjes përsëri për rigjykim.

---

<sup>201</sup> neni 58 i ligjit parashikon shkaqet për të cilat mund të ushtrohet rekursi

- c) prishjen e vendimit të apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues;
- d) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;
- e) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë me tjetër trup gjykues;

Përvec rasteve të parashikuara në paragrafin e mësipërm, Gjykata e Lartë kur vendos prishjen e vendimit të ankimuar ia dërgon aktet për gjykim gjykatës që ka dhënë vendimin që është prishur. Dërgimi i akteve bëhet në Gjykatën e Apelit, nëse është prishur vetëm vendimi i kësaj gjykate dhe nëse Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit por edhe Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, atëherë mundet që të vendosë dërgimin e akteve edhe në gjykatën e shkallës së parë, nëse shkak për të cilin prishen dy vendimet e mësipërme nuk mundet që të korigjohet në gjykatën e apelit.

Në LGJA është parashikuar që Gjykata e Lartë mundet të prishë vendimin e ankimuar jo në lidhje me të gjitha disponimet e këtij vendimi por vetëm të një pjese të tij duke deklaruar në vendim se cilat pjesë të vendimit të ankimuar prishen.

Më pas, për pjesën që vendimi i ankimuar priset, çështja kthehet për rigjykim. Kjo quhet ndryshe edhe prishje e pjesshme e vendimit të ankimuar. Në një rast të tillë pjesët e vendimit që nuk prishen nga Gjykata e Lartë, përbëjnë gjë të gjykuar nëse këto pjesë nuk kanë një lidhje thelbësore me pjesët e vendimit gjyqësor që prishen.

Prishja e vendimit dhe kthimi i çështjes për rigjykim është një ndër llojet e vendimeve që mund të marrë Gjykata e Lartë, në te cilin shprehet roli i kësaj Gjykate në sistemin

gjqësor, si autoriteti më i lartë gjyqësor që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta në gjykimin e çështjeve gjyqësore, duke mbetur një gjykatë ligji dhe jo një gjykatë fakti. Vendimi për prishjen e vendimit të ankimuar nga Gjykata e Lartë, lidhet me kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të ankimuar. Kontrolli mundet të jetë lidhur me mënyrën e çmuarjes së provave në gjykim dhe vlerës së tyre provuese, vlefshmërisë së tyre apo edhe mënyrën se si gjykatat më të ulëta kanë arritur në një konkluzion të caktuar lidhur me procesin e të provuarit.

Megjithatë, edhe nëse Gjykata e Lartë konstatn zbatim të gabuar të ligjit, në një rast të tillë, për shkak të natyrës së gjykimit që zhvillohet, që nuk është një gjykatë fakti, çështja dërgohet për rigjykim në gjykatën e faktit, me qëllim që gjykatat më të ulëta të bëjnë një rivlerësim të provave të administruara, kësaj herë sipas detyrave dhe konkluzioneve të Gjykatës së Lartë.

Pasi të ketë zbatuar detyrat e lëna në vendimin e Gjykatës së Lartë, gjykata më e ulët duhet që të marrë një vendim përfundimtar lidhur me çështjen objekt të gjykimit.

Detyrat e lëna në vendimin e Gjykatës së Lartë për gjykatën që do të rigjykojë çështjen mundet të jenë nga më të ndryshmet. Këto detyra mundet të kenë të bëjnë me vlerësimin dhe çmuarjen e drejtë të provave të administruara në gjykim, me marrjen e provave të reja apo me sqarimin e rrethanave të caktuara që mundet të kenë të bëjnë me ekzistencën e faktit.

Detyrat në këtë rast mund të kenë të bëjnë edhe me marrjen në konsideratë të pavlefshmërisë së veprimeve apo akteve procedurale të caktuara, e cila në mënyrë të gabuar mundet të mos jetë marrë në konsideratë në gjykimet e mëparshme apo mundet që të jetë marrë në konsideratë në mënyrë të gabuar.

Detyrat e lëna për rigjykimin e çështjes mund të kenë të bëjnë edhe me përdorshmërinë e provave të caktuara në gjykim apo edhe me ndreqjen e parregullsive të caktuara ose rimarrjen e provave gjatë rigjykimit të çështjes.

Lloji i detyrave të lëna në rigjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë janë rast pas rasti dhe do të varen nga karakteristikat individuale të çështjes administrative objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë.

Në varësi të natyrës dhe llojit të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, që lidhen detyrimisht edhe me mangësitë e verifikuara gjatë gjykimit të rekursit, do jetë edhe elementi tjetër i disponimit të Gjykatës së Lartë se në cilën gjykatë do të dërgojë çështjen për rigjykim, në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Shkallës së Parë, për;

- ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit;
  - Një vendim i tillë merret nga Gjykata e Lartë nëse ajo vlerëson se gjykatat më të ulëta nuk kanë kryer një vlerësim të drejtë të faktit, nuk kanë zbatuar drejtë ligjin administrativ lidhur me cilësimin ligjor dhe dispozitat administrative.
- lënien në fuqi të vendimit të apelit.
  - Nëse Gjykata e Lartë merr një vendim të tillë atëherë kjo tregon se vendimi për të cilin është bërë rekurs është një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se shkaqet e ngritura në rekurs nuk qëndrojnë dhe nuk përbëjnë shkak për cënimin e vendimit gjyqësor të ankimuar.

## **KAPITULLI V: PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE SUBJEKTET E SAJ**

### **5. Kuptimi i marrëdhënieve juridike procedurale administrative**

Thelbin e marrëdhënieve juridike procedurale administrative e përbëjnë gjykata dhe palët, por përveç tyre, në këto marrëdhënie mund të marrin pjesë edhe persona të tretë, të cilët bëjnë pjesë në ndërgjyqësi, siç mund të jetë për shembull Përmbaruesi në fazën e ekzekutimit dhe kur ky proces bëhet pjesë e gjykimit mbi ankim.

Me pjesëmarrjen e tyre aktive këto subjekte kryejnë veprime procedurale në përputhje me normat procedurale administrative, duke ndikuar në *“rrjedhën, zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit”*.

Në marrëdhëniet procedurale administrative marrin pjesë disa subjekte të cilët mbartin të drejta dhe detyra të caktuara procedurale të parashikuara nga ligji në fuqi.

Subjekti kryesor në këtë marrëdhënie është gjykata për shkak të rolit të saj vendimtar në zhvillimin e këtyre marrëdhënieve administrative.

Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë sepse është vetëm ajo që ka të drejtë të zgjidhë një çështje administrative duke dhënë vendim përfundimtar.

Kjo buron nga fakti që gjykata është i vetmi organ i autorizuar nga ligji për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.<sup>202</sup>

---

<sup>202</sup> Av.N.Uka, Av.J.Brati, “Magjistratura & Avokatia”, “ILARI” P.F., Tiranë 2012, fq.454.

Rëndësi paraqesin normalisht edhe subjektet e tjerë të kësaj marrëdhënie juridike. Kjo sepse pa ekzistencën e tyre nuk mund të lindë një marrëdhënie juridike procedurale administrative.

Si të tillë mund të përmendim faktin se pa kërkesën e palës kërkuese gjykata nuk mund të vihet në lëvizje. Në të njëjtën kohë, ekzekutimi i detyrueshëm i një vendimi gjyqësor që tashmë ka marrë formë të prerë nuk mund të nisë pa kërkesën e posaçme të kreditorit.

Si subjekte kryesore në një marrëdhënie procedurale administrative janë gjykata dhe palët ndërgjyqëse. Këto subjekte si palë aktive (paditësi, kërkuesi) por edhe pasive (i padituri, personi i tretë, i interesuari) mund të kryejnë veprime procedurale në pajtim me normat procedurale administrative duke ndikuar drejtëpërdrejtë por edhe tërthorazi në fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e një gjykimi konkret.

Është e pamundur që të kemi marrëdhënie juridike procedurale administrative pa ekzistencën e një padie të paraqitur për shqyrtim gjyqësor. Subjektet që ndërhyjnë në këtë marrëdhënie juridike procedural administrative, ndërhyjnë ose janë të detyruar të ndërhyjnë vetëm brenda procesit gjyqësor i cili është iniciuar me padi.

Marrëdhënia juridike administrative nuk varet nga procesi gjyqësor administrativ pasi ajo realizohet pavarësisht nga procesi gjyqësor. Por dhe jashtë procesit gjyqësor ajo realizohet prapë si një marrëdhënie më vete në një gjykatë të pavarur dhe jo më si pjesë e seksionit të saj.

Marrëdhënia juridike procedural administrative realizohet brenda procesit gjyqësor apo brenda gjykimit. Në procesin gjyqësor marrin pjesë edhe persona të tjerë si; mbajtësi i procesverbalit gjyqësor që është sekretari gjyqësor, përfaqësuesit e palëve

ndërgjyqëse, avokatura e shtetit si palë që mbron interes e palëve në gjykim, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, por këta nuk janë subjekte direkt të procesit gjyqësor administrativ.

Ata me pjesëmarrjen e tyre nuk kanë të njëjtin ndikim si palët ndërgjyqëse pasi ata në fakt kanë vetëm një rol ndihmës në veprimet e subjekteve të procesit.

Marrëdhënia juridike procedural administrative është më e gjerë se procesi gjyqësor administrativ.

Për kuptimin e marrëdhënies juridike procedural administrative janë dhënë përkufizime të ndryshme duke u përpjekur që të përfshijnë elementët themelor të saj.

Por, përgjithësisht mund të thuhet se marrëdhënia juridike procedural administrative është marrëdhënia e posaçme midis gjykatës dhe subjekteve të tjera procedurale. Këta janë të lidhur me të drejta dhe detyra të caktuara procedurale nga normat e së drejtës procedurale administrative.

**Me marrëdhënie juridike procedurale kuptohet tërësia e të drejtave dhe detyrave të subjekteve pjesëmarrës në procesin gjyqësor me palë kundërshtare në procesin gjyqësor administrativ.**

### **5.1. Subjektet e marrëdhënieve juridike procedurale administrative**

Në gjykimin administrativ, në zhvillimin dhe në zgjidhjen e çështjes administrative marrin pjesë gjykata, palët ndërgjyqëse por në disa raste edhe persona të tretë, të cilët quhen **subjekte të gjykimit administrativ**.

Ata kanë të drejta dhe detyra procedurale të caktuara dhe që me veprimet e tyre influencojnë rrjedhimin, zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit. Nga ana tjetër, sipas Giuseppe Ugo Rescigno, normat janë ato të cilat shpërndajnë fuqinë administrative. Dhe këto norma, më pas, i tregojnë subjekteve të procedurës civile pushtetin specifik që iu është dhënë si dhe në çfarë rrethanash duhet të ushtrohet<sup>203</sup>.

Në gjykimin administrativ marrin pjesë edhe të tjerë, si psh përkthyesit, dëshmitarët dhe ekspertët. Por këta nuk influencojnë me pjesëmarrjen e tyre në zhvillimin e gjykimit por thjesht dhe vetëm ndihmojnë veprimtarinë e pjesëmarrësve të tjerë në njoftimin e fakteve ose nëpërmjet njohurive të tyre teknike ose shkencore.

Prandaj, këta nuk janë subjekte të gjykimit,<sup>204</sup> duke u bazuar edhe në terminologji dhe analogji të ligjit procedural dhe konkretisht e gjejmë të specifikuar në nenin 15 të LGJA.<sup>205</sup>

---

<sup>203</sup>G. Ugo Rescigno, "Corso di diritto pubblico", undicesima edizione 2007/2008, fq. 1

<sup>204</sup>A.Lamani, "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë 1962, fq.27.

<sup>205</sup>neni 15 i ligjit



## 5.2. Gjykata Administrative

Gjykata si subjekt i marrëdhënies juridike procedural administrative ka një pozitë të veçantë dhe më kryesoren pasi është e vetmja që ka autoritetin të zgjidhë një çështje administrative më anë të një vendimi përfundimtar.<sup>206</sup>

Gjykata ka rol organizues dhe drejtues gjatë gjithë procesit gjyqësor administrativ, madje pa të nuk mund të mendohet zhvillimi dhe përfundimi i procesit.

Por njëkohësisht ajo ka edhe **rol pasiv** gjatë gjykimit.

Gjykata si subjekt ka të drejta dhe detyra të përcaktuara në një proces gjyqësor konkret administrativ. Detyra kryesore e gjykatës është të shqyrtojë dhe të japë vendime për çdo çështje që i paraqitet për shqyrtim nëpërmjet arsytimeve të ndryshme, psh, ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë (neni 1 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile).<sup>207</sup>

Gjithashtu, gjykata ka dhe detyra të karakterit juridiko procedural.

Psh, ajo është e detyruar të shprehet për të gjitha kërkimet dhe pretendimet e palëve, vetëm brenda kufijve të asaj që kërkohet. Vendimin e saj duhet ta mbështesë vetëm në faktet që janë paraqitur nga palët në procesin gjyqësor si dhe të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm. Kjo tregon rolin jo aktiv të gjykatës si edhe detyrimin që ajo t'u japë palëve mundësi të provojnë kërkimet dhe propozimet e tyre.

Kanë qënë jo të pakta rastet kur ky parim nuk është kuptuar drejt duke u konfunduar me çështjen e juridiksionit dhe kompetencës. Në rast se ligji mungon apo ka boshllëk juridik që nënkupton se për çështjen e caktuar nuk ka një dispozitë ligjore

---

<sup>206</sup> Av.N.Uka, Av.J.Brati, "Magjistratura & Avokatia", "ILARI" P.F., Tiranë 2012, fq.454.

<sup>207</sup>Po aty, fq.455.

procedurale që parashikon shqyrtimin e saj nga gjykata dhe çështja nuk hyn në juridiksionin e organeve të tjera, atëherë gjykata është e detyruar të pranojë çështjen për shqyrtim dhe të japë një vendim duke u bazuar pikërisht në këtë parim.

Njëkohësisht ajo bazohet edhe në normat e tjera të përgjithshme parimore të cilat rregullojnë çështje të tjera analoge. Madje edhe në rastet kur nuk gjendet asnjë zgjidhje e shkruar në një akt ligjor apo nënligjor si dhe në asnjë vendim nga gjykata analoge, gjykata zbaton drejtëpërdrejtë Kushtetutën për shkak se është e detyruar të plotësojë të drejtën e shkelur apo të munguar të pretenduesit.

Gjykata është subjekt i procesit gjyqësor dhe si e tillë ka të drejtë dhe detyrë të marrë masa për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor, të kërkojë nga palët pjesëmarrëse kryerjen e veprimeve procedurale, të marrë masat për sigurimin e provave kur palët e kanë të pamundur për t'i paraqitur si dhe të ngarkojë me përgjegjësi palën që përpiqet të pengojë zhvillimin normal të procesit apo zgjatjen dhe ndërlikimin e tij.

Gjykata ushtron pushtetin gjyqësor në mënyrë të pavarur duke qënë një organ kushtetues.

Neni 90, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, përcakton: *“Palë në një gjykim administrativ janë personat fizikë ose juridikë në emër ose kundër të cilëve zhvillohet gjykimi”*<sup>208</sup>. Një argumentin dhe përkufizim i tillë nënkupton se palët janë subjekte të marrëdhënieve juridike procedurale administrative pasi pa to nuk mund të ketë proces administrativ dhe me cilësinë e subjekteve ato gëzojnë të drejta dhe ngarkohen me disa detyra.

---

<sup>208</sup> Neni 90 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile

Ata janë të detyruar të kryejnë veprime procedurale në formën e kërkuar nga ligji, të ruajnë respektin që dikton procesi gjyqësor, nuk lejohen që të përdorin shprehje të papërshtatshme ose fyese pasi në rast të kundërt parashikohen sanksione për shkelje të këtij ndalimi.

Pala që i drejtohet me padi një ose disa personave të tjerë fizik apo juridik duke kërkuar mbrojtjen e të drejtave ose interesave të ligjshëm që pretendon se i mohohen ose i cënohen, vë në lëvizje gjykatën e cila nga ana e saj është e detyruar të kufizohet në shqyrtimin vetëm të çështjeve që ngrihen nga palët.

Padia në vetvete duhet të plotësojë disa kërkesa të parashikuara nga ligji administrativ pasi në rast të kundërt gjykata jep kohë për plotësim të metash dhe në rast se edhe atëherë nuk i plotëson brenda afatit, atëherë ka të drejtë të kthejë kërkesë padinë.

Personi që i drejtohet gjykatës për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e një të drejte që pretendon se i mohohet ose i shkelet nga një organ administrativ të cilin e thërret rregullisht para gjykatës, quhet “**paditës**”.

Ndërsa personi tjetër që thirret në gjykatë për t’u përgjigjur se sipas pretendimit të personit që e thërret në gjykatë ka mohuar ose ka shkelur një të drejtë të këtij, quhet “**i paditur**”.

Të dy këta, dmth, paditësi dhe i padituri, quhen palë, ose ndërgjyqës, ose palë ndërgjyqëse.<sup>209</sup>

Në ato raste kur çështja mund të ketë interes për persona të tjerë të cilët nuk marrin pjesë në proces, atëherë për të shmangur shqetësimin dhe përsëritjen e procesit të gjykimit, personave të tretë u është dhënë mundësia e ndërhyrjes në proces si palë.

---

<sup>209</sup> A.Lamani, “Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Tiranë 1962, fq.29.

Personi i tretë mund të ndërhyjë duke u paraqitur kundër të dy palëve ndërgjyqëse ose duke iu bashkuar njërës palë kundër palës tjetër dhe duke marrë kështu cilësinë e subjektit të marrëdhënies juridike procedural administrative.

Kjo ndodh vetëm atëherë kur pala e tretë ka për të mbrojtur një interes të tij të ligjshëm pasi në rast të kundërt nuk mund të pranohet ose nuk mund të thirret.

**Palët karakterizohen nga fakti:**

- Se gjykimi zhvillohet në emër të tyre dhe/ose kundër tyre në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre administrative;
- Se fuqia e vendimit gjyqësor në lidhje me konfliktin mbi të drejtat administrative shtrihet mbi ta;
- Se ata si rregull kanë në ngarkim shpenzimet gjyqësore.<sup>210</sup>

---

<sup>210</sup> A.Lamani, “Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë”, Tiranë 1962, fq.30.

### **5.3. Subjektet ndihmëse që bëjnë pjesë në procedurën administrative**

Subjektet që marrin pjesë në një marrëdhënie juridike të një procesi gjyqësor administrativ, me kërkesë të palëve apo të thirrur nga gjykata si subjekte që kanë interes në çështje, janë ato që nuk marrin përsipër pasojat e procesit por japin ndihmesën e tyre për palët dhe gjykatën për realizimin e procesit dhe përfundimin e tij.

Mund të përmendim, thirrja e personave të tretë, thirrjen si palë të interesuar, avokaturën e shtetit si dhe subjekte që japin ndihmesë në procesin gjyqësor.

Gjithashtu si subjekte të tillë mund të përmendim edhe sekretarinë gjyqësore që mban procesverbalin gjyqësor, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, etj.

Procesi gjyqësor është i gjerë dhe si i tillë mund të prekë fusha të ndryshme të jetës të cilat kërkojnë mendim të specializuar të ekspertëve të fushës përkatëse.

Eksperti është një subjekt i domosdoshëm në raste konfliktesh pronësie apo rastet kur palë në proces janë persona që nuk e njohim gjuhën shqipe apo kemi akte që nuk janë në gjuhën shqipe, etj. Sidomos në këto të fundit kërkohet prezenca e një përkthyesi për zhvillimin normal gjyqësor dhe një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes objekt gjykimi.

Këta aktorë hyjnë në marrëdhënie procedurale pasi veprimet e tyre kushtëzohen nga procedurat, ndihmojnë procesin gjyqësor dhe subjektet e tij por nuk janë subjekte të procesit.

#### **5.4. Përmbajtja e marrëdhënies juridike procedural administrative**

Përmbajtja e marrëdhënies juridike procedural administrative përmban në vetvete tërësinë e të drejtave dhe detyrave të subjekteve të këtyre marrëdhënieve si dhe të raportit midis të drejtave dhe detyrave që lindin gjatë zhvillimit të procesit administrativ.

Ushtrimi i këtyre të drejtave dhe përmbushja e detyrave në procesin administrativ siguron zhvillimin e një procesi të rregullt.

Palët ndërgjyqëse në gjykimin administrativ kanë të drejta procedurale dhe detyra procedurale të caktuara, ku këto të fundit parashikohen në mënyrën gjenerike dhe vetëm pak prej tyre në mënyrë të veçantë.<sup>211</sup>

Të drejtat procedurale administrative janë mundësia që u njeh ligji subjekteve të marrëdhënies juridike procedural administrative për të kryer veprime procedurale sipas dispozitave ligjore si p.sh., e drejta e paditësit të ngrejë padi, e drejta e të paditurit për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe/ose të veprimit tjetër administrativ të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë; të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës nga e cila ka lindur mosmarrëveshja objekt gjykimi, etj.

Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet në të cilat bazon pretendimin e saj.

Por edhe në këto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik kur ka dyshime të arsyeshme, të

---

<sup>211</sup> A.Lamani, "Procedura Civile e Republikës Popullore të Shqipërisë", Tiranë 1962, fq.36.

bazuara në prova me shkresë që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje, fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.

Detyrat procedurale administrative janë ato veprime procedurale që subjektet e marrëdhënies juridike procedurale detyrohen të kryejnë, si psh, gjykata ka detyrë të zgjidhë çështjen me vendim gjyqësor, paditësi ka detyrë të plotësojë të metat e padisë, palët detyrohen t'i bëjnë të njohur njëra-tjetrës provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, etj.

Në mënyrë që të kuptojmë përmbajtjen e marrëdhënies juridike procedural administrative duhet të sqarohet dallimi midis subjekteve të marrëdhënies juridike procedural administrative dhe subjekteve të procesit gjyqësor administrativ.

**Subjekte të marrëdhënies juridike procedural administrative** janë gjykata, pala paditëse, pala e paditur, personat e tretë që ndërhyjnë ose thirren në proces, sekretari gjyqësor, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, gjykatat e tjera që kryejnë veprime me delegim, përmbaruesi që merr pjesë në ekzekutim si dhe personat e tjerë që marrin pjesë në këtë fazë. Ndërsa **subjekte të procesit gjyqësor administrativ** janë ato që marrin përsipër pasojat e procesit, që janë gjykata dhe palët.

Subjekte të marrëdhënies juridike procedural administrative janë të gjithë ata që për shkak të ligjit apo të rrethanave hyjnë në marrëdhënie procedurale me njëri tjetrin dhe me gjykatën, realizojnë veprime procedurale administrative, ndërsa subjektet e procesit gjyqësor ndryshe nga subjektet ndihmëse marrin përsipër dhe realizojnë pasojat e procesit gjyqësor të konkretizuara me vendim të gjykatës.

Procesi gjyqësor administrativ është pjesë e marrëdhënies juridike procedural administrative. Subjektet e tij bëjnë pjesë në këtë marrëdhënie. Ndërsa, marrëdhënia juridike procedurale administrative është një fushë më e gjerë se procesi gjyqësor dhe e përfshin këtë të fundit brenda saj. Pra jo të gjithë subjektet e marrëdhënies janë subjekte edhe të procesit.



### **5.5. Veprimet procedurale të subjekteve të procesit gjyqësor**

Procesi gjyqësor administrativ realizohet ndërmjet një, dy ose më shumë personave të cilët vihen përballë njëri-tjetrit para një subjekti të veçantë i ngarkuar me zgjidhjen e një çështje administrative me vendim përfundimtar. Që të kemi një proces administrativ duhen detyrimisht tre subjekte në rast se gjykimi zhvillohet me dy palë.

Procesi gjyqësor administrativ ka palë të saj paditësin, të paditurin (organin administrativ) dhe të ashtuquajturin person i tretë, të cilët ndërhyjnë vullnetarisht për të mbrojtur interesat e tyre ose që janë të detyruar të ndërhyjnë pasi janë garanci për të paditurin.<sup>212</sup>

Paditësi në procesin gjyqësor administrativ është personi që i drejtohet gjykatës me padi për të kërkuar njohjen ose rivendosjen e një të drejte që pretendon se i është shkelur ose mohuar nga një organ publik të cilin me padi e thërret në gjykatë duke e cilësuar si të paditur.

Të paditurin e thërret paditësi me padi ndërsa gjykata si organ shtetëror në proces ka një pozitë të veçantë pasi është i vetmi organ që shqyrton një çështje administrative dhe jep vendim përfundimtar dhe që caktohet pavarësisht vullnetit të palëve.

Në procesin gjyqësor këto janë subjektet e domosdoshme pasi pa to nuk ka proces por pjesë e procesit mund të bëhen edhe personat e tretë të cilët mund të ndërhyjnë ose mund të thirren si të tillë në rast se me objektin e padisë objekt shqyrtimi kanë interesa.

---

<sup>212</sup> Av.N.Uka, Av.J.Brati, “Magjistratura & Avokatia”, “ILARI” P.F., Tiranë 2012, fq.551.

Pesonat e tretë mund të ndërhyjnë me kërkime kundrejt palëve në proces ose mund t'i bashkohen njëres palë përkundrejt palës tjetër. Të gjithë këto pjesëmarrës kryejnë veprime procedurale të cilët përbëjnë përmbajtjen e procesit administrativ.

Palët dhe subjektet e tjerë që marrin pjesë për të mbrojtur interes e tyre kryejnë veprime procedurale me qëllim që gjykata të zgjidhë mosmarrëveshjet midis tyre.

Nga kryerja ose moskryerja e këtyre veprimeve rrjedhin pasoja procedurale konkrete. Veprimet procedurale të palëve janë të rregulluara nga ligji.

Ndërsa gjykata ka pozicion ndryshe pasi ajo ka si detyrë zgjidhjen përfundimtare të çështjes objekt shqyrtimi, të kryejë veprime procedurale të caktuara për zgjidhjen e çështjes të cilat përgjithësisht janë të detyrueshme për pjesëmarrësit në proces.

Veprimet procedurale të gjykatës duhet të dallohen nga veprimet procedurale me karakter përgatitor nga ata me karakter vendosës.

Veprimet përgatitore kanë si synim të përgatisin sa më mirë procesin për gjykim pasi kjo ndihmon në zgjidhjen e shpejtë të çështjes. Ndërsa në veprimet procedurale vendosëse gjykata synon të zgjidhë një çështje të pretenduar.

Veprimet procedurale që kryejnë palët ose personat e tretë dallojnë me veprime të kushtëzuara me afat dhe me veprime të revokueshme ose të parevokueshme.

Në veprimet procedurale që janë me afat, mosrespektimi i këtij afati sjell humbjen e së drejtës për kryerjen e këtyre veprimeve.

Veprimet procedurale të revokueshme sjellin efekte të tërthorta siç janë ankimi, padia etj.

Është e përcaktuar se heqja dorë nga padia apo ankimi mund të bëhet në çdo kohë deri në çastin e dhënies së vendimit të formës së prerë. Veprimet procedurale të parevokueshme janë ato me efekt të drejtëpërdrejtë sepse në çastin e lindjes së tyre vjen pasoja procedurale e parashikuar në ligj p.sh, revokimi nga heqja dorë nga ankimi nuk mund të ndodhë, etj.

Ndërsa kur pala paraqet ankim kundër vendimit përfundimtar veprimi është i revokueshëm sepse pala mund të revokojë të heqë dorë nga ankimi por veprimi i heqjes dorë është i parevokueshëm. Nuk mund të hiqet dorë prej tij sepse procesi gjyqësor është mbyllur dhe pasoja vjen menjëherë.

Të parevokueshëm janë përgjithësisht veprimet procedurale disponibël në të cilat pala që i kryen e keqëson pozitën e vet procedurale pasi po të njëjët mundësia e revokimit do sillte si pasojë pasiguri për pozitën e palës tjetër dhe zvarritje pafund të procesit.

## 5.6. Kuptimi i palës

Në procesin gjyqësor administrativ me palë kundërshtare marrin pjesë dy palë: paditësi dhe i padituri si dhe personat e tretë që ndërhyjnë në mbrojtjen e interesave të tyre ose si garanci për palët e tjera.

**Paditësi** është personi që i drejtohet gjykatës dhe kërkon prej saj mbrojtjen juridike me anë të njohjes ose rivendosjes së një të drejte subjektive me pretendimin se i mohohet ose i shkelet nga organi publik.<sup>213</sup>

Paditësi është subjekti që vë në lëvizje gjykatën për kërkimin e një të drejte, apo interesi të ligjshëm, apo cënimi i të drejtës individuale, apo pronësisë si dhe çdo të drejtë tjetër në interes të tij.

**I padituri** quhet personi që thirret në gjykatë nga paditësi pasi sipas pretendimeve të këtij të fundit, ky i paditur i ka mohuar ose shkelur një të drejtë subjektive të caktuar dhe të mbrojtur nga ligji.<sup>214</sup>

Palët ndërgjyqëse janë subjekte të procesit gjyqësor administrativ të cilët kanë interesa të kundërta pasi mes tyre ekziston mosmarrëveshja lidhur me mënyrën e rregullimit të marrëdhënies juridike konkrete në të cilën bazohet e drejta subjektive e paditësit dhe detyrimi i të paditurit.

Subjekti i së drejtës e fiton cilësinë si paditës me paraqitjen e padisë në gjykatë, e cila shpreh vullnetin e tij të lirë dhe të pacënuar.

Ndërsa i padituri e fiton këtë cilësim pa vullnetin e tij pasi si të tillë e thërret paditësi në padi. Qënia si palë ndërgjyqëse merr fund me përfundimin e procesit gjyqësor, me

---

<sup>213</sup> Av.N.Uka, Av.J.Brati, "Magjistratura & Avokatia", "ILARI" P.F., Tiranë 2012, fq.511.

<sup>214</sup>Po aty, fq.514.

vdekjen e personit fizik, me mbarimin e personit juridik, por këtë cilësi e humbet personi fizik ose juridik edhe në rastet kur kemi të bëjmë me rast suksedimi dhe në vend të tij futet një person tjetër.

Nocioni palë ndërgjyqëse është nocion procedural-juridik ç'ka tregon se është i pavarur nga ekzistenca e marrëdhënies administrative. Kjo pasi, marrëdhënia administrative ndodh vetëm në procesin gjyqësor ku është me rëndësi koncepti i paditësit dhe të paditurit, cilësi e cila përgjithësisht u takon pjesëmarrësve të marrëdhënies juridiko- administrative.

Një person e fiton një cilësi të tillë vetëm me anë të padisë pavarësisht nëse ka qenë subjekt i marrëdhënies administrative. Palët ndërgjyqëse duhet të ekzistojnë dhe të jenë të individualizuar pasi në të kundërt nuk mund të ketë proces gjyqësor. Kjo sepse një person i panjohur nuk mund të jetë palë në një proces gjyqësor.

Përcaktimi i palëve ndërgjyqëse bëhet në padi duke treguar emër dhe mbiemër si dhe gjeneralitete për persona fizik, dhe emër dhe adresë për personat juridik si dhe përfaqësuesin e tyre. Në rast se padia nuk i ka të sakta këto të dhëna atëherë gjykata i jep kohë palës paditëse t'i saktësojë ato dhe në rast mos-saktësimi kthehet padia me vendim dhe quhet sikur nuk është paraqitur.

Me konceptin e paraqitjes së palëve në kërkesë padi nënkuptohet ndryshe si ndërtim i ndërgjyqësisë dhe kjo është ekskluzivitet i paditësit në respektim të parimit të disponibilitetit.

## 5.7. Kushtet për të qenë palë

Për të fituar zotësinë e palës në procesin gjyqësor, subjekti i së drejtës duhet të ketë:

- a. **zotësinë juridike** për të qenë palë ndërgjyqëse (zotësia juridike procedurale administrative);
- b. **zotësinë për të vepruar** në proces (zotësia procedurale për të vepruar).

Zotësinë për të qenë palë në proces e ka cilido person fizik që ka zotësinë për të gëzuar të drejta civile që nënkupton çdo person fizik që është gjallë si dhe çdo person juridik që ushtron aktivitet duke gëzuar të drejta dhe patur detyrime, ç'ka tregon se zotësia juridike procedurale administrative është e barabartë me zotësinë juridike.

Ndërsa zotësinë procedurale për të vepruar e kanë personat që kanë zotësinë për të ushtruar të drejtat civile që nënkupton ata që kanë zotësi për të vepruar.

Kjo tregon se zotësia juridike procedurale, ashtu dhe zotësia procedurale për të vepruar, janë pjesë përbërëse e zotësisë së përgjithshme juridike dhe zotësisë për të vepruar.

Kur hiqet apo kufizohet me vendim gjykate zotësia për të vepruar, hiqet apo kufizohet edhe zotësia procedurale për të vepruar. P.sh, një personi që i është hequr zotësia për të vepruar nuk mund të kryejë veprime juridike administrative dhe po për të njëjtën arsye nuk mund të ngrejë padi në gjykatë.

Zotësia procedurale për të vepruar ose zotësia për të qenë palë është zotësia e subjektit të së drejtës për të pasur të drejta dhe detyra procedurale që nënkupton një mundësi abstrakte për të qenë subjekt i procesit gjyqësor si paditës ose i paditur, pra, që i jep subjektit të së drejtës zotësi për të qenë palë ndërgjyqëse.

Kjo nënkupton se zotësia për të qënë palë u përket të gjithë subjekteve që kanë zotësi juridike administrative.

Zotësia për të qënë palë nënkupton zotësinë procedurale administrative.

Zotësia procedurale juridike është zotësi e plotë dhe ajo nuk mund të kufizohet. Ajo është e barabartë për të gjithë.

Personat fizikë e fitojnë zotësinë procedural juridike me lindjen e tyre dhe e kanë atë sa të jenë gjallë. Madje këtë zotësi e ka edhe fëmija që është në barkun e nënës me kushtin e vetëm që të lindë i gjallë.<sup>215</sup>

Zotësinë procedurale juridike e fiton edhe personi juridik nga çasti i krijimit ose nga çasti i rregjistrimit sipas parashikimit ligjor.

---

<sup>215</sup> neni 320 i Kodit të Procedurës Civile

## **5.8. Zotësia procedurale për të vepruar ose zotësia për të vepruar në proces**

Zotësia procedurale për të vepruar është zotësia e subjektit të së drejtës që si palë ndërgjyqëse të kryejë veprime procedurale me të cilat realizohen të drejtat dhe përmbushen detyrat procedurale. Kjo zotësi i përgjigjet zotësisë për të vepruar në të drejtën administrative.

Zotësia procedurale për të vepruar është e plotë kur ajo mund të kryejë të gjitha veprimet procedurale në proces. Zotësia e plotë procedurale për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18-vjeç, pasi para kësaj moshe nuk mund të gëzohet ajo për arsye se konsiderohet i mitur.

Duhet të theksohet se edhe mituria ndahet në dy faza ashtu si në të drejtën civile. Deri në moshën 14 vjeç nuk kemi zotësi procedurale për të vepruar dhe i mituri nuk mund të kryejë veprime procedurale. Këto veprime në emër të tij i kryen prindi ose kujdestari ligjor.

Nga mosha 14 vjeç deri 18 vjeç, i mituri gëzon zotësi procedurale për të vepruar të kufizuar pasi i lejohet të kryejë veprime vetëm me pëlqimin paraprak të përfaqësuesit ligjor. Kjo, me përjashtim të ndonjë veprimi që nuk cënon interesat madhore të të miturit si psh, ajo lidhur me marrëdhëniet e punës që kryen por nga ana tjetër nuk mund të ngrejë padi për kërkim shpërblimi për punën e kryer.

Aty ku pranohet zotësia e kufizuar për të vepruar në fushën civile aty pranohet edhe zotësia e kufizuar procedurale për të vepruar në fushën administrative. Psh, nëse të miturit 16 vjeç i lejohet të lidhë kontratë pune, atëherë i lejohet që të kërkojë me padi në gjykatë edhe të drejtat e cënuara që rrjedhin nga kjo kontratë.



Kjo ndarje që lidhet me moshën e subjektit ka rëndësi pasi ndikon drejtëpërdrejt në pasojat juridike. Veprimet e të miturit nën 14 vjeç janë absolutisht të pavlefshme dhe gjykata ka detyrim që kryesisht të verifikojë zotësinë procedurale për të vepruar edhe pse pala nuk e pretendon atë. **Kjo i jep rol aktiv gjykatës në procesin gjyqësor administrativ.**

## **5.9. Zotësia procedurale për të vepruar e personit juridik**

Ndryshe nga personi fizik, personi juridik e fiton zotësinë procedurale për të vepruar në të njëjtën kohë me zotësinë juridike, i cili është momenti i krijimit të tij ose kur e parashikon ligji që në momentin e rregjistrimit. Personi juridik e humb atë në momentin kur mbaron si person juridik, me organizim ose me shpërndarje.

Personat juridik që krijohen dhe ata që rregjistrohen në momentin e zyrtarizimit të tyre fitojnë njëkohësisht si zotësinë juridike procedurale civile ashtu edhe zotësinë procedurale për të vepruar dhe po në të njëjtin moment i humbasin të dyja në njërin nga format e sipërcituara të mbarimit të tyre.

## 5.10. Legjitimimi për të qenë palë

Neni 15 i LGJA shprehet se *“Padia mund të ngrihet: a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ, për ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ...”*

Nga kjo kuptohet qartë se padinë mund ta ngrejë në gjykatë një person fizik ose juridik që ka interes të ligjshëm i cili vjen si rrjedhojë e një marrëdhënieje juridike administrative konkrete. Kjo nënkupton në vetvete se palët ndërgjyqëse legjitimohen realisht për shkak se ato janë pjesëmarrëse në një marrëdhënie juridike administrative nga e cila ka lindur procesi gjyqësor. Në aspektin teorik ky legjitimim quhet **legjitimim real**.<sup>216</sup>

Nocioni interes i ligjshëm nënkupton së pari një përfitim vetjak që do të ketë personi duke kërkuar me anë të gjykatës shfuqizimin, ndryshimin, konstatimin ose zgjidhjen e mosmarrëveshjes me organin administrativ që në rastin konkret do të quhet si i paditur në kërkesë padi. Por gjithashtu duhet që interesi për të vepruar duke ngritur padi në gjykatë dhe duke iniciuar një proces gjyqësor të kushtëzohet me faktin se pa ndihmën e gjykatës paditësi do të pësonte një dëm konkret.

Lidhur me këtë, shprehen, Vendimi nr. 231, dt.22.11.2002 i Gjykatës Kushtetuese dhe Vendimi nr. 25, datë 28.03.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Padia mund të ngrihet si në rastet kur dëmi është aktual dhe i tanishëm por edhe në rastet kur ka rrezik që të vërtetohet një dëm në një kohë të afërt.<sup>217</sup>

---

<sup>216</sup>Neni 15 i ligjit

<sup>217</sup>Vendimi nr.231 dt.22.11.2002 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi nr.25 datë 28.03.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Sa më sipër kuptohet qartë se padia për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar mund të ngrihet vetëm prej atij që i përket e drejta e shkelur ose e mohuar prej tjetrit dhe pikërisht ky quhet **legjitimim aktiv**.

Padia mund të ngrihet vetëm kundër atij që me qëndrimin ose veprimet e tij shkel ose mohon të drejtën subjektive të kërkuesit dhe ky quhet **legjitimim pasiv**. Psh. Kreditori ka legjitimim aktiv për të ngritur padi kundër debitorit që nuk përmbush detyrimin dhe debitori ka legjitimim pasiv.

Gjykata verifikon legjitimimin e palëve ose të përfaqësuesve të tyre dhe në rast se konstaton të meta iu lë afat dhe detyra për plotësimin e tyre. Gjykata verifikon a legjitimohen vetë personat e paraqitur në gjykim si palë, a janë ata të shënuar në padi, a kanë zotësi për të vepruar, përfaqësuesit a i kanë tagrat e përfaqësimit, a i plotësojnë kushtet për të qenë të tillë, a janë të plota të dhënat për vendodhjen e personave, etj.

### 5.11. Bashkëndërgjyqësia

Bashkëndërgjyqësia ekziston kur një padi mundet të ngrihet nga disa persona bashkërisht por mund edhe të paditen disa persona.

Pra, **bashkëndërgjyqësi** kemi kur në palën paditëse ose të paditur ose në të dyja palët kemi shumë persona dhe personat që marrin pjesë quhen bashkëndërgjyqës.

**Bashkëndërgjyqësia është aktive** kur janë shumë paditës dhe **është pasive** kur kemi shumë të paditur.

Ndërsa **bashkëndërgjyqësia është e dyanshme ose e përzier** kur janë shumë paditës dhe shumë të paditur.

Përgjithësisht bashkëndërgjyqësia është fakultative por ka raste perjashtimore kur është e detyrueshme.

**Bashkëndërgjyqësia është fakultative** kur secili paditës bashkëndërgjyqës mund të bëjë padi të veçantë kundër shumë debitorëve ose kur shumë paditës mund të bëjnë padi kundër shumë debitorëve por edhe kundër një debitori.

**Bashkëndërgjyqësia është e detyrueshme** kur formimi i saj nuk varet nga vullneti i palës ndërgjyqëse por nga fakte jashtë procedurale.

Bashkëndërgjyqësia si koncept por edhe si pjesë e të drejtës procedurale civile rregullohet nga neni 24 i LGJA.<sup>218</sup>

Konkretisht, padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve në rast se :

- a) *Kanë të drejta ose detyrime të përbashkëta mbi objektin e padisë.*

---

<sup>218</sup>Neni 24 i ligjit

*b) Të drejtat dhe detyrimet e tyre nga pikëpamja e ligjit kanë po atë bazë.*

Bashkëndërgjyqësia mund të krijohet që në fillim me ngritjen e padisë kur ajo është ngritur nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve dhe që kjo quhet ndryshe **bashkëndërgjyqësi parësore.**

Por bashkëndërgjyqësia mund të krijohet edhe gjatë procesit gjyqësor me ndërhyrjen e personave të tretë kur paditësit të parë i bashkohet një paditës tjetër, e cila quhet **bashkëndërgjyqësi e mëvonshme.**

Në bashkëndërgjyqësi, qoftë, aktive, pasive, e përzier, fakultative, e detyrueshme, parësore apo e mëvonshme, çdo person që bashkohet merr cilësinë e paditësit ose të të paditurit sipas pozitës që ka ai në lidhje me objektin e gjykimit.

## **5.12. Të drejtat dhe detyrat procedurale të palëve**

Palët ndërgjyqëse në një proces civil përveç të drejtave të tyre procedurale kanë edhe detyra procedurale. Të drejtat procedurale të palëve në proces janë të shumta dhe të ndryshme dhe ndeshen në çdo fazë të gjykimit.

Disa të drejta mund të përmendim si më poshtë:

### *Për paditësin:*

E drejta të heqë dorë nga gjykimi i padisë ose nga e drejta e padisë në çdo fazë gjykimi pa qenë i nevojshëm pëlqimi i palës tjetër ose i gjykatës.

E drejta e paditësit të ndryshojë shkaku ligjor të padisë, të shtojë, pakësojë ose të ndryshojë objektin e padisë pa qenë nevoja e pëlqimit të palës së paditur ose gjykatës para fillimit të seancës gjyqësore.

### *Për të paditurin:*

E drejta të mohojë padinë tërësisht ose pjesërisht si dhe të bëjë kërkime të ndryshme e të pavarura.

Ka të drejtë të ngrejë kundërpadi, të pretendojë me prapësime deri në mungesën e legjitimitetit të paditësit para fillimit të seancës gjyqësore.

### *Për të dyja palët:*

Kanë të drejtë të zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim, kanë të drejtë të bëjnë ankim kundër vendimit të gjykatës, kanë të drejtë të ndjekin gjykimin personalisht ose me anë të përfaqësuesit, të mbrohen ose jo me avokat, kanë të drejtë të shprehen lidhur me provat, kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjykatës, ekspertëve dhe të sekretarit, të vihen në dijeni të materialit të çështjes, të pajisen me kopjen e akteve,

kanë të drejtë të kërkojnë përkthyes kur nuk njohin gjuhën shqipe ose kur materiali nuk është në gjuhën zyrtare, etj.

Detyrat e palëve:

- Palët kanë detyrë t'i ushtrojnë të drejtat e tyre procedurale në proces në mirëbesim. Gjykata i ngarkon me përgjegjësi kur ato pengojnë zhvillimin normal të procesit gjyqësor.
- Palët kanë detyrë të paraqiten para gjykatës që të parashtrojnë pretendimet e kundërshtimet e tyre por mosparaqitja nuk është detyrë procedurale pasi nuk sjell sanksione. Në rast mosparaqitje të paditësit nuk pushohet gjykimi ndërsa në rast mosparaqitje të të paditurit zhvillimi i gjykimit kryhet në mungesë.
- Palët janë të detyruara të respektojnë datën dhe orën e seancës në rast se duan të jenë prezent.
- Palët janë të detyruara të respektojnë njëra-tjetrën, të mos ndërhyjnë pa leje, të respektojnë gjykatën dhe të zbatojnë etikën e procesit gjyqësor.



# KAPITULLI VI: JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA

## *Seksioni I*

### **6.1. Juridiksioni gjyqësor**

Juridiksion vjen nga fjala latine *jus dicere* që do të thotë të deklarosh ligjin. Ky term është përdorur për të shpjeguar pushtetin dhe rolin që ka gjykata për të interpretuar, shqyrtuar dhe zbatuar ligjin.

Ndërsa fjala latine *jus dare* do të thotë të bësh ligjin dhe përdorej për të treguar pushtetin legjislativ për të bërë ligj.<sup>219</sup>

Në formacionet dhe shtetet moderne e drejta për të interpretuar dhe zbatuar ligjin, që nënkupton të drejtën për të gjykuar, i është dhënë pushtetit gjyqësor administrativ, i cili si pushtet është pushtet i ndarë dhe i pavarur nga dy pushtetet e tjera duke u bazuar kështu në parimin e sanksionuar si në akte ndërkombëtare ashtu dhe në aktet kombëtare (Kushtetuta apo ligjet përkatëse).

Në vendin tonë, Kushtetuta dhe ligjet e veçanta i kanë njohur këto tre pushtete si pushtete të ndara duke i'u njohur funksione të përcaktuara dhe në raste të caktuara zgjidhjen e çështjeve ose mosmarrëveshjeve që kanë lidhje me funksionet e tyre.

**Në vetvete, fjala *Juridiksion*, përdoret për të përcaktuar rrethin e çështjeve që në bazë të ligjit kanë të drejtë të zgjedhin organet e një sistemi.**<sup>220</sup>

Shtirja ose rrethi i çështjeve të juridiksionit administrativ gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, del nga kuptimi i pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së

---

<sup>219</sup> A.Bрати, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.51.

<sup>220</sup> A.Bрати, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.51

Shqipërisë në të cilën parashikohet se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj.<sup>221</sup>

Juridiksioni gjyqësor ndahet në:

- Juridiksion kushtetues
- Juridiksion gjyqësor i përgjithshëm
- Juridiksion gjyqësor i veçantë

Duke iu referuar nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kuptohet qartë se gjykimi i çdo procesi që ka lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive si dhe interesave kushtetuese dhe ligjore apo gjykimi i çdo lloj akuze i nënshtrohet një shqyrtimi gjyqësor nga gjykata.<sup>222</sup>

---

<sup>221</sup> A.Brati, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.51

<sup>222</sup> neni 42\2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

## 6.2. Juridiksioni gjyqësor administrativ

Ligji Nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, parashikon se në juridiksionin e gjykatave administrative hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet administrative dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë ligj.

Kjo tregon se juridiksioni gjyqësor administrativ është juridiksion i përgjithshëm, pasi përfshin shqyrtimin e të gjitha çështjeve administrative dhe nuk përcakton përjashtim prej tij.<sup>223</sup>

Gjithashtu duke iu referuar nenit 1 të LGJA, ky i fundit ka për objekt:

- a) *organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative si dhe statusin e gjyqtarëve që shërbejnë në to;*
- b) *juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative;*
- c) *parimet dhe procedurën e gjykimit, palët në proces dhe personat e tjerë në gjykimin administrativ;*
- ç) *vendimet gjyqësore administrative dhe ekzekutimin e tyre.*<sup>224</sup>

Juridiksioni gjyqësor administrativ ka për objekt marrëdhëniet juridike të natyrës publike nga të cilat lindin të drejta subjektive dhe interesa të ligjshme në favor të mbajtësit të saj.

---

<sup>223</sup>Ligji nr 49\2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”

<sup>224</sup> neni 1 i LGJA

E thënë në mënyrë subjektive, është juridiksioni mbi të drejtat, liritë, interesat kushtetuese dhe ligjore dhe ka për objekt të tij specifik deklarimin, garantimin dhe përmbushjen e të drejtave që i takojnë subjekteve në marrëdhëniet reciproke të tyre.<sup>225</sup>

---

<sup>225</sup> A.Bрати, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.53

### **6.3. Kufijtë e juridiksionit administrativ**

Juridiksionit administrativ, i janë vënë disa kufij të cilët:

- a) lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
- b) Kundrejt administratës publike.

Kjo ka në lidhje me aktet administrative të Këshillit të Ministrave si dhe institucioneve të administratës publike qendrore apo vendore me karakter normativ me përjashtim të rasteve kur çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe interesat e ligjshme të personave fizik dhe juridik.

Duke mos harruar se kufijtë kundrejt administratës publike janë vendosur edhe në lidhje me aktet administrative të cilat kanë rregullim të veçantë, sidomos ato që lidhen me emërimin dhe shkarkimin e funksionarëve publikë por edhe aktet të cilat sipas Kushtetutës janë kompetencë e Gjykatës Kushtetuese.

Këto kufij tregojnë qartë se asnjë gjykatë e pushtetit gjyqësor nuk ka juridiksion për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

#### 6.4. Juridiksioni gjyqësor civil kundrejt juridiksionit administrativ

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në bazë të parimeve në ndarjen dhe balancimin e pushteteve, ka treguar se me anë të ligjeve të ndryshme, iu ka njohur pushteteve juridiksion në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me funksionin e tyre.

Kodi i Procedurës Administrative i ka njohur pushtetit ekzekutiv dhe organeve të administratës publike qendrore e vendore juridiksion mbi aktet administrative me të cilët realizojnë veprimtarinë e tyre.<sup>226</sup>

Në Kushtetutë sanksionohet edhe parimi i shtetit ligjor krahas parimit të ndarjes së pushteteve. Kjo tregon se veprimtaria e administratës publike, qendrore dhe ajo vendore, rregullohet nga e drejta e cila përcakton qëllimet dhe rregullon mënyrat dhe format e kësaj veprimtarie. Parimi i shtetit të së drejtës sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës, parim i cili shprehet edhe në nenin 9 të K.Pr.C.<sup>227</sup>

Parimi i ndarjes së pushteteve dhe i shtetit ligjor nënkupton se veprimtaria e organeve të administratës publike rregullohet nga ligji dhe se veprimtaria e saj i nënshtrohet kontrollit gjyqësor i cili siguron zbatimin dhe respektimin e ligjit nga këto organe.

Kjo gjendet e shprehur në nenin 42 të Kushtetutës, në Kodin e Procedurave Administrative si dhe në nenet 324-333 të K.Pr.Civile.<sup>228</sup>

Administrata publike lidhur me ekzekutimin e akteve të saj e siguron vetë me mekanizmat e saj ligjorë, ndërsa kur hyn në marrëdhënie me subjekte të tjera, në

---

<sup>226</sup> Kodi i Procedurave Administrative

<sup>227</sup> neni 9 i Kodit të Procedurës Civile

<sup>228</sup> Neni 18 i K.Pr.A dhe nenet 324-333 K.Pr.A

marrëdhënie të së drejtës private, ajo gjendet e barabartë me këto subjekte duke vepruar edhe në rrugë gjyqësore si çdo subjekt tjetër i së drejtës.

Megjithëse shumë akte administrative mund të çënojnë të drejtat dhe interesat e subjekteve, jo të gjithë aktet administrative mund të kundërshtohen në gjykatë si, psh:

- a- Aktet administrative që kanë karakter normativ me përjashtim të rasteve kur çënojnë liritë dhe të drejtat themelore të personave fizik ose juridik.
- b- Aktet administrative që kanë rregullim ligjor të posaçëm dhe kanë të bëjnë me emërim dhe/ose shkarkim funksionarësh publik.
- c- Aktet administrative të cilët Kushtetuta ia lë për kompetencë Gjykatës Kushtetuese.<sup>229</sup>

Aktet administrative me anë të të cilëve realizohet veprimtaria administrative ndahen në akte normative dhe individuale ku këto të fundit mund të kundërshtohen në gjykatë nga personi i interesuar, ndërsa ato normative kundërshtohen në gjykatë vetëm kur çënojnë liritë dhe të drejtat themelore si dhe interesat e ligjshme të personave fizik dhe juridik.

Kodi i Procedurës Civile përcakton raportin midis juridiksionit administrativ dhe juridiksionit gjyqësor<sup>230</sup>.

Juridiksioni administrativ e pengon gjykatën në shqyrtimin e themelit ndërsa juridiksioni gjyqësor është pengesë për fillimin dhe vazhdimin e procedimit administrativ nga organet e administratës publike.

Kontrolli gjyqësor i një akti administrativ ndodh vetëm pasi është konsumuar rruga administrative.<sup>231</sup>

---

<sup>229</sup> neni 326 i Kodit të Procedurës Civile

<sup>230</sup>Nenet 59 dhe 36 të Kodit të Procedurës Civile

## 6.5. Kundërshtimi i juridiksionit administrativ në procesin gjyqësor

Në nenin 9 të LGJA përcaktohet e drejta e gjykatës që, edhe kryesisht, dhe në çdo fazë apo shkallë gjykimi, shqyrton nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor administrativ.<sup>232</sup>

Kjo tregon se juridiksioni administrativ kryesisht shqyrtohet nga çdo lloj gjykate që e shqyrton dhe ajo mund të shqyrtohet edhe kryesisht duke treguar se shqyrtimi i saj del përtej interesave të palëve ndërgjyqëse. Kjo sepse juridiksioni është i lidhur me elementë që kanë të bëjnë me administrimin e drejtësisë, me të drejtën për një proces të drejtë dhe të rregullt gjyqësor konform nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>233</sup>

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimin e datës 24.09.1994, Seria A, Nr.296-B në Çështjen Beaumartin kundër Republikës së Francës, shprehet se *vetëm një institucion që ka juridiksion të plotë dhe përmbush një numër kushtesh, si pavarësia nga ekzekutimi dhe nga palët, meriton të konsiderohet gjykatë brenda kuptimit të nenit 6.*<sup>234</sup>

Kjo tregon se, në një kërkesë të rëndësishme paraqitet edhe pasja e juridiksionit nga gjykata e cila shqyrton një mosmarrëveshje konkrete.

Duke qenë se qenia ose jo e juridiksionit është e lidhur më elementët e administrimit të mirë të drejtësisë dhe jo me interesat e ngushta të palëve, shqyrtimi i tij bëhet duke iu shmangur parimit të shqyrtimit të çështjes brenda objektit të gjykimit, sipas nenit 9 të LGJA, parime të cilat janë vënë në mbrojtje të interesave të palëve.

---

<sup>231</sup>Neni 328 i Kodit të Procedurës Civile

<sup>233</sup>Vendimi i datës 24.09.1994 Seria A nr.296-B në Çështjen Beaumartin kundër Republikës së Francës

<sup>234</sup>A.Bratî, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.62



Fakti që shqyrtimi i juridiksionit bëhet edhe kryesisht, nuk përjashton mundësinë e shqyrtimit të juridiksionit nga gjykata me kërkesë të palëve. Kjo është një e drejtë e cila parashikohet në nenin 9 të LGJA në të cilin përcaktohet se nëse një institucion shtetëror pretendon se mosmarrëveshja e pranuar nga gjykata për shqyrtim hyn në juridiksionin administrativ, atëherë mosmarrëveshja zgjidhet sipas një kërkesë nga Gjykata e Lartë.<sup>235</sup>

Kërkesa e palëve për shqyrtimin e çështjes së juridiksionit, nëse gjykata nuk e ka shqyrtuar kryesisht dhe palët nuk e kanë pretenduar një kërkesë të tillë, mund të shqyrtohet me ose pa kërkesë të palëve por edhe kryesisht nga Gjykata Administrative e Apelit si dhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë si në Dhomën e Këshillimit ashtu edhe në çdo fazë të gjykimit.

Nëse çështja e mungesës së juridiksionit rrëzohet nga gjykata, kërkesa për nxjerrje jashtë juridiksioni konsiderohet si vendim i ndërmjetëm dhe ndjek rrugën e ankimit me vendimin përfundimtar, ndërsa nëse një çështje nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, një vendim i tillë e pengon gjykatën që t'i futet shqyrtimit të themelit të çështjes.

Në këtë rast gjykata mund të marrë vetëm masë sigurimi padie dhe gjykimi pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin, pasi gjykata disponon me një vendim jo-përfundimtar i cili ka të drejtë ankimi të veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

---

<sup>235</sup> po aty

Kjo tregon qartë rëndësinë e gjykimt të çështjes së juridiksionit nga ana e gjykatës brenda afateve mjaft të shkurtra/prekluzive, kjo edhe nga Gjykata e Lartë pasi në rast zvarritje ka pasoja të zvarritet edhe gjykimi i vetë themelit të çështjes.

Ankimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë e detyron këtë gjykatë që brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së dosjes të shqyrtojë ankimin duke shmangur procedurat normale me kalim nga dhoma e këshillimit. Në rast se nga kjo gjykatë vendoset pranimi i juridiksionit gjyqësor atëherë i hapet rrugë gjykimit të themelit të çështjes nga gjykata që e ka regjistruar çështjen pa e paragjykuar atë.

## *Seksioni II*

### **6.6. Kuptimi i kompetencës**

Brenda sistemit gjyqësor, ushtrimi i juridiksionit gjyqësor në bazë të rregullave dhe kufijve ligjorë, është ndarë në mënyrë që çdo gjykatë ka një pjesë të juridiksionit gjyqësor administrativ që nënkupton kompetencën e saj.

Ndaj, **me kompetencë** kuptohet sasia e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj, konkretisht Gjykatës Administrative, asaj të shkallës së parë, Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Kompetenca në vetvete përcakton për çdo gjykatë të veçantë në çfarë rastesh dhe në lidhje me çfarë mosmarrëveshesh ajo ka pushtet për të gjykuar duke përcaktuar në mënyrë abstrakte rrethin e mosmarrëveshjeve që i është njohur e dhënë asaj për të gjykuar.<sup>236</sup>

Për çdo çështje administrative që ka lidhje me një mosmarrëveshje ka të paktën një gjykatë kompetente për shqyrtimin e saj. Por në mjaft raste mund të jenë kompetente dy ose më shumë gjykata. Kjo tregon se kemi të bëjmë me **kompetencë konkurruese** por ama një detyrimisht është kompetente për çdo rast konkret.

Kompetenca, në vetvete është një parakusht procedural, pasi ajo është kusht i domosdoshëm për vlefshmërinë e procesit dhe të akteve. Pra, një gjykatë jo kompetente nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural sepse ajo duhet detyrimisht të deklarojë moskompetencën e saj për shqyrtimin e çështjes.

---

<sup>236</sup> A.Bratî, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.80

Shqyrtimi i kompetencës për shqyrtimin e çështjes ngrihet ose kundërshtohet nga palët para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave.

Por pavarësisht kësaj, Ligji i jep të drejtë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që të zgjidhë mosmarrëveshjen mes Gjykatës që ka dhënë vendimin dhe Gjykatës që pretendon kompetencën.

Ky vendim merret në një dhomë këshillimi të përbërë nga 5 gjyqtarë brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së akteve ose e rregjistrimit të dosjes. Vendimi i komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje si dhe palëve.<sup>237</sup>

Në nenin 13/3 të LGJA, parashikohet se kur gjykata konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe dërgon aktet në gjykatën kompetente.

Kjo çështje që dërgohet nga një gjykatë e së njëjtës shkallë ose e një gjykate të një shkalle më lartë duhet të pranohet dhe të shqyrtohet nga gjykata të cilës i dërgohet.

Kur ka mosmarrëveshje mes dy ose me shumë gjykatave të cilat në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin në shqyrtim të njëjtën çështje administrative, gjykata me kërkesë të palëve ose kryesisht, ngre çështjen e mosmarrëveshjes me vendim të arsyetuar të Gjykatës së Lartë e cila vendos përfundimisht lidhur me rregullimin e kompetencës, referuar nenit 13/6 të LGJA.<sup>238</sup>

Kompetenca përcaktohet në momentin e ngritjes së kërkesë padisë duke iu referuar gjendjes faktike që ekziston në momentin e ngritjes së kërkesë padisë.

---

<sup>237</sup> Neni 13 i Ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

<sup>238</sup> Po aty

Pra, nuk kanë rëndësi se si ndryshojnë rrethanat në momente të mëvonshme të cilët mund të sjellin mungesën e kompetencës për gjykatën. Kjo nënkutpon se për një kërkesë padi, kriter për përcaktimin e kompetencës tokësore është se padia ngrihet në vendin ku ndodhet i padituri dhe një gjendje e tillë i referohet situatës faktike në momentin e ngritjes së padisë. Në këtë rast kompetenca nuk do ndryshojë nëse i padituri gjatë gjykimit ndodh të ndryshojë vendodhjen e tij.

Por edhe parimi i ekonomisë gjyqësore lejon që gjykata jokompetente të mundet të shqyrtojë çështjen nëse kompetenca i arrihet gjatë shqyrtimit të çështjes pavarësisht nëse në fillim i mungonte.

## 6.7. Kriteret e ndarjes së kompetencës

Ndarja e kompetencës mes gjykatave realizohet nga ana e Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrveshjeve administrative” në drejtim vertikal dhe në drejtim horizontal të cilët në alternim me njëri tjetrin tregojnë se kush është gjykata kompetente gjatë shqyrtimit të një mosmarrëveshjeje konkrete.

Duke iu referuar **drejtimit vertikal**, kjo ndarje e kompetencave bazohet në kriterin e natyrës së çështjes, ndërsa kriteri i territorit i shërben ndarjes sipas **drejtimit horizontal**.

Duke iu referuar drejtimit vertikal nënkuptohet ndarja e çështjeve me trupa gjykues me një ose tre gjyqtarë në rastin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit kemi përherë një trup të përbërë nga tre gjyqtarë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon me pesë gjyqtar, në përjashtim të rasteve kur LGJA parashikon ndryshe. Për të realizuar këtë ndarje çështjesh i referohemi natyrës së padisë pa iu referuar vlerës së saj.<sup>239</sup>

Ndërsa po t’i referohemi ndarjes në drejtim horizontal shpërndarja e çështjeve realizohet midis gjykatave të vendosura në vende të ndryshme të territorit të vendit tonë.

Shpërndarja e kompetencës mes gjykatave e sidomos krijimi i Gjykatës Administrative duke funksionuar edhe në bazë të ligjit të posaçëm, i cili është realizuar për t’i shërbyer mirëfunksionimit të dhënies së drejtësisë brenda një kohe relativisht të shpejtë, është kryer në bazë të këtij ligji në të cilin janë përcaktuar afatet

---

<sup>239</sup> Neni 12 i Ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”

dhe shpejtësia e gjykimit në të tre shkallët e gjykimit. Për këto arsye, shpërndarja e kompetencave është e pashmangshme.

Gjatë shpërndarjes së kompetencave duhet mbajtur parasysh fakti se kompetenca e Gjykatës Administrative është e kufizuar në dy raste<sup>240</sup>.

Rasti kur mosmarrëveshjet kanë lindur për shkak të një akti nënligjor që sipas Kushtetutës janë kompetencë e vet Gjykatës Kushtetuese si edhe rastet kur sipas ligjit mosmarrëveshja duhet të zgjidhet nga një gjykatë tjetër që nuk është Gjykata Administrative.

Sa më sipër, i referohemi ndarjes së kompetencës përse i përket gjykimit në shkallë të parë të çështjes (në numër dhe për territor të barabarta me ato të gjykatave të apelit civil) ndërsa lidhur me gjykimin në Shkallë të Dytë bëhet direkt nga vendi i Gjykatës së Apelit (një në Tiranë) e parapërcaktuar me dekret të Presidentit.

---

<sup>240</sup>Sokol Sadushi, “Gjykata Administrative dhe Kontrolli Ligjor mbi Administratën”, Botimet Toena, Tiranë, 2014, fq. 200.

## 6.8. Kompetenca duke iu referuar natyrës së çështjes

**Kompetenca sipas natyrës së çështjes merr në konsideratë natyrën e çështjes dhe nuk merr në konsideratë vlerën e padisë.**

Neni 12 i LGJA parashikon se: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë gjykon me një gjyqtar dhe në raste përjashtimore edhe me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë<sup>241</sup>, mosmarrëveshjet lidhur me kontratat administrative publike dhe kërkesat e paraqitura në zbatim të shkronjave "d" dhe "dh" të nenit 7 të LGJA.<sup>242</sup>

Kjo tregon se kur kemi të tilla çështje gjykimi, në gjykatën e shkallës së parë, trupi gjykues është i përbërë gjithmonë nga tre gjyqtarë. Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.<sup>243</sup>

Gjykatat administrative janë kompetente për:

- a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;
- b) mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimit të organit publik;
- c) mosmarrëveshjet e kompetencave ndërmjet organeve të ndryshme administrative në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative;

---

<sup>241</sup>Neni 12 i ligjit

<sup>242</sup>Neni 7 shkronja d dhe dh e ligjit

<sup>243</sup>Po aty



- ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike;
- d) kërkesat e paraqitura nga organet administrative për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, për të cilat ligji parashikon heqjen e lirisë deri në 30 ditë, si një lloj të dënimit administrativ për kundërvajtësin;
- dh) kërkesat e paraqitura nga kundërvajtësit për zëvendësimin e dënimit administrativ me heqje lirie deri në 30 ditë me dënimin me gjobë.

## 6.9. Kompetenca tokësore ose territoriale

Kjo kompetencë realizon ndarjen e çështjeve mes gjykatave me trupa gjykues të vendosura në pjesë të ndryshme të territorit duke iu referuar dy parimeve kryesore që janë:

- *Së pari:* për të lehtësuar dhe për të bërë komode mbrojtjen e palëve dhe në mënyrë të veçantë atë të të paditurit.
- *Së dyti:* që për kategori të veçanta mosmarrëveshjesh procesi të zhvillohet përpara një gjykate, vendodhja e së cilës ta ndihmojë të ushtrojë funksionet e saj në mënyrën më efikase.<sup>244</sup>

Nga kjo kuptohet se kemi të bëjmë me dy lloje kompetencash territoriale dhe konkretisht;

- kur ajo përcaktohet nga motivi i parë kompetenca mund të shmanget dhe të ndryshohet nga palët,
- ndërsa kur ajo përcaktohet nga motivi i dytë kompetenca është e pandryshueshme dhe e pashmangshme pasi ajo mund të quhet si kompetencë tokësore ose territoriale funksionale.

Parimisht përcaktohet në LGJA se **kompetente nga pikpamja tokësore është gjykata ku ndodhet qendra e organit publik si palë e paditur.**

Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet, ka selinë dhe funksionimin e saj.

---

<sup>244</sup> A.Bratî, "Procedura Civile", "DUDAJ", Tiranë 2008, fq.87

Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, kërkesë-padia ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë. Kjo si rrjedhojë e ndjekjes dhe ezaurimit të rrugës administrative në shkallë hirarkike deri në ezaurimin e plotë të ankimit administrativ në organin më të lartë.

Në nenin 11 të LGJA sanksionohet rasti kur kompetenca tokësore nuk mund të përcaktohet në mënyrat e parshikuara nga ligji në bazë të llojit të padive, atëherë kompetente është gjykata në territorin e së cilës ka qendrën organi publik i paditur.<sup>245</sup>

Paditë për marrëdhëniet e punësimit shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, që përfshin territorin (kompetenca tokësore), ku punëmarrësi kryen zakonisht punën e tij.

Paditë për mosmarrëveshjet administrative, që kanë për objekt mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm, që rrjedhin nga sendet e paluajtshme dhe që kanë të bëjnë me shfuqizimin e aktit administrativ, në konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ, etj. shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë që përfshin territorin në të cilin ndodhet sendi ose pjesa më e madhe e tij.

Paditë për mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, përveç sa është parashikuar në këtë ligj, shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, që përfshin territorin ku paditësi ka banimin ose vendqëndrimin.

---

<sup>245</sup>Neni 11 i ligjit

Lidhur me këto lloje padish është bërë një përcaktim i tillë sa i takon kompetencës në mënyrë që të zhvillohet përpara një gjykate, vendodhja e së cilës të mundësojë që ajo të ushtrojë funksionet e saj në mënyrë sa më efikase.

Kjo kompetencë nuk mund të ndryshohet apo të shmanget e as të kundërshtohet nga palët kur ka filluar shqyrtimi gjyqësor i provave pasi mund të konsiderohet si kompetencë tokësore. Ndërsa kundërshtimi i kompetencës territoriale funksionale mund të ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje apo shkallë të gjykimit.<sup>246</sup>

Sa i përket kompetencës vlen të theksohet se për mosmarrëveshje administrative të parashikuara në LGJA ka të paktën një gjykatë kompetente administrative të shkallës së parë të pushtetit gjyqësor. Por ky parim nuk përjashton që në mjaft raste për një çështje konkrete të jenë kompetente dy ose më shumë gjykata sa i përket kompetencës tokësore. Dhe në raste të tilla kemi të bëjmë me **kompetencë konkurruese**.

Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili vendos në Dhomë Këshillimi me 3 gjyqtarë brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve. Vendimi u njoftohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje dhe palëve.

Gjykata kompetente në aspektin e kompetencës tokësore për gjykimin e padive me anë të të cilave kërkohet ekzekutimi i detyrueshëm përcaktohet nga objekti i padisë.

Kur objekti i padisë lidhet me sende, paditë për ekzekutim të detyrueshëm ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre.<sup>247</sup>

Në ato raste, kur kemi të bëjmë me padi për ekzekutimin e një detyrimi për të kryer ose moskryer një veprim të caktuar, paditë për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm ngrihen në gjykatën e vendit ku duhet të përmbushet detyrimi.

---

<sup>246</sup> Neni 13 Ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”

<sup>247</sup>Neni 11/3 i ligjit

## **6.10. Kundërshtimi i kompetencës**

Kompetenca në vetvete është një parakusht/mjet procedural që nënkupton se është i domosdoshëm për vlefshmërinë e vetë procesit dhe të akteve të dala prej tij.

Kjo tregon qartë se një gjykatë jo-kompetente nuk mund të kryejë asnjë veprimtari procedurale dhe duhet të deklarojë moskompetencën e saj pasi shqyrtimi i kompetencës fillon që në seancë përgatitore.

Ashtu si kundërshtimi i juridiksionit edhe kundërshtimi i kompetencës mund të bëhet nga ana e palëve por edhe kryesisht nga gjykata.

Nëse objekt shqyrtimi gjyqësor janë kundërshtimi i kompetencës dhe pretendimet lidhur me mungesën ose jo të saj atëherë fati i procesit gjyqësor dhe i mënyrës së kundërshtimit të padisë së themelit do të varet nga vendimi që do marrë vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në shqyrtimin gjyqësor të çështjes së kompetencës.

Nëse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e rrëzon kërkesën për deklarim moskompetence të kërkuar nga palët atëherë dërgohet çështja në gjykatën kompetente. Ndërsa, nëse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton moskompetencën e saj për gjykimin e çështjes dhe vendos deklarimin e moskompetencës së saj, gjykata merr një vendim përfundimtar dhe ia dërgon çështjen gjykatës kompetente e cila duhet ta marrë në shqyrtim atë. Por nëse kjo e fundit ka pretendime lidhur me kompetencën atëherë mund t'i drejtohet Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për të bërë përcaktimin e gjykatës kompetente por kjo pa ndërprerë shqyrtimin e çështjes.

Gjykata e Lartë përveç rregullimit të kompetencës, në raste të tilla jep edhe udhëzime për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata kompetente.

Lidhur me moskompetencën Gjykata e Lartë gjykon në këto raste:

1. *Kur vendimi i moskompetencës së gjykatës që shqyrton çështjen nuk pranohet dhe kundërshtohet nga palët në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë atëherë e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi është i veçantë dhe afati i ankimit është brenda 5 ditëve. Në këtë rast, ushtrimi i kësaj të drejte ankimi e pezullon gjykimin e çështjes nga gjykata.*
2. *Kur vendimi i moskompetencës që ka vendosur moskompetencën e saj dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, atëherë gjykata duhet ta pranojë për shqyrtim çështjen por pa e ndërprerë gjykimin e saj. Gjykata në këtë rast ka të drejtë t'i paraqesë qëndrimin e saj Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ku kjo e fundit vendos për rregullimin e kompetencës (neni 13/5). Nga ana e saj Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e shqyrton ankimin brenda 10 ditëve nga dita e ardhjes së çështjes për gjykim.* <sup>248</sup>

Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep edhe udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohej kompetente. <sup>249</sup>

Duke iu referuar nenit 13 të LGJA, çështja e kompetencës hyn në kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të çështjes nga Gjykata e Lartë, edhe nëse ajo nuk është paraqitur atje për këtë arsye, por për arsye rekursi të zakonshëm.

Në këtë rast Gjykata e Lartë vendos në bazë të nenit 13 të LGJA prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente.

---

<sup>248</sup>Neni 13/5 e ligjit

<sup>249</sup>Neni 13/6 e ligjit

## **6.11. Kompetencat e gjyqtarit administrativ**

**Me kompetencë kuptojmë të drejtën dhe detyrimin e gjyqtarit që të marrë një vendim duke u bazuar në ligj.**

### **Kontrolli Objektiv dhe Kontrolli Subjektiv**

Për të trajtuar **kontrollin objektiv do marr si shembull rastin e Francës** dhe padinë për tejkalim pushteti. Këtu gjyqtari ka në kompetencën e tij të shqyrtojë vetëm ligjshmërinë e vendimit dhe nuk i futet çështjes në themel për të parë a ka ardhur ndonjë dëm e për rrjedhojë shkelje e të drejtës subjektive.

Në lidhje me **kontrollin subjektiv dhe trajtimin e tij do mar si shembull rastin e Gjermanisë**, ku gjyqtari administrativ në ndryshim nga gjyqtari i Francës nuk shqyrton vetëm ligjshmërinë e vendimit, karakterestikë e sistemit objektiv, por shkon më tej për të parë nëse ka ardhur një dëm nga ky vendim, pra a ka shkelje të së drejtës subjektive si pasojë e paligjshmërisë së aktit.

Nëse gjatë shqyrtimit gjyqtari konstaton se akti është i paligjshëm dhe nuk ka ardhur një shkelje e së drejtës subjektive por vetëm asaj objektive, atëherë gjyqtari nuk e anulon aktin, karakteristikë kjo e vendeve që vënë në plan të parë të drejtat e njeriut dhe jo zbatueshmërinë e ligjit siç bën Franca.

### ***Po ligji administrativ shqiptar çfarë sistemi ka përkrahur?***

Në pamje të parë duket sikur ka përkrahur sistemin objektiv pra vihet në radhën e shteteve që kanë përkrahur sistemin Francez të kontrollit gjyqësor. Kjo sepse në ligj thuhet se gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit.

Por, ligji, në lidhje me subjektet që legjitimohen për të ngritur padi dhe kushtet që duhet të ekzistojnë për të ngritur padinë, ka parashikuar se duhet të ndodhemi përballë shkeljes së një të drejte subjektive apo interesi të ligjshëm.

**Ky parashikim është një lajthim juridik sepse nuk mundet që sistemi subjektiv (*e drejta subjektive*) dhe ai objektiv (*konrolli ligjshmërisë*) të qëndrojnë së bashku për shkak të karakteristikave që mbartin.**

Interesi subjektiv nënkupton një dëm që ka ardhur nga vendimi administrativ e për rrjedhojë të jetë shkelur e drejta subjektive dhe nuk mund të jetë objekt kontrolli nga ato gjykata që kanë në kompetencë vetëm kontrollin e ligjshmërisë së vendimeve (*sistemi objektiv*).

Andaj mendoj se nëse ky ligj do përkrahë sistemin objektiv e për rrjedhojë kontrollin e ligjshmërisë së aktit duhet të hiqet termi *e drejta subjektive* dhe të lihet vetëm interesi i ligjshëm që korrespondon me sistemin objektiv.



## KONKLUSIONE

Krijimi i Gjykatës Administrative është derivate jo vetëm i nevojës së domosdoshme për zgjidhje të konflikteve administrative të shtuara së fundmi në sasi por njëkohësisht është një nga shtyllat kryesore të Reformës që po realizohet në Drejtësinë Shqiptare.

Krijimi i Gjykatave Administrative është arritur nëpërmjet organizimit të juridiksionit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe synimi i saj final ka qenë rritja e eficiencës dhe efektiviteti në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

Është e qartë nga shtjellimet e trajtuara në këtë punim se nuk ka një zgjidhje ideale, domethënë, një sistem gjyqësor efektiv me sa më pak shpenzime apo që të ketë gjykatë me juridiksion të plotë në çdo rreth dhe në të njëjtën kohë gjyqtarë shumë të specializuar.

Zgjidhja më e mirë e mundshme është kompromisi në balancimin e drejtë të interesave të kundërt duke marrë parasysh mundësinë e realizimit në praktikë. Krijimi i gjykatave autonome administrative është zgjidhja e duhur me qëllim garantimin që çështjet që i përkasin një fushe specifike të juridiksionit të gjykohen vetëm nga gjyqtarët e specializuar në këtë fushë.

Sa i takon ndjekjes së rrugës administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, LGJA ka parashikuar se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ dhe në të njëjtën kohë tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët, eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ.

Përveç rrugës së ankimit administrativ, unë do të rekomandoja edhe ndërfutjen e rolit të Ndërmjetësit në zgjidhjen e konflikteve administrative. Ndërmjetësi Ligjor si një figurë e re në drejtësinë shqiptare, u krijua në kuadër të Refomës në Drejtësi për të ndihmuar gjyqësorin në minimizimin e numrit të çështjeve të cilat shkojnë deri në Gjykatë, qoftë civile, qoftë administrative. Pra, mendoj që kjo mungesë e bën LGJA të çalët në rezultate, rrjedhimisht edhe vet Gjykatën Administrative të mbingarkuar me çështje në shqyrtim. Fenomeni i mbingarkesës sjell ngërçin që aktualisht ka lindur pranë Apelit Administrativ, ndërkohë që nëse do të ndërfutej Ndërmjetësi Ligjor ndoshta nuk do të ishim në kushtet aktuale të gjyqësisë administrative.

Për më tepër, edhe vet procesi gjyqësor në gjykatën administrative të apelit po tregon që nuk është eficient pasi çështjet në këtë shkallë të gjyqësorit administrativ shqyrtohen pas më shumë se 1 viti nga dita që dërgohen në sekretarinë e saj. Njëkohësisht, edhe gjatë shqyrtimit të tyre, për kufizimin që i bëhet kontradiktoritetit (prezencës së palëve gjatë gjykimit dhe mundësisë që ato të shprehen) dhe për kthimin e tij vetëm në leximin e akteve, përfaqëson mangësi në krahasim me gjykimin në shkallë të parë, në të cilin gjyqtari ka një kontakt të drejtëpërdrejtë me marrjen e provave dhe burimin e tyre.

Pikërisht, këta dy faktorë (koha dhe leximi i procesverbaleve të seancave të shkallës së parë) na kanë sjellë sot në këtë ngërç gjyqësor në gjyqësinë administrative.

Gjithashtu, gjykata, kur shqyrton një çështje me objekt një akt administrativ, nuk mund të mjaftohet vetëm me verifikimin e faktit të mos-shqyrtimit të ankimit nga instancat kompetente administrative për ta nxjerrë këtë çështje jashtë juridiksionit gjyqësor. Ajo është e detyruar të verifikojë paraprakisht nëse ankimi administrativ

është paraqitur në përputhje me kriteret ligjore. Gjykata, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, mund ta realizojë vetëm kur rezulton se ankimi administrativ tek organi kompetent është paraqitur në kundërshtim me ligjin.

Zhvillimi i shtetit të së drejtës, shtroi si nevojë imediate vendosjen e modelit të mbikëqyrjes administrative i cili, pikërisht siç mendohej, po arrin të sigurojë mbrojtje të gjerë juridike në fushën e veprimtarisë administrative.

Mendohet njëkohësisht se ky mision, duke qenë se është në hapat e tij të para, do të mund të arrihet në rezultate të dëshiruara nga të gjithë, nëse bartës i mbikëqyrjes do të bëhet ndonjë trup e veçantë, pavarësia dhe autoriteti i së cilës do të sigurojnë që administrata në veprimtarinë e vet të sillet në kuadër të normave juridike të së drejtës pozitive.

Kërkesa për instalimin e gjyqësisë administrative nëpërmjet gjykatave administrative u mbështet në një numër faktesh ndër të cilat u theksua veçanërisht ajo se gjyqësia administrative nëpërmjet gjykatave administrative paraqet një formë e mënyrë shumë adekuate të mbrojtjes juridike, qoftë për shkak të profesionalitetit, qoftë për shkak të pavarësisë së tyre organizative. Natyrshëm që mbi këtë dhe mbi një numër faktesh të tjera, Bashkimi Europian i dha një rëndësi të madhe gjyqësisë administrative. Duket se dy momente janë me ndikim për rëndësinë që Bashkimi Europian i jep Gjykatave Administrative:

**Së pari**, shkakun se pjesa më e madhe e së drejtës përgjithësisht gjendet në kompetencën e gjykatave administrative.

**Së dyti**, për shkakun se vetë Bashkimi Europian i jep rëndësi të veçantë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së interesit publik.

Sipas juristëve dhe legjislatorit, instalimi i një gjykate administrative në Republikën e Shqipërisë ka bërë të mundur:

- ndikimin në rritje të kontrollit gjyqësor të organeve publike që shihet me shumë interes në gjyqësinë administrative.
- ndërtimin edhe të një modeli të veçantë të kontrollit gjyqësor përgjithësisht, me qëllim parësor zgjerimin dhe forcimin e tij.
- shtrirjen e ndikimit të parimit të ndarjes së pushteteve në vëllimin e kontrollit gjyqësor që shihet me shumë interes në proceset e demokratizimit të shoqërisë.
- garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve, me qëllim parësor sigurimin dhe forcimin e parimit të ligshmërisë në gjyqësinë administrative.

Jeta është dinamike, me zhvillime të menjëhershme duke sjellë marrëdhënie të ndryshme juridike, rrjedhimisht edhe konflikte e mosmarrëveshje. Ligji e ka të pamundur të parashikojë çdo rrethanë të mundshme ndaj praktika që do të dalë gjatë punës së Gjykatës Administrative do të na udhëheqë në ato rrethana për të cilat vazhdimësia do të na tregojë që duhen bërë ndryshime, me qëllimin e vetëm përsosjen e kësaj instance dhe hallke tejet të rëndësishme në drejtësinë shqiptare.

Në lidhje me shkallën e tretë, efektet e mundshme mbi Gjykatën e Lartë, në rastin e krijimit të një gjykate administrative autonome të shkallës përkatëse nuk mund dhe nuk duhet të diskutohet më tej për arsyet e dhëna më sipër.

Pra, sic shikohet, sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Drejtësisë janë rregulluar dy aspekte, si ai financiar duke instaluar gjykatë administrative vetëm atje ku ka qenë

immediate dhe tepër e nevojshme dhe nga ana tjetër nuk i është humbur rëndësia gjykatave civile nga kjo gjykatë e re e posaçme.

Për ta përmbledhur, krijimi i gjykatave administrative autonome mund të ketë një ndikim negativ mbi disa gjykata rrethi, por përgjithësisht jo thelbësor. Për pasojë, ky efekt nuk është një faktor përcaktues por duhet të merret parasysh dhe të balancohet me argumentet e tjera pro dhe kundër. Bie në sy që përqindja e çështjeve administrative është tepër e lartë në ato gjykata apeli që kanë një numër të plotë më të ulët çështjesh.

Kështu, efekti negativ mbi gjykatat e zakonshme në nivelin e apelit është një argument shtesë kundër krijimit të një gjykate administrative autonome në nivelin e apelit, gjë për të cilën unë do të isha kundër. Kjo duke u bazuar në argumentin se aktualisht prezenca e vetëm një gjykate apeli administrative nuk ka mundur të realizojë eficiencën dhe efektivitetin në zgjidhjen e konflikteve administrative por vetëm se kjo gjykatë është bërë fotokopje e gjykatës civile të apelit.

Pyetja tjetër e rëndësishme kërkimore se a është i kualifikuar gjyqtari shqiptar për realizimin me sukses të detyrës dhënë nga ligji për respektimin e të drejtave themelore kushtetuese sa i takojnë ruajtjes së një procesi të rregullt dhe ligjor, praktika na tregoi se nëpërmjet kualifikimeve, trajnimeve dhe dëshirës për përsosje, në Shqipëri po vendoset një praktikë e pasur e gjyqësisë administrative. Ritmet e përsosjes janë të ngadalta por ato hapa janë garancia e duhur në respektimin e shtetit ligjor.

## **Konkluzione të tjera**

Ligji sjell domosdoshmërinë e barazisë së interesit publik nga njëra anë me të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të personit nga ana tjetër.

Në kuadrin e marrëdhënies administrative ndërmjet personave dhe organeve publike synohet forcimi i rolit aktiv të organeve administrative për respektimin e të drejtave subjektive të personave.

LGJA garanton mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të personave nëpërmjet detyrimit që i vihet organeve publike të provojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre.

Në të njëjtën kohë, ky ligj në teori ka synuar thjeshtimin e procedurave përkatëse lidhur me gjykimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative ndërmjet personave dhe organeve publike por realisht në praktikë shikojmë një sasi të madhe të çështjeve administrative të ngecura “në rradhë” në dollapët e numrit tejet të vogël të gjyqtarëve të apelit administrative.

Pothuajse të gjitha vendimet për investime apo projekte për infrastrukturën, duhet të kalojnë përmes një procesi licencimi, i cili mund të bëhet subjekt i një shqyrtimi ligjor nga gjykatat administrative.

Gjykatat administrative mendohet se do të rrisin transparencën e vendimeve administrative duke luajtur një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishmja, kontrolli gjyqësor i veprimeve publike administrative nga një gjyqësor administrativ që funksionon mirë është – përveç pikëpamjes strikte ligjore të çështjeve individuale – edhe një forcë stimuluese për

modernizimin e administratës publike, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të saj dhe si pasojë, rrit besimin e qytetarëve për institucionet shtetërore.

LGJA sjell një risi në kuadrin e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative lidhur me detyrimin e organeve publike për të paraqitur provat që kanë mundësuar nxjerrjen e akteve apo kryerjen e veprimeve administrative që më pas kanë sjellë cënimin e të drejtave të ligjshme të personave. Ky ligj ofron parimin se Gjykata Administrative gjykon mbi aktet shkresore dhe mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.

LGJA cakton rregulla të detyrueshme për subjektet e gjykimit administrativ, organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore administrative si dhe organizimin e gjykatave administrative.

Shqyrtimi ligjor i vendimeve administrative nga gjykata të pavarura është një parim demokratik i pranuar, i pranishëm në praktikat kryesore evropiane dhe një kontribut i rëndësishëm për të siguruar rendin, veçanërisht për të mbrojtur të drejtat individuale përballë administratës. Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarive qeveritare e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor i veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve por edhe interesin publik dhe rendin ligjor.

Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë. Njëkohësisht, zgjerimi i sektorit publik dhe rritja e kompleksitetit të vendim-marrjes administrative ka një ndikim të dyfishtë: nga njëra anë ka sjellë forma të reja të aktivitetit administrativ dhe rritje të kërkesës për fleksibilitet të administratës në shërbim të interesit publik dhe nga ana tjetër efektet e një zgjerimi të tillë mbi jetën individuale janë duke u rritur vazhdimisht.

Në këto kushte, për të kundërpeshuar efektet, nevojitet një fuqi e mirë-konfiguruar vlerësimi për administratën dhe forcimi i kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë e veta. Kjo vendos përherë e më tepër në pikëpyetje qasjet tradicionale ndaj intensitetit dhe shtrirjes së shqyrtimit gjyqësor mbi aktivitetin e administratës.

Përveç kësaj nevojë të brendshme dhe natyrale për ta rishikuar qasjen tradicionale kemi edhe një numër përherë e më të madh parimesh ligjore që rregullojnë hapësirën evropiane ku këto të fundit po ndikojnë fuqishëm zhvillimet në fushën e kontrollit gjyqësor të administratës publike.

Këshilli i Europës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) kanë luajtur një rol të veçantë në përcaktimin e standardeve në kontrollin gjyqësor të veprimtarisë së administratës publike. Këshilli i Europës ka miratuar disa rekomandime dhe ka shpërndarë informacion, dokumente dhe studime mbi praktikën më të mirë edhe të vendimeve gjyqësore.

Këto vendime gjyqësore me fuqi ligjore po influencojnë shtetet anëtare të BE-së sikundër edhe vendet candidate. Shtjellimi në një kuptim më të gjerë të parimit të pritshmërisë së ligjshme, disa teknika që kanë ndezur debate si nocioni ligjor i



përgjegjësisë dhe kontrolli i fuqive diskreciale, i kanë të gjitha rrënjët në legjislacionin e shteteve anëtare. Në këto rrethana, një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare të BE-së si dhe disa vende candidate, janë duke rivlerësuar zgjedhjet organizative që kanë bërë si dhe rregullat procedurale të shqyrtimit gjyqësor mbi aktivitetet administrative. Elementët më të debatueshëm e të rëndësishëm të këtij rishikimi kanë të bëjnë me:

- fushën e veprimit të shqyrtimit gjyqësor në kuptimin e shtrirjes dhe intensitetit të këtij rishikimi;
- gjendja e pranueshmërisë për marrjen e një veprimi;
- kapaciteti për t'i çuar procedimet përpara gjykatave administrative;
- kufizimet kohore për fillimin e shqyrtimit gjyqësor në dritën e aksesit tek drejtësia;
- roli i gjykatësit;
- organizimi i drejtësisë administrative; dhe
- zbatimi efikas i vendimeve.

LGJA i miratuar në Shqipëri parashikon si gjykata kompetente për gjykimin e mosmarëveshjeve administrative 3 të tilla: Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Gjykatën e Apelit Administrativ dhe Kolegjin Administrativ në Gjykatën e Lartë.

Në organizimin e gjykatave administrative bëhet referenca me dispozitat e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor, me përjashtim të rastit kur në këtë ligj parashikohet ndryshe, sidomos në lidhje me kriteret e emërimit dhe të karrierës së gjyqtareve, statusit të tyre, përgjegjësia për shkeljet disiplinore, masat disiplinore, procedimi

disiplinor, administrimi i shërbimeve në gjykatë, riorganizimi gjyqësor dhe delegimi i gjyqtarëve.

Përsa i përket përbërjes së trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në ligj është parashikuar gjykimi me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar dhe trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykata e Apelit Administrativ gjykon me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë për paditë ndaj aktit nënligjor normativ dhe nga tre gjyqtarë për çështjet e tjera. Në ligj, parashikohen gjithashtu edhe kompetencat lëndore, funksionale dhe tokësore të Gjykatës Administrative.

Risi e sjellë nga ky ligj, për herë të parë në legjislacionin shqiptar është parashikimi i kompetencës funksionale sipas shkallëve të gjykimit. Për një gjykim sa më eficient dhe në mbrojtje të interesave të palëve, ligji ka parashikuar edhe kompetencën tokësore sipas territorit në të cilin organi administrativ ka kryer veprimin administrativ ose në territorin e të cilës ka qendrën organi administrativ.

Ligji parashikon gjithashtu edhe mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata Administrative, konkretisht ato që lidhen me aktet nënligjore normative që sipas Kushtetutës janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. Ose, ato për të cilat shqyrtimi është parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kompetencën e një gjykate tjetër si dhe ato në të cilat punëdhënësi është organi publik i barazuar. Në këtë rast është sjellë edhe nocioni i shpalljes së moskompetencës nëse pavarësisht sa është parashikuar në ligj padia është ngritur. Për dhënien e një gjykimi të drejtë dhe eficient LGJA parashikon edhe shmangien e konfliktit të kompetencave dhe jep mjetet për zgjidhjen e tij.

Ligji mbi mosmarrëveshjet administrative do të sigurojë një mbrojtje të gjerë (përfshirëse) ligjore ndaj të gjitha veprimeve administrative, pavarësisht formës së tyre (p.sh. veprime individuale ose karakteriale). Për më tepër dhe si një rregull, të

gjitha paditë që lidhen me çështje administrative do të përfshihen brenda kompetencave të gjykatës administrative.

Në kompetencat e gjykatave administrative përfshihen gjithashtu të ashtuquajturat “akte të qeverisë” dhe të gjitha aktet e bazuara në diskrecion.

Në çështje të përziera (p.sh. prokurimi publik) zgjidhja legislative në lidhje me juridiksionin e gjyqësorit administrativ ose të përgjithshëm është, në fund të fundit, një çështje teknike ose organizative (shpërndarja e ngarkesës së punës mund të jetë një kriter i arsyeshëm), për të cilën mund të vendoset në mënyrë pragmatike, sigurisht me kushtin që të gjitha degët e gjyqësorit të sigurojnë mbrojtje gjyqësore të barasvlershme.

Disa tipe çështjesh administrative (p.sh kontrolli i akteve normative të lëshuara nga qeveria qendrore ose nga vetëqeverisja vendore) janë vendosur sipas procedurave të gjykimit në shkallë të parë nga gjykata e apelit.

Gjykatat administrative do të shqyrtojnë plotësisht faktet dhe çështjet e ligjshmërisë që lidhen me veprimet dhe/apo aktet administrative që sjellin mosmarrëveshjet administrative. Ligji jo vetëm që do t’u sigurojë gjykatës administrative kompetencën për të anuluar aktet administrative të paligjshme (vendim anulimi) por edhe do t’i lejojë gjykatat për të vendosur detyrime ligjore mbi institucionet e administratës.

LGJA parashikon subjektet që legjitimohen për të ngritur padi në gjykatën administrative. Sipas tij, përfshihet:

- çdo person që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim administrativ;
- subjektet e të drejtës publike që pretendojnë se janë cënuar në ushtrimin e kompetencave nga një Akt Administrativ apo nga një Akt nënligjor normativ, i paligjshëm për të cilën kërkohet pavlefshmëria i tij, me

përfashtim të rastit kur akti është nxjerrë nga organi në varësinë administrative të të cilit është subjekti;

- subjektet e tjera të cilëve kjo e drejtë i njihet shprehimisht në ligjet e tyre të posaçme; si dhe
- punëmarrësi, për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punësimit të rregulluara nga Kodi i Punës, kur punëdhënës është një organ publik.

Ligji sjell si rregull të përgjithshëm ezaurimin e rekursit administrativ përpara paraqitjes së padisë në gjykatën administrative. Përfashtim bëjnë rastet kur vetë legjislacioni i posaçëm ku rregullohet marrëdhënia ndaj së cilës lindin mosmarrëveshjet nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar si dhe kur shprehimisht parashikohet e drejta për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë. Gjithashtu përfashtim bëjnë edhe rastet e paraqitjes së padisë nga personat të cilët nuk e kanë ezauruar rekursin administrativ por janë cënuar nga një akt administrativ që sjell pasoja për një grup më të gjerë njerëzish, i nxjerrë nga organet administrative, me kushtin që të jetë dhënë një vendim pas një rekursi administrativ të paraqitur nga një person i ndryshëm nga i pari.

Ligji parashikon gjithashtu edhe afate të përshtatshme për ngritjen e padisë pranë gjykatës administrative në përputhje me kushtet sociale në interes të individëve. Afatet kohore për ngritjen e padisë janë një kontribut i nevojshëm për sigurinë ligjore. Siguria ligjore ka një rëndësi të veçantë nëse organi publik sjell dobi për një person në mënyrë që ai/ajo të dijë nëse dhe për sa kohë e drejta që i është dhënë mund të kundërshtohet nga palë të treta. Si rrjedhim, personi që përfiton duhet të ketë të drejtë të fillojë një procedurë njoftimi për palët e treta. Limitet kohore të shqyrtimit gjyqësor të veprimeve administrative duhet të fillojnë kur individi i prekur njoftohet për

veprimin administrativ dhe informohet saktësisht për të drejtat e tij/saj në lidhje me ankimin ose apelin. Në disa raste, palët në një mosmarrëveshje administrative kanë interes në vonimin e procedurave, veçanërisht nëse kundërshtohen aktet administrative që përmbajnë një detyrim. Në raste të tjera, palët e humbin interesin për padinë. Në të dyja rastet, palët shpesh nuk i binden urdhrave të gjykatës, madje përpiqen me qëllim që ta ndalojnë gjykatën që të marrë një vendim final. Për t'i lejuar gjykatësit që t'i përballojnë çështje të tilla shpejt dhe me efikasitet, ligji sjell detyrimin e organeve publike për të paraqitur provat shkresore në bazë të të cilave është nxjerrë akti/veprimi administrativ. Pra, në kontekstin e mosmarrëveshjeve administrative, është barra e organeve publike që të provojnë ligjshmërinë e aktit të kundërshtuar normativ apo individual.

Përsa i përket kërkesave që duhet të plotësojë padia dhe aktet që i bashkëlidhen asaj, ligji referon në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile për rregullimin e këtyre çështjeve dhe konkretisht neneve 154 e 156 të tij<sup>250</sup>. Gjithashtu, këtu përcaktohen edhe detyrimet e paditësit në momentin e depozitimit të padisë si dhe veprimet për të cilat ai është i detyruar të kryejë.

LGJA përcakton rastin e shqyrtimit dhe bashkimit të disa padive në një padi të vetme kur ato i drejtohen të njëjtit organ publik që ka nxjerrë aktin apo veprimin administrativ, kanë të njëjtin objekt dhe janë në kompetencën e një gjykate.

Duke iu referuar parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, ligji përcakton një afat prej 3 ditësh nga data e paraqitjes së padisë për kryerjen e një sërë veprimesh përgatitore nga gjyqtari kryesues, veprime të cilat dokumentohen në procesverbalin e veprimeve përgatitore, që përpilohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet edhe nga gjyqtari kryesues.

---

<sup>250</sup>Neni 154 dhe 156 i Kodit të Procedurës Civile

Përsa i përket kërkesës për sigurimin e padisë, ligji parashikon që paditësi ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ dhe/apo marrjen e çdo mase tjetër të përkohshme e cila është e përshtatshme për mbrojtjen e interesave tij. Gjykata pranë së cilës ndodhet padia, vendos sigurimin e padisë nëse:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në akte me shkresë për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për paditësin;
- nuk çënohet rëndë interesi publik; si dhe
- kur paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar nga gjykata për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Në ligj përcaktohet se në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme, atëherë gjykata vendos edhe marrjen e masave të tjera të përkohshme. Kundër vendimit të gjykatës sipas rastit (për pranimin apo refuzimin e kërkesës) për sigurimin e padisë mund të bëhet ankimi i veçantë, i cili nuk pezullon ekzekutimin e masës së sigurimit dhe nuk përbën shkak për pezullimin e gjykimit të çështjes nga gjykata.

Duke iu referuar gjithashtu parimit të një procesi brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, ligji përcakton një afat prej jo më shumë se 10 ditësh nga dita e paraqitjes së padisë, (pas përfundimit të veprimeve të nevojshme përgatitore) për të nxjerrë urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, si dhe elementët përbërës të një urdhri të tillë.

Përsa i përket rregullave lidhur me zhvillimin e seancës gjyqësore, ligji përcakton të njëjtën procedurë dhe referimin në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, për atë që ato janë të pajtueshme me këtë ligj. Gjithashtu, përcaktohen rregulla më të detajuara lidhur me mosparaqitjen e palëve në seancë pavarësisht njoftimit të rregullt,

shqyrtimin e çështjes nga gjykata në seancë gjyqësore; paraqitjen e ekspertit në seancën gjyqësore; si dhe paraqitjen e parashtrimeve përfundimtare nga palët.

Ligji parashikon konceptin e **barrës së provës**, i cili është i ndryshëm nga ai analog në Kodin e Procedurës Civile ku parashikohet se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.

Në ndryshim nga ky koncept, LGJA parashikon se detyrimin për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ dhe veprimit tjetër administrativ, e ka organi publik që e ka nxjerrë atë (duke përfshirë këtu edhe mosmarrëveshjen që ka objekt gjykimi marrëdhënien e punës). Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet në të cilat bazon pretendimin e saj. Përsa i përket mosparaqitjes së provave nga organi publik, LGJA parashikon një procedurë konkrete e cila lidhet me një afat kohor të përcaktuar brenda të cilit duhet të paraqiten provat. Shkelja e pajustificuar e detyrimit për të paraqitur dokumentet nga organi publik edhe brenda afatit të caktuar përbën shkak që gjykata, edhe kryesisht, të caktojë gjobë ndaj titullarit të organit publik, gjobë e cila është e barabartë me 20% të pagës minimale në shkallë vendi për çdo ditë vonese.

Rregulla të detajuara ligji parashikon edhe në rastin e mosparaqitjes së provave nga organi publik në seancë gjyqësore brenda një afati të dytë të caktuar nga gjykata.

Gjykata ka të drejtë të caktojë gjobë (në masën 20% të pagës minimale në shkallë vendi për çdo ditë vonese) ndaj titullarit të organit publik kur shkelja e detyrimit për të paraqitur dokumentet nga organi publik edhe brenda afatit të caktuar, është e pajustificuar nga ana e organit publik. Përsa i takon shqyrtimit gjyqësor të provave të paraqitura, ligji thekson shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimit administrativ që kundërshtohet në bazë të provave të paraqitura nga palët, ndërsa në rastin e aktit nënligjor normativ gjykata shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ që kundërshtohet si edhe zbatimin e parimeve të përcaktuara nga ky ligj. Gjithashtu,

gjkata shqyrton nëse objektivi dhe qëllimi i ligjit në dhënien e mundësisë së zgjedhjes së Organit Publik është ndjekur nga ky i fundit edhe nëse zgjedhja nga organi publik është bërë vetëm për të arritur qëllimin e ligjit (këtu përfshihet rasti kur ligji i jep organit publik të drejtën për të vlerësuar e zgjedhur ndërmjet më shumë alternativave njësoj të ligjshme në nxjerrjen/kryerjen e një akti apo veprimi tjetër administrativ).

Lidhur me mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punësimit procedura e mësipërme, përcaktohet të rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Përveç shqyrtimit gjyqësor të provave, LGJA rregullon gjithashtu çështjen e gjykimit dytësor të ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ, në bazë të të cilit është nxjerrë apo kryer veprimi. Në këtë rast gjykata administrative do të vazhdojë shqyrtimin e çështjes pa marrë në konsideratë aktin administrativ apo aktin nënligjor normativ edhe nëse gjykimi parësor i aktit sipas këtij ligji nuk është në kompetencën tokësore apo lëndore të saj. Përsa i përket rregullave lidhur me gjykimin incidental të ligjshmërisë me kërkesë të gjykatave të tjera, ligji i referohet disa momenteve kryesore të cilat lidhen me:

**a.** përcjelljen e çështjes Gjykatës së Apelit Administrativ nga ana e gjykatës jo administrative, kur konstatohet se zgjidhja e çështjes jo administrative varet nga një akt nënligjor normativ. Në këtë rast Gjykata e Apelit Administrativ duhet të shprehet vetëm për ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ.

**b.** afatin 15 ditor brenda të cilit duhet të shprehet Gjykata e Apelit Administrativ, vendimi i së cilës ka fuqi vetëm *inter partes* dhe ndaj tij mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë, ankim i cili nuk e pezullon gjykimin në gjykatën përkatëse ku është ngritur mosmarrëveshja;



c. konstatimin e paligjshmërisë së aktit nënligjor normativ nga gjykata më e lartë dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes nga gjykata në të cilën ka lindur mosmarrëveshja, e cila vendos pa u bazuar në aktin nënligjor normativ të paligjshëm.

d. investimin e gjykatës më të lartë me një kërkesë tjetër sipas rastit të parë me të njëjtin objekt dhe akt nënligjor normativ për të cilën është shprehur më parë.

LGJA përcakton gjithashtu, rastet e dhënies së vendimeve jo përfundimtare nga gjykata, kur vendoset rrëzimi i padisë, duke iu referuar dispozitave konkrete të këtij ligji dhe atyre të Kodit të Procedurës Civile.

Ky ligj parashikon gjithashtu në mënyrë mjaft të detajuar disponimin e gjykatës me anë të vendimeve përfundimtare, kur ajo vendos të pranojë padinë si të bazuar në prova dhe në ligj. Lidhur me vendimin përfundimtar, gjykata ka të drejtë të anulojë aktin administrativ, ta konstatojë atë të pavlefshëm dhe/ose t'i imponojë gjykimin e vet autoritetit administrativ (organit publik), por vendim-marrësi duhet ta rimarrë vendimin dhe kësaj radhe sipas ligjit sikundër është shpallur nga gjykata. Kur lëshimi i aktit është i detyruar me ligj, gjykata ka të drejtën të urdhërojë nxjerrjen e një akti apo përmbushjen e një detyre të caktuar. Kjo sigurisht nuk duhet të përjashtojë të drejtën e gjykatës për të modifikuar aktin dhe për të sqaruar të drejtat dhe detyrimet e palëve në një marrëdhënie në konflikt pa pasur nevojë për kthim mbrapsht (për shembull, gjykata duhet të ketë të drejtën të vendosë që sasia e një gjobe që kontestohet është më e ulët se ajo që është përcaktuar nga administrata).

Në dispozitën konkrete lidhur me vendimet përfundimtare, specifikohen edhe rastet e tjera kur gjykata vendos pranimin, rrëzimin apo shqyrtimin e padisë si p.sh:

- rasti kur barra e provës sipas këtij ligji i takon organit publik;
- rasti i shqyrtimit të padive të subjektit publik;

- rastet e tjera kur gjykata vlerëson se akti apo veprimi tjetër administrativ si dhe akti nënligjor normativ janë të ligjshëm, etj.

Ligji përcakton gjithashtu një afat të përgjithshëm prej 10 ditësh si afat për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës, në raste të veçanta dhe të justifikuara përcaktimin e një afati më të gjatë. Në pjesën urdhëruese të vendimit përfundimtar gjykata duhet të përcaktojë afatin dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit përkatës.

Përsa i përket ankimimit të vendimeve të gjykatave administrative, ligji parashikon që mjetet dhe afatet e ankimit të këtyre vendimeve do të jenë të njëjta me ato që parashikohen në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në LGJA apo ligje të veçanta.

Lidhur me vendimet e gjykatës administrative që shqyrtojnë padi për kundërshtimin e kundravajtjeve administrative me vlerë më të vogël se 3 fishi i pagës minimale në shkallë vendi, ligji përcakton ndalimin e shprehur të ankimit ndaj vendimeve të tilla.

Ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, parashikohet për të gjitha vendimet e seksioneve të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj. Gjithashtu, ligji përcakton afatet konkrete që duhet të zbatohet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit Administrativ për dërgimin e ankimit dhe shqyrtimin e çështjes përkatëse. Konkretisht, ligji parashikon dërgimin e ankimit dhe dosjes përkatëse, në Gjykatën e Apelit Administrativ brenda 15 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit si dhe shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Apelit Administrativ brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.

Si mjet tjetër të së drejtës së ankimit, LGJA parashikon ankimimin me rekurs në Gjykatën e Lartë për vendimet e shpallura nga Gjykata e Apelit Administrativ, sipas dhe për shkaqet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Një rol të rëndësishëm në LGJA i kushtohet edhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave administrative, ku parashikohet detyrimi për ekzekutimin e vendimit dhe ekzekutimi i detyrueshëm. Përsa i përket detyrimit për ekzekutimin e vendimit, në ligj parashikohet vënia në ekzekutim e vendimeve të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë që ka marrë formë të prerë, rregullat dhe afatet konkrete për ekzekutimin e tyre si dhe pavlefshmërinë e akteve apo veprimeve të organit publik të paditur të cilat janë në kundërshtim me dispozitivin e vendimit të gjykatës.

Gjithashtu, parashikohet rregullimi i ekzekutimit të detyrueshëm, i cili është i aplikueshëm në rastet kur nuk është bërë zbatim i vendimit të gjykatës nga ana e organit publik. Në këtë rast, gjykata merr masa për të siguruar ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit nga ana e përbaruesve gjyqësorë nëpërmjet kryerjes së veprimeve të posaçme apo marrjes së masave të nevojshme.

Lidhur me procedurën e ekzekutimit, ligji parashikon rregullat konkrete që do të ndiqen për vënien në ekzekutim të vendimeve të gjykatave administrative (nëse vendimi nuk është ekzekutuar pas kalimit të afatit 10 ditor për ekzekutimin vullnetar), sanksionet përkatëse për moszekzekutimin e vendimit apo urdhrin të gjykatës si dhe masat e gjobave janë në raport me pagën minimale në shkallë vendi.

Gjithashtu, përcaktohet rasti i kundërshtimit të veprimeve të ekzekutimit, për veprimet e kryera nga ana e përbaruesit gjyqësor në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, të cilat mund të ankimohen sipas dispozitave të KPrC apo të kundërshtohen me ankim të veçantë pranë Gjykatës së Apelit Administrativ.

LGJA përmban përcaktime tranzitore, të cilat lidhen me fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ.

Konkretisht, për çështjet administrative të cilat aktualisht janë në proces gjykimi në gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit deri në momentin e fillimit të funksionimit si më sipër, LGJA parashikon shqyrtimin dhe përfundimin e tyre nga gjykata ku është ngritur padia.

Ligji i miratuar përmbush angazhimet e marra nga qeveria shqiptare, lidhur me reformimin e kuadrit të përgjithshëm ligjor administrativ në vendin tonë si dhe krijimin e një sistemi të ri gjyqësor administrativ në përputhje me standardet europiane.

LGJA kur ka qenë në fazën e Projekt-Ligjit së bashku me relacionin shoqërues i është dërguar për mendim shumë institucioneve si psh Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Ministrit të Integritit, Ministrit të Financave, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrit të Brendshëm, Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, Konferencës së Gjyqtarëve të Shqipërisë, Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, etj.

Pas shumë kohësh, ai u miratua nga Parlamenti, mban Nr. 49/2012 dhe më dt. 04.11.2013 ka nisur punën Gjykata e Parë Administrative në vend.

## REKOMANDIME

Pas studimit të të gjithë argumenteve që kanë të bëjnë me Gjykatën Administrative dhe gjithshka tjetër që vërtitet rreth saj, ne mund të arrijmë në rekomandimet përkatëse. Pavarësisht problematikave që mund të lindin, modeli i një juridiksioni autonom siç është ngritja e Gjykatës Administrative, mundëson “rregulla loje” të ndershme për të gjitha palët në proces. Konkretisht, po rendis disa rekomandime në të cilat kush e gjen veten le t’i zbatojë në mënyrë që veprimet e ne të gjithëve të kontribuojnë për përsosje të mëtejshme të gjyqësisë administrative.

Për subjektet e gjykimit administrativ: Rekomandohet zbatimi i rregullave të detyrueshme për subjektet e gjykimit administrativ, organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore administrative si dhe organizimin e gjykatave administrative.

Për gjykatat administrative: Rekomandohet garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Rekomandohet zbatimi i parimit se Gjykata Administrative gjykon mbi aktet shkresore dhe mosparaqitja e palëve nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit.

Për gjykatat administrative dhe përmbauesit gjyqësorë: Rekomandohet të krijohen kushtet e përshtatshme për një shqyrtim efektiv duke vënë në vend të drejtat e cënuara nga veprimet dhe/apo aktet administrative të nxjerra nga organet publike. Rekomandohet thjeshtimi i procedurave përkatëse lidhur me gjykimin dhe

ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative ndërmjet personave dhe organeve publikë.

Për organet administrative: Rekomandohet forcimi i rolit aktiv të organeve administrative për respektimin e të drejtave subjektive të personave nëpërmjet detyrimit që i vihet organeve publike të provojnë ligjshmërinë e formës dhe të përmbajtjes së veprimit administrativ të nxjerrë prej tyre. Rekomandohet si risi në kuadrin e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative lidhur me detyrimin e organeve publike për të paraqitur provat që kanë mundur nxjerrjen e akteve apo kryerjen e veprimeve administrative që më pas kanë sjellë cënimin e të drejtave të ligjshme të personave. Rekomandohet dhënia e sigurisë në të gjitha format që çdo qytetar pavarësisht situatës së tij financiare, të ketë akses në drejtësinë administrative. Rekomandohet domosdoshmëria e barazisë së interesit publik nga njëra anë me të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të personit nga ana tjetër.

Për Ministrinë e Drejtësisë dhe legjislatorin: Rekomandohen ndryshime në legjislacionin e fushës administrative. Sidomos ndryshimet duhet të reflektojnë një reformë të plotë të rregullave procedurale përsa i takon çështjeve administrative të cilat duhet të shqyrtohet me hollësi, duke përfshirë edhe një ripërkufizim të objektit të juridiksionit administrativ.

# BIBLIOGRAFIA

## ➤ Legjislacioni

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, Fletore Zyrtare, Nr. 28, datë 7.12.1998;
2. Kodi i Procedurës Civile, miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 ndryshuar me ligjin nr. 1052, datë 29.12.2008;
3. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Proçedurave Administrative*”, Fletore Zyrtare, Nr.19, datë 20.07.1999;
4. Ligjit Nr.8480, datë 27.5.1999 “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike*”, Fletorja Zyrtare Nr.19 datë 20.7.1999.
5. Ligji “*Për kundravajtjet administrative*”;
6. Ligji “*Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”;
7. Ligji Nr. 49/2012 “*Organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”;
8. Dekreti i Presidentit nr. 1501, datë 29 maj 1996 “*Mbi Krijimin e Seksioneve Administrative, Tregtare dhe Familjare në Gjykatat e Rrethit*”;
9. *Rekomandimi për Shqyrtimin Gjyqësor të Akteve Administrative*, 15 dhjetor 2004 i Këshillit të Ministrave të Këshillit European;
10. Rezoluta(77) 31 “*Për mbrojtjen e individëve lidhur me aktet administrative* “ adoptuar nga Komiteti i Ministrave në 28 shtator 1977;

## ➤ Literaturë në shqip

1. American Bar Association ABACEELI, 25 qershor 1996, “*Punim për konceptin e gjykatave të specializuara*”, Tiranë;
2. Anastasi, A, 2009, “*E drejta Kushtetuese e Krahasuar*”, Shtëpia Botuese “Dajti 2000”, Tiranë;
3. Çomo, J, 1983, “*E drejta Administrative e Republikës së Shqipërisë*” botim i librit të tretë, Tiranë;
4. Dobjani, E, 2007, “*E Drejta Administrative I*”, Shtëpia botuese “Perlat Voshtina”, Tiranë;
5. Dobjani, E, 2013, “*Kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë administrative*”, Tiranë;
6. Floqi, K, 1923 “*Administrata ose E Drejta Sundimore*” Pjesa e përgjithshme, Shtypshkronja Vlora;
7. Grup autorësh (Ermir Dobjani, Elsa Toska, Erlir Puto, Erajd Dobjani), 2013, “*E drejta administrative (Kontrolli mbi Administratën Publike)*”, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë;
8. Leskoviku, M, 2013, Leksion për studentët e Doktoraturës “*Hapësira Administrative Europiane (HAE). Globalizimi dhe e drejta Administrative*”, Tiranë;
9. Mustafaj, A, 2012, “*Leksionet e së drejtës administrative të krahasuar*” Tirane;
10. Omari L, Anastasi A, 2010, “*E Drejta Kushtetuese*”, Tiranë;
11. Raporti Final i Konventës Kushtetuese Austriake - Pjesa 3 “*Endbericht des Oesterreichischen Verfassungskonvents -Teil 3*”



12. Raporti i Aktivitetet të Gjykatës së Lartë Austriake Administrative, 2004  
“*Taetigkeitsbericht des Oesterreichischen Verëaltungsgesichtshofs 2004*”
13. Sadushi.S, 1999, “*Teoria e aktit administrativ*”, Shtëpia botuese ILIRIA,  
Tiranë;
14. Sadushi, S, 2004, “*E Drejta Administrative*”, “Toena”, Tiranë;
15. Sadushi, S, 2008, “*Komentari i Kodit të Procedurave Administrative*”,  
Toena, Tiranë;
16. Sadushi, S, 2008, “*E drejta administrative 2*”, Shtëpia botuese “  
BOTIMEX”, Tiranë;
17. Sadushi, S, 2014, “*Gjykata Administrative dhe kontrolli Ligjor mbi  
Administratën*”, Botimet “Toena”, Tiranë;
18. Stavileci. E; Batalli. M; Sadushi. S; 2012, “*E Drejta Administrative*”,  
Shtëpia botuese “NSHG XPRINT”, Prishtinë;
19. OSCE, 2008, “*Pavarësia e gjyqësorit, analize juridike*”, Tiranë;
20. OSBE dhe BE, 2011, “*Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në  
Europë: Drejt një Modeli të Përbashkët*”, i redaktuar SIGMA, Tiranë;
21. Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë, prezenca ne  
Shqiperi, 2009, “*Analise e sistemit ligjor ne Shqiperi*”, Tiranë.
22. *Rekomandim mbi modelet e ndryshme të riorganizimit të gjykatave të  
rrethit*” i EURALIUS;
23. Studim i Ministrisë së Drejtësisë “*Mbi riorganizimin e gjykatave të  
shkallës së parë*”, datë 9 mars 2004.

➤ **Literaturë e huaj**

1. Benvenuti, F, 1952, “*Funzione amministrativa, procedimento, processo*”,  
Rivista Trimestrale del diritto pubblico, Bologna;
2. Casetta, E,1999, “*Manuale del Diritto Amministrativo*”, Giuffrè Editore,  
Milano;
3. Cassese, S, 2012, “*Corso di Diritto Amministrativo*”, “*Instituzioni di Diritto  
Amministrativo*”, quarta edizione, Giuffrè Editore, Varese, Milano;
4. Chapus, R. 1998, “*Droit administratif general Tome I*”, Montchrestien, Paris;
5. Cane, P, 1997, “*An Introduction to administrative law*”, London;
6. G.Caia, V.Caputi Jambrenghi, V.Domenicheli, F.Follieri, G.Greco,  
R.Marrama, L.Mazzaroli, C.Mignone, G.Morbidelle, G.Pericu, A.Romano,  
A.Romano Tassone, F.A. Roversi Monaco, F.G.Scoca, R.Villata, 1999,  
“*Diritto Amministrativo II*” Terza Edizione, Monduz E.Casetta, “*Manuale del  
Diritto Amministrativo*”, Giuffrè Editore, Milano;
7. Galligan, 1996, “*Discretionary powers*”, Firenze;
8. Giannini, Severo. M., 1998, “*Diritto Amministrativo II*”, Giuffrè Editore,  
Milano;
9. Irelli, Vincenzo.C., 1997, “*Corso di diritto amministrativo*”, G.Giappichelli  
Editore, Torino;
10. Giuseppe Ugo Rescigno, 2008, “*Corso di diritto pubblico*”, undicesima  
edizione, Editore “Tipografia Babina”, Bologna;
11. Lavagna C.,1956, “*Considerazioni sui caratteri degli ordinamenti  
democratici*” Rivista trimestrale del Diritto Pubblico, Roma;
12. Ministria Daneze e Drejtësisë

13. Ministria Austriake e Drejtësisë
14. Ministria Finlandeze e Drejtësisë
15. Ministria Suedeze e Drejtësisë
16. Ministria Lituaneze e Drejtësisë
17. Ministria Letoneze e Drejtësisë
18. Ministria Estoneze e Drejtësisë
19. OKB, 1985, “*Basic principles on the independence of the Judiciary*”, held in Milano, from August 26 till September 6;
20. Sandulli, M., 1989, “*Manuale del Diritto Amministrativo*”, Editore “Jovene”, Napoli;
21. S. Rose-Ackerman and P. L. Lindseth, 2010, “*Comparative Administrative Law*”, Printed and bound by MPG Books Group, UK;
22. Eade&Forsyth, 1998, “*Administrative law*”, Publisher: Oxford University Press, London;
23. Woehrling, Jean-Marie, “*Kontrolli Gjyqësor i Autoriteteve Administrative në Europë: Drejt një modeli të përbashkët*”, i redaktuar nga SIGMA (një iniciativë e përbashkët e OSBE-së dhe BE-së).

➤ **Vendime të Gjykatave Vendase dhe të Huaja**

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.231, dt.22.11.2002;
2. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 75/2002;
3. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 76/2002;
4. Vendimi Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.25, datë 28.03.2003 ;
5. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr.17/2004;
6. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 39, dt. 16.10.2007;
7. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 17, dt. 12.11.2014.
8. Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Nr. 296-B, Seria A, dt. 24.09.1994, “Beaumartin kundër Republikës së Francës”;
9. Vendim i Gjykatës Europiane të Drejtësisë Nr.110/10,d t . 13.12.2000,2003/5/EC, “Solvay v Komisionit European”;

➤ **Web site**

1. Faqet e internetit të gjykatave të Tiranës dhe Shkodrës;
2. Faqja e Misionit Europian te Asistencës për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë;
3. Faqja zyrtare e Gjykes se Larte: [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al);
4. [http// www.eurallus.org.al](http://www.eurallus.org.al);
5. Indeksi i reformes gjyqesore ne Shqiperi(Organizata e Juristeve Amerikan,prezenca ne Shqiperi);
6. Qendra e publikimeve zyrtare: [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al);
7. Shqipëria në Shifra / Albania in Figures 2005 – Instat;
8. Shoqata e Këshillave të shtetit dhe juridiksioneve administrative supreme të Bashkimit Europian: [http://193.191.217.21/en/home\\_en.htm](http://193.191.217.21/en/home_en.htm)
9. Statistikori i Ministrisë së Drejtësisë, 2002-2006.
10. <https://www.law.berkeley.edu/library/robbins/CommonLawCivilLawTraditions.html> dt. 31 Janar 2015

**© E drejta e autorit: Pranvera Xhafaj**

*Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cënues me çfarëdo lloj mjete apo forme pa lejen përkatëse me shkrim të autores.*